

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXVIII nr. 89 / 2009

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore

Viti XXXVIII nr. 89 - 2009

Botues:

Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës

Prishtinë, rr. Vellusha nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-024

e-mail: **edukataislame@hotmail.com**

Kryeredaktor:

Mr. Qemajl Morina

qemajlmorina@hotmail.com

Redaksia:

Akad. Jashar Rexhepagiq, Dr. Pajazit Nushi,

Dr. Fejaz Drançolli, Dr. Ejup Sahiti, Nexhat Ibrahim, i,

Hajrullah Hoxha dhe Xhabir Hamiti.

Sekretar i redaksisë:

Hajrullah Hoxha

Lektor:

Bislim Berisha

Korrektor:

Skender Rashiti

Realizimi: Shtëpia Botuese



Redaktor teknik &

Operator kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtyp: Koha - Prishtinë

Tirazhi: 1000

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XXXVIII nr. 89 / 2009

Prishtinë
2009

EDITORIALI

Qemajl Morina

MEHMET AKIF ERSOJI NË FAQET E REVISTËS
“ERR-RRISALE” TË KAJROS

Të rralla janë ato figura, të cilat gërsheojnë marrëdhëniet tradicionalisht të mira mes popullit shqiptar dhe atij turk, siç e bëri këtë poeti ynë i madh Mehmet Akif Ersoj. Ai u mishërua me Kosovën, vendlindjen e babait të vet, të cilës ia kushtoi njëren prej poezive të tij më të mira, “Unë jam shqiptar!”¹ (Beni Arnavudum), ku thotë:

Kudo që gjendem më parafytyrohet si fantazma

Një fushë e përgjakur.

A je ti e vërtetë apo parafytyrim?

E shkreta Kosovë?

Për të vazhduar:

“Dëgjojeni këtë prej meje, që vërtet, jam shqiptar...”

Gjë tjetër s’mund të them... Ja, atdheu im është rrënuar.

¹ Safahat, fq.206, marrë nga artikulli: “Me sy kah vendlindja”, i autorit Hajrullah Halit Aktur, (Rilindja), 28 korrik 1979, fq. 20, Prishtinë. Shih poashtu:

- Dr. Skender Rizaj, Shqiptari Akif Mehmeti – poeti më i madh i letërsisë turke, (Fjala), Prishtinë, 1 tetor 1984, fq.10.

- Dr. Skender Rizaj, Shqiptari Akif Mehmeti – poeti më i madh i letërsisë turke, (Bujku), Prishtinë, 17 dhjetor 1994, fq.11.

- Shyqri Nimani, Poeti i madh Akif Mehmet Pejani, “Ekskluzive” (revistë mujore për aktualitet, kulturë, shkencë, sport, Prishtinë, nr.25, maj 2002, fq.93-96.

Po ashtu, ai u mishërua me Turqinë, atdheun e tij, për të cilën shkroi tekstin e himnit kombëtar që mban titullin: “Marshi pavarësisë” (Istiklal Marsh)².

“Nuk shuhet flamuri i kuq që valëvitet në këto troje,

Pa u shuar oxhaku i fundit që tymon mbi vendin tim;

Ai është ylli i kombit tim, do të ndriçojë,

Ai është i imi, ai është vetëm i kombit tim!”

Prej kësaj shohim se sa ishte i lidhur ngushtë Mehmet Akifi me fatin e Kosovës, por edhe me fatin e të gjitha trojeve shqiptare. Kështu më 21 shkurt të vitit 1922, ai shkruan:

Ngrehu baba, ngrehu nga varri !

Dhe shih se për qefin e tri vetave kokëkrisur,

Si vritet një popull tre milionësh!

Eja shpejt, sepse të gjallët nuk po vijnë

Të shpëtojnë atdheun tonë...

Shqipëria po digjet flakë..

Baba! Nëna jote më e dashur, që është atdheu yt,

Vendlindja jote po flijohet

Për ambiciet e tre vetave kokëtrashë!

Tokë e lëvruar nga gjyshërit tanë

Dhe arat e mbjella po i merr lumi...

Sa keq, që tashmë po ngulitet në tokë kryqi i të huajit...

Dhe të vallëzojë në të këmba e sqaut (ushtarit serb)...

*Oh! Kudo më del përpara Kosova!*³




Mehmet Akif Ersoj (1873-1936)

² Mehmet Akif Ersoj, Fletët (Safahat), Logos A, Shkup, 2006, fq.568.

Mehmet Akifi në Kajro

Ashtu siç përmendet në biografinë e tij, Mehmet Akif Ersoj, pjesën e fundit të jetës së tij e kaloi në Egjipt. Për herë të parë shkoi në muajin tetor 1923, bashkë me princin Abbas Halim Pashën, nga dinastia shqiptare dhe si i ftuar i tij. Aty kaloi dy dimrat e viteve 1923 dhe 1924, pastaj bashkë, me Pashanë, u kthyen në Stamboll në pranverën e viteve 1924 dhe 1925. Pas vajtjes së fundit më 1925, nuk u kthye deri më 1936.



Mehmet Akifi, i dyti nga e majta me disa miq në vizitë piramidave

Gjatë qëndrimit të tij në Kajro, banoi dy vjet në një vilë të vogël të caktuar për të që ndodhej përballë sarajit të Abbas Halim Pashës në kasabanë e Hilvanit, jashtë Kajros, kurse pasi e pati sjellë familjen, pati marrë me qira një shtëpi të vogël në një skaj të Hilvanit.⁴

³ Nexhip Alpan, marrë nga "Drita Islame" (organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë), Tiranë, nr. 1 (84) 1996.

⁴ Mehmet Akif Ersoj, Fletët (Safahat), Logos - A, Shkup, 2006, fq.58.

Pas ardhjes së dytë në Kajro, Mehmet Akifi, me propozimin e kolegut dhe mikut të tij, dr. Abdul Vehab Azzam, u inkadrua në Universitetin e Kajros, në Fakultetin Filologjik, profesor i Gjuhës dhe Letërsisë turke⁵. Këtë profesion ai e kreu deri në vitin 1936, do të thotë për më shumë se dhjetë vjet me radhë. Kjo shihet edhe nga të dhënat e profesorëve, të cilat gjenden në Arkivin e Fakultetit të Filologjisë, të Universitetit të Kajros.⁶ Po ashtu kjo shihet edhe nga poezitë e tij të botuara në përmbledhjen e tij "Safahat", duke filluar me poezinë "Me Faronin sy më sy", e cila mban datën e 23 dhjetorit 1923 e deri në vitin 1926, përveç datës, autori shënon edhe vendin Hilvan, lagjeje e Kajros. ku banonte Mehmet Akifi.⁷

Vendosja e Mehmet Akifit në Kajro, në atë kohë si duket ishte një zgjidhje kompromisi, në rrethanat e krijuara në atë kohë në Turqi, si shkak i një seri reformash që ishin ndërmarrë në atë kohë nga pushteti i ri. Mehmet Akifi, si një mendimtar i kalibrit të lartë islam nuk mund të pajtohej me një veprimtari të tillë. Andaj, largimi i tij në Egjipt, ku kishte përkrahjen morale dhe materiale të dinastisë shqiptare, përkrahjen e rezervave të kolonisë shqiptare, por edhe të inteligjencës egjiptiane, të cilët e çmonin lart veprimtarinë e tij letrare, mu për këtë edhe e angazhuan në Universitetin e Kajros. Në të njëjtën kohë, Kajroja ishte një qendër e madhe dhe me rëndësi e mendimit islam. Me një fjalë Mehmet Akifi, në një mënyrë apo tjetër, kishte zgjedhur një lloj azili politik në atë kohë. Kurse në Kajro kishte gjetur një ambient të përshtatshëm për vazhdimin e krijimtarisë së tij letrare.

Mehmet Akifin, në atë kohë e mbante shpresa se Turqia, e cila ishte i vetmi shtet islam i pavarur dhe kishte mbetur i lirë, do të përpiquej pas kësaj, për t'i zgjuar kombet tjerë myslimanë të robëruar. Mirëpo, fakti që shteti i porsaformuar, duke u kthyer krejtësisht nga

⁵ الرسالة العدد 187 1 فبراير 1937 السنة الخامسة القاهرة ص 181

Ua prezantova profesorëve të Fakultetit Filologjik, poetin e madh, ata e zgjodhën ta ligjërojnë gjuhën dhe letërsinë turke. Ishte i dashur dhe i respektuar si tek profesorët, por edhe tek studentët.

⁶ Këto të dhëna i kam vërtetuar gjatë një hulumtimi që kam bërë në Arkivin e Fakultetit të Filologjisë në vitin 1978, kur isha në studime pas diplomike (1976-1979).

⁷ Safahat, shih: prej faqe 517 – 584, botimi shqip i Logos-A, Shkup 2006.

Evropa, e kishte braktisur botën islame, nuk ishte diçka që mund të pranonte Mehmet Akifi. Prandaj, duke e braktisur vatanin për besnikërinë ndaj të cilit kishte bërë titull me zë të lartë të Marshi i Pavarësisë, ishte tërhequr në pasivitet.⁸

Poeti i Islamit⁹ në faqet e revistës “Err-rrisale” të Kajros

Prezenca e tij në metropolin e Egjiptit, në veçanti angazhimi i tij profesor i Gjuhës dhe letërsisë turke në Universitetin e Kajros, kishin ndikuar që krijimtaria e tij letrare të jetë më shumë prezentë në shtypin egjiptian të kohës. Kështu shohim që nga vendosja e tij në Kajro botimin e pjesëve të zgjedhura të poezive të tij në shtypin e Kajros. Pjesa më e madhe e tyre në revistën “Err-rrisale”¹⁰ (Misioni). Botohet edhe pjesa e parë e veprës së tij “Safahat” në vitin 1353 h apo 1933, një kopje të së cilës ia kishte dhurua në shenjë kujtim Hasan ef. Nahit, i cili në atë kohë gjendej në studime në Universitetin e El-az-harit” në Kajro, që tregon për lidhjet e vazhdueshme që mbante Mehmet Akifi me shqiptarët.

Me këtë rast vlen të theksohet se nën rubrikën e rregullt, të cilën e mbante dr. Abdul Vehab Azam, hasim shumë poezi të përkthyer në shumë numra të revistës “Err-rrisale”. Prej tyre po përmendim: “Fyelltari



Faksimil i nënshkrimit të Mehmet Akifit, në librin Safahat, dhuruar Hasan ef. Nahit gjatë studimeve në Kajro më 1933

qorr”¹¹. Përkthimit i paraprin një hyrje nga dr. Abdul Vehab Azzam. Pastaj, vijnë poezitë “Sejfi Baba”¹², “Artisti”¹³ etj.

Por, ajo që zgjon kërshërinë e lexuesit, janë disa shkrime që u botuan pas vdekjes së poetit, të cilat kanë të bëjnë me jetën dhe veprimtarinë e tij. Autor i këtyre shkrimeve është kolegu dhe miku i tij i ngushtë, gjatë qëndrimit të Mehmet Akifit në Kajro, dr. Abdul Vehab Azzam. Andaj, në faqet në vijim do t'i bëjmë një vështrim të shkurtër disa artikujve, që janë botuar në revistën “Err-rrisale, të cilët janë të lidhur ngushtë me jetën, veprimtarinë, por edhe botën e brendshme të poetit, në dekadën e fundit të jetës së tij në Kajro.

Mehmet Akifi - poet i Islamit

Nën këtë titull, dr. Abdul Vehab Azam nis shkrimin e tij, për të vazhduar pesë vazhdimet për Mehmet Akifin.¹⁴

“Kisha lexuar emrin e Mehmet Akifit në mesin e shkrimtarëve më të njohur bashkëkohorë të letërsisë turke, por kisha pasur rastin të njihem me një pjesë shumë të vogël të veprimtarisë së tij poetike. Kur para shtatë vjetëve, kisha shkuar në Stamboll, Mehmet Akifi ishte vendosur në Egjipt. Ky rast më mundësoi të njihem për së afërmi me biografinë dhe veprimtarinë e tij, gjë që u bë më i dashur tek unë. Po- sa u ktheva në Egjipt shkova ta vizitoj. Ishte fat i mirë që ai ishte vendosur pranë meje në Hilvan, mysafir i princit Abas Halim Pashës.

Shkova në shtëpinë e tij, trokita në derë dhe ja para meje del një njeri që kishte kaluar të gjashtëdhjetat, me një trup të drejtë, ku dukeshin shenjat e modestisë dhe të pjekurisë. Më dëshiroi mirëseardhje. Hyra brenda u ula. Biseduam për një kohë, duke hapur me këtë një fazë të re të miqësisë mes nesh.

⁸ Safahat (Fletët), Logos – A, Shkup, 2006, fq.59.

⁹ Autori thotë se kështu quhej në Turqi Mehmet Akifi.

¹⁰ Revistë javore prestigjioze për letërsi dhe kulturë ku u botuan shumica e poezive të Mehmet Akifit, u botua në Kajro për afër 20 vjet me radhë.. Kryeredaktor i saj ishte shkrimtari i njohur egjiptian Ahmed Hasen Ez-zajat (1885-1968).

¹¹ Err-rrisale, Kajro, nr.9, 16 maj 1933, fq.29.

¹² Ibid, nr. 12, 1 korrik 1933, fq.27.

¹³ Ibid. nr. 18, 1 tetor 1933, fq .30-32.

¹⁴ Err-rrisale nr.187, 1 shkurt 1337, fq.181.

Miku im ishte i marrueshëm, fjalëpak, mendonte gjatë, heshte shumë, anonte në izolim, i ikte tubimeve të mëdha. Kjo më kishte bërë që gjithherë ta gjej në shtëpi dhe të bisedoj gjatë me të.”

“Vizitat tona ishin të shpeshta. Më vizitonte apo e vizitoja. Bisedonim gjatë për të kaluarën dhe të tashmen. Biseda kalonte në tema të ndryshme, si letërsi, histori dhe gjendjen aktuale të myslimanëve. Kur i pëlqente biseda kërkonte nga bashkëbiseduesi të vazhdojë, kurse ai dëgjonte me vëmendje. Kurse nëse në mexhlis merrte pjesë edhe dikush tjetër, ai heshte nga modestia dhe marrja. Kur kërkoja prej tij që ai ta merrte fjalën, lëvizte kokën duke refuzuar të bëjë një gjë të tillë. Nëse përgjigjej këtë e bënte shumë shkurt pastaj i kthehej heshtjes. Kur përfundonte mexhlisi, ai më shprehte mua përshtypjet e tij, i pajtuar apo jo, i kënaqur apo i nervozuar.”

Në vazhdimin e dytë¹⁵ ai boton një shkrim që dhëndri i tij Omer Rida kishte botuar në shtypin turk në muajt e fundit, pas keqësimit të gjendjes së tij shëndetësore.

Në vazhdimin e tretë¹⁶ autori shkruan një artikull të gjatë, ku përfshin shkrimet e të gjitha gazetave të Turqisë që kishin shkruar me rastin e vdekjes së Mehmet Akifit, duke e përfshirë edhe një biografi të tij. Ai fillon shkrimin me këto fjalë: “Vdiq poeti i madh në orën tetë pa një çerek të mbrëmjes të ditës së enjte të 29 dhjetorit, duke i lënë popullit turke vepra të pavdekshme si “Mbrojtja e Cana kalas” dhe “Himnin e pavarësisë”.

Mehmet Akifi kishte një respekt të madh ndaj shumë poetëve, prej arabëve ibnu al-Farid, prej turqve Fudulin, prej persianëve Sadiun, kurse prej francezëve La Martinin.

Në vazhdimin e katërt¹⁷. Dr. Abdula Vehab Azzam, i bën një analizë të veçantë poezisë së Mehmet Akifit, në mënyrë të posaçme veprës së tij më të njohur “Safahat”, duke filluar prej numrit të parë të saj deri te i shtati.

Në vazhdimin e pestë¹⁸, autori i bën një vështrim një lloj poezie tjetër të Mehmet Akifit, të cilën ai e quan poezi shoqërore, që ishte prezente në veprimtarinë letrare të poetit tanë të njohur.

Besoj se studimi dhe hulumtimi i poezisë së Mehmet Akifit në revistën “Err-rrisale” të Kajros do të sjellë risi të reja dhe do ta begatojë veprimtarinë e tij të gjithmbarshme letrare.

¹⁵ “Err-rrisale”, nr.188, 8 shkurt 1937, fq.226.

¹⁶ “Err-rrisale”, nr.189, 15 shkurt 1937, fq.267.

¹⁷ “Err-rrisale”, nr.194, 22 mars 1937, fq.469.

¹⁸ “Err-rrisale”, nr.220, 10 maj 1937, fq.782.

Qemajl Morina

MEHMET AKIF ERSOY IN THE PAGES OF THE “ER-RISALE” CAIRO MAGAZINE

(Summary)

Personalities, such as our great poet, Mehmet Akif Ersoy, who are a symbol of the traditionally friendly relations between Albanians and Turks, are not that common. He dedicated one of his best poems “I am Albanian” (Ben Arnavudum), to his father’s homeland (Kosova):

Wherever I go I see the image of...

... a bloody field.

Is it you or a vision?

Poor Kosova?

“Hear this from me, who am myself an Albanian...

I say no more... alas my afflicted country.

كمال مورينا

محمد عاكف ارسوى على صفحات مجلة "الرسالة" القاهرية (خلاصة البحث)

من النادر ان تجد شخصيات في التاريخ الطويل الالباني – التركي تصور العلاقات الحميمة بين الشعبين الالباني و التركي مثل ما فعل ذلك الشاعر الكبير محمد عاكف ارسوي. هو أحب كوسوفا مسقط راس والده و قد أهدى لها احدى اجمل قصائده "أنا الباني" (Beni Arnavudum) حيث يقول:

في أي مكان اسير فيه يتخيل إلى كطيف

ساحة ملطخة يدماء

هل أنت حقيقة ام خيال؟

كوسوفا المسكينة؟

و يستمر:

اسمعوا هذا مني لاننى الباني

لا استطيع ان اقول شيئا آخر

أنت وطنى المدمر.

AKAID

Nexhat Ibrahim

IMAM EL-ESH'ARIU
- mësuesi i madh i kelamit sunit
(260-324 h./873-935)

I. Jeta e Imam El-Esh'ariut dhe rrethanat shoqërore

Në kohën kur jetoi Imam El-Esh'ariu jetuan edhe dy dijetarë të tjerë të mëdhenj myslimanë, Imam Tahaviu (229-321 h./ 843-933) dhe Imam Maturidiu (238- 333 h./853-944), të dytë pasues të shkollës hanefite. Që të tre këta dijetarë përbëjnë trekëndëshin e famshëm, tri shtyllat kryesore dhe më të fuqishme të drejtimit sunit (të ehl'is-sunnetit dhe xhematit).

Përkundër faktit se El-Esh'ariu bën pjesë në mesin e dijetarëve më të mëdhenj myslimanë, megjithatë jeta e tij nuk është e njohur sa duhet. Një arsye për këtë qëndron në faktin se biografitë me famë si Et-Taberiu dhe El-Mes'udi nuk flasin për të, kurse El-Bagdadi dhe Ibn Hal-likani krejt kalimthi e theksojnë emrin e tij. Vetëm Ibn Asakiri (vd. 571 h./1175) do t'i kushtojë një vëmendje më të theksuar El-Esh'ariut. Ai madje paraqitjen e El-Esh'ariut e lidh me hadithin e njohur të Muhammedit a.s. se në çdo shekull do të paraqitet dijetari, i cili do të jetë lavdia e Islamit. Mirëpo, shkencëtarët i bëjnë vërejtje Ibn

Asakirit sepse kur flet për El-Esh'ariun së tepërmi mbështetet në traditën gojore dhe së tepërmi e glorifikon atë.¹

Emri i plotë i El-Esh'ariut është Ebu'l-Hasan Ali ibn Ismail ibn El-Bishr Is'hak.² U lind në qytetin e njohur irakian Basra në vitin 260 hixhrij apo 873 gregorian.³ Atë kohë, bashkë me Bagdadin, Basra paraqiste qendrën më të rëndësishme politike, ekonomike dhe kulturore të këtij nënqielli. Është interesant të theksohet se lidhjet ndërmjet El-Esh'ariut dhe El-Maturidiut kanë ekzistuar, qoftë edhe indirekt. Es-Sem'ani përkujton se e bija e Imam El-Maturidiut ishte e martuar për Hasan El-Esh'ariun, babain e Imam Hasan Ali El-Esh'ariut dhe pasardhësin e Ebu Ejub El-Ensariut.⁴

El-Esh'ariu ishte pasardhës i Ebu Musa El-Esh'ariut, as'habit të famshëm të Muhammedit a.s., i cili në atë kohë punonte si guvernator në Kufe dhe Basra. Pas vdekjes së babait të El-Esh'ariut, në cilësinë e njerikut, kujdesin ndaj tij, në pikëpamje materiale por edhe në atë intelektuale e shpirtërore, e mori Ebu Alij El-Xhubaiu, meqë u martua me nënën e tij.⁵ Është interesante të ceket se derisa El-Esh'ariu ishte me bindje mu'tezilite, në pikëpamje juridike herë deklarohet hanefit e herë shafi'it. Mirëpo, pas largimit nga mu'tezilizmi, El-Esh'ariun e gjejmë përjashtimisht si shafi'it.

El-Esh'ariu vdiq në Bagdad në vitin 324 hixhrij / 935 gregorian, në moshën 62-vjeçare sipas kalendarit diellor. Një burim tjetër pohon

¹ Sipas: Adnan Siljadzic, Filozofijska teologija Abu al-Hasan al-As'arija, Sarajevë, 1999, fq. 17 (tezë doktore).

² Gjenezologjia e tij e plotë është: Ebu'l-Hasan Ali bin Ismail bin Ebi Bishr Is'hak bin Salim bin Ismail bin Abdil-lah bin Musa bin Bilal bin Ebi Burdeh Amir bin Ebi Musa El-Esh'arij, shoku, as'habi i Muhammedit a.s.. Sipas: Mewsuat'ul-edjan, botimi I, Bejrut, 1422 h./ 2001, fq. 27.

³ Burimet historike nuk kanë datë të saktë të lindjes së tij. Megjithatë kjo datë (260 hixhrij) merret si më e mundshme. Madje edhe në një shënim hyrës në veprën *El-Ibaneh* ceket data 260 hixhrij. Shih: El-Esh'arij, El-Ibanetu an usuli'd-dijaneh, botimi I, Bejrut, 1423 h./ 2003, fq. 5; Krhs.: Adnan Siljadzic, Filozofijska teologija, po aty, fq. 17-22.

⁴ Këtë të dhënë nuk e kemi gjetur në shkrime të tjera. Sipas: Ejub Ali, Maturidizmi, në: Imam El-Maturidiu - Jeta, vepra dhe mësimi, Prishtinë, 2003, fq. 6.

⁵ Umer Ferruh, Tarih'ul-fikr'il-arabij ila ejjami Ibni Haldun, botimi IV, Bejrut, 1983, fq. 331-332; Adnan Siljadzic, Filozofijska teologija, po aty, fq. 22.

se El-Esh'ariu u varros ndërmjet Kerhit dhe Babu'l-Basra në hyrje të qytetit Basra të Irakut.⁶

II. Shkollimi fillestar i El-Esh'ariut dhe ndarja e tij nga mu'tezilizmi

Fati jetësor i El-Esh'ariut që të rritet nën kujdesin e El-Xhubaiut, ndikoi që ai mësimet e para t'i marrë nga vetë El-Xhubaiu. Këtë orientim e pati edhe në rini, ku ai paraqet një ndër nxënësit e zellshëm të shkollës besimore të mu'tezilitëve. Mësoi nga shumë mësues por autoriteti më i njohur nga i cili mësoi është El-Xhubaiu (vd. 303 h./917). Këto mësimet i ka plotësuar vazhdimisht deri në moshën 40-vjeçare dhe i ka mbrojtur me tërë fuqinë e tij intelektuale. Madje, në këtë fazë shkruan edhe disa shkrime.

Mirëpo, në moshën 40-vjeçare, rreth vitit 300 h./914, në shpirtin e El-Esh'ariut ndodhi një ndryshim kulmues. Një ditë prej ditësh, i shtyrë nga trazimi i tij shpirtëror, ai i shtroi mësuesit e njëherësh edhe njerëzit të tij disa pyetje interesante, që do të jenë vendimtare jo vetëm për të personalisht, por edhe për tërë rrjedhat politike, fetare e intelektuale të botës myslimane:

El-Esh'ariu i thotë mësuesit të tij:

Për shembull, i kemi tre vëllezër; njëri është besimtar, i cili bën vepra të mira, i dyti është mëkatar, kurse i treti ka vdekur si fëmijë i vogël. Ç'do të ndodhë me ta?

Mësuesi u përgjigj: *Besimtari do të hyjë në xhenet, mëkatarin në xhehenem, kurse ai që vdiq ende sa ishte i fëmijë do të shkojë në A'raf - 'përmirësim'.*

El-Esh'ariu vazhdoi me pyetje: *Nëse sipas doktrinës mu'tezilite el-aslaha Zoti i zgjedh krijesat më të mira, përse atëherë vdiq fëmija?*

Mësuesi u përgjigj: *Për arsye se Zoti e ka ditur se fëmija do të bëhet mëkatar dhe për këtë shkak ia ndërpreu jetën që ta shmangë xhehenemin, që edhe është përzgjedhja më e mirë.*

⁶ Umer Ferruh, po aty, fq. 331.

Sërish El-Esh'ariu pyeti: *Përse atëherë Zoti i lejoi mëkatarit të rritet dhe të piqet, kurse vetëm atëherë e dënoi?*

Në këtë pyetje mu'tezilitët nuk patën përgjigje, kështu që fillimisht erdhi deri te izolimi i El-Esh'ariut nga aktivitetet e tij.

⁷ Cyril Glasse, Enciklopedija Islama, Sarajevë, 2006, fq. 144-145.

Ibn Asakiri, biografi më i mirë klasik i El-Esh'ariut, nuk e përmend "Çështjen e tre vëllezërve" (ihwetu eth-thelatheh). Këtë nuk e bënë as Makrizi e Subki, por Shehrestani dhe Taftazani e përmendin rastin. Sipas: Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, Prishtinë, 2002, fq. 136-137.

Ne po ofrojmë versionet e mundshme:

Lidhur me ndarjen ndërmjet Xhubaiut dhe El-Esh'ariut përmenden edhe dy versione:

I. *"Të përfytyrojmë fëmijën dhe njeriun e rritur në qiej dhe të supozojmë se të dy kanë vdekur me besimin e vërtetë. Por, i rrituri në qiej ka vend më të lartë sesa fëmija. Fëmija do t'i drejtohet Zotit: "Përse ky njeri ka vend më të lartë se unë?". "Ai ka bërë shumë vepra të mira", do t'i thotë Zoti. Atëherë fëmija do të thotë: "Përse lejove të vdes aq herët, pa m'u dhënë rasti të bëj vepra të mira?". Zoti do t'i përgjigjet: "E kam ditur që, po të rriteshe, do të bëheshe mëkatar; prandaj ishte më mirë të vdisje fëmijë". Sakaq do të ushtojë britma e atyre që janë të gjykuar të banojnë në thellësitë e ferrit: "Përse, o Zot, nuk bërë të vdisnim edhe ne para se të bëheshim mëkatarë?"* Sipas: Fazrul Rahman, Duh Islama, Beograd, 1982, fq. 136 ose përkthimi në gjuhën shqipe, i cili pritet të botohet shumë shpejt nga SHB Logos-A në Shkup.

II. Gojëdhëna na tregon se El-Esh'ariu një ditë u konfrontua me mësuesin e tij El-Xhubba'iun për problemet që vijnë: tre vëllezër, një i keq, një i drejtë dhe një i vogël, vdiqën. Cili ishte fati i secilit prej tyre? El-Xhuba'iu iu përgjigj se i drejti ishte në Parajsë, i keqi në Ferr; dhe i treti i përkiste grupit të papërcaktuar të "Njerëzve të Paqes". El-Esh'ari-u e pyeti: Nëse i vogli kërkon leje ta vizitojë vëllain e tij në Parajsë, a do t'i pranohet? Përgjigja e El-Xhuba'iut, e bazuar në doktrinën mu'tezileh të drejtësisë, ishte: Jo! - sepse Parajsa mund të fitohet vetëm me vepra të mira. El-Esh'ari-u iu përgjigj: Por çfarë nëse i vogli pohon: Po të isha lejuar të jetoja, unë do ta kisha fituar atë. Duke e bazuar pozicionin e tij mbi parimin mu'tezileh të gjithëmirësisë hyjnore, El-Xhaba'iu iu përgjigj se djalit do t'i thuhej se ishte më mirë për të që kishte vdekur më herët. El Esh'ari-u atëherë nxori konkluzionin e tij: Por nëse djali i keq atëherë do ta pyeste Zotin: Ju e keni ditur të mirën e të voglit dhe vendosët t'i jepnit fund jetës së tij me qëllim që ta pengoni atë prej bërjes së të keqes dhe shkatërrimit të vetes. Ju e dinit të ardhmen time gjithashtu. Përse atëherë Ju i bëtë atij favor dhe mua jo? El-Xhuba'iu u nxor në rrenë dhe el Esh'ariu doli nga radhët mu'tezileh." Sipas: Islamil R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York - London, fq., fq. 292 (Përkthimi jepet sipas përkthimit shqip në dorëshkrim).

Shih edhe versionin e afërt të: Muhammed Ebu Zehreh, Tarih'ul-medhahib'il-islamijeh, Kajro, pa vit botimi, fq. 172.

Isolimi i El-Esh'ariut në shtëpi zgjati për dy javë, do të ndërpritet duke dalë në Xhaminë e Madhe të Mensurit në Basra, në hallkën (katedrën) e juristit shafi'it Ebu Is'hak Ibrahim ibn Ahmed El-Mervezej, dhe duke njoftuar se:

“Ai që më njeh, më njeh. Atij që s'më njeh, do t'i prezentohe vetë: Unë jam Ali ibn Ismail El-Esh'ariu. Deri para pak kohësh kam predikuar mësimin mu'tezilit, duke besuar në Kur'anin e krijuar, kam mohuar të pamurit e Zotit në atë botë, ia kam mohuar Zotit çdo atribut dhe çdo shenjë pozitive... Bëhuni të gjithë dëshmitarë se tash e mohoj këtë mësim dhe se përfundimisht heq dorë prej tij.”⁸

Ka shumë mendime përse El-Esh'ariu e bëri këtë kthesë në jetën e tij. Disa thonë se shkak për këtë ishte një ëndërr e parë në gjum⁹, që personalisht nuk kam prirje t'i ndërlidhi transformimet e këtilla intelektuale dhe shpirtërore me ëndrra çudi të tjera. Ekziston edhe bindja tjetër, që më duket e drejtë se, El-Esh'ariu, duke lexuar dhe duke u thelluar në dituritë islame vërejti se doktrina mu'tezilite nuk është e drejtë dhe se ai nuk mund të qëndroj në pozitë e mëparshme mu'tezilite.¹⁰

Ky divorc besimor dhe intelektual bëri që El-Esh'ariu të pozicionohet në qendër, me një theks të lehtë nga hanbelizmi, nga skajshmëria e mu'tezilizmit, respektivisht e racionalizmit të ekzagjeruar. Në kohën para El-Esh'ariut ishte krijuar një botëkuptim se preokupimi me kelam është rrezikim i besimit dhe se kjo shkencë ishte lënë në duar të rrymave ekstreme. Për këtë arsye, nëse nuk e numërojmë autoritetin e madh në shkencën e ilm'ul-kelamit, Imam Ebu Hanifen, i cili i vendosi themelet e kësaj shkence dhe Imam El-Maturidiun, i cili si vazhdimësi e shkollës hanefite, e ndërtoi, e plotësoi dhe i formuloi bazat e ilm'ul-kelamit sunit, i ngriti në nivel të lartë intelektual dhe në

sistem më konzistent, do të mund të pranohej se El-Esh'ariu është ndër të parët, sidomos jashtë shkollës hanefito-maturidite, që i theu stereotipet e vjetra për mosguxim të preokupimit me shkencën e akaidit.¹¹

Në të gjitha fazat historike El-Esh'ariu gëzoi autoritet nga bashkëbiseduesit, nga miqtë dhe armiqtë, madje edhe në kohën moderne. Një autor bashkëkohor, Sa'd Abdulaziz, El-Esh'ariun e përshkruan si një prej dialektikëve më të mëdhenjë, si të parin që i vendosi bazat e filozofisë së kelamit islam, autoritet i logjikës, themelues i medhhebit esh'arit¹² etj.

III. Veprat kryesore të El-Esh'ariut

Imam El-Esh'ariu është autor i frytshëm. Ai në të gjitha fazat e jetës së tij, edhe mu'tezilite edhe el-esh'arite, ka shkruar shumë. Ibn Furaku thotë se ka shkruar mbi 300 vepra (vepra e trajtesa - NI) nga të gjitha fushat islame të kohës si në tefsir, hadith, fikh, kelam, hereziografi, fe komparative dhe filozofi.

Ibn Asakiri, duke u bazuar në vetë fjalët e El-Esh'ariut në veprën *Kitab 'ul-'amad fi'r-rru'ja* thotë se El-Esh'ariu deri në vitin 320 h./932 ka shkruar shtatëdhjetë vepra. Në periudhën tjetër i ka shkruar edhe njëzet e tre vepra, që gjithsej janë 93 vepra¹³ nga fusha e teologjisë, sidomos në fushën e tefsirit, hadithit, shariatit, pastaj trajtesa kundër sekteve të shumta me ngjyrim islam etj.

Me këtë rast do t'i paraqesim përmbledhazi disa vepra mjaft të rëndësishme:

1. Kitabu Mekalat'il-islamijjin we'l-ihtilaf'il-musal-lin (Diskursi i islamistëve ...), botim i orientalistit Hellmut Ritter, Wiesbaden, 1382/1963. Disa shkencëtarë konsiderojnë se kjo vepër është shkruar qysh si mu'tezilit, apo së paku pjesa e parë e kësaj veprë. Në këtë vepër El-Esh'ariu në mënyrë shumë të qartë, të saktë dhe objektive i

⁸ Umer Ferruh, *Tarih'ul-fikr'il-arabij ila ejjami Ibni Haldun*, botimi IV, Bejrut, 1983, fq. 331-332. Henry Corben, *Historia e filozofisë islame*, Shkup, 1997, fq. 125. Po ashtu: M. M. Sharif, *Historija islamske filozofije*, I, Zagreb, 1988, fq. 241.

⁹ Shibli, *Ilm'ul-kalam*, Azemgarh, 1341/1923, fq. 56, sipas: M. M. Sharif, po aty, fq. 241.

¹⁰ Këtë mendim e mban edhe intelektual i boshnjak Nerkez Smailagiq. Shih: Nerkez Smailagiq, *Leksikonislama*, Sarajevë, 1990, fq. 80.

¹¹ Nerkez Smailagiq, *Leksikonislama*, po aty, fq. 80.

¹² Sa'd Abdulaziz, *Felasifet'ul-islami*, Kajro, 1977, fq. 81.

¹³ Adnan Siljadzic, *Filozofijska teologija*, po aty, fq. 22.

shtron problemet besimore të kohës së tij, sidomos mësimet shi'ite, harixhite, murxhite, mu'tezilite, kulabite, xhehmite, dirarite, nexhari-te, bekrite dhe të tradicionalistëve.¹⁴ Vepra konsiderohet si njëra nga më të mirat dhe ndër të parat në tërë historinë e akaidologjisë islame. Vepra përbëhet prej tre pjesëve: *Pjesa e parë* përmban paraqitjen e hollësishme të sekteve dhe doktrinave të ndryshme islame; *pjesa e dytë* përmban doktrinën e literalistëve (ehl'ul-hadith we ehl'us-sunneh) dhe *pjesa e tretë* paraqet degët e ndryshme të kelamit, mendimet dhe nocionet e kelamit. Fjalë pozitive për këtë vepër flasin edhe Ibn Tej-mije dhe Ibn Xhevzij.¹⁵

2. El-Ibanetu an usuli'd-dijaneh (Sqarimi i bazave të fesë), disa botime. Vepra i takon periudhës së fundit, kur autori tashmë e kishte braktisur mu'tezilizmin. Ajo paraqet mësimet e zbërthyer të akaidit sunit.¹⁶ Normalisht, El-Esh'ariu në këtë periudhë është reaktiv dhe plot pezëm kundrejt qëndrimeve të ish-grupit të tij. Vepra karakterizo-het me ton polemizues dhe apologjetik kundrejt mu'tezilizmit dhe xhehmizmit. Po ashtu, ai me kujdes i bën lavd Ibn Hanbelit, por gjithashtu edhe ua bën me dije se nuk ka asgjë blasfemuese nëse të vërtetat fetare vërtetohen me dëshmi racionale.¹⁷

3. Kitab'ul-lum'a fi'r-rreddi ala ehl'iz-zejgi we'l-bidei (Thelbi i polemikës me heretikët dhe risimtarët), Bejrut, 1953. Kjo vepër e El-Esh'ariut paraqet një *summa teologia* të sunizmit. Ai me këtë vepër bën nivelimin ndërmjet ekzagjerimit racionalist të mu'tezilizmit dhe atij literalist të tradicionalistëve. Rëndësia e kësaj vepre manifestohet

edhe në angazhimet e shumë dijetarëve që ta komentojnë si El-Bakil-laniu, Ibn Furaku etj.¹⁸

4. Risaletu fi istihsani'l-hawdi fi'l-kelam (Trajtesa mbi arsyeshmërinë e ilm'ul-kelamit), botim i orientalistit Richard J. MacCarthy, në gjuhën angleze e përkthyer me titullin *The Theology of al-Ash'ari*, Bejrut, 1953. Vepra e fundit për të cilën mendojmë të flasim e shqyrtton arsyeshmërinë e shkencës së kelamit kundrejt qëndrimeve puritane të kundërshtarëve dhe çështjen e përdorimit të kelamit në temat e besimit. Vepra nuk shtron mësimin për tewhidin (njësinë e Allahut), sepse këtë El-Esh'ariu e bën në veprat e tjera, por vepra e shtron dëshmimin e relevancës së plotë të metodës racionale. Hanbelitëve, të cilët e braktisën ixhtihadin dhe e pranuan taklidin (imitimin) u tregon se nuk mund të quhen muxhtehidët inovatorë sepse thellohen në horizonte të kuptimeve në të vërtetat fetare dhe se mendimi fetar nuk mund të rrëgjohet vetëm në dy burimet e para, në Kur'an dhe Hadith, por ky horizont duhet të zgjerohet edhe në burime të tjera të njohjes.¹⁹

Meqë kjo vepër qëndron para jush e përkthyer edhe në gjuhën shqipe dhe i nënshtrohet edhe vlerësimit tuaj kritik, shkencor e intelektual, nuk do të ndalemi më gjerësisht.

IV. Doktrina e El-Esh'ariut dhe e shkollës së tij

Është shumë e vështirë të shtrohet me sukses doktrina e El-Esh'ariut. Ndërlikueshmëria qëndron në faktin se veprat e tij janë të shumta, të shkruara në disa faza jetësore nga pozicione të ndryshme, të rënda për t'u kuptuar dhe sidomos për shkak të ekspozimit jokonzistent të doktrinës. Një çështje El-Esh'ariu e shtron në një vepër, e plotëson në veprën tjetër, kurse e argumenton në veprën krejt tjetër, duke përdorur edhe metoda të ndryshme: logjike-racionale dhe formën me-

¹⁴ Henri Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989, fq. 123.

¹⁵ El-Esh'arij, Kitab Mekalat'il-islamijjin we ihtilaf'il-musal-lin, në redaktim të Hellmut Ritter, bot. III, Wiesbaden, 1980, fq. 690.

¹⁶ Henry Corben, po aty, fq. 126. Henri Laoust, po aty, fq. 123.

¹⁷ El-Esh'arij, El-Ibanetu an usuli'd-dijaneh, botimi I, Bejrut, 1423 h./ 2003, fq. 110.

¹⁸ Abu Al-Hasan Al-As'ari, Kitab'ul-lum'a fi'r-rreddi ala ehl'iz-zejgi we'l-bidei, Bejrut, 1953 ose botimi boshnjak: Bit polemike sa otpadnicima i inovatorima, Sarajevo, 1421 h./ 2000 - përkthim bilingual. Henri Laoust, po aty, fq. 123.

¹⁹ Adnan Siljadzic, Filozofijska teologija, po aty, fq. 22-26. Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, po aty, fq. 138.

sjetare silogjistike apo disputative. Kjo gjendje e vështirëson punën e analizës.

Por, doktrina e El-Esh'ariut në përgjithësi karakterizohet me ton apologjetik dhe pajtues. Respektivisht, El-Esh'ariu në angazhimin e tij intelektual përparësi e kishte mbrojtjen e mësimëve sunitë, e më pak përsiatjen e thellë të institucioneve shpirtërore të fesë islame; ai më pak ishte teolog i lirë spekulativ, siç do të veprojnë më vonë Ibn Sinai, El-Gazaliu, Ibn Arebiu etj. Teologjia dhe filozofia e tij do ta reflektojë frymën e kohës në të cilën pragmatizmi religjioz ishte vendimtar, por pa të cilën, siç e thotë këtë S. H. Nasr, nuk do të kishte as arabeskë, as miniaturë persiane, as Taxh El-Mahal, as Mesnevi të Rumiut, as Xhavid-Name të Ikbaliut.²⁰

Duke u pozicionuar jo vetëm kundrejt liberalizmit ekstrem mu'tezilit por dhe fatalizmit ekstrem të sunizmit të hershëm, ai paraqitet si pajtues i racionalizimit mu'tezilit dhe asketizmit të hershëm të manifestuar te Hasan El-Basriu dhe Vasil Ibn El-Atai. Kjo e bëri El-Esh'ariun që ai mos të bëhet apologjet i fesë së trashëguar, i cili e zhvlerëson vlerën e arsyes njerëzore, as racionalist kartezian, i cili vetësigurinë e njeriut e sheh përjashtimisht në mendjen e tij, kjo e bëri që ai të qëndrojë ndërmjet racionalizmit të thatë mu'tezilit dhe fideizmit primitiv hanbelist.²¹ El-Esh'ariu mendon se shkollat sunitë pajtohen në parim, kurse ndahen në çështjet e aplikimit të tyre. Lidhur me këtë Ibn Asakiri e transmeton një gjykim të El-Esh'ariut: *“Çdo muxh-tehid ka të drejtë dhe të gjithë muxh-tehidët qëndrojnë në truallin e fortë të së vërtetës. Ndarjet e tyre nuk u përkasin parimeve, por dalin nga aplikimi.”*²²

Kjo përçasje e tij ndërmjet dy ekstremizmave dhe falë rrethanave të favorshme politike që i shkuan për dore dhe pozitës gjeografike të

veprimit të tij (që nuk i kishte edhe Imam El-Maturidiu), do t'i sigurojë El-Esh'ariut në pjesën më të madhe të kohës vend prevalent brenda traditës kognitive myslimane.²³

Në vazhdim do t'i marrim në shqyrtim disa çështje të mëdha teologjike me shpresë se do të arrijmë ta pasqyrojmë së paku kalimthi opusin e El-Esh'ariut.

1. Ekzistenca e njësisë së Zotit (Tewhidi)

El-Esh'ariu e refuzoi perceptimin në mënyrë negative (ta'til) të Zotit nga ana e mu'tezilitëve, të cilët cilësitë e Krijuesit i perceptonin brenda vetë Krijuesit e jo si të ndara nga vetë Qenia e Tij. Ai e refuzoi edhe perceptimin antropomorfist (teshbih) të një pjese të tradicionalistëve (hanbelizmit, hashevizmit...) dhe të literalistëve (dhahirizmit ...), të cilët atributet i perceptojnë si kompleks i emrave dhe shenjave jashtë vetë qenësisë së Tij. Në vend të këtyre pikëpamjeve ai ofron perceptimin e tij (el-esh'arit), i cili thotë se Qenia e Zotit njëmend posedon atributet dhe emrat që theksohen në Kur'an. Këto kanë njëmendësinë e tyre pozitive, të ndryshëm nga esenca por që megjithatë jashtë saj nuk kanë as ekzistencë as njëmendësi. Me këtë ai bëri edhe një hap, duke e dalluar atributin si koncept dhe konsideron se si dyjësina ndërmjet qenësisë dhe atributit duhet vendosur në rrafshin cilësor e jo në atë sasior. Dorën, fytyrën, uljen në fron e të tjera ai i kupton në njëmendësinë e tyre që lidhen me Zotin, por tërheq vërejtjen kundër çdo perceptimi trupor, material kur ato i përshkruhen Zotit dhe duke mos shtruar pyetje “si” (بلا كيف - bila keje).²⁴

Kundrejt atyre që nuk besojnë (ateistëve) El-Esh'ariu ofron tri prova:

- E para: Bota është e përbërë prej trupave kurse trupat nga atomet. Rrjedhimisht kësaj, meqë atomet janë të krijuara rezulton se edhe çdo gjë është e krijuar. Krijues i tyre është i pakrijuari, e ai është Krijuesi - Zoti.

²³ Shih: Adnan Siljadzic, po aty, fq. 216.

²⁴ Parafrazuar sipas: Henry Corben, po aty, fq. 128.

²⁰ Sipas: Adnan Siljadzic, po aty, fq. 215 etj.

²¹ Edhe pse El-Esh'ariu në veprat e tij të shkruara pas largimit nga mu'tezilizmi, në *El-Ibaneh* dhe në *El-Lum'a*, polemizon shumë gjallë dhe rreptë, duke përdorë argumente të arsyes dhe të Kur'anit, është interesant se ai pak e përdorë traditën (sunetin), madje, e thekson legjitimitetin e ilm'ul-kelamit dhe ruajtje ekzegjeshën alegorike (te'vil), natyrisht të kufizuar. Shih: Henri Laoust, po aty, fq. 124.

²² Henry Corben, po aty, fq. 127.

- E dyta: Qeniet janë të Domosdoshme ose të Mundshme, të kush-tëzuara. Qenie e Domosdoshme është vetë Zoti, i cili nuk ka shkak, nuk ka kurrfarë kushtëzimi kohor apo hapësinor, material apo çfarëdo tjetër. Qeniet e mundshme janë të kushtëzuara nga shkakut i parë, nuk janë të domosdoshme, sepse kjo do të thoshte se edhe këto do të ishin ekzistenca të përvetshme.
- E treta: Çdo gjë e krijuar përbëhet prej rregullësisë, synimit, urtësisë. Pa këto elemente krijimi do të ishte i pamundur. Kjo rregullsi flet për një qenie e cila është vetë Zoti, Një dhe i Vetëm.²⁵

2. Mësimi mbi Kur'anin e (pa)krijuar (halk'ul-Kur'an)

Perceptimi i Kur'anit, është apo nuk është ai i krijuar, ka shkakuar një rrëmujë në mesin e të gjithë dijetarëve myslimanë. Grupimi mu'tezilit predikonte se Kur'ani është fjalë e krijuar e Zotit, duke mos dalluar fjalën e Zotit si atribut i amshueshëm hyjnor nga thënia e cila e paraqet në Kur'an.

Ana tjetër, grupimi literalist, kategorikisht e ka refuzuar bindjen mu'tezilite, duke e ngatërruar fjalën e Zotit dhe thënien njerëzore të manifestuar në kohë e hapësirë. Madje, ata deklaroronin se në Kur'an është e amshueshme jo vetëm përmbajtja dhe fjalët, por edhe letra, ngjyra, kopertina, faqet, zëri që e artikulon etj.

El-Esh'ariu ndërmjetëson ndërmjet këtyre dy skajeve duke thënë se natyra e fjalës nuk mund të rrëgjohet në njërin apo në tjetrin aspekt. Fjala është thënie e shpirtit (hadith nefsij) dhe me këtë është e pavarur nga çdo manifestim verbal (hadith lafdhij). Kur deklaroi se Kur'ani është i amshueshëm, ai me këtë nënkupton atributin hyjnor të kelamit, i cili vazhdimisht mbijeton në Zotin dhe i cili si i tillë është i lirë nga çdo artikulum verbal dhe i zëshëm. Ai thënie e tij i argumenton me disa ajete por edhe me disa hadithe, sidomos një hadith që e përdor në El-Ibaneh: *“Të folurit e Allahut e tejkalon çdo të folur tjetër në atë*

*masë aq sa Ai si i tillë e tejkalon krijesën e Tij.”*²⁶ Por, Kur'ani po ashtu është i sajuar prej fjalëve. Ai është i shkruar. Nga kjo pikëpamje, Kur'ani është fakt i krijuar kohor dhe nuk ka diskutim. Por, si të harmonizohen këto dy qëndrime antinomike, njëri i krijuar e tjetri i pakrijuar? ²⁷ El-Esh'ariu është konfuz dhe nuk saktëson se çka kupton me togfjalëshin *kelam'ull-llah*, çka është e amshueshme dhe çka e krijuar, fjalët apo domethënia. Në një vend ai e thotë se është e mundur të dëgjohet të folurit e amshueshëm drejtpërdrejt pa ndërmjetësimin e zërit të krijuar, por ky mendim disi çon në përfundimin se edhe fjalët edhe domethëniet janë të amshueshme.²⁸ Pra, El-Esh'ariu nuk ofron ndonjë përgjigje të fuqishme, por rekomandon *“pa pyetur si?”* (بلا كيف).

Mirëpo, nxënësit e tij, sidomos Esh-Shehrestani dhe nxënësit tjerë el-esh'arit mendojnë se edhe mendimi i mësuesit por dhe i tyre është se fjalët janë të krijuara, por domethënia nuk është e krijuar.²⁹

3. Vullneti i lirë

Për çështjen e vullnetit të lirë apo për aftësinë e njeriut të përzgjedhë dhe të kryejë aksionin, el-esh'aritët sërish janë ndërmjet dy qëndrimeve skajshmërisht të kundërta, ndërmjet qëndrimit fatalist, siç ishin literalistët dhe xhebritët dhe qëndrimit liberalist siç ishin mu'tezilitët dhe kaderitët.

Literalistët dhe xhebritët mendonin se veprat njerëzore janë të paradeterminuara dhe të paradestinuara nga Zoti. Njeriu nuk ka mundësi as fuqi të “krijojë” (sajojë) vepër. Çdo gjë është e krijuar prej Zotit.

²⁶ Këtë dhe mendimet e tjera shih në: El-Esh'arij, Kirab'ul-lum'a, po aty, fq. 44 dhe fusnota 71.

²⁷ Shih për këtë: Henry Corben, po aty, fq. 128-129. M. M. Sharif, po aty., fq. 250-251. Po ashtu: El-Esh'arij, Mekalat'ul-islamijjin, bot. III, Wiesbaden, 1980, fq. 290 e tutje.

²⁸ Shih: Abu Al-Hasan Al-Ash'ari, Kitab'ul-lum'a, po aty, fq. 44-62. El-Esh'arij, El-Ibaneh, po aty, fq. 31, 42 dhe 46. Nexhat Ibrahim, Imam Ebu Hanifeh dhe imam El-Maturidui, perla të akaidit islam, Prishtinë, 2007, fq. 41.

²⁹ Fazlur Rahman, po aty, fq. 137-138.

²⁵ Parafrazuar sipas: Ismail R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, po aty, fq. 292-293.

Zoti ka fuqi absolute mbi të gjithë, prandaj edhe është mbi vullnetin njerëzor dhe mbi aksionin njerëzor.

Nga ana tjetër, mu'tezilitët dhe kaderitët mendonin se njeriu ka fuqi dhe aftësi të plotë të krijojë vepër dhe ka liri të plotë në përzgjedhjen e vet, edhe pse kjo fuqi te ai është e krijuar prej Zotit.

El-Esh'aritët zgjodhën rrugën e mesme. Ata bënë dallimin mes krijimit (halk) dhe fitimit (kesb) të një veprimi. Sipas tyre, Zoti është krijues (halik) i veprimeve të njeriut kurse njeriu është ai që i fiton (arrin) (muktesib) veprat. Vetëm fuqia e amshueshme (kadima), fuqia e Zotit mund të krijojë vepra, kurse fuqia njerëzore është e krijuar (haditha) dhe si e tillë ajo nuk mund të krijojë. Duke përzgjedhur ndërmjet alternativave, njeriu arrin (iktisab) ose shpërblimin ose ndëshkimin prej Zotit. Me 'institutonin' e "fitimit (arritjes - el-kesb)" el-esh'aritët iu shmangen fatalizmit të tradicionalistëve, xhebriëve e hashevitëve por edhe liberalizmit absolut të mu'tezilitëve dhe kaderitëve dhe pohojnë se njeriu me anë të fuqisë 'së fituar' (relative) merr pjesë në sajimin e veprave. Kështu, El-Esh'ariu i jep njeriut jo *kudretin* (krijimin e veprave të veta), por *kesbin* (arritjen e veprave të veta). Këtë e ka shprehur kështu Esh-Shehrestani: "*Zoti e krijon te njeriu fuqinë, aftësinë, përzgjedhjen dhe vullnetin që ta nxjerrë (krijojë) një vepër, kurse njeriu me këtë aftësinë e nxjerrë lirisht përzgjedh një nga alternativat dhe synon apo dëshiron ta kryejë veprimin dhe në pajtim me këtë synim, Zoti krijon dhe e përmbaron këtë vepër.*"³⁰

Megjithatë, duhet vërejtur se perceptimi i 'kesbit' nuk është i njëjtë si te shkolla el-maturidite. Ai nuk e dëshironte idenë e lirisë së zgjedhjes, sepse mendonte se vullneti i njeriut është i përcaktuar me vullnetin e Zotit, dhe si i tillë, vullneti i njeriut nuk ka kurrfarë efekti real në veprën e tij. Në esencë, sipas tij, Zoti është ai i cili e krijon dhe e kryen veprën nëpërmjet njeriut. Njeriu vetëm e dëshiron një gjë, kurse Zoti me fuqinë e tij i jep dëshirës së njeriut ekzistim.³¹ Njeriu fiton meritën apo mëkatën jo pse vepron por pse dëshiron.³²

³⁰ Esh-Shehrestani, El-Milel we'n-nihal, fq. 50, sipas: M. M. Sharif, po aty, fq. 248.

³¹ Sipas: Abu Al-Hasan Al-As'ari, Kitab'ul-lum'a, po aty,

³² Ismail R. al Faruqi, po aty, fq. 293.

Një njohës i mirë i veprës së El-Esh'ariut, A. Silajxhiq, në doktraturën e tij, doktrinën e fitimit (kesbit) te El-Esh'ariu e përkufizon si vijon:

- 1) Fuqia e krijuar njerëzore na mundëson ta diferencojmë përvojën e domosdoshme (p.sh. lëvizja e dorës së një paraplegjistit) dhe të fituar (p.sh. lëvizja e fituar ose e vullnetshme e dorës së njeriut kur synon të shkruajë;
- 2) Duke e krijuar te njeriu aftësinë e fitimit (kesb) Zoti ia përshkruan njeriut veprën për të cilën mund ta shpërblejë respektivisht ndëshkojë, e që gjatë kësaj të mos jetë subjektiv. Me këtë respektohet drejtësia hyjnore por edhe vullneti i lirë i njeriut;
- 3) Zoti e dëshiron dhe e krijon të keqen, por njëkohësisht ia ndalon njeriut atë.³³

4. Vizioni i bukur

Vizioni i bukur është një ndër problemet vijuese të cilin me shumë kujdes e trajtoi El-Esh'ariu. Ai nuk do të pajtohet me qëndrimet ekstreme antropomorfiste të një pjese të tradicionalizmit dhe të dhahirizmit, të cilët mendonin se Zoti do të shihet në Botën Tjetër dhe se Njerëzit e Mirë njëmend do ta shohin Zotin në Botën Tjetër si shpërblim për veprat e mira të tyre. Ata po ashtu thonë se Zoti qëndron mbi Arshin e Tij etj.

El-Esh'ariu nuk do të pajtohet as me mu'tezilizmin dhe filozofët, të cilët e refuzonin të parit e Zotit me sy, sepse ky të parë do të implikonte ekzistimin fizik, kurse kjo është absurde.³⁴

El-Esh'ariu pjesërisht pajtohet me tradicionalistët se Zoti është e mundur të shihet në Botën Tjetër³⁵, por nuk mund të pajtohet me që-

³³ Gjerësisht: Adnan Silajdzic, op. cit., fq. 182-183.

Shumica e el-esh'aritëve të dalluar, sikurse Kadi Ebu Bekr Bakil-lani, Ebu Is'hak Isfirani dhe Imam El-Haremejn El-Xhuvieniu nuk janë pajtuar me të në këtë çështje dhe ofroi shpjegim të shprehjes (kesb-un). (Gjerësisht: Adnan Silajdzic, op. cit., fq. 182-183.

³⁴ M. M. Sharif, po aty, fq. 251-252. Shih qëndrimin el-esh'arit: El-Esh'arij, Kitab'ul-lum'a (teksti arabisht-boshnjakisht), Sarajevë, 1421 h./ 2000, fq. 81 e tutje.

³⁵ El-Esh'arij, El-Ibanetu an usul'id-dijaneh, botimi I, Bejrut, 1424 h./2003, fq. 20 e tutje.

ndrimin e tyre se Zoti është hapësinor (i shtrirë) dhe se në drejtim të Tij mund të bëhet me shenjë. Ai dhe shkolla e tij e pranuan parimin filozofik se çdo gjë që është hapësinore duhet të jetë i rastit dhe kalues, kurse Zoti nuk është as qenie e shtrirë hapësinore as kohore. Kundërthënien që shfaqet se vetëm qeniet hapësinore dhe kohore mund të shihen dhe se Zoti nuk mund të shihet meqë nuk është ekzistencial, ata e zgjidhin duke thënë se mundësia e të parit të një lënde ekziston madje edhe kur ajo qenie nuk qëndron para atij që e vrojton.³⁶ Këtë e thotë kështu El-Esh'ariu: *“Afirmimi i të parit e Zotit (visio beatifica) nuk nënkupton afirmimin e krijueshmërisë së Tij, sepse një gjë mund të jetë objekt i të parit ose i shikimit e që gjatë kësaj nuk është e krijuar në kohë.”*³⁷

Në pikëpamje të *të parit* të Zotit (ru'jet'ull-llah) Imam El-Maturidiu është tradicionalist i plotë, nuk e përfill arsyen sikur në disa raste, dhe interpretimin e bën duke u bazuar në hadithin e Muhammedit a.s.:

إنكم سترون ربكم كما ترون القمر ليلة البدر.

*“Sigurisht do ta shihni Zotin tuaj (aq qartë) sikur që e shihni Hënën (në natën e katërmbëdhjetë, të plotë)!”*³⁸

5. Shpallja dhe arsyeja

Në kohën para El-Esh'ariut dhe gjatë jetës së tij debatohej rreptë për raportet shpallje-arsye dhe për vendin e tyre në tërësinë e fesë islame. Mu'tezilitët i jepnin epërsi arsyes kundrejt shpalljes, kurse të mirën dhe të keqen e vlerësojnë si gjykime racionale të konfirmuara nga shpallja.

Mirëpo, El-Esh'ariu i dha shpalljes epërsi të padiskutueshme sepse *e mira dhe e keqja, imani (besimi) dhe mëkati, ringjallja dhe gjykimi* janë çështje shpalljeje e jo arsyeje. Këto, sipas tij, nuk janë të domosdoshme në vetvete. Po ashtu, këto mund të jenë në domen të Zotit,

³⁶ Sipas: M. M. Sharif, po aty, fq. 252.

³⁷ Sipas: El-Esh'arij, Kitab'ul-lum'a, po aty, fq. 82.

³⁸ Imam El-Maturidiu - Jeta, vepra dhe mësimi, Prishtinë, 2003, fq. 49-50.

por jashtë vullnetit të Tij.³⁹ Ai mendon se shpallja është burimi i së vërtetës dhe njëmendësisë më të lartë, kurse arsyeja duhet të pajtohet me të dhënat e shpalljes, në rast konflikti ndërmjet tyre. Sipas tyre, po të bëhej arsyeja primare, Islami do të bëhej filozofi spekulative apo teologji racionale e jo teologji doktrinare e Islamit. Meqë Islami bazohet në disa parime apo koncepte mbishqisore dhe të pakapshme për dëshmi racionale, në këto parime duhet besuar në bazë të Shpalljes. Kjo nuk do të thotë se pikëpamja racionale eliminohet. Jo, Islami e lejon racionalizimin e besimit të tij, përsiatjen rreth tij, por kjo nuk e rrëgjon Islamit në mendje të pastër si kriter kryesor. Islami nuk mund t'i nënshtrohet vlerësimit racional, por mund t'i pranojë shpjegimet në funksion të lehtësimit të perceptimit të tyre.⁴⁰

V. Raportet El-Esh'arij-Maturidij

Shkolla besimore el-esh'arite dhe el-maturidite, si dy shkollat më të mëdha të sunetit dhe xhematit, kanë pika të përbashkëta por edhe pika ndarëse. Mendimtarët që kanë prirje për analiza të tilla, kanë numëruar rreth 50 pika ndarëse, kryesisht në çështjet dytësore.⁴¹

Që të dyja shkollat e respektojnë Kur'anin dhe Hadithin dhe trashëgiminë e krijuar rreth tyre, por nuk e braktisin as mendjen, arsyen. Me këtë qëndrim të tyrin el-esh'arinjtë dhe el-maturidinjtë pozicionohen ndërmjet tradicionalizmit rigoroz të hanbelizimit, të cilët e refuzojnë çfarëdo roli të arsyes dhe racionalizimit liberal të mu'teziles, të cilët arsyes i japin vend dominues. Mirëpo, një studim më i thellë do të tregojë se dallimet nuk qëndrojnë vetëm ndërmjet el-esh'arizmit-el-maturidizmit nga një anë dhe tradicionalizmit nga ana tjetër, por edhe ndërmjet vetë këtyre dy shkollave kryesore të sunetit dhe xhematit.

³⁹ Islamil R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, po aty, fq. 293.

⁴⁰ M. M. Sharif, po aty, fq. 248-250.

⁴¹ D. B. Macdonald pretendon se dallimet ndërmjet mësimi el-esh'ariut dhe el-maturidiut janë më të thella. Përkundër këtij pohimi, mendojmë se të dy shkollat i kanë ruajtur kufijt e tyre të ortodoksisë. Sipas: Luis Gardet et M. M. Anawati, Introduction a la theologie musulmane, Paris, 1970, sipas: Nerkez Smailagic, Klasicna Kultura Islama, I, botimi II, Zagreb, 1976, fq. 162.

Ajo që i ndan këto dy shkolla është së pari rreptësia e kundërshtimit të tij të mu'teziles, sepse el-maturidizmi ishte diç më larg nga burimi dhe vorbulli i mu'teziles, kurse el-esh'arizmi ishte në vetë burimin, pjesë e tyre në dy të tretat e jetës së El-Esh'ariut. Si i larguar nga brumi mu'tezilit, El-Esh'ariu ishte tejet i rreptë, i revoltuar. Por, kjo rreptësi e tij mund të thuhet se nuk ka edhe subjektivizëm të caktuar, madje edhe hakmarrje personale⁴², e nga ana tjetër edhe ndikim të caktuar mutezilit, nga i cili El-Esh'ariu nuk kishte mundur tërësisht të ndahet. Ky ndikim ka shkaktuar inkonsekuencë të mendimi i tij, herë duke i mbetur besnik drejtimit të parë, e herë duke i mbetur besnik drejtimit të ri. Por, ky rebelim i El-Esh'ariut kundër ish-shkollës së tij i dha popullaritet vetë El-Esh'ariut. Madje, ai fillimisht deklaroi se është pjesëtar i vetë tradicionalistëve. Në emër të mbrojtjes së fesë, ai e fitoi edhe përkrahjen e masës por edhe të një pjese të tradicionalistëve dhe të të pakënaqurve por edhe të vetë sunduesve të caktuar. Por, këta njerëz nuk e kuptuan se luftëtari i parë kundër mendimeve sektare ishte pikërisht Imam Ebu Hanifeh dhe nxënësi më i madh i kësaj shkolle besimore Imam El-Maturidiu. Nuk duhet harruar as fakti se në kohën kur Imam El-Esh'ariu konvertoi nga mu'tezilizmi, viti 300 hi-xhrij, Imam El-Maturidiu tashmë kishte mbi 60 vjet punë në mësimet sunite hanefite-maturidite. Imam El-Maturidiu nga ana tjetër, ka qenë më i qetë, mendimi i tij ishte në vazhdimësi e sipër dhe shumë më konsekuent, më i fuqishëm dhe më i saktë në respektimin e traditës dhe arsyes. Mësimi maturidit ishte më larg debatit (munadhara) dhe më larg polemikës (xhedel), ishte më i kthjellët, më i matur dhe më të kuptueshëm.

Marrë në përgjithësi, përkundër faktit se kundërthëniet dhe kundërshtimet ndërmjet El-Maturidiut dhe El-Esh'ariut kanë qenë verbale (el-lafdhijeh) dhe formale (esh-shekljeh), respektivisht disa të tjerë thonë se kundërshtimet kanë qenë kuptimore, rrënjësore (el-ma'nevijeh), dijetarët e të dyja grupeve unanimsisht pajtohen se el-esh'arizimit dhe el-maturidizmit “nuk mund t'i përshkruhet sajimi (tebdî') as lajth-

⁴² Henri Laoust, po aty, fq. 123.

itja (tadlil)” dhe se gjatë historisë nuk mund të shohim ndonjë përplasje më të madhe ndërmjet këtyre dy shkollave.⁴³

Më herët theksuam se dallimet midis tyre nuk janë të theksuara, por megjithatë ato ekzistojnë. Dijetarët i numërojnë ndërmjet 13 deri në 50 dallime, kurse disa prej tyre janë:

1. Maturidinjtë mendojnë se njeriu e ka një vullnet të pjesshëm (el-iradet'ul-xhuz'ijeh), kurse esh'arinjtë mendojnë se ky vullnet nuk është i lirë, por atë vullnet e krijon Allahu xh. sh..
2. Maturidinjtë mendojnë se njeriu mund ta njohë Allahun edhe pa shpallje. Nëse njeriu nuk arrin deri te shpallja, ai e ka për detyrë ta besojë Atë. Esh'arinjtë mendojnë se njeriu nuk mund ta njohë Allahun pa shpallje.
3. Maturidinjtë mendojnë se e mira (husn) dhe e keqja (kubh) (e bukura dhe e shëmtuara), legalja (meshru') dhe jolegalja (gajr'ul-meshru') njihen me anë të mendjes (akl), kurse urdhri (emr) dhe ndalimi (nehj) hyjnor i tregojnë ato. Esh'arinjtë mendojnë se e mira dhe e keqja nuk mund të njihen me anë të mendjes por ato konstatohen me anë të ligjit (shariatit), respektivisht diçka është e mirë pasi që urdhërohet fetarisht.
4. Maturidinjtë mendojnë se Allahu e ka një atribut të veçantë të pavarur, të cilin e quajmë tekwin التكوين, që do të thotë, “krjimi”. Esh'arinjtë mendojnë se ky atribut përfshihet te atributi el-kudretu (القدرة), që do të thotë, “fuqia”.⁴⁴
5. Maturidinjtë mendojnë se besimtari ka të drejtë të thotë “Unë pa dyshim jam besimtar”, sepse alternativa e shkatërron besimin (imanin).

Kurse el-esh'arinjtë e fusin problemin e përjashtimit (el-istithna) dhe thonë: “Unë pa dyshim jam besimtar nëse Zoti dëshiron”. Mirëpo, ky mendim bie në kundërshtim me ajetin kur'anor: “Besimdrejtë janë

⁴³ Shih gjerësisht: Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, po aty, fq. 143-145.

⁴⁴ Sipas: Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, po aty, fq. 146. Edhe Ahmed Emin mendon se çështjet që ndajnë EL-Esh'ariun dhe El-Maturidiun nuk janë më shumë se 40 sosh. Sipas: Ahmed Emin, Dhuhur'ul-islam, libri 4, botimi V, Kajro, 1982, fq. 92-93.

*vetëm ata që i besojnë Allahut dhe të Dërguarit të Tij e pastaj nuk dështojnë...". (El-Huxhurat, 15).*⁴⁵

VI. Pasardhësit e El-Esh'ariut

Metodat e El-Esh'ariut qenë tërheqëse për shumë dijetarë, por sidomos për pasuesit e shkollës juridike shafi'ite edhe sa ishte gjallë vetë ai. Por, mësimet e El-Esh'ariut u përhapën edhe pas vdekjes së mësuesit, kurse këtë punë e kryen nxënësit e tij të shumtë dhe të famshëm dhe disa sundues myslimanë, të cilët doktrinën el-esh'arite e bënë doktrinë zyrtare dhe me mekanizmat shtetërorë e përhapën këtë doktrinë. Ka shumë, por dijetarët më të famshëm janë: Sehl Saluki, Shejh Ebu Muhammed Taberiu dhe Ebu Hasan Bahiliu. Radha e dytë e nxënësve të njohur jep këta emra: Kadi Ebu Bekr El-Bakil-laniu, Ebu Bekr bin Furaku, Ebu El-Kasim El-Kushejriu, Ebu Is'hak Isfira-iniu, Abdulkadir El-Bagdadiu, Ebu El-Meali El-Xhujevniu i njohur si Imam'ul-Haremejn, El-Gazaliu⁴⁶, Ibn Tumarti, Shehrestani, Fahrud-din Rraziu, Azududdin Ixhiu, Xhurxhaniu, Senusiu⁴⁷ etj. etj.

Ç'i tërhiqte të gjithë ata dijetarë për El-Esh'ariun? Mendoj se ai prej shumë tipareve shquhej sidomos me: jetën e tij shembullore, mendimin e tij me vlera religjioze dhe me përpjekjen e tij që t'i ruajë ato. Me rëndësi ishte edhe ajo që tërthorazi u theksua edhe në pjesë të tjera të këtij shkrimi se, El-Esh'ariu shërbeu si digë dhe strehim i fuqishëm kundër literalizmit të ngushtë të njerëzve të hadithit dhe kundër racionalizmit ekzagjerues të mu'tezilitëve. Kjo bëri që ai të gjendet në atak të ish-shkollës së tij mu'tezilizmit për shkak të tradhtisë së tij por edhe në atak të hanbelizmit që, sipas tyre, El-Esh'ariu nuk mori guxim të afrohet në burimet e Islamit. Ai u gjend edhe në atak hanefito-maturidizmit, të cilët ia zënin për të madhe që esh'arizmi bëri një reformë të

⁴⁵ Shih gjerësisht: Imam El-Maturidiu, Jeta, vepra dhe mësimi, Prishtinë, 2003, fq. 71-72 dhe fusnotat 118-123. Shih edhe: Nerkez Smailagic, Klasicka ..., po aty, fq. 161-162.

⁴⁶ M. M. Sharif, po aty, fq. 242. Nerkez Smailagic, Leksikon Islama, Sarajevë, 1990, fq. 80.

⁴⁷ Henry Corben, po aty, fq. 133.

pasuksesshme, e kritikonin konservatizmin dhe konformizmin e kësaj shkolle.⁴⁸

Përkundër të gjithë faktorëve të disfavorshëm dhe përkundër kritikave, shkolla zhvillohej dhe përhapej relativisht shpejt. Fillimisht mësimet el-esh'arite qenë pranuar vetëm brenda shkollës së tyre, duke mos u pranuar nga hanefinjte-maturidinjte, as dhahirinjte, por më të rreptit kundër tyre qenë hanbelitët. Me kalimin e kohës, sidomos me institucionalizimin e doktrinës el-esh'arite nga ana e Nidham'ul-Mulkut në Medresenë Nidhamijje në shekullin V hixhrij / XI g., dhe shkollat e tjera në sundimin e tyre⁴⁹, doktrina el-esh'arite, pak a shumë, depërtoi thuajse në tërë botën myslimane.⁵⁰ Përjashtim bënë aty ku vehabizmi dominon. Vija hanbelite-vehabiste mendojnë se el-maturidizmi dhe el-esh'arizmi janë jashtë rrugës islame. Madje, edhe një enciklopedi, nga e cila pritej të ofrojë shkrime të nivelizuara e shkencore, shkollën el-esh'arite dhe el-maturidite do ta gjejmë nën titullin "Sektet ideologjike në Islam" bashkë me shi'itët, ibaditët, mu'tezilitët, zejditët.⁵¹ Natyrisht, këto ide janë të pranuar vetëm brenda tyre dhe paraqesin ide retrograde, maksimalisht përçarëse dhe të gjykuara në shkatërrim dhe me qëndrimet e këtilla sektare ata e pozicionojnë veten në një sekt.

⁴⁸ Henry Corben, po aty, fq. 131.

⁴⁹ Islamil R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, po aty, fq. 291.

⁵⁰ Përhapjen e el-esh'arizmit e ndihmoi edhe dhuna shtetërore, herë me metoda institucionale e herë-herë edhe me dhunë. Shih: Nerkez Smailagic, Klasicka ..., po aty, fq. 162-163.

⁵¹ Në këtë enciklopedi do të gjeni qëndrime jomaturidite që i mvëshen atij, dhe joesh'arite që i mvëshen atij, me qëllim të diskreditimit të tyre. Është e qartë se këta autorë vehabinjë fare nuk janë konsultuar me veprat origjinale të këtyre dijetarëve të mëdhenjë, por flasin me hamendje dhe me plotë shpifje. Shih: El-Mewsuat'ul-mujessereh - Islamska enciklopedija, redaktor dhe recensent: Mani' El-Xhuhenij, Sarajevë, 1427 h./2006, fq. 79-89 por edhe fq.69-78.

Nxënësit më të dalluar esh'arite

Ebu Bekr El-Bakil-laniu (vd. 403 h./1013)

Nuk është e qartë data e lindjes së El-Bakil-laniut, por dihet se u lind në qytetin Basra. Me përkatësi medhhebore ishte malikit, që më vonë ka ecur më tepër drejt el-esh'arizimit. U shkollua në Bagdad por edhe nga mësues të tjerë jashtë Bagdadit. Ai është autor shumë produktiv, por deri te ne kanë arritur disa prej tyre. Vepra kryesore e tij është Kitab'ut-temhid, e cila përmban reagim të ashpër kundër ateizmit, mu'tezilizmit dhe shi'izimit.

El-Hakim En-Nisaburiu (vd. 405 h./10140)

El-Esh'arizmi En-Nisaburin e konsideron të vetin. Ka shkruar nga hadithi Mustedrekun dhe një jetëshkrim për Shafiun.

Ibn Furaku (vd. 406 h./1015)

Për Ibn Furakun dihet pak. Është me prejardhje nga Ispahani, kurse u arsimua në Basra dhe Bagdad. Një kohë jetoi në Re'j dhe Nishapur, ku udhëhiqte edhe me medresenë e qytetit.

Ebu Is'hak El-Isfera'iniu (vd. 418 h./1027)

Pak dihet edhe për të. Ishte pjesëtar i shkollës së Nishapurit, kurse e udhëhiqte grupin studiues dhe mësonte nxënës të shumtë.

Ebu Mensur El-Bagdadiu (vd. 429 h./1037)

Pas pushtimit të Nishapurit nga gaznevitët El-Bagdadiu shkoi në Isfarain. Vepra e tij *Kitab usul'id-din* është ndër veprat më të shtrira të doktrinës el-esh'arite në fillim të shekullit XI. Po ashtu, vepra *El-Ferk bejn'el-firek*, me karakter hereziografik, sjell dokumentacion të bollshëm dhe argumente për refuzimin e tyre. Ishte më i butë ndaj sufizmit.

Ebu Bekr El-Bejhekiu (vd. 458 h./1066)

Tradicionalist, nxënës i En-Nisaburit dhe jurist i çmuar shafiit. Është autor i Kitab ul-mearif, por edhe i përmbledhjes së njohur Kitab'us-sunen. Përpiqej t'i pajtonte drejtimit el-esh'arite dhe hanbelite.⁵²

Nxënësit e kësaj shkolle kanë vazhduar të veprojnë me sukses relativ dhe deri në ditët e sotme paraqesin digë të fortë në mbrojtjen e Islamit. Krahës mesimit hanefito-maturidit el-esh'arinjtë po ofrojnë kontribut të vyer në rrugën e pasuesve të sunetit dhe xhematit.

Literatura:

1. Abu Al-Hasan Al-As'ari, Kitab'ul-lum'a fi'r-rreddi ala ehl'iz-zejgi we'l-bidei, Bejrut, 1953 ose botimi boshnjak: Bit polemike sa otpadnicima i inovatorima, përkthim bilingual, Sarajevë, 1421 h./ 2000.
2. Adnan Siljadzic, Filozofijska teologija Abu al-Hasan al-As'arija, Sarajevë, 1999 (tezë doktorature).
3. Ahmed Emin, Dhuhur'ul-islam, libri 4, botimi V, Kajro, 1982.
4. Bekir Topaloglu, Hyrje në kelam, Prishtinë, 2002.
5. Cyril Glasse, Enciklopedija Islama, Sarajevë, 2006.
6. El-Esh'arij, El-Ibanetu an usuli'd-dijaneh, botimi I, Bejrut, 1423 h./ 2003.
7. El-Esh'arij, Kitab Mekalat'ul-islamijjin we ihtilaf'il-musal-lin, të redaktim të Hellmut Ritter, bot. III, Wiesbaden, 1980.
8. El-Esh'arij, Kitab'ul-lum'a (teksti arabisht-boshnjakisht), Sarajevo, 1421 h./ 2000.
9. El-Mewsuat'ul-mujessereh - Islamska enciklopedija, redaktor dhe recensent: Mani' El-Xhuheni, Sarajevë, 1427 h./2006.
10. Fazrul Rahman, Duh Islama, Beograd, 1982 -pritet të botohet shumë shpejt nga SHB Logos-A në Shkup.
11. Henry Corbin, Historia e filozofisë islame, Shkup, 1997.
12. Henri Laoust, Raskoli u islamu, Zagreb, 1989.
13. G. F. Haddad, Imam Abu'l-Hasan al-Ash'ari, në:
14. http://www.masud.co.uk/ISLAM/misc/al_ashari.htm . Data e marrjes së shkrimit më: 07. 05. 2009.

⁵² Henri Laoust, po aty, fq. 164-167.

15. Imam El-Maturidiu, Jeta, vepra dhe mësimi, E përgatiti, parathënien e shkroi dhe e përktheu: Nexhat Ibrahim, Prishtinë, 2003.
16. Islamil R. al Faruqi and Lois Lamya al Faruqi, The Cultural Atlas of Islam, New York - London, (Përkthimi jepet sipas përkthimit shqip në dorëshkrim).
17. M. M. Sharif, Historija islamske filozofije, I, Zagreb, 1988.
18. Mewsuat'ul-edjan, botimi I, Bejrut, 1422 h./ 2001.
19. Muhammed Ebu Zehreh, Tarih'ul-medhahib'il-islamijeh, Kajro, pa vit botimi.
20. Nerkez Smailagic, Klasicka Kultura Islama, I, botimi II, Zagreb, 1976.
21. Nerkez Smailagic, Leksikon Islama, Sarajevë, 1990.
22. Nexhat Ibrahim, Imam Ebu Hanifeh dhe Imam El-Maturidiu - perla të akaidit islam, Prishtinë, 2007.
23. Sa'd Abdulaziz, Felasifet'ul-islami, Kajro, 1977.
24. Umer Ferruh, Tarih'ul-fikr'il-arabij ila ejjami Ibni Haldun, botimi IV, Bejrut, 1983.

Shtojcë:⁵³

Veprat e Imam Ebu'l-Hasan El-Esh'ariut

I. Veprat e El-Esh'ariut të shkruara deri në vitin 320, të numëruara në veprën El-'Umad:

- Edeb 'ul-Xhedel ("The Etiquette of Disputation").
- El-Esma' we'l-ahkam ("The Names and the Rulings"), which describes the divergences in the terminology of the scholars and their understanding of the general and the particular.
- Ed-Dafi' li'l-Muhadhdhab ("The Repelling of 'The Emendation'"), a refutation of al-Khalidi's book by that title.
- El-Funun ("The Disciplines"), a refutation of atheists. A second book bearing that title was also written, on the disciplines of kalâm.
- El-Fusul ("The Sub-Headings") në 12 vëllime, a refutation of the philosophers, perennialists, and members of various religions such as Brahmans,

- Jews, Christians, and Zoroastrians. It contains a refutation of Ibn al-Rawandi's claim that the world exists without beginning.
- Idah 'ul-Burhan fi 'r-rredd 'ala ehl'iz-zajg wa't-tug'jan ("The Clarification of the Proof in the Refutation of Heretics"), a preliminary to El-Muxhez.
- El-Idrak ("The Awareness"), on the disciplines that address the subtleties of dialectic theology.
- El-Istita'a ("Potency"), a refutation of the Mu'tazila.
- El-Xhewabat fi's-sifat 'an Masa'il ehl'iz-zajg wa'sh-shubuhât ("The Replies Pertaining to the Attributes On the Questions and Sophistries of Heretics"), al-Ash'ari's largest work, a refutation of all the Mu'tazili doctrines he had upheld previously.
- El-Xhewhar fi'r-rreddi 'ala ehl'iz-zajgi we'l-munker ("The Essence: Refutation of the People of Heresy and Transgression").
- El-Xhism ("The Body"), a proof of the Mu'tazila's inability to answer essential questions that pertain to corporeality, contrary to Ahl al-Sunna.
- Xhumal 'ul-Mekalat ("The Sum of Sayings"), which lists the positions of atheists and the positions of monotheists.
- Halk'ul-A'mal ("The Creation of Deeds"), a refutation of the doctrine of the Mu'tazila and Qadariyya whereby man creates his own deeds.
- El-Lum'a fi'r-rreddi 'ala ehl'iz-zajg wa'l-bida' ("The Sparks: A Refutation of Heretics and Innovators"), a slim volume.
- El-Luma' el-kebir ("The Major Book of Sparks"), a preliminary to Idah 'ul-Burhan and, together with the Luma' es-sagîr, the last work composed by al-Ash'ari according to our Shaykh 'Isa al-Humyari.
- El-Luma' es-sagîr ("The Minor Book of Sparks"), a preliminary to al-Luma' el-kebir.
- Mekalat 'ul-Falasifa ("The Sayings of Philosophers").
- Mekalat 'ul-Islamijjin we lhtilfa 'il-Musal-lin ("The Discourses of the Propponents of Islam and the Differences Among the Worshippers"), an encyclopedia of Islamic sects.
- El-Mesa'il 'ala ehl 'it-tethnijja ("The Questions in Refutation of the Dualists").
- El-Muxhez ("The Concise") in twelve volumes, which identifies and describes the various Islamic sects. It contains a refutation of the Shi'i doctrines of the questioning of Abu Bakr al-Siddiq's imamate and of the infallibility of the Imam in every era.
- El-Muhtesar fi't-tawhidi wa'l-kadar ("The Abridgment: On the Doctrine of Oneness and Foreordained Destiny"), a review of the different doctrinal issues which the opponents of Ahl al-Sunna are unable to address.

⁵³ Këtë listë veprash do ta ofrojmë sipas tekstit të: Dr. G. F. Haddad, Imam Abu'l-Hasan al-Ash'ari, në: http://www.masud.co.uk/ISLAM/misc/al_ashari.htm . Data e marrjes së shkrimit nga web faqja: 07. 05. 2009.

- El-Muhtazan (“The Safekeeping”), on the questions which opponents did not bring up but which pertain to their doctrines.
- El-Muntahal (“The Sifted”), a response to questions from the scholars of Basra.
- Nakd ‘ul-Balhi fi Usul ‘il-Mu‘tazila (“Critique of al-Balhi and the Principles of the Mu‘tazila”), a refutation of the book of the Mu‘tazili scholar al-Balkhi entitled Nakd Ta‘wil ‘ul-Adil-la (“Critique of the Interpretation of the Textual Proofs”).
- En-Nawadir fi Daka‘ik ‘il-Kelam (“The Rarities Concerning the Minutiae of Dialectic Theology”).
- El-Kami‘ li Kitab‘l-halidi fi‘l-Irada (“The Subduer: A Refutation of al-Khalidi’s Book on the Will”), a refutation of al-Khalidi’s doctrine whereby Allah creates His own will.
- Er-Rredu `ala Ibn er-Rawandi (“Refutation of Ibn al-Rawandi”) concerning the Divine Attributes and the Qur’an.
- Er-Rredu `ala Muhammad ibn `Abd al-Wahhab el-Xhubba‘i, an extensive refutation of a Mu‘tazili scholar and of his book al-Usul (“The Principles”).
- Er-Rredu `ala ‘l-Muxhessima (“Refutation of the Anthropomorphists”).
- A refutation of `Abbad ibn Sulayman in the minutiae of kalâm.
- A refutation of a book by `Ali ibn `Isa.
- A refutation of al-Balkhi’s book in which the latter claimed he had rectified Ibn al-Rawandi’s error in his disputation.
- A refutation of al-Iskafi’s book entitled al-Latif (“The Subtle”).
- A refutation of al-Jubba‘i on the principles and conditions of scholarly investigation and the derivation of rulings.
- A Refutation of al-Jubba‘i’s objections to al-Ash‘ari on the vision of Allah in the hereafter as reported by Muhammad ibn `Umar al-Saymari.
- A refutation of al-Khalidi’s book on the denial of the vision of Allah in the hereafter.
- A refutation of al-Khalidi’s book on the denial of the creation of the deeds of human beings by Allah Almighty and Exalted according to His decision.
- The refutation of the philosophers, especially the Perennialist Ibn Qays al-Dahri and Aristotle’s books “On the Heavens” and “On the World.”
- Er-Rru‘je (“The Vision”), which affirms the vision of Allah by the believers in the hereafter, contrary to the Mu‘tazili doctrine which denies the possibility of such a vision.
- Esh-Sherhu wa‘t-tafsilu fi‘r-rreddi `ala ehl‘il-Ifki wa‘l-tadlili (“The Detailed Explanation in Refutation of the People of Perdition”), a manual for beginners and students to read before al-Luma`.

- Es-Sifat (“The Attributes”), a description of the doctrines of the Mu‘tazila, Jahmiyya, and other sects that differ from Ahl al-Sunna on the topic of the Divine Attributes. It contains a refutation of Abu al-Hudhayl, Ma‘mar, al-Nazzam, al-Futi, and al-Nashi, and an affirmation that the Creator possesses a face and hands.
- Tafsir ‘ul-Kur’an wa‘r-rredu `ala man halafa el-bajan min ehl ‘il-ifki wa ‘l-buhtan (“A Commentary on the Qur’an and Refutation of Those Who Contradicted it Among the People of Perdition and Calumny”) which Ibn el-‘Arabi el-Maliki says numbered 500 volumes. Ibn es-Subki reports from edh-Dhahabi that this Tafsir was written at a time al-Ash‘ari was still a Mu‘tazili.
- Various epistles in response to questions from the scholars of Tabaristan, Khurasan, Arrujan, Sayraf, Amman, Jurjan, Damascus, Wasit, Ramahramuz, Baghdad, Egypt, and Persia.
- Zijadat ‘un-Newadir (“Addenda to ‘The Rarities’”).

II. Veprat e El-Esh‘ariut të shkruara ndërmjet viteve 320-324, të numëruara nga Ibn Furaku:

- Af‘al ‘un-Nabi Sal-lall-lahu `alejhi wa sel-lam (“The Acts of the Prophet - Allah bless and greet him”).
- El-Ahbar (“The Reports”).
- Bejan Madhhab en-Nasara (“Exposition of the Doctrine of Christians”).
- Hikajat Madhhab el-muxhessima (“The Tales of the Schools of the Anthropomorphists”), a refutation of the proofs they adduce.
- El-Ihtijaxh (“The Adducing of the Proofs”).
- El-Imama (“The Doctrine of the Imam”).
- Ithbat ‘ul-Kijas (“The Upholding of the Principle of Analogy”).
- Sessions around the lone-narrator report (el-haber ‘ul-wâhid).
- Muteshabih ‘ul-Kur’an (“The Ambiguities in the Qur’an”), in which he brought together the stands of the Mu‘tazila and the atheists in their invalidations of the ambiguities in the hadith.
- Nakd Ibn ‘r-Rawandi `ala Ibtal ut-Tawatur (“The Critique of Ibn al-Rawandi’s Denial of Mass-Narrated Hadiths”), which contains an affirmation of the principle of Consensus (ijmâ’).
- Nakd ‘ul-Mudahat (“Critique of ‘The Similarity’”), a refutation of al-Iskafi on the term qadar.
- Nakd ‘ul-Taxh `ala‘r-Rawandi (“The Diadem: Critique of Ibn al-Rawandi”).
- On questions put to al-Jubba‘i concerning names and rulings.

- A refutation of Abu al-Hudhayl on the limitlessness of the foreknowledge and decisions of Allah Almighty and Exalted and another on motions.
- A refutation of Harith al-Warraq on the Attributes.
- A refutation of the logicians.
- A refutation of the proponents of metempsychosis and reincarnation.
- El-`Umad ("The Supports") on the vision of Allah in the hereafter.
- El-Wukuf wa'l-`Umum ("The Abeyance of Rights and the Public at Large").

III. Ibn Asakiri thotë se, pos listës së Ibn Furakut, ka parë edhe vepra të tjera.

Ai numëron këto vepra:

- El-Hathth 'ala'l-Bahth ("The Encouragement to Research").
- Risalet'ul-Iman, an epistle on Belief which discusses whether it is permissible to say that belief is created. Ibn Haxhar heard it from Abu Ishaq at-Tannuhi with the latter's chain of transmission back to al-Ash'ari, through the latter's student Abu al-Hasan Ahmad ibn Muhammad ibn Miksam al-Mukri' al-Baghdadi.
- Risala ila ehl 'ith-Thugar ("Epistle to the People of al-Thugar"), a definition on the doctrines of Ahl al-Sunna.

Nexhat Ibrahimi

IMAM AL-ASH'ARI - the great teacher of sunni kalam (260 - 324 h./ 873 - 935)

(Summary)

I. The life of Imam Al-Ash'ari

Imam Tahawi (229-321 h./ 843-933) and Imam Maturidi (238- 333 h./853-944) were great Muslim scholars, followers of the Hanafi school of law. The two were contemporaries of Imam Al-Ash'ari. The three comprise the main pillars of the Sunni creed (al-sunnah and Jamaat).

نجد إبراهيم

الامام الاشعري – مدرس كبير لعلم الكلام

(260-324 هـ / 773-935)

(خلاصة البحث)

حياته و الظروف الاجتماعية:

في الزمن الذي عاش فيه الامام الاشعري تصادف ان عاش في الزمن امامان كبيران و هما: الامام الطهاري (943-933 / 321-229 هـ) و الامام الماتوريدي (853-944 / 33-238 هـ) و الاثنان تابعان للمذهب الحنفي. هؤلاء العلماء الثلاثة يمثلون المثلث المشهور و ثلاثة أعمدة قوية للمذهب السني (أهل السنة و الجماعة)

AKAID

Orhan Bislimaj

NDALOHET PËRJASHTIMI
“INSHALLAH” NË BESIM

(الاستثناء في الإيمان)

(Shpjegim akaidologjik i thënies së Ebu Hanifes r.h.)

قوله: و المؤمن مؤمن حقاً و الكافر كافر حقاً، و ليس في الإيمان شك كما أنه ليس في الكفر شك لقوله تعالى: أُولَئِكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقّاً و أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقّاً.

Imam Ebu Hanife r.a. ka thënë: “Besimtari është besimtar i vërtetë, ndërsa jobesimtari është jobesimtar i vërtetë. Brenda imanit, nuk mund të ekzistojë dyshimi, sikurse që brenda ku-firit nuk mund të ekzistojë dyshimi, sipas fjalës së Allahut të Lartësuar: “Të tillët janë besimtarë të vërtetë...”¹; dhe: “Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë...”²”³

¹ Kur’ani, El-Enfal:4.

² Kur’ani, En-Nisa:151.

³ Ebu Hanife “Kitabu’l-vesijeti”, sipas: Doç. Dr. Mustafa Öz, “Imam-i A’zamin beş ese-ri, El Alim ve’l muteal-lim; El Fikhu’l Ebsat; El Fikhu’l Ekber; Risaletu Ebi Hanifete; El-Vesijeh” Stanboll, 1992, fq. 87.

Hyrje

Besimi-imani, paraqet besueshmërinë e vërtetë dhe të sigurt të nje-riut në Allahun e Lartësuar. Si i tillë nuk lejohet të lëkundet asnjëherë dhe në asnjë rrethanë. Është obligim i besimtarit që ta ruajë karakterin e besimit të tij të mirëfilltë. Në këtë aspekt, ai duhet të tregojë vendos-mëri në besim dhe të refuzojë çdo veti që e luhatë besueshmërinë e tij. Sepse luhatja është vetë dyshimi, ndërsa dyshimi drejtpërdrejt shpie në mosbesim.

Përkufizimi i çështjes

Imam Ebu Hanife r.h. në thënien e tij të sipërthënë, potencon një çështje të rëndësishme besimore, e cila në shkencën e Kelamit njihet si “**përrjashtimi në besim**” (الاستثناء في الإيمان), dhe ka të bëjë me frazën “inshallah” (nëse do Allahu). Do të thotë, në pyetjen ndaj një njeriu se: a je besimtar?, ai përgjigjet: “unë jam besimtar inshallah” (أنا مؤمن (إن شاء الله)). Kjo mënyrë e përgjigjes, respektivisht shtimi i frazës “in-shallah”, është poenta e çështjes, që disa prej dijetarëve e kanë lejuar, e disa të tjerë e kanë ndaluar rreptësisht.

Si gjithnjë Ebu Hanife r.h. prin në çështjet delikate të besimit. Edhe në këtë çështje, Imami A’dham Ebu Hanife r.h. ndalon që besi-mtari të thotë: “unë jam besimtar inshallah”, sepse paraqet dyshim në besim, ndërsa dyshimi në besim është mosbesim. Por, besimtari duhet të thotë: “unë jam besimtar i vërtetë” (أنا مؤمن حقاً). Pra, në vend të fjalës “inshallah” (nëse do Allahu), duhet të thotë “hak-kan” (i vërte-të).

Le të themi se kjo çështje, për nga ndërlikueshmëria, u bashkën-gjitet atyre çështjeve të nxehta akaidore, që kanë qenë edhe arsye për disa dijetarë të cekët (me theks të veçantë pretenduesit e jomedhhebi-zmit) që ta akuzojnë për gabim të madh dijetarin e të gjitha kohërave, imamin e medh’hebit tonë hanefij, Ebu Hanife, Allahu e ndriçoftë va-rrin e tij. Mirëpo, më poshtë, do të shohim se qëndrimi i Ebu Hanifes

r.h. është mendimi dominant, i bazuar në fuqishmërinë e argumenteve tradicionale dhe të arsyes.

Qëndrimet e dijetarëve rreth përjashtimit në besim

Rreth çështjes së përjashtimit (inshallah) në besim, dijetarët ndahen në dy grupe:

1. **Ata që e lejojnë “përjashtimin” në besim.** Të këtij mendimi janë një pjesë e selefit, madje sahabë dhe tabiinë sikurse kjo tregohet nga Shafiu r.a., të cilët mbrojnë qëndrimin se lejohet ‘përjashtimi’ (inshallah) në iman, e që shprehet duke thënë: “unë jam besimtar inshallah” (أنا مؤمن إن شاء الله).⁴ Të këtij mendimi janë edhe të gjithë fraksionet konservatore, që ftojnë në jomedh’hebizëm (mohim të shkollave juridike); dhe që tekstet tradicionale i marrin në aparençën e tyre, pa u thelluar fare në studimin e objektivave të fesë; dhe
2. **Ata që e ndalojnë “përjashtimin” në besim.** Të këtij mendimi janë një pjesa dërrmuese e selefit, prej tyre Ebu Hanife r.a. dhe nxënësit e tij, të cilët mbrojnë qëndrimin se nuk lejohet ‘përjashtimi’ në iman, por besimtari duhet të thotë: “unë jam besimtar i vërtetë” (أنا مؤمن حقا), për të eliminuar çdo lloj dyshimi.⁵

Shprehja “inshallah” dhe përdorimi i saj

Më lart pamë se objektivi i çështjes është thënia “inshallah” me rastin e deklarimit të imanit. Pra, kur njeriu thotë se “unë jam besimtar”, ia shton menjëherë edhe përjashtimin “inshallah”- nëse do Allahu. A lejohet të thuhet ky ‘përjashtim’ apo nuk lejohet? Prandaj, për ta kup-

⁴ El-Mulla Alij bin Sulltan, El-Kari El-Hanefijj, “*Sherhu Kitabi’l fikhi’l ekber*”, me tahkik të Alijj Muhamed Dendel, boton ‘darul kutubi’l ilmiyyeh’, botimi i parë, Bejrut-Liban, 1995/1416, fq. 239.

⁵ Shih: El-Al-lametu Mes’ud bin Umer bin Abdullah, Sa’dud-din Et-Taftazani, “*Sherhu’l mekasid*”, botimi i parë, 2001/1422, boton ‘darul kutubi’l ilmiyyeh, Libon Bejrut, vëll. III, fq. 450.

tuar çështjen e lejimit apo ndalimit të “përjashtimit” në iman, nevojitet ta njohim frazën “inshallah” dhe domethëniet e saj relevante.

1. Faza inshallah, është shprehje e gjuhës arabe dhe përbëhet nga tri pjesë: in+sha+Allahu, që do të thotë: “nëse+do+Allahu”. Folja “sha - do”, referon dëshirën apo vullnetin e Allahut. Ndërsa dëshira apo vullneti i Allahut është çelësi i ekzistimit të çdo gjëje që ekziston në gjithësi, përfshirë njeriun, veprimet e tij, perceptimet, mendimet etj. Në këtë aspekt, dijetarët e kanë themeluar parimin për të cilën janë të një mendimi edhe selefi (të parët) edhe halefi (të mbramët) se:

مَا شَاءَ اللَّهُ كَانَ وَمَا لَمْ يَشَأْ لَمْ يَكُنْ

“Çka ka dashur Allahu ka ekzistuar dhe çka nuk ka dashur nuk ka ekzistuar”⁶

Sipas këtij parimi, konkludojmë se shprehja “inshallah” - nëse do Allahu, në kuptimin e saj të vërtetë, ekskluzivisht ka për qëllim vërtetimin e ekzistimit të një gjëje nga dëshira e Allahut. Mohimi i këtij parimi apo të kontestuarit e tij, konsiderohet kontradiktë e besimit (imanit). Sepse nëse nuk e vërtetojmë dëshirën e Allahut për çdo gjë që ekziston, atëherë lë të kuptohet se në krijimin e Allahut mund të ndodhka edhe ajo që nuk është vullneti i Tij, gjë që konsiston pafuqinë e të Lartësuarit. Prandaj, meqë shprehja “inshallah”, aludon ekzistimin e subjekteve nga dëshira e Allahut, po kështu me rastin e deklarimit të imanit, ajo referon esencën e imanit, me të gjitha atributet e tij.

2. Shprehja “inshallah”, konsiston dyshimin dhe pandehen. Përjashtimi si nocion nuk përdoret në sferën e arritjes në njohje dhe dije, por ajo përdoret në sferën e dyshimeve dhe pandehmave:

لأن الإستثناء لا يستعمل في موضع الإحاطة و العلم، وإنما يستعمل في موضع الشكوك و الظنون.⁷

⁶ Pjesë e hadithit (shih: Suneni i Ebu Davudit, Kitabu: Es-sunnetu, babu: Luzumus-suneti, hadithi nr. 3996).

⁷ Belkasim El-Gali “*Ebu Mensur El-Maturidi –hajatu ve arauhu el-akdiyyetu*” boton: darut-turkij lin-neshri’ 1989, Tunis, fq. 247.

3. Shprehja “inshallah” konsiston pasigurinë e njeriut për një veprim që akoma s’ka ndodhur⁸. Allahu na ka mësuar në Kur’an, se shprehja “inshallah” implikon dëshirën e njeriut për ekzistimin e një çështjeje e cila akoma nuk ka ndodhur dhe jo për një çështjeje e cila ka ndodhur. I Lartësuar thotë:

وَلَا تَقُولَنَّ لشيءٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَلِكَ غَدًا إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ وَادْكُرْ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ وَقُلْ عَسَى أَنْ يَهْدِيَنِي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِنْ هَذَا رَشَدًا

“Dhe mos thuaj kurrësi për ndonjë çështje: ‘unë do ta bëj këtë nesër!’. Vetëm (nëse i shtoni): Në dashtë Allahu!. E kur të harrosh, përmende Zotin tënd dhe thuaj: shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij” (El-Kehf, 23-24).

Pra, çdo çështje që e aspirojmë për ta bërë, atë e ndërlidhim për dëshirën e Allahut. Nëse do Allahu ajo çështje do të ndodhë, e nëse do Ai ajo nuk do të ndodhë. P.sh., studenti thotë: “Inshallah e kam dhënë provimin”, apo “inshallah në muajin e ardhshëm do ta kryej fakultetin”, dhe shembuj të tjerë. Mirëpo, nuk është metodike dhe e drejtë që të themi “inshallah” për një punë që e kemi bërë. Një libër të cilin e kemi lexuar, nuk themi: inshallah e kemi lexuar, sepse nuk ka kuptim të bëhet një gjë e tillë, kur dihet sigurt se e kemi lexuar dhe se e kaluara deri në momentin që po flasim, është më se e sigurt se ka ndodhur me krijimin dhe dëshirën e Allahut.

⁸ Po ashtu, përdoret për ndodhien e asaj që ka premtuar Allahu se do të ndodhë ose i Dërguari i Tij, Muhamedi a.s.. Kur, fraza inshallah vjen në ndonjë citat kur’anor apo hadith të Pejgamberit, me të synohet mbështetja e të ardhmes te Allahu Lartësuar. P.sh. ajeti: **“inshallah (me vullnetin e Allahut) do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të sigruar...”** (El-Fet’h, 27). Mirëpo, ky aspekt, nuk është objekt shqyrtimi, sepse e vërteta e kësaj është e padiskutueshme dhe nuk përmban kurrfarë dyshimi në atë që i referohet fraza “inshallah”.

Argumentet e dijetarëve, që lejojnë ‘përrjashtimin’ në iman

Dijetarët që e mbrojnë këtë qëndrim, sjellin argumente nga Kur’a-ni dhe Sunneti.

Argumentet nga Kur’ani:

Allahu i Lartësuar në Kur’an ka thënë:

لَقَدْ صَدَقَ اللَّهُ رَسُولَهُ الرُّؤْيَا بِالْحَقِّ لَتَدْخُلَنَّ الْمَسْجِدَ الْحَرَامَ إِنْ شَاءَ اللَّهُ آمَنِينَ مُحَلِّقِينَ رُءُوسَكُمْ وَمُقَصِّرِينَ لَا تَخَافُونَ فَعَلِمَ مَا لَمْ تَعْلَمُوا فَجَعَلَ مِنْ دُونِ ذَلِكَ فَتْحًا قَرِيبًا

“Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet: se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të sigruar, të rruani flokët e kokave tuaja, t’i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra, Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, andaj, para kësaj ju dha një fitore të shpejtë.” (El-Fet’h, 27). Dhe ajeti tjetër:

وَلَا تَقُولَنَّ لشيءٍ إِنِّي فَاعِلٌ ذَلِكَ غَدًا إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ وَادْكُرْ رَبَّكَ إِذَا نَسِيتَ وَقُلْ عَسَى أَنْ يَهْدِيَنِي رَبِّي لِأَقْرَبَ مِنْ هَذَا رَشَدًا

“Dhe mos thuaj kurrësi për ndonjë çështje: ‘unë do ta bëj këtë nesër!’. Vetëm (nëse i shtoni): Në dashtë Allahu!. E kur të harrosh, përmende Zotin tënd dhe thuaj: shpresohet se Zoti im do të më japë udhëzim edhe më të afërt prej këtij” (El-Kehf, 23-24).

Argumentet nga Hadithi:

1. Prej haditheve, është hadithi i Aishes r.a., e cila ka thënë: Pejgamberi a.s. në pjesën e fundit të natës dilte në varrezat ‘el-beki’ dhe thoshte:

السَّلَامُ عَلَيْكُمْ دَارَ قَوْمٍ مُؤْمِنِينَ وَأَتَاكُمْ مَا تُوْعَدُونَ غَدًا مُؤَجَّلُونَ

وَأَنَا إِنْ شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لِأَحِقُونَ اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِأَهْلِ بَقِيعٍ

“Es-selamu alejkum (shpëtimi i Allahut qoftë mbi ju) o ju besimtarë, ajo që ju është premtuar, do t’ju vijë nesër në afatin e caktuar. Edhe ne, inshallah (nëse do Allahu) do të vijmë pas jush. O Allah, fali banorët e varrezave bekie...”⁹

2. Hadithi i shefatit (ndërmjetësimit) në Ditën e Gjykimit, ku Pejgamberi a.s. ka thënë:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ لِكُلِّ نَبِيٍّ دَعْوَةٌ مُسْتَجَابَةٌ فَتَعَجَّلْ كُلُّ نَبِيٍّ دَعْوَتَهُ وَإِنِّي اخْتَبَأْتُ دَعْوَتِي شَفَاعَةً لِأُمَّتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ فَهِيَ نَائِلَةٌ إِنْ شَاءَ اللَّهُ مِنْ مَاتَ مِنْ أُمَّتِي لَا يُشْرِكُ بِاللَّهِ شَيْئًا

“Për secilin pejgamber ka një lutje që do të gjejë përgjigje, dhe secili pejgamber e ka ngutur bërjen e lutjes së vet. Ndërsa unë e kam fshehur lutjen time, që ajo të jetë ndërmjetësimit për popullin tim, dhe ajo do t’i arrijë në dashtë Allahu secilit prej ymetit tim që ka vdekur duke mos i bërë me asgjë rivalitet Allahut”¹⁰

Argumentet që ndalojnë ‘përrjashtimin’ në iman

Argumentet e dijetarëve që e ndalojnë ‘përrjashtimin’ në iman, janë të mirëfillta, që burojnë nga Kur’ani dhe Sunneti.

A) Argumentet nga Kur’ani:

1. Allahu i Lartësuar, në mënyrë të prerë ka dëshmuar për besimin e atij që beson në Allahun dhe të dërguarit e Tij, pa e ndërlidhur këtë me përrjashtimin ‘inshallah’ (nëse do Allahu). I Lartësuar i ka thënë:

⁹ Sahihul Muslim, Kitabu: El-xhenaizu (babu: ma jukalu indeed-duhulil kuburi ved-dua liehliha), nr.1718

¹⁰ Muttefekun alejhi sipas hadithit të Ebu Hurejres. “Sahihu’l Muslim” op.cit. Kitabu Imani, hadithi, Nr. 490.

أَمَّا الرَّسُولُ بِمَا أُنْزِلَ إِلَيْهِ مِنْ رَبِّهِ وَالْمُؤْمِنُونَ كُلٌّ آمَنَ بِاللَّهِ وَمَلَائِكَتِهِ وَكُتُبِهِ وَرُسُلِهِ لَا نَفَرَقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِنْ رُسُلِهِ وَقَالُوا سَمِعْنَا وَأَطَعْنَا غُفْرَانَكَ رَبَّنَا وَإِلَيْكَ الْمَصِيرُ

“I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi Allahut, engjëjve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij dhe thanë: Iu përgjigjem (thirrjes) dhe respektuam (urdhrin). Kërkojmë faljen tënde o Zot ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë.” (El-Bekare, 285)

2. Allahu i Lartësuar, i ka lavdëruar besimtarët për qëndrimin e tyre të prerë në besim, përsëri pa e ndërlidhur këtë me shprehjen e përjashtimit ‘inshallah’ (nëse do Allahu). I Lartësuar i duke përmendur qëndrimin e besimtarëve ka thënë:

رَبَّنَا إِنَّا سَمِعْنَا مُنَادِيًا يُنَادِي لِلْإِيمَانِ أَنْ آمِنُوا بِرَبِّكُمْ فَآمَنَّا رَبَّنَا فَاغْفِرْ لَنَا ذُنُوبَنَا وَكَفِّرْ عَنَّا سَيِّئَاتِنَا وَتَوَفَّنَا مَعَ الْأَبْرَارِ

“Zoti ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat tonë dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!”. (Ali Imran, 193).

Në këto ajete (dhe shumë të tjera), Allahu nuk i ka urdhëruar besimtarët, që të thonë përrjashtimin “inshallah” në besim.¹¹

B) Argumentet nga Hadithi:

1. Imam Ebu Hanife r.a., në veprën e tij “El-Fikhu’l-Ebsat” (kaptina mbi kaderin), ka thënë: “Njeriu duhet të thotë: unë jam besimtar i vërtetë, për të vërtetuar se nuk dyshon në imanin e tij.” I është thënë: A mund të jetë imani i tij, i ngjashëm me imanin e melaikëve?. Ebu Hanife ka thënë: Po. I është thënë: A edhe nëse ka mangësi në

¹¹ Dr. Muhamed bin Abdur-Rrahman El-Ham-mis “Usulud-din inde’l-Imami Ebi Hanife-te”, boton darus-samii’ij, botimi i dytë 1428 / 2007, Rijad, fq. 417.

zbatimin e veprave ai është besimtar i vërtetë? Ebu Hanife tha: ma kanë transmetuar hadithin e Harithit kur me një rast Pejgamberi a.s. i ka thënë atij:

قال له: كيف أصبحت؟ قال أصبحت مؤمناً حقاً، قال أنظر ما تقول فإن لكل حق حقيقة فما حقيقة إيمانك؟ فقال عزفت نفسي عن الدنيا حتى أظلمات تخاري وأسهرت ليلي. فكأنني أنظر إلى عرش ربي، وكأني أنظر إلى أهل الجنة يتزاوون فيها، وكأني أنظر إلى أهل النار حين يتعلون فيها. فقال رسول الله صلى الله عليه وسلم أصبت فألزم، أصبت فألزم، ثم قال من سره أن ينظر إلى رجل نور الله تعالى قلبه فليُنظر إلى حارثة ثم قال: يا رسول الله أدع الله لي بالشهادة، فدعا له بها فاستشهد.

“Si u zgjove nga gjumi? (Harithi) tha: jam zgjuar si besimtar i vërtetë. (Pejgamberi a.s.) Tha: ke kujdes çka po thua, sepse çdo e vërtetë e ka të vërtetën e vet, cila është e vërteta e imanit tënd? (Harithi) Tha: jam distancuar nga kënaqësitë e kësaj bote, gjersa ditën e kalojë me etje (agjërim) e natën me pagjumësi (ibadet). Më duket sikur po e shoh Arshin e Zotit tim, pastaj sikur po i shoh banorët e xhennetit duke vizituar njëri tjetrin, dhe banorët e xhehennemit në kohën kur përpëliten në të. I Dërguari s.a.v.s. tha: ia ke qëlluar, përmbaju kësaj, ia ke qëlluar, përmbaju kësaj!, pastaj vazhdoi: kush dëshiron që ta shoh një njeri, të cilit Allahu ia ka ndriçuar zemrën e tij, le ta shikojë Harithin! (Harithi) Tha: o i Dërguari i Allahut lute Allahun për mua që të bjerë dëshmor. (Pejgamberi a.s.) u lutë për të dhe ai vdiq dëshmor.”¹²

2. Transmeton Abdullah bin Zejd El-Hatmij, se Pejgamberi a.s. ka thënë:

إذا سئل أحدكم مؤمن أنت فلا يشك

“Nëse dikush nga ju pyetet: a je besimtar?, të mos dyshojë në besimin e vet.”

3. Transmeton Alij bin Ebi Talibi, i cili ka thënë:

كنا جلوسا عند النبي إذ دخل علينا عويمر أبو درداء فقال: يا نبي الله إني أقول أنا مؤمن حقاً، فقال: يا أبا درداء إن لم تقل حقاً فكأنك قلت أنا مؤمن باطلاً

“Kemi qenë ulur te Pejgamberi a.s., kur ja hyri Uvejmir Ebu Derdai dhe tha: O Pejgamber i Allahut, unë e deklaroj besimin duke thënë: “unë jam besimtar i vërtetë”. (Pejgamberi a.s.) Tha: o Ebu Derda nëse nuk thua “i vërtetë”, atëherë sikur po thua “unë jam besimtar jo i vërtetë”.

Dhe hadithe të tjera.

Konfrontimi i argumenteve

Duket qartë, se argumentet e dijetarëve që e lejojnë përjashtimin në iman, respektivisht ajetet dhe hadithet e sjella më lart përkritazi për këtë, nuk kanë kurrfarë relevance me çështjen në fjalë. Sepse, fraza inshallah (nëse do Allahu), e cila konsiderohet frazë e përjashtimit në besim, në citatat e lartcekura, nuk ka të bëjë me gjendjen momentale të besimit të myslimani. Ndërsa, diskutimi i çështjes fokusohet nga këndvështrimi përse ‘përjashtimi’ në besim ndodh pikërisht në gjendjen momentale të besimtarit. Kur besimtari e thotë frazën e përjashtimit: unë jam besimtar inshallah, ai në fakt e ka vënë në pikëpyetje gjendjen momentale të besueshmërisë së tij, e jo gjendjen e ardhshme. Pra, poenta e çështjes është gjendja momentale e besueshmërisë së myslimanit e jo ajo e ardhshmja.

Prandaj, “Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet: se me vullnetin e Allahut do të hyni në xhaminë e shenjtë (në Qabe) të siguruar...” (El-Fet’h, 27); aludon në një sukses që do të ndodhë në të ardhmen, dhe nuk ka kurrfarë relevance me gjendjen momentale. Për këtë ajete, respektivisht për synimin e përjashtimit ‘in-

¹² Ebu Hanife “El-Fikhul Ebsat” (kaptina mbi kaderin), cituar sipas: Doç. Dr. Mustafa Öz, “Imam-i A’zamin...” op.cit. 52.

shallah', Imam Maturidiu, jep disa komentime, gjersa paraprakisht thotë se të vërtetën e tij më së miri e di Allahu i Lartësuar. Ai thotë:

1. Është një lajm, të cilin (Pejgamberi a.s.) e ka lajmëruar se është thënie e Allahut dhe jo e tij, prandaj nuk ka thënë: letedhulenne in shitu - do të hyni nëse dua unë, por ka thënë: inshallah - "nëse do Allahu", për të bërë me dije se është thënie (premtim) i tjetërkujt (Allahut).
2. Allahu e ka mësuar të Dërguarin e Tij, që ta thotë atë (ëndrrën), dhe ta shoqërojë me përjashtimin (inshallah), pasi që ajo (hyrja në xhaminë e shenjtë), është premtim i Allahut. Me këtë rast sikur i Lartësuari ka thënë: **"Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: 'unë do ta bëj këtë nesër!'. Vetëm (nëse i shtoni): Në dashtë Allahu!..."** (El-Kehf, 23-24). Pasi që Allahu "hyrjen" e ka mbështetur te Vetja e Tij, dhe ajo është premtim, përjashtimi (inshallah) vjen për ta eliminuar frikën për një gjë të tillë;
3. Pejgamberi a.s. i ka informuar shokët e tij për hyrjen në xhaminë e shenjtë, por kohën e saktë nuk e ka pasur të qartë, prandaj e ka shoqëruar me përjashtimin inshallah; dhe mendime të tjera.¹³

Po kështu është edhe me hadithet e Pejgamberit a.s., të cilat, më drejtpërdrejt referojnë veprimet që do të ndodhin në të ardhmen, dhe atë në botën tjetër.

Prandaj, ajetet dhe hadithet, në të cilat përmendet 'përjashtimi' (inshallah), referojnë një realitet të caktuar që do të ndodhë në të ardhmen. E për të ardhmen, është shumë e vërtetë se jemi të thirrur, madje të obliguar që të themi inshallah - nëse do Allahu, sipas ajetit El-Kehf, 23-24. Lidhur me këtë, njëri ndër dijetarët eminent të maturidizmit, imam Gaznevij El-Hanefij thotë:

"Nëse thuhet: do të jem besimtar inshallah, do të vdesë besimtar inshallah, konsiderohet iman i pranuar nëse do Allahu të ndodhë dhe është veprim i arsyeshëm. Sepse, gjithmonë besimtari duhet të jetojë

¹³ Ebi Mensur Muhamed bin Muhamed bin Mahmud, El-Maturidijj Es-Semerkandij, "Kitabut-Tevhid", boton ISAM-i (Turkiye Diyanet Vakfi) me nr.318, botimi i parë, 1423/2003, Ankara, fq. 624.

ndërmjet frikës dhe shpresës, dhe në mënyrë të veçantë frikës së përfundimit të jetës. Kjo është prej çështjeve më të rëndësishme për të ardhmen e besimtarit. Njeriu nuk mund ta dijë nëse do ta përfundojë jetën e vet me iman apo me kufr. Në këtë pikë më së shumti kanë qarë ata që i kanë frikën Allahut. Nga ky aspekt, obligohet që të shprehet fraza e përjashtimit 'inshallah' (فمن هذا الوجه يجب الإستثناء). Mirëpo, konsiderohet dyshim (شكاً), kur ndodhë për vërtetimin e ekzistimit të imanit, vazhdimësinë e tij dhe pranimin e esencës së tij."¹⁴

Sa u përket atyre që thonë se fraza "inshallah" përdoret për qëllim të kërkimit të mirësisë (التبرك), kjo është jorelevante, sepse në pyetjen: a jeni besimtar?, nuk po kërkohet përgjigjja për mirësinë e besimit, por për deklarimin e identitetit të përkatësisë, dhe përgjigja duhet të jetë: "Po jam besimtar". E nëse shtrohet: "A jeni besimtar i vërtetë?", përgjigjja duhet të bëhet sipas pyetjes: "Po jam besimtar i vërtetë". Sikurse atij që i bëhet pyetja: "A jeni burrë?" Përgjigja është: "Po jam burrë", e nuk lejohet të thotë "po jam burrë inshallah".

Pikat konkluduese që e ndalojnë përjashtimin "inshallah" në iman

Argumentet, që e ndalojnë përdorimin e përjashtimit "inshallah", janë të gjithanshme. Pikat në vijim e vërtetojnë atë që dëshirojmë ta themi:

1. Është parim i prerë deklarimi i imanit dhe identifikimi me të dhe braktisja e përjashtimit në besim (elistithnau).¹⁵ Sepse, përjashtimi (elistithnau) si nocion nuk përdoret në sferën e arritjes në njohje dhe dije, por ajo përdoret në sferën e dyshimeve dhe pandehmave لأن الإستثناء لا يستعمل في موضع الإحاطة والعلم، وإنما يستعمل في موضع الشكوك والظنون.

¹⁴ Xhemalud-din Ahmed bin Muhamed, El-Gaznevijj El-Hanefijj, "Kitabu usulid-dini", tahkik ed-duktur Omer Vefik Da'uk, boton: darul beshairi'l islamijeh, botimi i parë, 1998/1419, fq. 264.

¹⁵ El-Maturidijj Es-Semerkandij, "Kitabut-Tevhid", op.cit. fq. 629.

Allahu i Lartësuar i ka tërhequr vërejtjen për këtë me Fjalën e tij “thumme lem jertabuu” **“Besimtarët janë vetëm ata që i besuan Allahut, të Dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan...”** (El-Huxhurat, 15), dhe e ka lavdëruar qëndrimin e prerë në besim, me urdhrin e Tij: **“Ju (besimtarë) thojeni: Ne i besuam Allahut...”** (El-Bekare 136). Ndërsa transmetohet nga Pejgamberi s.a.v.s. se është pyetur për veprën më të vlefshme dhe ka thënë:

أَنَّ النَّبِيَّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ سُئِلَ أَيُّ الْأَعْمَالِ أَفْضَلُ قَالَ إِيْمَانٌ لَا شَكَّ فِيهِ وَجِهَادٌ لَا غُلُولَ فِيهِ وَحُجَّةٌ مَبْرُورَةٌ

“Më e mira vepër është: një besim (në Zotin) që është i palëkundur, lufta e shenjtë (xihadi) të cilën nuk e shoqëron kurrrfarë hamendje, dhe haxhi i cili kryhet sipas rregullave të parapara”^{16, 17}

2. “Përrjashtimi (inshallah) e shkakton dyshimin dhe asgjësimin e bindjes dhe si pasojë e këtyre ai shpie në kufër (mosbesim) në mënyrë të prerë”:¹⁸ (أَلَيْسَتْ يورث الشك و عدم اليقين و ذلك يؤدي إلى الكفر قطعاً). Po edhe nëse nuk vërtetohet kufri (mosbesimi), në këtë rast më së paku që mund të thuhet është fjala “haram”-ndalohej përjashtimi, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë është dyshim (لأنه صريح في الشك), më se dhe nuk përdoret në atë që është e sigurt (الْمُحَقَّقُ) në gjendje momentale, si p.sh., nuk thuhet: “Unë jam djalë inshallah” (أنا شاب إن شاء الله).¹⁹ Apo, sikurse ai që është i gjallë në jetë, nuk i lejohet të thotë: “Unë jam gjallë inshallah” (أنا حي إن شاء الله). Pra ai është besimtar te Allahu i Lartësuar për shkak të ekzistimit të besimit tek ai në moment në të cilin ekziston, pa marrë parasysh se Allahu e di se ai në një moment tjetër më vonë mund të kalojë në mosbesim. Sikurse që Allahu e di se i gjalli është i gjallë sepse e posedon gjallërinë, edhe nëse e di

se pas pak do të vdesë. Madje ne themi: Iblisi ka qenë besimtar dhe fatlumë në kohën kur e adhuronte Allahun, edhe pse Allahu e ka ditur se ai do të mohojë pas kësaj. Thënia e Allahut: وَكَانَ مِنَ الْكَافِرِينَ - **“ishte prej pabesimtarëve”** (El-Bekare, 34), me të synohet: **“u bë prej pabesimtarëve”** (صَارَ مِنَ الْكَافِرِينَ), sikurse ka thënë Allahu i Lartësuar për djalin e Nuhit a.s.: فَكَانَ مِنَ الْمَغْرِقِينَ - **“...ishte prej atyre të mbyturve në ujë.”** (Hud, 43), do të thotë: **“e ai (djali) u mbyt në ujë.”**²⁰

2. Nocioni iman është emër për besimin e plotë - “et-tasdik”, që e arrin bindjen e prerë në besueshmëri. “Tasdiki” është prej fjalëve, që kanë domethënie të vërtetë dhe të ditur, e cila kur përvetësohet ndaj një objektivi, obligohet cilësimi me të, sikurse është, qëndrimi në këmbë, qëndrimi ulur, e zeza dhe e bardha. Nuk ka dyshim se kur këto cilësime i ka dikush apo një send, është e drejtë të thuhet ndaj tij se: është në këmbë, është i ulur, i zi apo i bardhë, dhe nuk ka vend për të bërë përjashtim (si p.sh., është në këmbë inshallah, apo është i ulur inshallah...). Ngjashëm është edhe me imanin. Kur një njeri e deklaroi besimin, është e drejtë të thuhet se ai është besimtar i vërtetë, e jo të thuhet është besimtar inshallah.²¹ Sepse, derisa për një send, të cilin e shohim me sy se është i bardhë, themi bindshëm se është i bardhë, dhe nuk ka vend të dyshojmë në bardhësinë që duket, nuk themi: është i bardh inshallah. E tillë çështja është edhe për besimin. Derisa besimi është akt i prerë dhe besimtari është i sigurt për të, duhet të thotë se është besimtar i vërtetë, e jo të thotë ‘inshallah’.
3. Përrjashtimi ‘inshallah’ kur i bashkohet fjalës së thënë, e ndërpret vazhdimësinë e pohimit të asaj që e ka thënë më parë (منع مضيه), siç është me rastin e deklarimit (الإقرار), (علي ما تفوه به),

¹⁶ Sahihul Buhari, Kitabul imani; Suneni i Nesaiut, Kitabuz-zekati, Babu: Xhehdul mekal, nr. 2479.

¹⁷ Belkasim El-Gali “Ebu Mensur El-Maturidi –hajatuhi ve arauhu el-akdiyyetu” boton: darut-turkij lin-neshri’ 1989, Tunis, fq. 247.

¹⁸ Belkasim El-Gali “Ebu Mensur El-Maturidi...” op.cit. fq. 246.

¹⁹ El-Gaznevijj El-Hanefijj, “Kitabu usulid-dini”, op.cit. fq. 264.

²⁰ Esh-Shejh’ul Imam Nurud-din Es-Sabuni “Kitabu’l-bidajeti mine’l-kifajeti fi’l-hidajeti fi usulid-din”, tahkik dr. Fet’hullah Hulejf, boton ‘darul mearif’ Egjipt, 1969, fq. 155-156.

²¹ “Tebisiretul edil-leti”, cituar sipas: El-Ham-mis “Usulud-din inde’l-Imami Ebi Hanife-te”, op. cit. fq. 416.

marrëveshjeve (العقود), premtimeve (المواعيد)²², lirimit të rob-it (العتاق), kurorëzimit (الأنكاح) dhe shitblerjes (البيع). Po kështu ai e eliminon edhe lidhjen e imanit (يرفع عقد الإيمان).²³

4. Shprehja inshallah, për nga përmbajtja e saj, nuk përdoret për veprimin që është kryer, por për veprimin që ende nuk është kryer. Bazuar në këtë rregull besimor, për të kaluarën dhe për kohën e tashme deri në momentin e tanishëm, nuk thuhet “inshallah”. Sepse, bëhet kontestim formal i dëshirës së Allahut dhe vullnetit të Tij, për sa kohë që obligohet besimi se e kaluara dhe e tashmja ndodhin me dëshirën e Allahut dhe vullnetin e Tij. Ndërsa kontestimi i dëshirës së Allahut për ekzistimin e një gjëje, është mosbesim i pastër. Në këtë rrafsh, kur e analizojmë deklarin: unë jam besimtar inshallah, që në logjikën e një veprimi të kryer i bie: nëse Allahu ka pasur apo ka dëshirë për këtë, del një frazë e gabuar, e ndaluar dhe tërësisht e panevojshme. Sepse po thuhet inshallah për një akt që ka ndodhur, e ajo që ka ndodhur, nuk dyshohet se është me dëshirën e Allahut. Vetë deklarimi “unë jam besimtar” është një akt i krijuar, i cili që nga momenti kur deklarohet, kalon nga akti i tanishëm në atë të kaluar. Shtimi “inshallah”, nënkupton pasigurinë e njeriut në ndodhjen e këtij akti. Kjo është rreptësisht e ndaluar. Kjo i bie sikurse ai që është i gjallë në jetë të thotë: “Unë jam i gjallë inshallah”. Kjo nuk ka kuptim, sepse ai është i gjallë në moment, dhe se derisa është i tillë, kjo padyshim se paraprakisht është me dashjen e Allahut. Apo për njeriun, që ka vdekur dhe është varrosur, të thuhet “ka vdekur inshallah”. Apo, sikurse thotë Imam Maturidiu, të thuhet: “eshhedu en la ilahe il-lallah inshallah”, ose “Muhamedun Resulul-lallah inshallah”, dhe kështu me radhë për të gjitha konditat tjera të besimit.²⁴ Pastaj, për zbritjen e Kur’anit, të thuhet: “I ka zbritur Muhamedit a.s. inshallah”. Në të gjitha rastet, përdorimi i frazës “inshallah” është i gabuar dhe i ndaluar.

²² El-Maturidijj Es-Semerkandijj, “Kitabut-Tevhid”, op.cit. fq. 624.

²³ El-Ham-mis “Usulud-din inde’l-Imami Ebi Hanifete”, op. cit. fq. 418.

²⁴ El-Maturidijj Es-Semerkandijj, “Kitabut-Tevhid”, op.cit. fq. 624.

Orhan Bislimaj

DOUBT IN FAITH IS DISBELIEF (Akaidologic explanation of the saying of Abu Hanifa)

(Summary)

According to Imam Abu Hanifa: “A believer is a believer truly and a disbeliever is truly a disbeliever. There is no (element of) doubt in faith. “They are, truly, the believers”²⁵; and: “They are, truly, the disbelievers”²⁶

Introduction

The term Iman refers to ones commitment to God. As such there can be no doubt in it (under no circumstances). All believers must safeguard the character of their faith. Thus, they must show firmness in their faith and refuse anything that can affect it. This is due to the fact that insecurity leads to doubt, whereas doubt leads to disbelief.

²⁵ Qur’an, Al-Anfal:4

²⁶ Qur’an, An-Nisa:151

أورحان بسلماي

الاستثناء يحرم الايمان

(خلاصة البحث)

الشرح العقائدي لكلمة أبوحنيفة رضى الله عنه:

قوله: و المؤمن مؤمن حقا و الكافر كافر حقا، و ليس في الإيمان شك كما أنه ليس

في الكفر شك لقوله تعالى: **أُولَئِكَ هُمُ الْمُؤْمِنُونَ حَقًّا و أُولَئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ حَقًّا**

المدخل:

الإيمان يمثل الاعتقاد الصادق و الحقيقى للانسان بالله جل و علا. و الإيمان بهذه

الصفات لا يمكن أن يهتز تحت أي ظرف من الظروف و من واجب المؤمن أن

يحافظ على إيمانه الصحيح. و في هذا المجال هو يجب أن يكون ثابتا في إيمانه و

يجب أن برفض أية صفة تؤثر فيه، لان أي احتراز يؤدي إلى الشك و الشك قد

يؤدي إلى الكفر.

SHPALIME

Tahir efendi Boshnjaku - Gjakova

HYDÁ RABBËM “Perëndia është Zoti im”

1b:

Perëndia është Zoti im, Pejgamber kam Muhamedin,
Fenë Islame fe e kam, libër Fjalën e Allahut.

Në punë t’mira dhe në besim, kam drejtimin hanefit.
Drejt看 ithtarësh të synnetit dhe xhematit për Allah!

Jam pasardhës i Ademit, në ymmet të Muhamedit,
Drejt看 kthimi për adhurim, kam Shtëpinë e Allahut.

Asgjë s’ka në gjithësi që shëmbëllen në Perëndinë,
Nuk ka formë trup as gjymtyrë, i Lartësuar Allah.

I pashoq është krejtësisht, nuk ka prind dhe as fëmij,
Një është t’ngjashëm nuk ka, në Ihlas përmend Allahu.

2a:

Nga ndërrimet e ndryshimet, si dhe nga format e ngjyrat,
Vërtet i pastër është Ai, kështu përshkruhet Allahu.

As në tokë dhe as në qiell, djathtas majtas para prapa,
N’katër anë t’horizontit, nuk ka vendqëndrim Allahu.

Perëndia është mbrojtës i pafillim i pambarim,
T’qenët e ka nga vetveti, veti këto të Allahut.

Fare pa qenë gjithësia, që i gjithëfuqishmi Zot,
Për askend nuk ka nevojë, kanë të gjithë për Allahun.

Me veti të përsosura, gjithmonë është cilësuar,
Nga veti të mangësisë, është larg Zotynë Allah.

2b:

Veti t’përsosura t’qenies Tij janë dije e vullnet,
Ekziston ka fuqi krijon, shiqon dëgjon flet Allahu.

Është i gjallë Ai por, si çdo gjallesë nuk jeton
Me mish e gjak, ha e pije, s’është jeta e Allahut.

Dijen absolute të Tij, s’e arrin dija askujë,
T’gjitha gjërat i përfshinë, dituria e Allahut.

Dëgjon absolutisht çdo fjalë të fshehtë apo me zë,
Larg nga trupi dhe organet, është dëgjimi i Allahut.

Sheh absolutisht çdo send, të gjitha gjërat i mbikëqyr,
Është larg nga të pasurit sy por çdo send vështron Allahu.

3a:

Çfardo që synon të bën, është i gjithëmundësishëm,
Çkado që don realizon sipas qëllimit Allahu.

Zoti flet por i pastër dhe i çveshur është nga gjuha,
Me shkronja fjalë e zë s'është t'folurit e Allahut.

N'tokë e n'qiell ka melek Zotit që janë nënshtruar,
Në çdo rrahje të qepallës zbatojnë urdhëra t'Allahut.

Dhe Xhibrili Mikaili Israfili Azraili,
Katër melek më të afërm aty është Emin – Allah.

Njëqind e katër libra t'dërguarve t'Zotit u zbritën,
Njëqind fletë katër libra përmbajnë ligje t'Allahut.

3b:

Ademit iu dhanë dhjetë, Shitit pesëdhjetë fletë,
Tridhjetë i mori Idrizi, dhjetë Halil – Allahu,

Zeburi iu dha Davudit dhe Tevrati Musasë,
Tërë Inxhili i erdhi Isasë Shpirt i Allahut.

Habib'ull-LLahut iu pru Kur'ani kur qe e nevojshme,
Për njëzetetri vjet u krye gjithë shpallja e Allahut.

E nevojshme është të dihet për këta të dërguar,
Ishin t'sinqertë besnikë kumtues ligjesh t'Allahut.

Nga zbulimi i sekretit nga rrena e tradhëtia,
Janë të pastër të paprekur t'dërguarit e Allahut.

4a:

Disa thonë është vaxhib, të dihen emrat e tyre,
Njëzetetë iu shpallën në Kur'an Habib – Allahut.

I pari është Ademi, Idrz, Nuh, Hud dhe Salihu,
Pastaj Is'haku, Ismaili, Ibrahim Halil- Allahu.

Pastaj Jakubi , Jusufi, Shuajbi, Luti dhe Jahja,
Zekerija, Haruni vëllai Musasë Kelim- Allah.

Sylejmani dhe Ejubi, Yzejr, Iljasi, Davudi,
Njëri është Eljasai dhe Isaja Rruh – Allahu.

Njëri quhet Dhylkifli tjetri profet është Junusi,
I fundit është i dashuri Muhamed Resul-Allah.

4b:

Për Llukmanin Dhylkarnejnin, dijetarët nuk pajtohen,
Disa thonë janë peygamber, disa thonë velijj-Allah.

I pari i sa të dërguar, është peygamberi Adem,
I fundit është famëmadhi Muhamed Habib- Allah.

Në mes të këtyre dyve, erdhën të dërguar shumë,
Numrin askush nuk e din pos t'Gjithëditurit Allah.

Kaza dhe kaderri hajri dhe sherri nga Zoti janë,
Ka ditë t'Kijametit t'vdekurit do t'i ngjall Allahu.

Logari dhe Libër ka, sikundër dhe Ditë Gjykimi,
Tetë xhenete do u jep besimtarëve Allahu.

5a:

Besimtarët fatëbardhë që do hynë Brenda n'xhenet,
Pa dyshim që me xhenetin, do të shofin Xhemal- Allah.

Marrje n'pyetje nga dy melek dhe vuajtje varri do t'ket,
Shtatë klasësh xhehenemi, pret mohuesit e Allahut.

Pesë kushte ka Islami, namaz agjërim dhe tevhid,
Zekat dhe haxh për t'pasurit, kumtoi Profet'i Allahut.

Të gjashtë kushtet paraprake të namazit që janë,
Si dhe gjashtë rregullat, detyrim janë nga Allahu.

Fillimisht t'pastrohesh t'mbulohesh t'a din kohën për namaz,
T'merr abdes t'kesh qëllim dhe t'kthehesh kah Shtëpi e Allahut.

5b:

Rregull është t'qëndrosh n'këmbë, t'lexosh Kur'an, rukuë t'bësh,
Tekbir'i parë ulja e mbrëmë sexhde për Allahun.

Farzet e abdesit fytyrën krahët brrylat t'i pastrosh,
Këmbët me nyje laj kokës jepi mes'h na thot Allahu.

Farzet e gusullit janë t'pastrosh gojën t'pastrosh hundën,
Dhe të gjithë trupin ta pastrosh o njeri i Allahut.

Vaxhib është t'bësh tejemum, si për gusull dhe për abdes,
Mbi dhë t'pastër, n'kushte t'veçanta, ne na bëri Allahu.

Nga sa thash më lartë, Zotit n'ju paqa rrebeluar,
Me gjithë mend e trup pendohem, për falje lus Allahun.

6a:

Ç'është hallall kam kuptuar, hallallin e kam pranuar,
Nga haramet kam ikur, kam kuptuar haram t'Allahut.

Mospajtim juridik n'pastë n'vepra dhe n'fjalë të mia,
Ato ia kam lënë t'kaluarës, jam kthyer kah Allahu.

Urdhërat që Muhamed Mustafasë i kan zbritur,
I kam pranuar e vërtetuar, kam thënë besoj në Allah.

“Zaîfi” me gjuhë përsëriti, me zemër vërtetoi,
Në mbrojtjen dhe n'ruajtjen Tënde qoftë, amanet o Allah.

P ë r f u n d o i

Kopjuar nga Bajram Jusuf Gjakova, Zoti e mëshiroftë,
Më 13 qershor 1906

1a

Dije se metri e kësaj është katër herë mefâîlun¹
Kjo është vepra Hazîne-i Dîn (“Thesari i fesë”)

Beso im bir se xhahili² s'bëhet dëshmor as luftëtar
Njeri fatzi gjithnjë mbetet injoranti n'këtë dynja.

Njeriu xhahil është më i keq se sa shtaza që han bar
Është armik i Qitapit³ dhe i fesë n'këtë dynja.

¹ Fjala është për vepër poetike të shkruar në metrin gjashtëmbëdhjetë rrokësh, të cilit jemi përpjekur t'i përmbahemi edhe në përkthim.

² Xhâhil (ar.) = injorant.

³ Qitâp (turq.) > Kitâb (ar.) = libër. Këtu është fjala për Librin hyjnor Kur'anin.

Xhahilin ti e ke armik edhe në qoftë baba yt
Dhitës i tokës veçse është xhahili n'këtë dynja.

Dëgjo tani se ç'është thesari i fesë po ta them
Merr ti nga thesar i fesë mos u shkallmo n'këtë dynja.

Njëri tefsir⁴ hadithi⁵ është i treti tesavvufi⁶
I katërti thesar fikhu⁷ është timon n'këtë dynja.

Indolenti vigjilenti fikhut prore i mbështeten
Kush s'nxu fenë nga ky thesar i pafe mbet n'këtë dynja.

Nëpërmjet të tesavvufit tarikatin ndien njeriu
Kush nuk gjen shpëtim nga zjarri është gomar n'këtë dynja.

Nxë nga fikhu "Myltekanë"⁸ për çdo gjë në te mbështetu
Mos thuaj pa Halebinë bëhet namaz n'këtë dynja.

1b

Ç'është thesar i këtyre shkencave fetare dëgjo
Po edhe i katër shkencave të tjera n'këtë dynja.

I gramatikës sintaksës i logjikës retorikës
Katër shkenca që mbështeten n'ato katrat n'këtë dynja.

⁴ Tefsir quhet shkenca mbi komentimin e Kur'anit.

⁵ Hadith quhet shkenca mbi traditën muhamedane.

⁶ Tesavvufi apo misticizmi islam është sistem botëkuptimesh filozofike islame që mbështeten në idenë e kalueshmërisë së kësaj bote dhe në afrimin e njeriut kah Krijuesi, i udhëhequr nga motivi i dashurisë.

⁷ Fikhu është shkencë juridike islame.

⁸ Multekâ el-ebhur, është emri i veprës së njohur të autorit Ibrahim b. Muhamed b. Ibrahim el-Halebî, vdekur në vitin 1549. Kjo vepër ka qenë tekst mësimor i detyrueshëm për studentët e së drejtës islame.

Gramatika dhe sintaksa janë ushqim për njeriun
Me logjikë dhe retorikë gjen respekt n'këtë dynja.

Dikush bëhet nga shoqëria efendi i lartësuar
Me akaid⁹ ushuli- fikh¹⁰ ia arrin n'këtë dynja.

Por dhe një fjalë për ty e kam do të duhet merre pra
Gjysëm alimi¹¹ dhe mëkatar prish fenë n'këtë dynja.

Dy persona studiojnë njëri melek tjetri shejtan
Studion studion tamam dreq i bëhet hallkut n'këtë dynja.

Dikush studion pin sherbet dhe njerëzve u jep të pinë
Dikush studion ngopet me helm bëhet dexhall¹² n'këtë dynja.

Çfarëdo gjen han pin vesh qesh meskini kujton është diç
Lutu për "Zaif" Tahirin qoftë i falur n'këtë dynja.

*Përktheu nga osmanishtja:
Nehat Krasniqi*

⁹ Akaidi është shkenca mbi besimin islam.

¹⁰ Bazat e së drejtës islame.

¹¹ Dijetar fetar.

¹² Mashtrues i njerëzimit të cilin e karakterizojnë djallëzia, tirania dhe ateizmi. Dexhalli është figurë es'hatologjike, jo vetëm islame. Në krishterizëm ai njihet si antikrisht.

TERMINOLOGJI FETARE

Qemajl Morina

GLOSARI ÇIFUT - (5)

kadish (aramisht): formulë e shkurtër liturgjike në gjuhën aramite, për të cilën besohet se ka ndodhur në periudhën e hershme të gaonit. Si duket funksioni burimor i kadishit ishte të sigurohet nëpërmes normave liturgjike që autoriteti i priësve të babilonëve jeshivë (hebr. Geonim) të jetë i pranuar nga ana e të gjitha bashkësive çifute. Në realitet prej kohës kur në Babiloni pushoi së ekzistuari Gjykata e Madhe, hebraizmi ndërkombëtar ka pranuar normat liturgjike të vendosura nga geonët babilonas si të vlefshme në shumë qendra edhe pse në shumë vende nuk i kanë pranuar si gjyq meritator edhe pse në shumë qendra kanë konsideruar se gjyqi gaon ka statut të lartë se cilido qoftë prej gjyqeve të rabinëve. Me obligueshmërinë e formulës liturgjike në të cilën madhërohet emri i Zotit: “Jigadal vejitkadash sheme raba bealma divera hirute, vejamlil malhute, vejecmah purkane.....”. (Le të madhërohet dhe le të ndriçojë emri i madh në botë, i cili krijoi sipas vullnetit të vet dhe le të rritet pushteti i Tij dhe le të lulëzojë shpëtimi i Tij....), paralajmëron ardhjen e shpejtë të Mesisë, duke përmendur gaonin, i cili në atë kohë ka qëndruar në krye të babilonëve, ka për qëllim që i tërë Izraeli ta përmend geonin në çdo lutje, që duhej të ishte hap i

parë për pranimin e autoritetit të tij. Ky kadish burimor citohej para dhe pas mbrëmjes, pas lutjes së pas ditës, para mbrëmjes dhe mëngjesit të Kerijat shemes, si dhe pas lutjes së mëngjesit. Në mesjetë ishte bërë traditë që kadishi, i cili vinte pas lutjes së (mbrëmjes, mëngjesit apo të pas ditës) t'i shtohet pjesa ku bëhej fjalë që lutja të jetë e pranuar.

Ky kadish quhet *kadish titkabal*, kurse ai para lutja para mbrëmjes dhe e pas ditës, si dhe ajo e para mbrëmjes dhe e mëngjesit *Kerijat shema*, në të citohet vetëm një kadish i shkurtër, i cili ende quhet *haci kadish*.

kadish derabanan: (aram.): “*kadish i rabinit*” - i cili citohet pas recitimit kolektiv. Traditë e përgjithshme e përhapur që pas çdo lutje publike pas *kadish titkbal* lexohet ndonjë psalmeh apo pjesë të *Mishnes*- pas së cilës citohet *kadish derabanan*. *Kadish* derabanan, citohet edhe në fund të *limudes*.

kadish jetom (aram.): “kadishi i ankesave”. Kadishi, që menjëherë pas varrosjes citon njëri prej të bijve apo nipave, nëse nuk ka, atëherë atë mund ta bëjë kushdo tjetër. Kadishi, burimisht ka paraqitur një formulë të shkurtër liturgjike në gjuhën aramite, e cila qysh në shekullin trembëdhjetë, në kohën e luftërave të kryqëzatave, bëhet lutje e të pashpresëve. Përmbajtja e kadishit është deklarimi i besimit në Zotin dhe pranimi i gjykimit të Tij, në bazë të parimit se njeriu është i obliguar që të shprehë falënderimin edhe për fatkeqësinë që i ndodh, ashtu siç shpreh falënderimin edhe për të mirën. I biri i të ndjerit me zë reciton: “*Jitkadal vejitkadash sheme raba*” (“Le të madhërohet e le të ndriçohet emri i Tij”). Kadishi recitohet duke qëndruar në këmbë, tre herë në ditë gjatë njëmbëdhjetë muajve në vitin e pikëllimit, si dhe në njëvjetorin e vdekjes, edhe atë nëse ka

kadish tikbal: (aram.): “Kadishi le të jetë e pranuar lutja e jonë”, kadishi i cili recitohet pas çdo

kala (hebr.): e reja, nusja. (shumësi: kalot).

kalendari – shih: luah (h)a-shana.

kantor – prijës i lutjeve, udhëheqës i shërbimeve në sinagogë, *hazan*.

karpas (hebr.): selino-ja; pjesë e pandarë e lutjes së mbrëmjes. Sikur edhe *marori*, *karpasi* na përkujton për jetën e hidhur të izraelitëve nën robërinë e egjiptianëve. Karpasi hahet në fillim të darkës, që fëmijëve t'u jepet rasti të shtrojnë pyetje. Para ngrënies së karpasit, lahen duart dhe bëhet dhe recitohet lutja: “Baruh Ata, Adonaj, Elo(h)enu, Meleh (h)a-olam, bore peri (h)a-dama”. I lavdëruar je Ti o Zot i ynë, Mbret i botëve që krijon begatitë e tokës”.

kasher (hebr.): ceremonial i përshtatshëm.

Kasherut ose kashrut (hebr.): tekstualisht ceremonial i përshtatshëm, ka të bëjë po ashtu edhe me ceremoninë e ushqimit. Si për shembull për rregullat e ushqimeve të kafshëve të pastra dhe të papastra, në ndarjen e ushqimeve të mishit dhe të qumështit, përgatitjen dhe paketimin e venës, në eliminimin e dhjamit të ndaluar etj.

keara: (hebr.): tekstualisht: çini. Në diasporë ka të bëjë me çininë, në të cilën përdoren bukët pa tahrimë, barërat e hidhëta. (shumësi: kearot).

kerija (hebr.): ceremonia e shqyerjes së rrobave në shenjë pikëllimi. Kerija kryhet duke qëndruar në këmbë, për arsye se pikëllimin duhet pranuar vertikalisht. Në qëndrimin vertikal në raste të tragjedisë individuale udhëzon edhe Bibla-kur Jovi ka dëgjuar për vdekjen e anëtarëve të familjes së tij është ngritur në këmbë dhe ka grisur rrobat e tij. Kerija zakonisht kryhet në kapelë apo te varrezat, te xhenazja, para varrimit. Në rast të vdekjes së babait apo nënës,

rrobat grisen prej anës së majtë kah zemra, kurse në rast të vdekjes së anëtarëve tjerë të familjes grisja bëhet nga ana e djathtë. Në rast të vdekjes së babait dhe nënës, grisja bëhet me dorë, ndërsa në rast të vdekjes së anëtarëve tjerë të familjes, grisja bëhet me thikë, nga lart poshtë në një gjatësi prej një pëllëmbë. Grisja e rrobave me dorë bëhet me vështirësi, për këtë rabinët konsiderojnë se kjo grisje e mban dhembjen, pikëllimin dhe hidhërimin që i pikëlluari ndjen, duke i ndihmuar atij ta shprehë atë. Edhe fëmijët nën moshën trembëdhjetëvjeçare e kryejnë kerijen. Nëse lajmi mbi vdekjen e babait apo motrës arrin pas tridhjetë ditëve, kerija nuk duhet të kryhet, përveç në rast të vdekjes së babait dhe nënës, për të cilët kerija bëhet pa e marrë parasysht se kur arrin lajmi i vdekjes. (shumësi: kerijot).

Kerijat (h)a-Megila (hebr.): lexim. *Megilat Ester* (Kokorrethi i Esterit). Sa rëndësi e madhe i është dhënë leximit të Megiles shihet nga fakti se Telmudi urdhëron ndërprerjen e lutjes në tempullin e Jerusalemit për të pasur mundësinë që të gjithë ta dëgjojnë leximin e Megiles. (H)alaha urdhëron që njeriu duhet ta ndërpresë leximin e Tevratit apo mbarimin e çfarëdo urdhri tjetër biblik, për t'iu dhënë mundësia e dëgjimit të Megiles. Përrjashtimi i vetëm mund të jetë urdhri i varrimit. Nëse nuk ka askush që mund ta bëjë varrimin, secili çifut ka obligim së pari ta varrosë të vdekurin, pastaj ta dëgjojë leximin e Megiles.

Kerijat (h)a-Tora (hebr.): leximi publik i Tevratit gjatë lutjes së për-bashkët, e cila bëhet ditëve të hënë, të enjteve, të premteve, festave, gjysmë festave, në Rosh Hodesh, me rastin e agjërimeve, kryhet pas *shahritit*, kurse të shtunave, ditëve të festave, ditën e *Jom (h)a Kipurim* dhe ditëve të agjërimit edhe para *minhas*. Në mëngjes të Kerijat (h)a-Tora në shabat ka shtatë *alijot*, në Jom-(h)a-Kipurim gjashtë, në festa pesë, në Rash Hodesh dhe gjysmë festë katra, kurse të hënë, të enjten, ditëve të agjërimit dhe në Hanuka dhe Purim tri. Në pasditen e Kerijat (h)a-Tores lexojnë

vetëm tre veta. Për leximin publik të Tevratit është i domosdoshëm minjani.

Kerijat shema (hebr.): tregim (recitim) pjesë nga “*shema Jisrael*” (“Dëgjo o Izrael”). Në librin e pestë të Mojsiut, 6:4-9, në pjesën të quajtur me fjalët, sipas të cilave edhe fillon “*shema Jisrael*” (“Dëgjo o Izrael”) gjenden të shkruara këto fjalë: “Këto fjalë, të cilat unë po t’i urdhëroj sot, le të mbeten në zemrën tënde, përsëriti ato edhe kur të jesh ratë edhe kur të jesh në këmbë”. Në të njëjtën libër, 11:13-21, në kaptinën, që fillon me fjalët: “Ve(h)aja im shamo tishmeu”, “Dhe do të bëhet nëse ju dëgjoni”, thuhet: “Vendosni këto fjalë të mia në zemrat tuaja.... mësoni fëmijët tu të flasin me ato kur ti je ulur në shtëpinë tënde, kur je duke ecur, kur je shtrirë në shtrat dhe kur je në këmbë”. Vargjet e përmendura paraqesin urdhrin hyjnor që duhet së paku dy herë në ditë të përmendet. Në librin e pestë të Mojsiut 16:3 hasim:”....Ti përkujtohet ditët e dëbimit tënd nga toka e Misirit (Egjiptit) gjatë të gjitha ditëve të jetës tënde”. Të urtit e Telmudit nga ky varg kanë kuptuar si një udhëzim praktik, që obligon në përmendjen (e çdo vendi kur foljet përmenden në Tevrat, ato të kuptohen si imperativ, kurse rabinët e kanë komentuar si udhëzim që fjalët e caktuara të nënvizohen), dëbimi nga Misiri në mëngjes dhe në mbrëmje.

kevod (h)a-met (hebr.): nderi i të ndjerit, thirrja e tubimit sipas rregullit që ka të bëjë me xhenazën e të vdekurit. Është traditë që xhenazja të mos lihet vetëm. Xhenazja ruhet si ditën ashtu edhe natën, ditëve të festave, të shtunave si dhe ditëve të punës. Meqenëse ky veprim konsiderohet obligim fetar, të gjithë ata që merren me këtë punë janë të liruar prej të gjitha obligimeve tjera fetare.

kevura (hebr.) varrimi. Sipas mësimave të Tevratit edhe kriminelin i dënues për vdekje ka të drejtë të varroset. Sipas (H)alaha varrimi duhet të kryhet në një kohë sa më të shkurtër - sipas mundësive brenda 24 orëve. Çdo vonesë e ceremonisë së varrimit konsidero-

het moskujdes ndaj të ndjerit si dhe nënçmim ndaj dinjitetit të tij - si dhe ofendim ndaj Zotit - sepse njeriu është krijuar në formën më të bukur. Mirëpo, nëse për shkaqe të domosdoshme që kanë të bëjnë me të ndjerin varrimi ka nevojë të shtyhet, si për shembull të tubohen të afërmit, të cilët jetojnë në vende të ndryshme apo të ngjashme me këtë, atëherë shtyrja e varrimit konsiderohet e arsyeshme dhe e lejuar. (shumësi: kevurot).

kidush (hebr.): tekstualisht: shugurim, formulë e shkurtër liturgjike e përbërë prej lutjes për venën, lutje për hyrje të shabatit apo festës (shih: Jom-Tov), me të cilën fillon mbrëmja e festës së darkës të shtunës. Është urdhër biblik që shabati të shugurohet me fjalë, sepse në të thuhet: “Përmende ditën e shtunë që ta shugurosh”. Shabati duhet të përmendet para hyrjes dhe para darkës. Para hyrjes me kidush, kurse para daljes me (h)avdal. Është rregull që kidushi të thuhet në vigjilje të së premtes në të shtunën, por nëse dikush nuk e ka thënë për shkak të harresës apo me qëllim, atëherë atë duhet ta thotë në çfarëdo kohe gjatë shabatit. Pas hyrjes së shabatit (pas përfundimit të diellit të së premtes) është e ndaluar ngrënia apo pirja e venës para se të thuhet kidushi. Po ashtu pas daljes së shabatit (pas daljes së tre yjeve të shtunës në mbrëmje) është e ndaluar të ngrënit, pirja e venës, fillimi i punës apo të shijohet diçka derisa para se të thuhet (h)avdala. Megjithatë, lejohet pirja e ujit. Nëse dikush ka harruar, apo me qëllim ka thyer rregullin, ka ngrënë apo ka pirë para kidushit apo para (h)avdalaes, atëherë duhet ta thotë kidushin pasi të hajë. Është urdhër i rabinëve që kidushi dhe (h)avdala të thuhet mbi venë. Në fillim bekohet vena, pastaj thuhet kidushi, kurse duart nuk lahen përpara, por pas kidushit, para ngrënies së bukës. Kidushi thuhet vetëm në vendin e ngrënies së bukës. Do të thotë nuk mund të thuhet kidushi në një shtëpi, e ngrënia të bëhet në një shtëpi tjetër. Për dallim nga kidushi, h)avdala nuk mund të bëhet mbi bukë, por vetëm mbi venë.

kosher – shih: kasher

Ladino (Ladino): dialekt para klasik i gjuhës spanjolle, i cili deri në Luftën e Dytë Botërore ishte gjuhë amnore e shumicës së safaridve të ish-Perandorisë Osmane. Sot, nuk ka asnjë familje ku Ladino nuk është gjuhë e parë në të cilën fëmijët kanë mësuar dhe janë rritur.

limud (hebr.): tekstualisht, në traditën safaride me këtë termin kuptohet mësimi i përbashkët, që organizohet në shtëpi apo në sinagogë në ditën e vdekjes së anëtarit të familjes. Në lumud zakonisht mësohen mishnajot.

levaja (hebr.): varrim. Në përcjellje nuk ka dallim mes të varfërve dhe të pasurve, ata që janë të njohur në shoqëri dhe të panjohur. Nëse për një ditë ka më shumë varrime, varrimi bëhet sipas radhës së vdekjes. Ai që ka vdekur më herët ai edhe do të varroset më përpara. Përcjellja e të vdekurit konsiderohet obligim i madh, për hir të cilit lejohet edhe ndërprerja e leximit të Tevratit. Është traditë që anëtarët më të afërm të familjes të hedhin disa lopata dhe mbi varr, sepse ata janë të obliguar të bëjnë varrimin dhe me këtë akt ata në mënyrë simbolike kryejnë obligimin e vet. Vendosja e luleve në varr konsiderohet traditë pagane. Zhvarrosja është e ndaluar, vetëm atëherë kur eshtrat transferohen në Tokën e Shenjtë, apo në varrezat çifute. (Shumësi:levajot)

luah (h)a-shana (hebr.): kalendar. Viti i thjeshtë kalendarik hebraik ka dymbëdhjetë muaj, nga njëzet e nëntë apo tridhjetë ditë, kurse në vitet vijuese (me qëllim të barazimit të viteve diellore dhe viteve të thjeshta të kalendarëve hebraike prej 354 ditëve) shtohet muaji i trembëdhjetë. Këta janë emrat e muajve sipas kalendarit hebraik:

1. Nisan = Mars – Prill,
2. Ijar = Prill – Maj,
3. Sivan = Maj – Qershor,

4. Tamuz = Qershor – Korrik,
5. Av = Korrik – Gusht,
6. Elul = Gusht – Shtator,
7. Tishri = Shtator- Tetor,
8. Heshvan = Tetor- Nëntor,
9. Kislev = Nëntor – Dhjetor,
10. Tevet = Dhjetor – Janar,
11. Shevat = Janar – Shkurt,
12. Adar = Shkurt – Mars,
13. Vedar ose Adar sheni = Mars – Prill.

maariv (hebr.): lutje e përbashkët e mbrëmjes, apo lutje individuale. Në traditën safaride është më i popullarizuar termini arvit.

maca (hebr.)bukë pa tharmë që përdoret ditëve të Festave Bukës pa Tharmë, i cili në gjuhën popullore quhet Pesahom, edhe pse Pesah është dita e katërmëdhjetë e muajit nisan (mars-prill) si dhe sakrificës që ai sjell. Buka pa tharmë (bekimi i së cilës është i obligueshëm në ditën e parë të festave të bukës pa tharmë), kanë (ashtu si edhe vetë Festa) karakter ambivalent. Në Librin e dytë të Mojsiut 12:39 shkruan: “Dhe prej gjërave që keni marrë prej Misirit ishin pogaçet e pjekura pa kripë, sepse nuk kishit kohë kur ju debuan Miserlinjtë”, prej kësaj shihet sipas Tevratit, se bukët pa tharmë hahen në shenjë kujtimi të shpejtësisë në të cilën u bë premtimi i daljes nga Misiri (Egjipti) - do të thotë si simbol i lirisë. Në të njëjtën kohë, në (H)agadë, bukët pa tharmë quhen me emrin “lahma anja” (buka e mjerimit), sepse ajo u përkujton ushqimin e vetëm që e posedonin, përveç rrënjëve, të cilat vetë i kishin nxjerrë gjatë punës së mundimshme në Egjipt, si dhe simbolizon robërinë. Festa e Bukëve pa Tharmë, në vetvete simbolizon lirim nga robëria e kësaj bote, si dhe pranimin e robërisë së Mbretërisë Hyjnore; lirim nga robëria e njeriut, shoqërisë, historisë si dhe fuqive që udhëheqin me ato, si dhe orientimin e vetëdijshëm për adhurimin e Zotit, për të cilën Tivrati thotë si mënyrë

e vetme për arritjen e lirisë së vërtetë. Kështu pra edhe bukët pa tharmë simbolizojnë të dyja këto gjëra në të njëjtën kohë. (Shumësi: macot).

maces (Jidish): fjalë hebraike e Jidishiizuar macot, bukë pa tharmë, të cilat hahen në Hag(h)a-Macot, Festën e Bukëve pa Tharmë. Shih: Pesah.

Maceva (hebr.): monument mbivarrezor. Maceva apo monumenti mbivarrezor ndërtohet pas kalimit të tridhjetë ditëve të vitit të parë të vdekjes. Tradita e vendosjes së monumentit mbivarrezor është e hershme. Shumë monumente të tilla janë ruajtur edhe sot, si për shembull monumenti i Mbretit Davud në Jerusalem, varrezat e paraardhësve në Hebron. Që nga kohërat biblike, deri në periudhën kur ngritja e përmendoreve është bërë praktikë e përgjithshme, ka mbisunduar tradita që mbi varr të hidhet një grumbull gurësh, apo pranë varrit të vendoset ndonjë shenjë i qartë apo ndonjë shtyllë. Kjo është bërë për dy shkaqe: që trupi të ruhet prej kafshëve të egra si dhe t'u tërhiqet vëmendja kalimtarëve, në veçanti Ko(h)animëve se aty gjenden varrezat. Ashkinazet sipas rregullit vendosin monumentet mbivarrezor vertikalisht, kurse Safaridët horizontalisht. Vendi në varr ku varrosen librat e përdorur me tematikë të Tevratit quhen geniza. Monumenti në genizë zakonisht shënohet me gdhendjen apo vizatimin e librit të hapur. Nuk ka rregull të përgjithshëm sa u përket monumenteve mbivarrezore. Në kohën biblike as që kishte monumente mbivarrezore. Më vonë janë paraqitur mbishkrimet e shkurtra si: “Zihrono livraha” (Përkujtimi për të le të jetë lutje), e të ngjashme. Në përmendoret e Ashkinazve zakonisht gjenden shkronjat hebraike “pe” “tet”, të cilat janë anagram i fjalëve “po nikbar” {këtu është varrosur}, ose “po temuna” (këtu është strehuar) ose “po temuna” (këtu është e strehuara), ose “pe” “nun”, të cilat janë anagram i fjalëve “po nikbar” (këtu është varrosur), ose “po nikbera” (këtu është e varrosura). Safaridët si për meshkuj ashtu edhe për femra vendosin shkronjën “me” “kof”, të

cilat janë anagrame të fjalëve “macevet kevura” (varr guri). Në përmendore shkruhen mbishkrime të shkurtra mbivarrezore, emri, mbiemri, data e lindjes dhe vdekjes, në të shumtën e rasteve të përcjella me deklarata çifute “Tije nishmato cerura bicror (h)a-hajim” (Le të jetë shpirti i tij me tufën e të gjallëve) ose me anagramin e tij. (shumësi: macevot).

Magen David (hebr.): mburoja e Davidit, emërtimi hebraik për yllin gjashtërembash, i cili në shekujt e fundit ka marrë statutin e simbolit çifut par-exelance - edhe pse rezultatin e këtij simboli duhet kërkuar krejtësisht në tradita tjera.

magen Tora (hebr.): mburoja e Tevratit, zbukurimi me të cilin mbështillet libri i Tevratit, zakonisht prej argjendit, kurse prej motiveve më të shpeshta të këtij zbukurimi janë dy luan që mbajnë pllakën, ku janë të shënuar dhjetë urdhrat.

Mahzor (hebr.): lutësi për festa.

Ekzistojnë tri lloje të Mahzorim:

Mazor për shalosh regalin,

Mahzor për Rosh (h)a-shana,

Mahzor për Jom(h)a-kipurim.

maror (hebr.): sallatë e gjelbër, e cila hahet gjatë lutjes së mbrëmjes. Marori, gjatë lutjes hahet dy herë. Herën e parë kur të gjithë të pranishmit të kenë ngrënë masën e caktuar të macesit. Të gjithë të pranishmit janë të obliguar të hanë “kezajit” (masë hebraike e një ushqimi mesatar) të sallatës së gjelbër pa farë shtese. Herën e dytë marori hahet në të ashtuquajturën “senduiqi (H)ilel”, i cili përbëhet prej “haci kezajit”. Sallata e gjelbër duhet të jetë e freskët, e kontrolluar mirë që të mos ketë krimba apo insekte, nuk guxon të ketë kripë, vegetë, vaj apo uthull. (shumësi: merorim).

Matanot la-evjonim (hebr.): dhurata për të varfër, emërtim për dhuratat e obligueshme për të varfrit, të cilat u jepen në kohën e seudat Purim. Është obligim që secili të çojë nga një dhuratë së paku dy të varfërve. Ky urdhër ka mbështetje në vargun 9:22 të Librit mbi Esterin: “.....që atyre ditëve të festoni duke dërguar ushqime njëri-tjetrit dhe të varfërve dhurata”. Edhe ai, i cili jeton nga ndihmat nuk përjashtohet nga plotësimi i këtij urdhri.

Megilat Ester (hebr.): kokorreth ose libri mbi Esterin - njëri prej njëzet e katër librave biblike. Leximi apo dëgjimi i i Megilat Esterit në Purim është obligim edhe për meshkuj dhe për femra. Megilat Esteri në Purim lexohet dy herë - pas arviti dhe pas shahritit.

meil (hebr.): mushema (mbështjellësi) me të cilin mbështillet libri i Tevratit. (shumësi: meilim).

meldar (Ladino): tekstualisht: lexim, emërtim për shkollën fillore çifute që është bërë traditë në mesin e çifutëve safarid.

maldadu = shih: limud.

met micva (hebr.); i ndjeri, që nuk ka pasur radhës të cilët do të angazhoheshin për varrosjen e tij. Me këtë rast varrimi është obligim për çdo çifut.

mezuza (hebr.): tekstualisht: shtalka e derës, ka të bëjë me komentimin e dy pasuseve të Biblës (Libri i pestë i Mojsiut 6:4-9 dhe 11:13-21, të cilët sipas rregullave të Biblës duhet të shkruhen në një lëkurë të posaçme dhe duhet vendosur në shtalkat e dyerve dhe të gjitha hapësirat ku qëndrojnë njerëzit. (shumësi: mezuzot).

midrash (hebr.): emër i përgjithshëm për egzegezën e literaturës klasike të rabinëve. (shumësi: midrashim).

mila = shih: berit mila.

mikve (hebr.): banjë ceremoniale, (shumësi: mikvaot).

minha (hebr.): lutje e përbashkët e pas ditës ose lutja e pas ditës e individëve.

Minjan - tekstualisht: numërimi - emërtim për kuorum deri në dhjetë çifut (meshkuj), më të vjetër se trembëdhjetë vjet, i cili është i domosdoshëm për mbajtjen e lutjes publike, leximit publik të Biblës dhe recitimin e kadishit. Për lutje individuale si dhe për shqiptim. (shumësi: minjanim).

mishloah manot ish lere(h)u (hebr.): tekstualisht: “dërgimi i ushqimit të afërmit tënd” - emërtim për dhurata të cilat dërgohen në Purim. Është obligim për secilin që në Purim t'i dërgojë së paku një miku dy pjata me ushqim. Si për shembull: tortë dhe venë, djathë dhe bukë, suxhuk dhe raki - e të ngjashme. Ky urdhër mbështetet në vargun 9:22 të Librit mbi Esterin: “.... që ato ditë të festoni duke dërguar ushqime njëri-tjetrit si dhe të varfërve dhurata”. Edhe ai që mbahet nga ndihmat nuk përjashtohet nga obligimi i këtij urdhri.

Mishna (hebr.): tekstualisht: ajo që vazhdimisht përsëritet, mësim përmendësh, termini kryesisht ka të bëjë me një përmbledhje rregullash dhe udhëzimeve të hartuara në fund të shekullit të dytë të erës së re, nga ana e Rabinut Jude (h)a-Nasije, përfaqësues i atëherëshëm i San(h)adrines, që paraqet përpjekjen e parë të kodifikimit të mësimi gojor të Tevratit. Termini mishna do të thotë përmbledhja e tërësishme, kështu që secili rregull i veçantë si njësi më e vogël e përmbledhjes. Gjuha hebraike nuk njihet shkronja të mëdha dhe të vogla, por në gjuhët evropiane ekzistimi i shkronjave të mëdha dhe të vogla shfrytëzohet për eliminimin e këtyre dyshimeve

para shfrytëzimit të këtij termini. Kur fjala mishna shkruhet me shkronja të mëdha në fillim, atëherë ajo ka të bëjë me përmbledhjen e rregullave si tërësi, kurse kur shkruhet me shkronja të vogla në fillim, ka të bëjë me rregullat individuale.

moel = shih: mo(h)el.

mo(h)el (hebr.): syneti, prerje. (shumësi: mo(h)alim).

musaf (hebr.): lutje shtesë e cila thuhet pas shahritit të shtunave, festave dhe me rastin e hënës së re.

neila (hebr.): lutje shtesë që thuhet në Jom(h)a-Kipurim pas minhas.

ner tamid (hebr.): dritë e amshueshme, kandil.

netilat jadajim (hebr.): tekstualisht: ngritja e duarve, larja ceremoniale e duarve para Kerijat shema, tefilit apo lutjes së bukës.

pajtan (hebr.): shkrimtar, pijuta (poezi me të cilat madhërohet Zoti ose udhëzohet në rrugë të drejtë). (shumësi: pajtanim).

parohet (hebr.): mbulojë e lidhur me të cilën mbulohet aron(h)a-ko-desh. Termini origjinal ka të bëjë me perden që ka ndarë Shenjtërinë mbi Shenjtërinë një tendë të një takimi, që është bërë me urdhër të veçantë të Krijuesit, shih, Librin e Dytë të Mojsiut (26:31-33): “Dhe bëri perde prej purpuri...që perdet të ndajnë Shenjtërinë prej Shenjtërisë mbi Shenjtërit”.

perashat (h)a-shvua (hebr.): pjesa e shtatë e Tevratit, e cila lexohet publikisht me rastin e lutjes së mëngjesit të shtunave.

pesah (hebr.): Festa e çlirimit nga robërimi egjiptian dhe festa e vetëdijesimit për ta adhuruar Zotin. Në aspektin etimologjik termini

Pesah ka pasur domethënien e sakrificës që është flijuar me katërmbëdhjetë të muajit nisan (mars-prill) pas dite, si dhe periudhën e flijimit e që është quajtur Hag (h)a-Pesah (Festa Pashalle e flijimit, shih: Libri i Dytë i Mojsiut 34:25).

pikuah nefesh (hebr.): tekstualisht: interesimi për shpirtin, rregullat e sjelljes me rastin e rrezikut të jetës.

pijut (hebr.): me të cilën madhërohet Zoti, apo e cila nxit në përmbajtjen e urdhrave të Tij. (shumësi: pijutim).

pizmon (her.): kënga me të cilën madhërohet Zoti, ose që nxit në përmbajtjen e urdhrave të Tij, të cilat (për dallim nga pijuti) jepen në manifestime shtëpiake. (shumësi: pizmonim).

Purim (hebr.): tekstualisht: shorti. Festa në të cilën festohet shpëtimi i çifutëve nga veziri i madh persian (H)amana, i cili kërkoi nga mbreti Ahashverosh ka kërkuar dekretin për shkatërrimin e tërë perandorisë çifute. Kjo festë në vet qytetin Shushan si dhe në qytetet tjera izraelite, të cilat kanë ekzistuar në kohën e Jeshuës ben Nunit festohet më 14, kurse në pjesën tjetër të botës më 15 Adar (shkurt-mars). Tregimi për Purinin përmendet në librin e Biblës për Esterin. Ngjarja ka ndodhur gjatë sundimit të mbretit Ahashveroshit (485-464) para erës së re dhe është përshkruar në librin biblik mbi Esterin. Në këtë ditë ndalohej agjërimi apo të mbahet zi. Secili çifut është i obliguar që në Purin t'i kryejë këta katër urdhra:

1. Kerijat (h)a-Megila
2. Mishloah manot ish le-re(h)u
3. Matanot la-evjonim
4. Seudat purim – ceremonia e festës.

Shprehjet të cilat përdoren për urimin e festës. Te Safaraidët: Purim lesimha!
Gëzuar Purimin!

Përgjigja:
 Purim Lesimha!
 Gëzuar purimin!
 Apo në Ladin:
 Buen Purim!
 Gëzuar Purimi!
 Përgjigja është:
 Buen Purim!
 Gëzuar (mirë) Purimi!
 Tek Ashkinazet:
 Purm Sameah!
 Gëzuar (mirë) Purimi!
 Përgjigja:
 Purim Sameah!
 Gëzuar (me fat) Purimi!

Purim di Saraj - shih: Hag (h)a-Asirim.

rabanit (hebr.): gruaja e rabinit.

rabi (hebr.): interpretues meritör dhe gjykatës i pranuar i ligjit çifut, shqiptimi i titullit burimor i titullit hebraik sipas variantit ashkinaz *ribi*. (shumësi:rabanim).

rabin - ekuivalenti greko-latin i termit hebraik që ka hyrë në gjuhën shqipe.

rabiner - varianti i jidishaizuar i termit rabin.

rav (hebr.): rabin, personi i specializuar në të drejtën çifute, *haham*. Shih po ashtu *ribi*. (shumësi:rabaim).

rebecin (jidaisht): ekuivalenti ashkinaz i termit hebraik rabanit, gruaja a rabinit.

ribi (hebr.): interpretues meritör dhe gjykatës i pranuar i ligjit çifut.

rabin është ekuivalenti greko-latin e termit çifut Rav - ka për qëllim personin e specializuar në zakonet çifute, pa marrë parasysh se çfarë funksioni ka në shoqërinë çifute (mësues, dajan, hazan e të ngjashme.) ose jo. Shpallja e titullit rabin në kohën e sotme i është lënë pothuaj më tepër rrethit evropian e jo nevojave të drejtësisë çifute. Rabini nuk ishte funksion, por është shkallë e të arriturve arsimore. A do të zërë ndonjërin prej funksioneve një dijetar i caktuar në komunën çifute është çështje e brendshme e komunës në të cilën nuk mund të përzihen faktorët e jashtëm.

rimonim (hebr.): ka të bëjë me zbulimet e argjendta në formë të kurorës të cilat vendosen në librin e Tevratit.

Rosh (h)a-shana (hebr.): tekstualisht; krye viti, Viti i Ri.

Rosh Hodesh (hebr.): fillimi i vitit, dita e të parit të hënës së re dhe shpallja e muajit të ri.

rubí (hebr.): devijim nga *ribi*, me këtë emërtim, zakonisht, në mesin e Safaridve quhet mësuesi i fesë.

rubisa (Ladino): ekuivalenti safarid i termit hebraik rabanit, gruaja e rabinit.

sandak (hebr.): personi që mban në krah fëmijën që bëhet synet.

seder shih: darka e sederit.

seder (darka): darka e festës, (natën e parë në diasporë, të dytën natë. Festa e bukës pa tharmë (shih: Pesah). Në darkën e sederit hahen ushqime të caktuara, të cilat i përkujtojnë çifutët për robërimin në Egjipt si dhe në mrekullinë e shpëtimit.

Sefarad (hebr.): emërtim hebraik i Spanjës.

sefard shih: sefaridët.

Sefaridët (hebr.): spanjollë në gjuhën hebraike. Ky termin ka për qëllim si çifutët spanjollë si një grup etniko- kulturor, i cili me shekuj më nuk jeton në Spanjë, si dhe banorët e tashëm të Spanjës pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike apo përkatësinë fetare. Në gjuhët tjera ky termin ka të bëjë vetëm me çifutët spanjollë. Në shumë gjuhë botërore termi hebraik u është përshtatur ligjeve fonetike dhe morfologjike të çdo gjuhe, si Sefard, apo Sefardi anglisht dhe sefaridët shqip etj.

Sefer Tora (hebr.): Libir i Torës (Tevrati) , pesë librat e Mojsiut, të shkruar me dorë në një lëkurë të veçantë që përdoret në lutje nëpër sinagoga.

seudat (h)avras (hebr.): ushqim ngushëllimi, emërtim për ushqimin e parë që u përgatitet të pikëlluarve pas kthimit nga varrimi. Ushqimin e përgatisin miqtë, fqinjët, anëtarët e Hevra Kadishit, sepse sipas (H)alahut është e ndaluar që të pikëlluarit ushqimin e parë ta përgatisin vetë.

Seuadat Purim – festa e purimve, ceremoni gjatë të së cilës të gjithë meshkujt të moshës madhore janë të obliguar të pinë venë derisa të mos flenë. Ky urdhër ka mbështetje në vargun 9:17 të Librit mbi Esterin: “*Festuan atë ditë të gostitur e të gëzuar*”.

Sidur (hebr.): lutës për ditë pune dhe shabat.

suka (hebr.): kolibe, e cila ndërtohet pranë shtëpisë, ku hahet dhe pihet gjatë festës së *Sukotit*. Muret e Suke mund të jenë të ndërtuar prej dërrasave, kartonit, gurit apo tullave. Ajo që është me rëndësi

se Suka nuk mund të jetë e mbuluar me tjegulla, lesonit apo najlon, por me dega, me letva druri, kallam dhe hasra, kështu që nëpërmes tyre të shihet qielli.

Sukot (hebr.): tekstualisht: tendë. Festa e Tendës, e cila festohet në shenjë kujtimi të daljes nga Egjipti dhe rrugëtimit të gjatë nëpër shkretëtirë deri në Izrael. Festa e Tendës zgjat prej pesëmbëdhjetë deri më njëzet e dy tishrijit (shtator-tetor).

Shabat (hebr.): E shtunë, festa më e madhe çifute. Në shabat rreptësisht është e ndaluar kryerja e çfarëdo pune. Veprimet të cilat i ka ndaluar *Tora Gojore* quhen *avot melahot* (veprime prototip), numri i të cilave arrin në tridhjetë e nëntë. Ligjet e rabinëve i kanë ndaluar edhe veprimet që dalin nga këto tridhjetë e nëntë, apo që i nxisin ato.

Shprehjet me të cilat urohet festa:

Shabat shalom!

Të uroj të shtunë të paqes!

Përgjigja:

Shabat shalom umvorah!

Të shtunë të qetë dhe të bekuar!

Tek Sefaridët thuhet edhe:

Buen shabat!

Të shtunë të mirë!

Në çka përgjigjet:

Buen shabat!

Të shtunë të mirë!

Tek Ashkinezët :

Hag sameah!

Gëzuar festën!

Përgjigja:

Hag sameah!

Gëzuar festën!

Apo te Jidishët:
 Gut Jontef!
 Mirë (urime) Festa!
 Përgjigjja:
 Gut Jontef!
 Mirë (urime) Festa!

shehita (hebr.): prerja e kafshës sipas rregullave të drejtës çifute. (shumësi: shehitot).

shiva (hebr.): tekstualisht: shtatë, periudha shtatëditore e pikëllimit për më të afërmit. Gjatë shtatë ditëve të para, pas varrimit ndalohet en gjërat në vijim: shkurtimi i flokëve dhe rrujtja, larja e rrobave, larja e trupit, noti, marrëdhëniet seksuale me bashkëshorten, mbathja e këpucëve të rrypta, kryerja e punëve, mësimi i Tevratit (gojarisht edhe me shkrim), rregullimi i krevatit, zbulimi i kokës dhe përshëndetja me njerëzit. Në rast se i vdekuri ka bërë vetëvrasje, fëmijës që lind i vdekur, fëmijës që vdes para se t'i mbushë tridhjetë ditë, këto rregulla nuk hyjnë në fuqi. Rregullat e shivas hyjnë në fuqi në rast të vdekjes së gjashtëve më të afërt: babës, nënës, djalit, vajzës, vëllait dhe motrës së pamartuar.

sheloshim: (hebr.): tekstualisht: tridhjetë, periudha tridhjetëditëshe e pikëllimit pas vdekjes së ndonjërit nga anëtarët e familjes (babës, nënës, vëllait, motrës, vajzës, burrit, gruas).

shofar (hebr.): briri i dashit, i cili përdoret në sinagoga gjatë shërbësive fetare në Rosh (h)a-shana.(shumësi:shofarot).

shohet (hebr.): kasap që therë kafshët sipas rregullave të së drejtës çifute. (shumësi: shohatim).

taanit (hebr.): agjërim. (shumësi: taanijot).

Taanit Ester (hebr.): agjërim i Esterit. Agjërim gjysmëditor, që zgjat prej lindjes së diellit e deri në përfundimin e tij më trembëdhjetë adar (një ditë para Purimit).

ta(h)ara – (pastrim apo larje): emërtim për ceremoni rituale e trupit, që bëhet para varrimit. Mbështetet në citatin e Biblës “.....shkon ashtu si ka ardhur”, (Libri i Tregimeve 5:15). Pasi që njeriun e lajnë kur të lindet, duhet të lahet edhe kur të vdesë. Larjen sipas rregullit duhet ta kryejnë anëtarët e Hevra Kadishit, në shtëpi të veçantë apo në kapelë të varrezat. Rohacim, ata që e lajnë, duhet të sillen ndaj xhenazes me respektin më të madh. Gjatë larjes vazhdimisht ndizet qiri. Ceremonia e larjes fillon me vendosjen e xhenazes në një gur, ku duhet të shtrohet një çarshaf. Uji i nxehtë duhet të hidhet në çdo pjesë të trupit, duke filluar prej kokës në drejtim të këmbëve. Flokët lahen dhe krihen, kurse thonjtë pastrohen. Çarçafi përdoret për terjen e disa pjesëve të trupit, kështu që duart nuk prekin trupin. Pas larjes trupi mbështillet në çarçaf, teret mirë e pastaj vishet në rroba të vdekjes.

tahrihim (hebr.): një çarshaf i thjeshtë me ngjyrë të bardhë me të cilin varroset çdo i vdekur, pa marrë parasysh gjendjen e tij ekonomike. Në të kaluarën janë bërë varrime luksoze, janë blerë rroba të shtrenjta me të cilat është bërë përcjellja e fundit e të vdekurve. Shuma të mëdha që janë bërë me rastin e varrimit kanë bërë që të varfrit të jenë në pozitë të vështirë. Kështu Raban Gamaliel, kryetar i San(h)ederinit, i cili ka jetuar në fund të shekullit të parë dhe në fillim të dytë të erës së re, ka urdhëruar që të vdekurit të varrosen në mënyrë sa më të thjeshtë. Është traditë popullore që tahrihim (qefini) të përbëhet prej më së shumti shtatë pjesëve, e së paku prej tre pjesëve, duhet të qepet pa tegel, pa nyje dhe pa xhepa të jetë sa më i gjerë. Qefini nuk ka xhepa, sepse pasuria e fituar në këtë botë nuk mund të bartet në botën tjetër. Qefini, në të shumtën e rasteve është me ngjyrë të bardhë, sepse ajo simbolizon pastërti-

në. Veshja e të vdekurit me rroba klasike konsiderohet traditë pagane. Shumë njerëz gjatë jetës së tyre përgatisin qefinin e tyre. Është traditë që me të vdekurin të varroset taliti (mushemja), të cilën e ka përdorur gjatë lutjeve të tij.

talit (hebr.): musheme e lutjeve.

Talmud (hebr.): tekstualisht: mësim i përgjithshëm i ligjeve dhe shqyrtimeve individuale mbi kuptimin e rregullave dhe argumenteve gojore dhe të shkruara të Tevratit si dhe dimensionin e rregullave të rabinëve, precedentët, legjendat si dhe thëniet e njerëzve të urtë, që janë zhvilluar rreth Mishnes. Ekzistojnë dy Telmuda. Një, më i vjetër, më i thjeshtë, më i shkurt konkret, që është zhvilluar në akademitë izraelite (përfundimisht është shkruar rreth vitit 350 të erës së re.), i cili quhet Talmud Jerushalmi (Telmaudi i Jerusalemit), i dyti, shumë më i shkurt që anon kah skolasitika që është zhvilluar në akademitë e Babilonit, (përfundimisht i shkruar kah mesi i shekullit të pestë të erës së re), i cili quhet Talmud Bavli (Telmudi i Babilonit).

Tanah (hebr.): emërtimi origjinal hebraik i Biblës. Krishterimi në tërësi ka pranuar Biblën duke emërtuar atë Djathta e Vjetër, duke i shtuar asaj Djathtën e Re, të cilën çifutet nuk e konsiderojnë të shpallur nga Zoti.

tefila (hebr.): lutje publike e përbashkët apo lutje individuale e përditshme.

tefilin (hebr.): brezi i lutjes, të cilin meshkujt e bartin gjatë ditës së punës e lidhin në muskul të dorës së dobët (me atë të cilën nuk shkruajnë) dhe në kokë. Sot çifutet e bartin vetëm gjatë lutjes së mëngjesit.

teshuva (hebr.): pendim, kthimi në jetë sipas urdhrave të Zotit.

teva (hebr.): pjesë e ngritur në mes të sinagogës nga e cila lexohet Tevrat, para të cilit qëndron hazani gjatë shërbesës fetare. (shumësi: tevot).

tevila (hebr.): larje ceremoniale.

Tora (hebr.): tekstualisht: mësim, udhëzim, emërtim i përbashkët për të dy Tevratat – E shkruar dhe Gojore.

Tora shebihtav (hebr.): Tevrat i shkruar, Pesë librat e Mojsiut.

Tora she-be-al pe (hebr.): Tevrat gojor, shpjegim i detajizuar i rregullave të Tevratit të shkruar.

Tubishvat – shih: Hamisha Asar bi-shvat.

- Fund -

Literatura:

- Glosar religijskih pojmov, Sarajevo, 1999.
- Cadik Danon, Zbirke Pojmov iz Judaizma.
- Verski praznici, izbor, Beograd, 2007.

TRASHËGIMI

Mr. Sadik Mehmeti

VËSHTRIM TRI VAKËFNAMEVE ORIGJINALE (1608) TË MEHMED PASHË KAÇANIK(LI)UT*

Për arsye të ndryshme, historia jonë kombëtare është pasqyruar me shumë boshllëqe, të cilat sigurisht që do të plotësohen me kohë për t'i dhënë asaj atributet e vërteta shkencore. Deri më sot nuk janë pasqyruar sa duhet dhe si duhet shumë ngjarje dhe figura dhe, nga ana tjetër, mjaft autorë të historisë sonë janë përmendur shkarazi, e herë-herë, madje janë paraqitur edhe në mënyrë joobjektive dhe të njëanshme. Ndodh që veprimtaria e disa prej personaliteteve tona më shumë njihet jashtë sesa në vendlindjen e tyre.

Ndër këto personalitete bën pjesë edhe *Koxha Sinan pasha* dhe djali i tij, *Mehmed pashë Kaçanik(li)u*, të cilët për nga vlerat humane, ushtarake, politike dhe historike tejkalojnë statusin e prijësve lokalë. Këta dy padyshim paraqesin personazhe historike me përmasa kombëtare dhe krahasuar me historinë e shkruar për shumë pashallarë, vezirë, kryearkitektë..., shqiptarë që vepruan në atë kohë, *Koxha Sinan pasha* dhe *Mehmed pashë Kaçaniku* paraqiten, do të thoshim, si më të prekshëm, pasi akoma deri në ditët tona ruhen disa vepra arkitektonike të bëra nga ata, si në trojet shqiptare ashtu edhe në vise të tjera që dikur i takonin Perandorisë Osmane.

Katër janë arsyet kryesore pse e kemi nisur këtë shkrim dhe pse e kemi ndier detyrim që t'i hedhim në letër disa rreshta për këto figura kaq të shquara, që tashmë do t'i quajmë me plot gojën figura të një niveli kombëtar.

Së pari, duke hulumtuar tash së voni në Arkivin e Kosovës¹ kemi gjetur tri Vakëfnametë origjinale të Mehmed pashë Kaçanikut, që këtu janë marrë në shqyrtim, dhe të cilat, meqë shumica e vakëfeve që ka lënë ky personalitet i yni janë shkatërruar dhe kanë shkuar në paktim, paraqesin dokumentin e vetëm që dëshmojnë për vakëfet e këtij fisniku shqiptar.

Së dyti, vakëfet e Mehmed pashë Kaçanikut janë themeluar më 1608, do të thotë, ky dokument merret në shqyrtim me rastin e katërkind e njëvjektorit të legalizimit dhe shkrimit të tij.

Së treti, Vakëfnametë e gjetura, sikurse u tha, janë origjinale (arsyet se përse mendojmë se janë origjinale do t'i themi në vazhdim) dhe janë vakëfnametë e vetme të kësaj periudhe, të cilat kanë arritur në këtë formë dhe në tërësinë e tyre deri në ditët tona.

Dhe, *së katërti*, të dhënat dhe literatura që ka të bëjë me Mehmed pashë Kaçanikun dhe të atin e tij, *Koxhain e Vjetër - Sinan pashën*, po thuaj, të gjitha janë në gjuhë të huaja, dhe rrjedhimisht pak të njohura për lexuesit tanë.

Ç'është e drejta, për Vakëfnametë e Mehmed Kaçanikliut me mjaft kompetencë dhe seriozitet kanë shkruar dr. Hasan Kaleshi dhe Mehmed Mehmedovski², të cilët i kanë përkthyer dhe u kanë bërë një vështrim kritik e objektiv vakëfnameve të sipërpërmendura, megjithëse, vakëfnametë që këta studiues kanë pasur në dorë, kanë qenë, - siç shihet nga faksimilet që janë ofruar në këtë studim dhe siç e thonë edhe vetë ata, - kopje të Vakëfnameve të Mehmed pashë Kaçanikliut

* Ky punim është version i zgjeruar i kumtesës së lexuar në Simpoziumin Ndërkombëtar "Kosova dhe Perandoria Osmane në dokumentet arkivore", mbajtur në Prishtinë, më datë 14-15 prill 2009.

¹ Arkivi i Kosovës, *Fondi i dokumenteve osmane*, i parregulluar.

² Hasan Kaleši i Mehmed Mehmedovski, "Tri vakufnami na Kačanikli Mehmed paša", Skopje, 1958.

dhe jo vetë origjinali i tyre. Monografia e këtyre autorëve është në gjuhën maqedone dhe e botuar në një kohë relativisht të largët, andaj mendojmë se sikur të përkthehej në gjuhën shqipe, do t'i bëhej një shërbim i mirë shkencës shqiptare në përgjithësi.

Të dhëna për Mehmed pashë Kaçanikun, dhe sidomos për të atin e tij, pesë herë sadriazemin e Perandorisë Osmane, shqiptarin Koxha Sinan pashën, orientalisti i shquar dr. Hasan Kaleshi ofron edhe në vepërën e tij: “*Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku*”, Prishtinë, 1972, f. 257-308. Ky studiues është edhe i pari i cili Mehmed pashë Kaçanikun e ka identifikuar që është djali i Koxha Sinan pashës, dhe kështu ka përmirësuar disa lajthitje (të qëllimshme apo të paqëllimshme) që kishin të bënin me prejardhjen e këtij vakëflënësi e fisniku të shquar shqiptar.³

Por, para se të bëjmë fjalë për tri Vakëfnametë origjinale të Mehmed pashë Kaçanikut dhe para se t'i japim disa të dhëna për to, e gjejmë me vend që, mbi bazën e burimeve të sipërhënuara dhe të tjera, t'i paraqesim disa të dhëna për paraardhësit e Mehmed pashë Kaçanikliut; për këto personalitete të shquara të kësaj familjeje fisnike shqiptare, të cilët vepruan në kohën e Perandorisë Osmane; për këta vakëflënës të mëdhenj, emri i të cilëve, - dhe sidomos emri i Koxha Sinan pashës dhe djalit të tij Mehmed pashës, - është i lidhur ngushtë me Kaçanikun dhe me ndërtimin e tij, po edhe me qytetet e tjera shqiptare, si Lumën, Shkupin, Tetovën, Dibrën, Gostivarin, etj., pa përmendur këtu edhe shumë vakëfe që këta bamirës kanë lënë në vende të tjera, si në Jemen, Gjeorgji, Turqi, Siri, Greqi, Bullgari, Egjipt, Arabi Saudite etj. Dhe, edhe pse kjo familje fisnike dhe bujare shqiptare ka

³ Studimi i Dr. Hasan Kaleshit “Veliki vezir Kodža Sinan paša, vjegovе zadužbine i njegova vakufnama” - “Veziri i madh Koxha Sinan pasha - përshtipërjetimet dhe Vakëfnamja e tij”, që paraqet kapitullin e tetë të veprës “Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku”, Prishtinë, 1972, f. 257-308, është përkthyer në gjuhën shqipe nga Ismail Rexhepi dhe Sadik Mehmeti dhe është botuar në revistën “Edukata Islame”, nr. 82, Prishtinë, 2007, f. 95-143. Po nga këta dy është përkthyer e tërë vepra e Dr. Hasan Kaleshit, “Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku” – “Dokumentet më të vjetra të vakëfeve në gjuhën arabe në Jugosllavi”, e cila pritet që së shpejti të botohet.

vënë vulën e saj në ndërtimin dhe zhvillimin e shumë vendbanimeve tona, për të ende nuk kemi një monografi të mirëfilltë, ku do të përfshiheshin të gjitha vakëfet që kanë lënë këta bamirës dhe burrështetas të shquar, nga më të mëdhenjtë e kohës.

Kjo familje fisnike shqiptare ka origjinë nga *Topojani i Lumës (Shqipëri)*. Gjyshi i Mehmed pashë Kaçanikliut tonë, ishte *Ali Begu*. Titulli *beg* që mbante ky fisnik shqiptar, tregon se ai kishte qenë një njeri me ndikim dhe me pozitë në shoqëri. Po ky Ali begu është ai i cili në Prizrenin e lashtë ngriti katër ura, ndër to edhe Urën e njohur të Gurit, e ndërtuar më 1533, e cila ruhet edhe sot⁴.

Dihet se gjyshi i Mehmed pashë Kaçanikut, Ali begu i sipërpërmendur, kishte tre djem: *Hysen begun*, *Ajas pashën* dhe *Koxha Sinan pashën*.

Hysen begun në Vakëfnametë e tij e përmend edhe Mehmed Kaçaniku dhe thotë se në fshatin e tij (në Topojan) nga Hysen begu e kishte blerë çifligun të cilin tani e vakëfnonte.

Për djalin tjetër të Ali begut, *Ajas pashën* dihet se qe bërë vali i Bagdadit në vitin 1545 dhe në atë cilësi kishte ndërmarrë fushatën ushtarake kundër Basrasë. Më pastaj kishte fituar titullin vezir, kurse në vitin 1549 qe bërë vali në Dijar Bekir. Meqë gjatë rebelimit të Shehzade Bajazidit, Ajas pasha duke qenë në pozitën e valiut të Erzurumit, i kishte ndihmuar rebelët, ndaj dhe qe likuiduar në vitin 1559. Bijtë e tij kanë qenë *Mehmed pasha* dhe *Mustafë pasha*.⁵

Sami Frashëri në “*Kamus al-a’lam*”-in e tij të mirënjohur, për Ajas pashën, shkruan: “Edhe ky është shqiptar. Është vëllai i kryeministrit Sinan pasha të njohur si Çlirues i Jemenit. Gjatë kohës së sulltan Sylejmanit u caktua bejlerbe i Erzurumit. Për shkak se ia mundësoi dhe ia lehtësoi ikjen për në Iran, Shehzade Bajazid Hanit, i cili shpalli kryengritje në Anadoll, më 966/1558 në Erzurum, Ajas pasha u dënua

⁴ Kjo urë më 18-19 nëntor 1979 është rrënuar tërësisht nga përmytjet e lumit Lumbar-dhë, kurse rikonstrukcioni i saj është bërë më 1982. Për Urën e Gurit më gjerësisht shih: Raif Vermica, *Kosova'da Osmanli mimari eserleri, I*, Ankara, 1999, f. 126.

⁵ Dr. Hasan Kaleši, *Najstariji vakufski...*, vep. cit., f. 268.

me vdekje nga ana e sulltan Seimit II. Djali i tij Mustafë pasha gjendej në luftën e Vllahisë me mixhën e tij, Sinan pashën”⁶.

Mustafë pasha, djali i Ajaz Pashës dhe djalë axhe i Mehmed Kaçanikut tonë, ishte vali i Prizrenit, i cili në vitin 970/1562-63 në Prizren mbi themelet e një bazilike bizantine kishte ndërtuar një xhami të bukur, e cila në vitin 1950 qe goditur nga rrufeja, kurse në vitin 1952 qe rrënuar tërësisht dhe mbi të ishte ndërtuar Tregu i Gjellbër, e më pastaj më 1979/80 qe ndërtuar godina e Bankkosit, ku pas luftës së fundit në Kosovë qe vendosur UNMIK-u, kurse sot është i vendosur Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Për ndërtimin e kësaj xhamie, në “*Kronikën*” - “*Menakib*”-in e Tahir efendiut, shkruan: “Në më të lartin vend, Mustafë pasha e ka ndërtuar xhaminë, ku më parë ishte një faltore e të krishterëve”⁷. Tahir efendi, më tutje, në “*Kronikën*” e tij e përmend edhe një ngjarje, një ngatërresë që kishte ndodhur midis Jemishxhi Hasan pashës⁸ dhe Mustafë pashës, ngjarje kjo e cila kishte përfunduar tragjikisht për këtë të fundit.

⁶ Sami Frashëri, *Kamus al-a'lam*, I, f. 505. Cituar sipas: Sami Frashëri, *Vepra*, 9, (përktheu Mehdi Polisi), Shkup, 1994, f. 41.

⁷ Nehat Krasniqi, *Kronika (menakib) e Tahir efendiut burim i rëndësishëm për historinë e kulturës në Prizren gjatë periudhës turko-osmane*, “Edukata Islame”, nr. 57, Prishtinë, 1995, f. 94.

⁸ *Jemishxhi Hasan pasha* (1535-1603) ka lindur në Rogovë të Hasit, ku edhe ka ndërtuar shumë objekte me karakter profane dhe sakral. Në sajë të këtyre objekteve që ka ndërtuar ky personalitet i shquar shqiptar dhe burrështetas i Perandorisë Osmane, Rogova kishte fituar statusin e kazasë. Për vakëfet e Jemishxhi Hasan pashës shih: Prof. Shaqir Shala, *Zbulim i rëndësishëm historik në Rogovë të Hasit*, “Edukata Islame”, nr. 80, Prishtinë, 2006, f. 125-153.

Sami Frashërit, në “*Kamus al-a'lam*”, III, f. 1946, për Jemishxhi Hasan pashën, shkruan se ka qenë një nga vezirët që në kohën e sulltan Mehmed Hanit III, qe emëruar sadri-azem (kryeministër), dhe se është me origjinë shqiptare. Në vitin 985/1577 kishte hyrë në kategorinë e zylyfliballtaxhive (klasë e posaçme në oborrin mbretëror; pastaj qe bërë çeshnegir bashë, ket-huda i kapuxhive dhe dy herë aga i jeniçerëve. Më vonë qe emëruar vali i Shervanit me gradën e vezirit. Pas një kohe, me gradën vezir i katërt qe tërhequr në Stamboll. Punoi në shtypjen dhe përmirësimin e monedhës. Jemishxhi Hasan pashës i qenë besuar edhe detyra të tjera të rëndësishme. Kështu në vitin 1009/1600 qe emëruar kajmekam, kurse më 1010/1601 sadriazem... (Sami Frashëri, *Vepra*, 9, Shkup, 1994, f. 86-87).

Nga xhamia e sipërpërmendur në ditët tona njihen dy fotografi të bëra nga këndvështrime të ndryshme të vitit 1930. Këto dy fotografi, kujtojmë, janë të mjaftueshme që mbi bazën e tyre të bëhet rikonstrukcioni i xhamisë së Mustafë pashës. Kështu, sipas këtyre fotografive, xhamia ka qenë afër ndërtesës asokohe të Prefekturës së Prizrenit dhe se ka qenë një xhami e bukur, me një minare të hollë dhe elegante me një sherife. Xhamia ka qenë e ndërtuar nja 5 metra mbi nivelin e rrugës. Nëse e krahasojmë me ish-ndërtesën e Prefekturës, mund të konstatohet se xhamia ka qenë e lartë afro 8-9 metra, kurse minarja 27-30 metra. Xhamia nuk ka pasur kube, por ka pasur një kulm karakteristik katërstrehësh të mbuluar me qeramidhe. Në pjesën jugore kanë qenë të vendosura shtyllat e korridorit mbi murin rrethues. Hyrja kryesore ishte në pjesën perëndimore.



Në plan të dytë: Xhamia e Mustafë pashës në Prizren, e rrënuar më 1952

(Foto: 1930)

Do të ishte e ndershme dhe e drejtë që në vendin ku ka qenë xhamia e Mustafë pashës ose aty afër të ndërtohet një xhami, e cila, pak a

shumë, do t'i ngjante asaj që duket në fotografi dhe që do të mbante emrin e bamirësit dhe valiut të Prizrenit - Mustafë pashës, dhe kështu, ne do të lanim, deri në njëfarë mase, borxhin që kemi ndaj këtij vakëflënësi dhe valiut të njohur të Prizrenit.

Nga pinjollë të tjerë të kësaj familjeje fisnikësh shqiptarë nga Topojani i Lumës së Shqipërisë, përmenden edhe vëllai i Mustafë pashës, Mehmed pasha dhe Hasan pasha, për të cilët në literaturë mungojnë të dhënat, përveç faktit se për të dytin, Hasan pashën, dihet me siguri se ka qenë vali i Adenit, atëherë kur Jemeni qe qeverisur nga axha i Hasanit, Koxha Sinan pasha⁹.

Ndërkaq, për sa i takon djalin të tretë të Ali Begut, *Koxha Sinan pashës*, të dhënat biografike janë më të bollshme. Për të kanë shkruar shumë studiues, si Tahir efendi, Sami Frashëri, Jorga, Babingeri, Peçeviu, Mehmed Syrejai, Hameri, G. Elezoviçi, Jastrebovi etj. Por kontributin më të madh për ndriçimin e kësaj figure kaq të shquar, më pastaj për përkthimin e Vakëfnamesë së tij dhe për sqarimin e shumë çështjeve të cilat shkenca serbe i kishte futur në rrugë të gabuar, - e ka dhënë dr. Hasan Kaleshi, i cili edhe i ka shfrytëzuar të gjitha burimet e sipërsënuara¹⁰.

Kështu, dr. Hasan Kaleshi për Koxha Sinan pashën, shkruan: "*Koxha Sinan pasha, Gazi Sinan pasha ose Sinan pasha, "Çlirues i Jemenit"* (*Fatih-i Yemen*) është lindur në fshatin Topojan të Lumës (Shqipëri), kishte qenë pesë herë Vezir i Madh, kishte komanduar shumë fushata ushtarake kundër Austrisë përtej Danubit...

Në "*Kronikën*" e përmendur të Tahir efendiut në kreun "*Kronika e Vezirit të Madh, gaziut dhe çliruesit të Jemenit, Sinan pashës*", shkruan: "*E quaj në Sinan pasha. Është me prejardhje nga Topojani. E ka pushtuar Jemenin...*"

Në Vakëfnametë e birit të Koxha Sinan pashës, Mehmed pashë Kaçanikut, shihet se Mehmed pasha, kishte vakëfnuar pasuri në Topo-

jan,¹¹ nga se mund të përfundohet se aty (në Topojan) ai dhe i ati i tij kishin pasur pasuri të tyre, gjithsesi të trashëguar, sepse pasi që Sinan pasha ishte bërë Vezir i Madh, nuk do të blinte pasuri në një vend të tillë të paperspektivë të Lumës. Në këtë fshat (Topojan) ishte ndërtuar edhe *mesxhidi*, kurse Mehmed pasha imamit dhe myezinit i caktonte pagën ditore prej tri, respektivisht dy akçeve. Kjo do të thotë se këtë mesxhid e kishte ndërtuar vetë Mehmed pasha ose babai i tij, Koxha Sinan pasha. Në "*Kronikën*" e Tahir efendiut thuhet se afër fshatit të tij, Sinan pasha ka ndërtuar ujësjellësin, kurse në rrethinë ka lënë shumë vakëfe.

Gjatë kohës së sulltan Sylejman Kanuniut, Sinan pasha ka qenë *qeshnegir-bash* (*shef i kontrolluesve të ushqimit*), kurse më vonë qe bërë *sanxhakbej* i Malatisë, Kastamunit, Gazës, Tripolit të Sirisë, Erzurumit dhe Halepit. Në pranverë të vitit 1568 ishte caktuar mëkëmbës i Egjiptit. Sinan pasha në vitin 1571 qe nisur për në Medinë, e nga këtu për në Jemen. Nga Jemeni e kishte dërguar një kontingjent ushtarak për në Aden dhe më pastaj e kishte pushtuar atë. Për vali të këtij qyteti e kishte caktuar djalin e vëllait, *Hasanin*. Më pastaj, njëren pas tjetrës, kishte filluar marrjen e disa krahinave: Tazin, Sanën në viset malore, i kishte nënshtruar fiset arabe dhe Jemenin në tërësi. Kah mësi i vitit 1571, përmes detit, qe kthyer në Xhide, e nga këtu kishte vazhduar për në Mekë, ku kishte kryer haxhillëkun dhe kishte ndërtuar një seri vakëfesh, prej të cilave disa janë ruajtur edhe sot. Në të njëjtin vit ishte kthyer në Kajro dhe kishte dhënë urdhrin që të pastrohej kanali për ujitje nga Kajroja deri në Aleksandri, i cili kishte dalë nga përdorimi. Në të njëjtin vit po ashtu kishte përfunduar ndërtimin e xhamisë së tij në paralagjen Bulak të Kajros, e cila ekziston edhe sot. Xhamia ka një kube të madhe, tri dyer dhe tri galeri. Për dallim nga minaret arabe, në këtë xhami është ndërtuar minarja e tipit osman. Si duket, xhaminë e ka ndërtuar me pasurinë që kishte grumbulluar në Jemen, sepse kur pas Jemenit kishte arritur në Stamboll, ai kishte sje-

⁹ Dr. Hasan Kaleši "Najstariji vakufski dokumenti u Jugoslaviji na arapskom jeziku, Prishtinë, 1972, f. 270.

¹⁰ Dr. Hasan Kaleši "Najstariji vakufski..., vep. cit., f. 257-308.

¹¹ Hasan Kaleši-Mehmed Mehmedovski, *Tri vakufnami na Kačanikli Mehmed paša*, vep. cit., f. 73.

llë pasuri të mëdha, ishte prituri si hero dhe i qe dhënë titulli *gazi*. Në pranverën e 1574 kishte komanduar ushtrinë osmane në fushatën kundër Tunizisë, së bashku me kapitenin Këllëç Ali pasha. Gjatë rrugës kishin marrë disa vende dhe kishin zbarkuar në bregdetin e Tunizisë. Spanjollët ishin fortifikuar në fortifikatën Halk ul-vad (La Goleta). Ushtria osmane e kishte rrethuar atë fortifikatë dhe një muaj, ditë e natë, e kishte bombarduar dhe më në fund e kishte marrë me sulm. Me këtë edhe Tunizia i qe bashkuar Perandorisë. Në Stamboll Sinan pasha qe kthyer si vezir. Në pranverë të vitit 1580 kishte udhëhequr ushtrinë osmane kundër Gjeorgjisë. Në të njëjtin vit (më 25 gusht) qe caktuar kryeministër (Vezir i Madh), në vend të Ahmed pashës, i cili vdiq. Gjeorgjia ishte pushtuar, por mbeti e panënshtuar, kështu që pikërisht para përfundimit të luftës, qenë paraqitur vështirësi që ishin bërë shkas që Sinan pasha të shkarkohej dhe të ndiqej në Dimotok (më 5 dhjetor 1582). Me përkrahjen e grave dhe me ryshfetin prej 100.000 dukateve së shpejti kishte arritur sukses dhe në vend që të ishte dëbuar në Malgarë, ai qe bërë vali në Damask, nga i cili në prill 1589 qe kthyer në Stamboll si Vezir i Madh. Edhe pse larg nga vendlindja - Luma, ai kurrë nuk e kishte harruar atë. Me lutjen e tij, në dekadën e parë të muajit rebiul-ahir të vitit 994 (22-31.III.1586) Sulltan Murati III, kishte lëshuar një ferman, me të cilin banorët e pesë fshatrave, që ishin pronë e Sinan Pashës, liroheshin nga të gjitha tatimet. Ajo pjesë e fermanit, thotë:

“Ish-Veziri im i Madh, tani nga ana ime i caktuar vali i vilajetit të Damaskut, Sinan pasha, me qëllim që të bëjë vepër të mirë për fshatrat e tij: Qajle, që për çdo vit i sjell të ardhura 6.000 akçe, Fluri 4.000 akçe, Topojani 5.000 akçe, Kalimashi 8.000 akçe, Beleshqeja, të cilën e ka blerë Sinan pasha nga spahiu Lutfi me të ardhura prej 3.000 akçe-ve, me të gjitha malet, arat, kopshtet, pyjet, që janë në kufij të atyre fshatrave, - ua dhuron në shfrytëzim të përhershëm banorëve të këtyre fshatrave, rajës. Për vërtetimin e kësaj, e lëshoi këtë ferman dhe urdhëroi që nga banorët e fshatrave të lartpërmendur askush të mos guxojë të marrë yshyrin, as tatim në dele dhe kurrfarë tatimi tjetër nga tokat, të cilat tani janë bërë pasuri e rajës”.

Pasuria e madhe i kishte dhënë mundësi Sinan pashës që të harxhonte dhe me të t'i blinte shumë personalitete. Ai sërish i qe përvshur punës që, me ndihmën e një kanali që do të gropohej nga deti te vendi Sabanxhë kah Gjiri i Nikomedisë, të realizonte planin e vjetër për vendosjen e lidhjeve mes Detit të Zi dhe të Gjirit të Nikomedisë. Për shkak të luftërave, kjo ndërmarrje e tij kolosale nuk qe realizuar, për ç'arsye më 20 gusht 1591 Sinan pasha sërish kishte rënë në mëshirën e sulltanit dhe qe shkarkuar nga pozita. Mirëpo, më 29 janar 1593, me rastin e një rebelimi të jeniçerëve, qe ftuar për të tretën herë në pozitën e Vezirit të Madh. Nga ajo kohë, Sinan pasha kishte bërë përpjekje që të gjahtonte në perëndim të Perandorisë, para së gjithash në Hungari. Në pranverën e 1593, kishte komanduar ushtrinë në betejën në Hungari. Këtë luftë e kishte përfunduar duke pushtuar një varg qytetesh dhe kështjellash. Asokohe e kishte pushtuar Pollatën dhe në të njëjtin vit kishte kaluar dimrin në Beograd. Si duket, me këtë rast e kishte kallur Zemunin dhe kishte vendosur tatim për mullinjtë e Beogradit. Në Beograd kishte qëndruar deri në pranverën e vonë të vitit 1594.

Një muaj pas vdekjes së Sulltan Muradit III (27.I.1595), Sinan pasha qe detyruar serish që të largohej nga pozita dhe me 300.000 akçe të pensionit vjetor qe detyruar që përsëri të largohej për në Malgarë, por vetëm për disa muaj. Sepse, më 7 korrik të të njëjtit vit Sinan pasha e kishte zëvendësuar bashkëvendësin, rivalin dhe familjarin e tij, Ferhat pashën,¹² kurse disa javë më vonë kishte filluar fushatën

¹² Ferhat pasha me prejardhje është shqiptar. Ka qenë dy herë Vezir i Madh. Detyra e vërtetë më e madhe e tij ka qenë kapuxhibash, pastaj mirahor i parë, bejlerbe i Rumelisë, kurse në vitin 1578, në luftën kundër persianëve u bë serdar. Në këtë luftë ai i mundi persianët. Kur në vitin 1591 për të dytën herë Koxha Sinan pasha u shkarkua nga detyra e Vezirit të Madh dhe në vend të tij erdhi Ferhat pasha. Pas tetë muajsh edhe ky u shkarkua. Me ardhjen në fron të sulltan Mehmedit III (1595), Ferhat pasha për të dytën herë u bë Vezir i Madh. Asokohe u nis në luftë kundër Hungarisë. Ai ndërtoi urën mbi Danub. Por pikërisht kur duhej të nisej për në luftë, u shkarkua nga detyra, u kthye në Stamboll dhe pas një kohe u likuidua. Duket se kishte rënë pre e rivalitetit me Koxha Sinan pashën. Sami Frashëri në “Kamus al-a’lam”, për Ferhat pashën, shkruan: “Është nga vezirët që në kohën e sulltan Mehmed Hanit III dy herë kaloi në postin e sadriazemit (kryeministrit). Është me origjinë shqiptarë. Ka mësuar dhe është edukuar në oborrin mbretëror

ushtarake kundër Vllahisë, e cila ishte rebeluar. Në atë kohë, Koxha Sinan pasha për serdar të ushtrisë osmane e kishte emëruar birin e vet, Mehmed pashën, dhe me një ushtri e kishte dërguar në Kran. Mirëpo, ushtria osmane aty kishte pësuar humbje të plotë, të cilën Sinan pasha ia veshte qëndrimit qyqar të Mehmed pashës, i cili ishte tërhequr dhe kthyer në Budim¹³. Për më tepër, në gjithë atë fushatë në Vllahi nuk ishte arritur kurrfarë suksesi. E gjithë kjo u bë shkak që Koxha Sinan pasha më 19 nëntor 1595 sërish të shkarkohej dhe të internohej në Malgar. Mirëpo, kur pasuesi i tij, Lala Mehmed pasha vdes disa ditë pas emërimit, sërish qe ftuar Koxhai i Vjetër - Sinan pasha dhe kështu atij për të pestën herë i qe dorëzuar vula e Vezirit të Madh. Edhe pse tetëdhjetëvjeçar, ky “*shqiptar i pazbutur*”, siç e quan Hameri, kishte menduar që sërish të nisej në fushatë luftarake kundër Habzburgeve, por ishte vdekja ajo që e pengoi më 3 mars 1596.¹⁴ Sinan pasha u varros në tyrben e tij, në lagjen Sifiler në Stamboll.

(Haremi-i Hymayun). Pasi nga aty doli me gradën kapuxhibashë, në kohën e sulltan Murat Hanit III së pari u bë mirador, e më pastaj aga i jeniçerëve; e më pastaj vali i Rumelisë. Me gradën vezir i katërt, hyri në kategorinë e vezirëve. Në ekspeditën ushtarake të Iranit që u hap në vitin 986/1578 shkoi si serdar (kryekomandant). Arriti të bëhet i famshëm për sukseset e tij. duke lidhur marrëveshje dhe duke marrë me vete si peng djalin e vëllait të Shahut që ishte mirza (titull ushtarak në Iran) shumë i guximshëm, u kthye. Pas largimit të Koxha Sinan pashës, më 999/1590 për të dytën herë u bë vezir i dytë dhe iu besua detyra e lartë shtetërore dhe me përgjegjësi (myhyri i sadriazemit). Pasi i udhëhoqi punët shtetërore 8 muaj, e shkarkuan dhe e kthyen në detyrën e mëparshme. Në vitin 1003/1594, me ardhjen e sulltan Mehmed Hanit III në fron, për të dytën herë bëhet vezir i madh (sadrizem). Më pastaj, kur u hap fronti i Vllahisë, ndërtoi urën mbi Danub. Në kohën kur ia filloi luftës, pa farë shkakut iku, duke mos pritur zëvendësimin. Erdhi në çifligun e tij që e kishte në afërsi të Stambollit dhe aty u fsheh. Pas një kohe të shkurtër paraqitet dhe e burgosën në Jedikule. E dënuan me vdekje dhe e varrosen në lagjen Ebu Ejub Ensari, Zoti e mëshiroftë! Si sadriazem shërbeu, herën e parë 8 muaj dhe herën e dytë 6 muaj, d.m.th. 14 muaj gjithsej. Ishte një personalitet trim, i drejtë dhe i fuqishëm, sidomos është i çmueshëm rezultati dhe shërbimi që e bëri në luftën e Iranit. Rivaliteti i Koxha Sinan pashës ndaj tij, i cili ishte bashkëkombës i tij, i shkaktoi fatkeqësi dhe dëm.” (Sami Frashëri, *Vepra*, 9, Shkup, 1999, f. 65-66).

¹³ Në të vërtetë, ky është Mehmed pashë Kaçanikliu, për të cilin do të bëhet fjalë më poshtë.

¹⁴ Sipas historianit Peçevi, kurse sipas disa burimeve evropiane kjo kishte ndodhur më 3 prill 1596.

Kronistët turq nuk shkruajnë mirë për shumë çështje të Koxha Sinan pashës, edhe pse i përmendin meritat e tij të mëdha për Perandorinë Osmane. Ata thonë se ka qenë i ashpër, mendjemadh e hakmarrës. Kronisti osman Peçevi, nganjëherë e quan “*Arna’ud na’ud*” (*shqiptari kokëfortë*). Jorga konsideron se ai ka qenë i fundit nga më të mëdhenjtë e periudhës së shkëlqyeshme të Perandorisë Osmane. Peçevi po ashtu ia sheh për të madhe përse i ka ngritur shqiptarët në pozita të ndryshme. Kështu, ai në një vend, shkruan: “Në luftërat në Hungari, para rrethimit të Janikut, agallarët jeniçerë u caktuan si suitë të Sinan pashës, që kjo deri atëherë nuk kishte qenë adet. Ai, pas rënies së Kështjellës së Tatës, e shkarkoi agën e jeniçerëve, Mehmed agën, dhe në vend të tij e emëroi Jemishxhi Hasan pashën, i cili ishte nga radhët e shqiptarëve”. Duke iu falënderuar atij, shumë shpejt përparoi edhe djali i tij, Mehmed pashë Kaçanikliu.

Koxha Sinan pasha, si përfaqësues tipik i qarqeve më të larta feudale të Perandorisë, në mënyrë të veçantë ka tërhequr vëmendjen e disa historianëve perëndimorë, për shkak të pasurisë së tij dhe shfrytëzimit të pushtetit për pasurim personal. Duke u gjetur rreth dyzet vjet në pozitat më të larta shtetërore, nga ato rreth pesëmbëdhjetë vjet Vezir i Madh dhe komandant suprem, ai ka mundur të arrinte pasuri të mëdha. Haset e tij shtriheshin në sanxhaqet e Pashës (Manastir, Kesri, Demir Hisar, Serez, Lerin, Plovdiv), Nikopol, More, Janinë, Tirhali, Vlorë, Smederevë, Krushec, Silistri, Konjë, Akshehir, Aksaraj, Nigde, Agribozu, Marash dhe Ajdin. Këto hase i sillnin 2.263.680 akçe në vit, natyrisht, derisa ishte Vezir i Madh. Sipas burimeve, Sinan pasha kur ka vdekur ka lënë 600.000 dukatë ari dhe 29 milionë akçe argjendi. Që të kuptohet se sa është kjo shumë, do të përmendim se në vitin 1592, sipas pohimit të Lornc Bernardit, të ardhurat e përgjithshme të Perandorisë arrinin 10 milionë dukatë ari.

Emri i Koxha Sinan pashës është i lidhur ngushtë me Kaçanikun dhe ndërtimin e tij. Të dhënat për këto i kemi që nga Evlia Çelebiu, i

cili thotë se Koxha Sinan pasha e ka ndërtuar Kalanë e Kaçanikut¹⁵. Përveç Kalasë, nga Vakëfnameja e tij kuptojmë se Sinan pasha në Kaçanik ka ndërtuar një xhami, - atë që ekziston edhe sot, një imaret (kuzhinë popullore), dy hane, një shkollë dhe një hamam¹⁶. Ajo që është më e rëndësishme, për të funksionuar xhamia, shkolla dhe kuzhina, ai i ka vakëfnuar jo vetëm objektet (dy hane dhe hamamin) në Kaçanik, po edhe pasuri të mëdha në vende të tjera¹⁷.

Në vazhdim të shohim se kush është *Mehmed pashë Kaçanikliu*. Sipas studiuesve dr. H. Kaleshi dhe M. Mehmedovski¹⁸, thuhet se në të gjitha kronikat turke, e përmes tyre edhe te historianët evropianë, përmendet që Mehmed pasha ishte djali i Koxha Sinan pashës, por që ky ishte Mehmed pashë Kaçaniku këtë nuk e thotë asnjë nga këto burime. Mehmed pashë Kaçaniku e përmend vetëm G. Elezoviçi, por ai konstaton gabimisht se Mehmed pasha është djali i Këllëç Arslan begut, nip i Mehmed begut, e stërnip i Jahja pashës, kurse bij të tij na

¹⁵ Evliya Çelebi, *Siyāhātname* V, f. 552: "Këtu (në Kaçanik), në gojë të grykës dhe në breg të Lepencit, ngadhënjyesi i Jemenit Sinan Pasha, ka ngritur një kështjellë. Kjo kështjellë e bukur me formë katrore dhe një perimetër 800 hapa, ndodhet në një luginë me pengime të forta. Ajo ka dizdarin, pesëdhjetë ushtarë, dy topa e një portë. Brenda saj ndodhen dyzet shtëpi që shërbejnë për banesat e ushtarëve". Cituar sipas: Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë*, përkthyer nga Sali Vuçiterni, Tiranë, 2000, f. 119-120.

Se Sinan pasha është ndërtues i Kaçanikut, kemi argumente edhe në Vakëfnamenë e Mehmed pashë Kaçanikliut, ku shkruan: "Në grykën me emrin Kaçanik (kam vakëfnuar) mullirin prej tre gurëve në lumin e përmendur të Lepencit, i cili rrjedhë mospërmes vendbanimit të quajtur Kaçanik, të cilin (vendbanim) e ka ndërtuar bamirësi im dhe shkaktari i përparimit tim, i ndjeri dhe nga Zoti i falur, Sinan pasha...". (H. Kaleshi - M. Mehmedovski, *Tri vakufnami na Kaçanikli Mehmed Paša*, vep. cit., f. 27).

¹⁶ Përveç xhamisë, Evlia Çelebiu nga përmendoret e rëndësishme në Kaçanik përmend edhe një teqe bektashiane, shkollën fillore, hanin e madh dhe hamamin e vogël, por ai nuk thotë se i ka ndërtuar Sinan pasha. Shumë objekte i ka ndërtuar edhe Mehmed pashë Kaçanikliu, por Evlia Çelebiu aspak nuk e përmend Mehmed pashë Kaçanikliun, dhe as ndonjë prej vakëfeve të tij në Kaçanik. Shih: Evlia Çelebi, *Shqipëria 350 vjet më parë*, përkthyer nga Sali Vuçiterni, Tiranë, 2000, f. 119-120.

¹⁷ Dr. Hasan Kaleshi "Najstariji vakufski dokumenti...", vep. cit., f. 257-308.

¹⁸ Hasan Kaleshi i Mehmed Mehmedovski, "Tri vakufnami na Kaçanikli Mehmed paša", Skopje, 1958.

paskëshin qenë Maksud begu, Abdyl Bakiu dhe Murad begu.¹⁹ Është e qartë se G. Elezoviçi nuk e kishte lexuar Vakëfnamenë e Mehmed pashë Kaçanikut, sepse në të do t'i gjente të dhënat që kanë të bëjnë për djalin e Koxha Sinan pashës. Kështu, në një vend në këtë Vakëfname, qëndron: "*Bamirësi im dhe shkaktari i përparimit tim, i ndjeri dhe nga Zoti i mëshiruar, Sinan pasha*". Në disa vende shohim se Mehmed pashë Kaçaniku vakëfnoi pasurinë që ia kishte lënë në trashëgim babai i tij, e në një vend shprehimisht thotë se është biri i Koxha Sinan pashës. Ai po ashtu vakëfnoi pasuri në Kaçanik dhe në Topojan, siç kishte bërë edhe Sinan pasha. Prandaj, nuk ka vend për dyshim se Mehmed pashë Kaçaniku është djali i Koxha Sinan pashës.

Edhe kronikat turke ofrojnë shumë pak të dhëna për Mehmed pashën. Pozita e parë më e madhe e tij ka qenë *kapuxhibash*. Në vitin 999 (fillon më 30.X.1590) Mehmed pashë Kaçaniku e gjejmë si *aga të jeniçerëve*, kurse në vitin 1592 ai bëhet *bejlerbej i Rumelisë*. Në këtë detyrë e kishte emëruar babai, i cili asokohe ishte Vezir i Madh. Një vit më vonë, ai është *vali i Sirisë*, kurse nga viti 1004 (duke filluar nga 27.IX.1593) bëhet *serdar* me gradën vezir. Mirëpo, në luftërat kundër Hungarisë, Mehmed pasha i biri i Koxha Sinan pashës, nuk kishte treguar aftësi ushtarake, siç kishte treguar babai i tij, për ç'arsye qenë shkarkuar ai dhe babai i tij. Kur në muajin sheval të vitit 1004 (fillon më 29.V.1595), sulltani ishte nisur në luftë kundër Hungarisë, atë (sulltanin) pranë Batoçinës e kishte pritur Mehmed pasha. Sulltanit i qe kujtuar humbja që kishte pësuar Mehmed pasha te Krani, andaj kishte urdhëruar burgimin e tij dhe konfiskimin e pasurisë e tij. Por, vetëm pas tre ditëve, ai qe liruar dhe qe emëruar *muhafiz (komandant) i Kalasë së Beogradit*. Më vonë Mehmed pashë Kaçaniku e gjejmë në pozitën e valiut të Konjës dhe Damaskut. Kur në vitin 1599 në lindje të Perandorisë qenë rebeluar kurdët dhe turkmenët me Karajaxhiun e njohur në krye, kundër këtij të fundit qe dërguar vali Karaman Hysen pasha, por ky u qe bashkuar rebelëve. Sipas disa të dhënave, ky Hysen pasha kishte qenë në lidhje familjare me Sinan pa-

¹⁹ G. Elezović, *Turski spomenici I*, Beograd, 1940, f. 309.

shën, e rrjedhimisht edhe me Mehmed pashën. Në fund, kundër këtyre dy rebelëve të sipërpërmendur që dërguar Mehmed pasha, i cili i kish-te rrethuar në Rohë. Pasi rebelët nuk kishin mundur dot të çanin rrethimin, Karajazixhiu kishte filluar bisedimet me Mehmed pashën, duke i ofruar dorëzimin e Hysen pashës, me kusht që Karajazixhiut t'i ndahej pushteti në Amasia. Propozimi i tij ishte pranuar, kurse Hysen pasha që dërguar në Stamboll, ku edhe ishte likuiduar. Mirëpo, kur Karajazixhiu edhe më tej nuk ishte qetësuar, atëherë, si duket, Mehmed pasha që shkarkuar.

Të gjithë kronistët pajtohen se Mehmed pasha, përveç përkrahjes nga babai, ka pasur edhe përkrahjen e oborrit perandorak, sepse ka qenë i martuar me motrën e sulltan Selimit II, princesshën Xhemile. Rreth vitit të vdekjes së Mehmed pashës po ashtu ekziston konfuzion i vërtetë. Sipas Peçeviut, versionin e të cilit e pranon edhe Hameri, Mehmed pasha ishte vrarë në Stamboll me urdhër të sulltanit, në vitin 1012 (fillon më 11 qershor 1603), kurse sipas Syrejasë,²⁰ supozimin e të cilit e ka pranuar turkologu i Vjenës, *Herbert Duda*,²¹ Mehmed pasha kishte vdekur në vitin 1014 (fillon më 19.05.1605). Mirëpo, të dy datat janë të gabuara. Siç edhe kjo shihet nga Vakëfnameja e tij, e cila është hartuar në Shkup midis datës 10.11.-20.12.1608, e kurrse si është konsideruar deri më tani.

Duke ndjekur rrugën e babait të tij, edhe Mehmed pashë Kaçaniku ka ndërtuar në Kaçanik disa objekte, kështu që Kaçaniku rreth vitit 1600 kishte një pamje të një vendbanimi të zhvilluar me një serë institucionesh publike. Në të vërtetë, në Vakëfmet e Mehmed Pashë Kaçanikut gjejmë të shënuar: “*Në grykën e quajtur Kaçanik po ashtu kam vakëfnuar tre mullinj të tjerë...*” “*... Edhe në kasabanë me emrin Kaçanik (kam vakëfnuar) urën e ndërtuar në lumin Nerodime, e cila rrjedh kah Kalaja, kam vakëfnuar edhe kroyin dhe katër hane të ndër-*

²⁰ Mehmed Süreyya, *Sicil-i Osmani*, IV, Istanbul, 1890-1893, f. 139.

²¹ Herbert Duda, *Balkanturkische Studien*, Wien, 1949, f.39-40. Herbert Duda-it i është e njohur se Mehmed pasha kishte zgjedhur Shkupin, që në të kalonte vitet e pleqërisë dhe se në Shkup është varrosur. Cituar sipas Dr. Hasan Kaleši “*Najstariji vakufski dokumenti...*”, vep. cit., f. 257-308.

tuara rishtazi, të cilët gjenden në lagjen e jobesimtarëve të kasabasë së përmendur”.²²

Mehmed pashë Kaçaniku, sikurse u tha, themeloi një varg vakëfesh. Në vitin 1601 ai vakëfnoi një xhami në Shkup dhe vaizit (predikuesit) të saj i caktoi pagën ditore prej tri akçesh. Po në Shkup ai ndërtoi një shkollë dhe mësimdhënësit të saj i caktoi pagën ditore prej gjashtë akçesh. Mehmed Pasha ka vëkëfnuar edhe një bibliotekë dhe një teqe në Shkup. Po ky vakëflënës ka ndërtuar edhe një xhami dhe një shkollë në Gostivar, kurse për mirëmbajtjen e tyre ka vakëfnuar një karvansaraj dhe një hamam në Gostivar.

Nga ana tjetër, vakëfet e mëdha në Shkup, Kërçovë, Dibër, Gostivar, në shumë fshatra të Shqipërisë, në mesin e tyre edhe në Topojan, në vendlindjen e babait të tij, tregojnë se njerëzit e ndryshëm e me dinjtet kurrë nuk e kanë harruar vendlindjen e tyre, por janë përpjekur që në një farë mënyre ta shpaguejnë atë. Mirëpo, këto vakëfe të mëdha tregojnë se si pasuria e arritur me mund, që të ruhej nga ndonjë konfiskim eventual, ishte shndërruar në *evladijet-vakëf*, me se trashëgimtarëve u siguroheshin privilegje dhe një forcë e konsiderueshme ekonomike.

Në Vakëfnamenë e birit të Koxha Sinan pashës, Mehmed pashë Kaçanikut, shihet se Mehmed pasha, kishte vakëfnuar pasuri në Topojan,²³ Përveç kësaj, Mehmed pashë Kaçaniku në fshatin e vet e përmend edhe axhën e tij, do të thotë, vëllanë e Koxha Sinan Pashës, me emrin Hysen beg, nga i cili kishte blerë çifligun që tani e vakëfnonte. Në këtë fshat (Topojan) ishte ndërtuar edhe *mesxhidin*, kurse Mehmed pasha imamet dhe myezinit i caktonte pagën ditore prej tri, respektivisht dy akçeve. Kjo do të thotë se këtë mesxhid e kishte ndërtuar vetë Mehmed pasha ose babai i tij, Koxha Sinan pasha²⁴.

I biri i Mehmed pashës, *Mustafë pashë Kaçaniku*, në vitin 1644 ka ndërtuar një xhami në Gostivar, kurse i biri i Mustafë pashës, *Ebube-*

²² Hasan Kalesi-Mehmed Mehmedovski, vep. cit., f. 27.

²³ Po aty, f. 73.

²⁴ H. Kaleši - M. Mehmedovski, *Tri vakufnami na Kačanikli Mehmed Paša*, vep. cit., f. 27).

kir Pasha, po në Gostivar ka ndërtuar Xhaminë e Saatit dhe medresenë pranë saj²⁵.

Tri Vakëfname të Mehmed pashë Kaçanik(li)ut

Originali i tri Vakëfnameve të Mehmed pashë Kaçanikut, i cili ruhet në Arkivin e Kosovës është i shkruar në osmanishte me shkrimin arab *nes'h* të trashë, jashtëzakonisht bukur, shumë qartë dhe lexueshëm. Vakëfname të kanë gjithsej 65 faqe të formatit 26x17 cm. Kurse teksti 20x11 cm. Secila faqe ka nga 13 rreshta. Letra është e verdhe dhe e lëmuar. Në faqen 1b, ka një *tugra sulltanore*²⁶ të formatit të madh. Vakëfname të janë të vokalizuara. Kanë të shënuar numrin e faqeve dhe faqet kanë kustodat.

Është e ruajtur mirë, përveç faqes 39, e cila është e përgjysmuar. Është e mbuluar me kapakë të fortë, secili me nga një ornament të bukur në formë elipse me dimensione 8x6 cm., por paksa të dëmtuar nga koha.

Në të vërtetë, edhe pse formalisht janë tri vakëfname, secila prej tyre ka hyrjen dëshmitarët dhe vërtetimet e kadinjve, që do të thotë, se në të vërtetë kjo është një vakëfname e vetme dhe unike.

²⁵ Nehat Krasniqi, Roli i fisnikërisë shqiptare në zhvillimin e kulturës dhe civilizimit islam në trojet shqiptare gjatë periudhës osmane, "Vjetari" i Arkivit të Kosovës, nr. XXXV-XXXVI, Prishtinë, 2006, fq. 218.

²⁶ *Tugra* tregon logotipin ose memorandum-in e sulltanëve osmanë, që lajmërohet në cili ndo dokument zyrtar të tyre. "*Tu(g)ra*" është fjalë turke, të cilën turqit e lexojnë si "*tura*" pa shkronjën fytores "g", kurse arabët, boshnjakët dhe shqiptarët këtë fjalë e flasin ashtu siç shkruhet – "*tugra*".

E dimë se përkufizimi "*tura*" (tek shqiptarët "*turra*") në terminologjinë tonë, tregon faqen e parë të monedhës metalike, në të cilën, në periudhën osmane, është gjetur "*tugra*" e sulltanit në kohën e të cilit kjo monedhë qe farkuar, kurse, në rastin tonë, dimë që përkufizimi "*tugra*" ("*turra*") tregon anën e parasë së farkuar në të cilën gjendet stema shtetërore. Në "*Fjalori i shqipes së sotme*", Tiranë, 1984, f. 1268, për fjalën *turrë*, jepet ky shpjegim: "*turrë, turra, turrat, - vula e sulltanëve në shkresat e në paratë e Perandorisë Osmane*". Kurse në "*Fjalori i fjalëve të huaja*", Prishtinë, 1988, f. 633, thuhet: "*turrë, turra, - ana me fotografi e monedhës metalike*".



Faqeja e parë e vakëfmesë së Mehmet pashë Kaçanikut

Vakëfnameja e parë ka të bëjë me vakëfet në Shkup dhe në Kaçanik, e dyta me vakëfet në Tetovë, Gostivar dhe në Kërçovë, kurse e treta me vakëfet në Dibër dhe në rrethinën e saj. Në vakëfnamenë e parë janë dhënë edhe titujt e librave që ky bamirës i kishte lënë vakëf.

Mënyra dhe forma e hartimit të këtyre tri vakëfnameve sikurse edhe kadinjtë janë të njëjtë, përveç të parës, të cilën e ka verifikuar edhe poeti, stilisti dhe kadiu shumë vjeçar i Shkupit, *Vejsiu*.²⁷

Vakëfmetë janë hartuar në një periudhë prej 14 ditësh: E para është hartuar në dhjetëditëshin e par të muajit shaban 1017 (10-20.XI.1608), e dyta në dhjetëditëshin e fundit të muajit shaban të të njëjtit vit (prej 30.11-9.12.1608) dhe e treta në dhjetëditëshin e parë të muajit ramazan të të njëjtit vit. (nga 9-19.XII.1608).

Arsyet të cilat na shtyjnë që ne të konstatojmë se këto vakëfname të Mehmed pashë Kaçanikut që ruhen në Arkivin e Kosovës janë origjinale, përveç të tjerash, janë:

Që në fillim duhet thënë se Vakëfmetë që ruhen në Arkivin e Kosovës me siguri nuk janë tri Vakëfmetë, të cilat i kanë marrë në shqyrtim studiuesit H. Kaleshi dhe M. Mehmedovski. Autorët kanë bërë mirë, dhe kjo ia shton edhe më vlerën studimit të tyre - kur gjatë publikimit të monografisë së sipërpërmendur, në fund kanë dhënë edhe faksimilet e vakëfnameve të cilat ata i kanë pasur në dorë. Mirëpo, kur ne i krahasojmë këto faksimile me Vakëfmetë tona, shihet qartë se nuk kemi të bëjmë me të njëjtin shkrim dhe as me të njëjtin format.²⁸

²⁷ *Vejsi* është *mahlasi* (pseudonimi) i poetit dhe shkencëtarit osman Vejsi bin Mehmed, i cili ka lindur më 969 (1561) në Alashehir dhe është djali i Mehmed efendiut. Pas përfundimit të studimeve në Stamboll ka shërbyer në detyrën e kadiut në Rozetë, Kajro, Ak-Hisar, Teri, Alashehir, Serez, Rodos dhe për disa vjet në Shkup ku edhe ka vdekur më 1037 (1628) në moshën 68 vjeçe. Është varrosur në Shkup (varri i tij deri më 1954 ka qenë në varrezat e Gazi Babës afër mauzoleut të Kral Kzi-së, kur edhe është shkatërruar para se të ndërtohej Fakulteti Filozofik. Ka qenë një nga stilistët më të njohur të kohës së tij, edhe pse stilistika e tij janë të mbushura me shumë elemente persiane. Është autor i shumë veprave në prozë dhe në vargje. Veprat më të njohura të tij janë "*Sirat en-Ne-bij*", e cila rëndomë quhet "*Siyari Vejsi*" dhe "*Habnameja*". Vepra e parë ka të bëjë me jetëshkrimin e pejgamberit Muhamed a.s.

Përveç këtyre dy veprave, *Vejsiu* është autor edhe i veprës fetare "*Shehadetname*", pastaj i një përmbledhjes me poezi, i librit për çlirimin e Egjiptit dhe është autor i disa veprave nga lëmi i leksikografisë arabe. (Më gjerësisht: Hasan Kaleši i Mehmed Mehmedovski, "*Tri vakufnami...*", op. cit., f. 8-9.

²⁸ Vakëfmetë që kanë pasur në shqyrtim H. Kaleshi dhe M. Mehmedovski kanë qenë të shkruara me shkrimin arab *rik'a* dhe kanë pasur gjithsej 30 faqe të gjata 20 cm, të gjera 14 cm.



Faqja e parafundit e vakëfmesë së Mehmet pashë Kaçanikut

Sido që të ketë qenë, ajo që neve na shtyn që të konstatojmë se kemi të bëjmë me vakëfnametë origjinale është fakti se të tri këto Vakëfname janë të vulosura dhe aty kanë vënë vulat e tyre kadinjtë me rastin e verifikimit. Kurse në kopjen e vakëfnameve që kanë pasur në dorë H. Kaleshi dhe M. Mehmedovski në vend të vulave, që te ne janë në origjinal, aty janë bërë disa rrathë jokonvencionalë nga kopjuesi dhe në brendi të tyre është kopjuar teksti i vulave të kadinjve.

Më pastaj, stili i shkrimit të këtyre vakëfnameve, dhe sidomos firmat që kanë vënë kadinjtë secili veç e veç në fillim të vakëfnameve, është fakt i mjaftueshëm që ne të përfundojmë se kemi të bëjmë me origjinalin e Vakëfnameve të Mehmed pashë Kaçanikut.

Kështu, me llojin e shkrimit arab *nes'h*, Uveys Çelebiu ka shkruar verifikimin e tij, i cili thotë:

الله حسبي

يعمل بما في هذه المجلة المطرزة بالطغرى الخاقاني مما يسوغ و قصيته شرعا

زبره الى اللطف الرباني

ويسى القاضى باسكوب المحروسه

“Allahu është mbrojtësi im. Ajo që është gdhendur dhe vërtetuar me tigrën sulltanore në këtë dokument, ashtu siç edhe shkruan, dhe e cila është ligjësuar sipas Sheriatit, e ka shkruar i mëshiruari nga Zoti i tij, Vejsiu, kadi në qytetin e mbrojtur të Shkupit”.

Kurse në brendinë e vulës së tij shkruan:

راجى لطف الهى ويسى سنه ١٠٠٧

“Lutësi për mëshirë nga Zoti i tij, Vejsiu! Viti 1007/1598”

Në verifikimin e dytë, me shkrimin *nes'h-ta'lik*, Aliu i biri i Mehmedit i quajtur Hakirzade, shkruan:

ما فيه من اصل الوقف و طوابط ثبت و تحقق عندى مع شرائط و حكمت

بصحته و لزومه انا خادم الشرع المذنب على بن محمد الشهير بحاقرزاده

الاقسام العسكرية بلواء اسكب حميت عن الكروب

“Ajo që është në dokument që nga fillimi i vakëfnamesë dhe rregullave të tjera është verifikuar dhe konfirmuar sipas Sheriatit, kurse unë kam gjykuar për rregullsinë dhe vlefshmërinë e saj. E, unë jam shërbëtori i Sheriatit, i ngrati Aliu i biri i Muhamedit, i njohur si Hakirzade, nëpunës gjyqi në sanxhakun e Shkupit, le të jetë i ruajtur nga fatkeqësitë”.

Kurse në brendi të vulës së tij shkruan:

توكلى الى الله

“Mbështetja ime është në Allahun!”

Ndërkaq, verifikimi i tretë është i Jusufit të birit të Myrtezait, i cili ka vënë firmën e vet me llojin e shkrimit arab *ta'lik* dhe pa shenja diakritike, ku shkruan:

لما عرض على هذا الكتاب و طالعه من اوله الى اخره و جدته موافقا للشرع

القويم و النهج المستقيم فعلته و امضيته و يعدته كتبه العبد الفقير اليه تعالى

يوسف ابن مرتضى القاضى بلواء اسكوب حمي عن الكروب لولجترين القسام

العسكري عفى عنهما

“Pasi e shikova dhe e lexova këtë dokument që nga fillimi e deri në fund dhe pasi pashë se është në harmoni me Sheriatin e fortë dhe të rregullt, e verifikova, e nënshkrova dhe e vërtetova. Këtë verifikim e ka shkruar i ngrati rob i Zotit, Jusufi i biri i Myrtezait, kadi në sanxhakun e Shkupit, - le të jetë i ruajtur nga fatkeqësitë, - dhe nëpunës i gjykatës ushtarake në Vushtrri. Le të jenë të falur ai dhe babai i tij”.

Kurse në brendi të vulës shkruan:

فى كل الامور يوسف توكلى الى الله

“Unë mbështetem tek Zoti për çdo gjë, Jusufi!”

Gjithashtu gabimet teknike të cilat i kanë vërejtur me të drejtë studiuesit H. Kaleshi dhe M. Mehmedovski, në Vakëfnametë tona, nuk ekzistojnë. E, megjithëkëtë, disa gabime u janë përvjedhur edhe këtyre studiuesve.

Përveç kësaj, pas një përmirësimi të bërë në faqen 10 dhe 11 të Vakëfnameve tona, është vënë edhe një vulë tjetër, jo nga ato të kadinjve që janë vënë në fillim të vakëfnameve. Edhe kjo e dhënë na shtyn që ne të konstatojmë se kemi të bëjmë me origjinalin e vakëfnameve të Mehmed pashë Kaçanikut.

Nga sa thamë më sipër mund të përfundojmë se tri Vakëfnametë e Mehmed pashës Kaçanikut që ruhen në Arkivin e Kosovës, paraqesin vakëfnametë e fundit që janë ruajtur deri më sot në Kosovë. Janë origjinale, kurse tekstet e verifikimeve janë edhe autografe. Vulat e vëna aty gjithsesi kanë vlerën e tyre.

Nga ana tjetër, studimi i veprës së Koxha Sinan pashës si njëri nga sadriazemët më të suksesshëm të Perandorisë Osmane të shek. XVI dhe si themelues i qytetit të Kaçanikut, më pastaj studimi i vakëfeve të tij dhe të djalit të tij Mehmed pashë Kaçanikliut, si dhe pinjollëve të tjerë të kësaj familjeje fisnikësh shqiptarë, përbën një detyrim për studiuesit tanë. Kjo edhe për të pasuruar listën e emrave të mëdhenj që historia e shqiptarëve ka nxjerrë gjatë shekujve dhe për të mbushur faqet e saj.

Kurse Luma, Kaçaniku, Prizreni, Dibra etj., duhen të mburren dhe të jenë krenarë për këta bijë të mëdhenj të trevave të tyre, të cilët me gjithë ofiqet dhe privilegjet që kishin në Stamboll dhe gjetiu preferuan që të ktheheshin në vendlindjen e tyre dhe aty të ndërtonin objekte dhe të themelonin vakëfe, duke ngritur shumë vepra bamirëse dhe duke u qëndruar pranë njerëzve të thjeshtë; ata kurrë nuk harruan vendlindjen e tyre dhe as harruan që të ndihmojnë në çdo pikëpamje zhvillimin ekonomik, arsimor, fetar, zejtar, arkitektonik etj. të vendit të tyre.

Kaçaniku duhet t'i ketë për nder këta dy themelues, këto dy figura historike, Koxha Sinan pashën dhe djalin e tij, Mehmed pashë Kaçanikun. Ky i fundit madje për mbiemër të vetin kishte zgjedhur emrin e qytetit që ai dhe i ati i tij e themeluan - *Kaçaniku*; këtë asnjëherë nuk harroi që ta shkruante.

Emrat e këtyre dyve duhet t'i mbajë me plot nder ndonjë institucion arsimor, fetar, kulturor, zejtar etj., në Kaçanik dhe me gjerë.

Dhe fare në fund, për shkak të rëndësisë që kanë këto Vakëfname, sidomos për Kaçanikun dhe për qytetet e tjera shqiptare, **propozojmë që nga institucionet kompetente të shpallen dhe të trajtohen si monument i shkruar kombëtar.**

Mr. Sadik Mehmeti

A OVERVIEW OF THE ENDOWMENTS MADE BY (1608) MEHMET PASHA KAÇANIKU*

(Summary)

Due to different reasons our national history has not been dealt with properly. There are many gaps in it, which need to be filled in the future. Up to now, different events and personalities have not been presented properly. Some figures have been presented superficially or in a biased manner. Quite frequently, the deeds of some of our fellow countrymen are better known abroad.

صادق محمد

دراسة لثلاث وقفنامات أصلية لمحمد باشا كاشانيكو لسنة 1608

(خلاصة البحث)

لأسباب مختلفة تم تصوير تاريخنا القومي بنواقص عديدة قد يتم تصحيحه مع مرور الزمن حتى يرتقى إلى المستوى العلمي الذي نرجوه. و حتى الآن لم تقدم الكثير من الأحداث و الشخصيات الوطنية حسب الاسهام الذي قدموه إلى الوطن بل هناك شخصيات أخرى تم اعطاءهم وزنا وطنيا هم لا يستحقونه. بناء عليه فان الكثير من شخصياتنا الوطنية لها شهرة و تعرف أكثر لدى الشعوب الاخرى مما نعرف نحن في تاريخنا القومي.

HISTORIOGRAFI

Mr. Samir B. Ahmeti

OSMANLINJTË DHE METODAT E TYRE RRETH PËRHAPJES SË FESË ISLAME NË KOSOVË¹

Prej problemeve studimore të historisë së Kosovës me kufijtë e sotëm të saj, është edhe çështja e përhapjes së islamit përmes osmanlinjve², qysh prej paraqitjes së tyre të parë në Kosovë, e më pas. Ekzistojnë çështje të shumta që kanë të bëjnë me përhapjen e islamit, e të cilat kanë nevojë të qartësohen, prej tyre: Cilat ishin format e procesit të përhapjes së islamit? Cilat ishin metodat që kanë përdorur osmanlinjtë, në përhapjen e islamit në shtetet (vendet) e Ballkanit, në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti? Cila ishte gjendja jetësore e banorëve të Kosovës dhe cilat ishin rrethanat e tyre pas arritjes së shtrirjes islame në vendin e tyre? A ekziston dallimi në gjendjen (rrethanat) e shqiptarëve të Kosovës para dhe pas përhapjes së islamit në Kosovë? Për përgjigje të këtyre pyetjeve, i jam referuar thënieve të historianëve myslimanë dhe jo myslimanë, shqiptarë qofshin ata apo jo shqiptarë, e këtë e kam bërë, në mënyrë që e vërteta të jetë e dukshme dhe reale para të gjithëve.

¹ Kapitulli i parë i kreut të katërtë nga tema e magistraturës - në gjuhën arabe: Roli i osmanlinjëve në përhapjen e fesë islame në Kosovë, të autorit Mr. Samir (Bajrush) Ahmeti.

² Ismail Sulejman Ahmed, fq: 44, 45.

Dokumentet dhe burimet e mundshme vërtetojnë qartë se stabiliteti i plotë i sistemit feudal³ osman, në trojet shqiptare në përgjithësi dhe ato të Kosovës në veçanti, hapi mundësi të reja në unitetin e kombësisë shqiptare, në aspektin politik dhe kulturor, mirëpo kësaj radhe nën flamurin e fesë islame dhe civilizimit përparimtar të saj⁴.

Të qenit e shtetit osman si një shtet islam, pakicës fetare jo islame e cila banonte brenda kufijve të tij, si dhe e cila njihte sundimin e tij ndaj saj, i jepte të drejtën e ruajtjes së fesë së saj, në kryerjen e ceremonive fetare, në kuadër të pagesës së një takse vjetore, e ajo është “xhizja”, e cila në esencë konsiderohet si kompensim, për sigurinë të cilën e ka gëzuar pakica fetare (minoriteti fetar) nën hijen e sundimit osman. Pra kështu vërejmë se sundimi osman nuk ka përdorur dhunë të organizuar dhe të drejtpërdrejtë në zhdukjen e rrënjëve të fesë prezente (krishtere) dhe zëvendësimin e saj me fenë islame, as në Shqipëri e as në Kosovë⁵. Pra islami filloi të përhapej në formën më të gjerë me arritjen e turqve osmanë në trojet e Kosovës, do të thotë në çerekun e fundit të shekullit 14-të, kjo sipas mendimit që peshon më së shumti⁶, si dhe prej asaj kohe feja islame filloi që ta hapë rrugën e saj drejt gjirit të popujve ballkanikë, ku këta popuj filluan që të njihen me parimet e fesë së re (islame) dhe njerëzve të saj, të cilët posedonin cilësi të miqve të denjë, të etikës së lartë morale dhe sjelljeve të mira. Ku disa grupe të popujve ballkanikë, hynë në fenë islame pasi gjetën veten e tyre, se më parë kishin qenë të humbur. Më pastaj pasoi hyrja e grupeve të tjera, pasi që panë përmirësimin e qartë, e të dukshëm, i cili ndodhi te vëllezërit e tyre, që hynë në fenë islame⁷. Krahas veçorive dhe karakteristikave me të cilat dallohet islami nga fetë e tjera,

³ Sistemi feudal osman: ka qenë ai sistem, i cili përputhej me parimet e islamit, si dhe dallon me sistemin feudal evropian, sepse feudalët osmanë nuk i kanë konsideruar punëtorët, si robër të tyre, ashtu siç ka qenë gjendja në sistemin feudal evropian, në kohërat e mesjetës.

⁴ Dituria islame: Revistë mujore fetare kulturore shkencore, viti XIII, NR. 100, Shkurt 1998, fq: 55.

⁵ Historia e popullit shqiptarë: fq: 596.

⁶ Ejub Sidki Selman: fq: 18.

⁷ Ismail Sulejman Ahmed, fq: 46. / - Ejub Sidki Selman, fq: 20, 21. / - Dr. Bekër Ismail El Kusufi: El alakatu bejne l-lugati ..., fq: 11, 12.

ekzistojnë faktorë të tjerë, që kanë qenë prapa përhapjes së islamit në Kosovë, prej atyre faktorëve ka qenë përçarja e drejtimit religjioz, mes banorëve të Kosovës dhe sundimtarëve të tyre serbë. Të parët (banorët e Kosovës) kanë qenë në drejtimin ortodoks, në të cilin drejtim sundimtarët serbët i detyruan banorët e Kosovës që të konvertohen nga drejtimi katolik. Megjithatë, ka ekzistuar një pjesë e banorëve të Kosovës, që e kanë ruajtur drejtimin e tyre katolik, mirëpo këta të fundit kur u shfaq islami në shtetet e Ballkanit ka qenë më pak të entuziazmuar në përqafimin e islamit, sesa ajo pjesë e cila u detyrua të jetë në drejtimin ortodoks⁸, sepse kjo e fundit kishte pranuar drejtimin ortodoks me tortura dhe kundër dëshirës së saj. Po ashtu atë që duhet përmendur këtu është, që të dëftojmë për ekzistimin e një grupi (drejtimi) të tretë në shtetet e Ballkanit, e ajo është drejtimi i BOGOMILËVE⁹, i cili shtrihej (i përket) në pjesën e Bosnjës, ku shumica e këtij grupi e përqafoi fenë islame. Me rastin e privilegjeve të shumta që arrin, ai i cili rreshtohet në radhët e fesë islame, ku prej atyre privilegjeve ishte barazia me vëllezërit e tyre myslimanë, në detyra dhe të drejta, marrja e detyrave të ndryshme në shtet, për derisa kanë plotësuar kushtet, anëtarësimi (pjesëmarrja) në kulturën dhe civilizimin osman islam, kulturë e cila në atë kohë ishte në kulmin e madhështisë së saj, po ashtu caktimin e detyrës së xhihadit që bënë osmanlinjtë, për mbrojtjen e tokave ballkanike - që u bënë pjesë e shtetit osman - nga rreziku i shteteve krishtere evropiane, si Hungaria, Rumania, këtë të

⁸ Ali M. Basha: Nën gjurmët e islamit - Përmbledhje studimesh, analizash, shënimesh historike - kritike, refleksionesh..., Tiranë, 2005, fq: 116.

⁹ Bogomilët: Për herë të parë u shfaqën në shekullin e X-të miladi, në Bullgari, sektë ky i cili beson në ekzistimin e dy zotërave: zotit të të mirës dhe atij të keqës, zoti i parë është krijuesi i anës shpirtërore, kurse i dyti krijues i anës materiale, me idetë dhe bindjet e tyre nuk bazohen në librat e shenjtë. Marrëdhëniet e besimtarëve të këtij drejtimi me Papën dhe me Imperatorin e Austrisë kanë qenë të këqija. Bogomilët kanë qenë prezent në tërë shtetet e Ballkanit, ku sipas disa historianëve ekzistimi i Bogomilëve dhe kundërshtimi i tyre ndaj sistemeve qeverisëse dhe të kishës ka qenë prej shkaqeve që lehtësuan procesin e përhapjes së islamit në mesin e ithtarëve të bogomilëve në rend të parë, e më pas edhe në mesin e grupeve dhe rajoneve të tjera ballkanike, si dhe të Kosovës. (Këto njohuri i kam përfituar drejtpërdrejtë nga Prof. Dr. Milazim Krasniqi, studiues i njohur në Kosovë).

fundit e pengoi përparimi i shpejtë i osmanlinjve që bënë në shtetet e Ballkanit dhe ndjeu rrezik prej tyre, sa që mobilizoi ushtrinë e saj (Rumania) për t'i dalë ballë osmanlinjve, të cilët arritën ta stopojnë - shtetin osman - deri në një masë. Mirëpo, nga ana tjetër, kultura osmane islame ngriti fatin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe nxiti grupe prej tyre që të hyjnë në fenë islame¹⁰. Dhe si shtesë e asaj që u përmend, është se osmanlinjtë kishin miratuar një politikë të qëndrueshme, duke u interesuar në rrethanat jetësore për nënshtetasit e tyre, me ndërtimin e shkollave, instituteve, fakulteteve, bibliotekave, spitaleve dhe xhamive, si dhe interesim të diturisë dhe dijetarëve. E tëra kjo në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave dhe kërkesave të nënshtetasve të tyre, prej shërbimeve falas, që ofronin këto institucione. Osmanlinjtë, me edukatën e tyre islame dhe të shëndoshë kujdeseshin për robërit e luftës, e në veçanti për fëmijët e tyre, në mënyrë që të bëhen thirrës të islamit dhe mbrojtës të tij, në mesin e vëllezërve dhe farefisit të tyre, apo kudo që të gjenden¹¹. Kurse në anën tjetër osmanlinjtë kanë ndjekë një politikë të zgjuar ndaj njerëzve të fesë krishtere, në Kosovë në veçanti, si dhe në shtetet e Ballkanit në përgjithësi, duke i nderuar ata dhe ofruar një hapësirë të madhe, për lëvizje dhe ushtrim të aktiviteteve të tyre të ndryshme, si dhe ofrimin e sigurisë, garancisë dhe publikimin e dekreteve, të cilat diktojnë për ato gjëra. Ku prej shembujve të atyre dekreteve është dekreti, të cilin e publikoi sulltan Mehmeti II, të quajtur me emrin "Ahëdname"¹².

Nuk kanë qenë faktorët paraprakë të vetmit faktorë, që ishin prapa përhapjes së islamit në Kosovë, por ka pasur faktorë të tjerë, të cilët nuk kanë qenë më me pak rëndësi se ato të parat, e ata faktorë janë: metodat, në të cilat u mbështetën osmanlinjtë në tërheqjen (joshjen) e kosovarëve për islamin dhe afrimin e tyre tek ai, pra për shkak të rëndësisë së këtyre faktorëve të bëjmë një vështrim të tyre një nga një.

¹⁰ Ismail Sulejman Ahmedi, fq: 46. / - Dr. Rexhep Jashar Boja, El Albanij-june (El Arnaut) vel Islamu, fq: 43.

¹¹ Ismail Sulejman Ahmedi, fq: 47, 48.

¹² Po aty, fq: 49.

Metodat që përdorën osmanlinjtë rreth përhapjes së islamit në Kosovë

S'ka dyshim se ato metoda kanë qenë të lidhura, me ca prej shkaqeve dhe rrethanave të favorizuara, për transferimin (kalimin) e islamit të organizuar në trojet shqiptare¹³, andaj t'i cekim ato metoda si vijon:

E para: Mbajtja e ceremonive të synetisë. Osmanlinjtë u interesuan në mbajtjen e ceremonive, në raste të përgjithshme dhe të veçanta, duke i konsideruar ato si mjete efektive, për joshjen e nënshtetasve të tyre dhe mbledhjen e tyre në një vend të caktuar, si dhe paraqitjen e pamjes së mirëseardhjes së tyre në islam, për joshjen e tyre. Prej ceremonive në të cilat gjeti interesimin e tyre, ishin ceremonitë e synetisë, të cilat ishin dukuri e re, që e futën osmanlinjtë në shtetet e Ballkanit, ku këto ceremoni patën sukses në joshjen e një numri të madh të kosovarëve në islam¹⁴.

E dyta: Inkurajimi i të krishterëve krahas përqafimit të fesë islame. Ky inkurajim është bërë kur janë mbajtur ceremoni popullore, me rastin e përqafimit të islamit, nga ana e ndonjërit prej tyre (të krishterëve), si dhe me furnizimin e tij, me çdo gjë që i ndihmon në jetesë, duke kërkuar prej tij të shkojë në xhami, etj¹⁵.

E treta: Shëmbëlltyra e mirë. Osmanlinjtë u kujdesën shumë në të përmbajturit e fesë islame dhe kryerjen e riteve fetare, ku kjo është ajo që i bëri ata të denjë dhe të arrijnë admirimin e disa të të krishterëve, si dhe joshjen e tyre në islam¹⁶.

E katërta: Dhënia e ca privilegjeve atij që pranon islamin. Si dhënia e të drejtës së tij, në ruajtjen e tokës dhe pasurisë së tij, si dhe caktimin (ndarjen) e ca pronave, nëse ka qenë prej njerëzve më me ndikim në popullin e tij, etj...¹⁷.

¹³ Dituria islame, NR. 100, fq.: 55.

¹⁴ Dr. Rexhep Jashar Boja, El Albanij-june (El Arnaut) vel Islamu, fq: 44.

¹⁵ Po aty, fq: 44, 45. / - Ali Muhammed Muhammed Es-sal-labi: Ed-devletul uthmanij-jetu ..., fq: 76.

¹⁶ Ali Muhammed Muhammed Es-sal-labi: Ed-devletul uthmanij-jetu ..., fq: 76.

¹⁷ Dr. Rexhep Jashar Boja, El Albanij-june (El Arnaut) vel Islamu, fq: 44.

E pesta: Butësia me robin dhe mirësia ndaj tij. Osmanlinjtë janë sjell me robërit e të të krishterëve me një sjellje, e cila është karakterizuar me butësi, që ishte nga sinqeriteti i tyre krahas parimeve fetare islame, gjë që i kanë liruar robërit atëherë kur janë bindur në sinqeritetin dhe besnikërinë e tyre, edhe nëse kanë mbetur në fenë e tyre, ashtu siç kanë marrë përsipër përkujdesjen e robërve edhe pas lirimit të tyre, e në veçanti të moshuarit prej tyre. Pra për shkak të meritës së sjelljes së mirë të osmanlinjve ndaj robërve të të krishterëve, u bënë myslimanë një numër i konsiderueshëm i robërve¹⁸.

E gjashta: Lirimi i robërve të krishterë të luftës. Osmanlinjtë i kanë liruar robërit e krishterë të luftës, si dhe të tjerët nga fetë tjera, nëse kanë hyrë në fenë islame me dëshirën e tyre të sinqertë, ku kjo metodë ka kontribuar në shtimin e myslimanëve dhe rritjen e tyre¹⁹.

E shtata: Interesimi për ruajtjen e sigurisë, luftimin e fanatizmit fisnor dhe ndalimin e ngatërresave grupore. Osmanlinjtë u kujdesën shumë në paraqitjen e islamit, në formën e cila e shfaq atë, ashtu siç është reale, si një fe që i shikon pjesëtarët e saj me pikëpamjen e barazisë, në të drejta dhe obligime. Përveç këtyre, feja islame ka prishur rrugët e lidhjeve të kabileve, të farefiseve dhe të grupeve. Sepse, largimin e këtyre pikëpamjeve nga ekuacioni politik dhe shoqëror, bën që t'i ofrosh njerëzit mes vete, si dhe bën zhdukjen e zilive, mlllefeve dhe ndarjeve shoqërore, i ofron mes vete nga largësitë dhe i bën ata vëllezër, të dashur mes vete për hir të Zotit, duke iu përmbajtur një ligji, duke iu drejtuar një kibleje dhe duke adhuruar vetëm një Zot, e Ai është All-llahu i Madhërishtëm²⁰.

E teta: Largimi i osmanlinjve nga përdorimi i dhunës gjatë thirrjes në fenë islame. Pjesa e mëhershme dëshmoi për rrethanat e osmanlinjve në shtetet e Ballkanit, si dhe në luftën mes drejtimeve

¹⁸ Ali Muhammed Muhammed Es-sal-labi: Ed-devletul uthmanij-jetu ..., fq: 76.

¹⁹ Po aty, fq: 77. / - Dr. Rexhep Jashar Boja, El Albanij-june (El Arnaut) vel Islamu, fq: 44.

²⁰ Dituria islame: NR. 100, fq.: 56.

fetare kishtare të atyre shteteve, ku ballkanasit janë dëmtuar nga kjo konkurrencë apo luftë, sepse kishat serbe dhe sllave... kanë miratuar një politikë, e cila qëndron prapa asimilimit të popujve, popuj të cilët refuzojnë hyrjen në krishterimin e drejtimit të tyre. Pra, kjo politikë kishtare, kishte hapur rrugën e thirrjes islame, e në veçanti kur thirrësit myslimanë osmanë u popullarizuan me mirësjellje, butësi dhe urtësi, me rastin e paraqitjes së islamit te të tjerët²¹.

E nënta: Përcaktimi që bëri islami për pjesëtarët e tij në dhënien e mundësisë për ruajtjen e lidhjeve të tyre fisnore dhe rajonale. Shtetet e Ballkanit para çlirimit osman të tyre, kanë qenë të shpërndara në disa grupe fetare. Ata që kishin lidhje me këto grupe krishtere nga ballkanasit, i përkisnin një shteti, një vendi apo një kombi, me të cilin kishte lidhje grupi i tyre. Pra, ata që kishin lidhje me Greqinë konsideroheshin grekë, etj... Ku, këto grupe, prapa kësaj politike të tyre kanë synuar shkëputjen e lidhjeve mes ballkanasve dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të tyre fisnore dhe rajonale, etj... Kurse osmanlinjtë, në bazë të fesë së tyre islame dhe duke qenë të kujdesshëm në përcjelljen e thirrjes islame te të tjerët, siguruan hapësirë të gjerë për popujt ballkanas. Andaj, ballkanasit hynë në fenë islame, ngase ajo u mundësonte për të kërkuar origjinën e tyre dhe t'i bashkëngjiten asaj, si dhe për të ngjallur trashëgiminë e tyre kombëtare. Shqiptarët shfrytëzuan këtë shans dhe kthyen prejardhjen e tyre tek origjina e vjetër e tyre, do të thotë, tek origjina ilire²².

E dhjeta: Hapja e vendeve të punës për të gjithë. Islami është interesuar në dy përbërjet themelore të njeriut: materien dhe shpirtin, në mënyrë që të krijojë një shoqëri të shëndoshë dhe të qëndrueshme. Dhe në shërbim të këtyre dy aspekteve, dispozitat dhe parimet e islamit aktivizuan funksionimin e tyre. Pra duke u nisur nga kjo, thirrësit (islamë) osmanë paraqitën fenë islame nga ana teorike

dhe praktike si një fe stabile, e cila angazhohet në përgjigjen e të gjitha nevojave të njeriut, në atë formë që përshtatet me doktrinat e njeriut. Ku, prej metodave më të spikatura që iu mundësua njeriut t'u përgjigjet nevojave të tij, atyre materiale në veçanti, ishte puna. Pra, osmanlinjtë përmes hapjes së vendeve të reja të punës për të gjithë shqiptarët myslimanë hapën shansin e bashkimit, po ashtu shansin e avancimit në shkallët më të larta dhe marrjen e detyrës të të gjitha posteve me përjashtim të postit të Sulltanit²³.

E njëmbëdhjeta: Mosrritja e obligimeve financiare ndaj nënshtetaseve të tyre dhe përmbushja e minimumit të obligimeve detyruese financiare. Popujt e Ballkanit, para çlirimit islam të vendeve të tyre kanë jetuar një jetë të vështirë, për shkak të detyrave obliguese financiare që ishin të shumta për ta, të cilat caktoheshin nga feudalët pushtues, e të cilët vinin prej shteteve sunduese të popujve të Ballkanit. Ku, nga këto obligime financiare nuk kanë shpëtuar as pronat e kishës. Ndërsa, kur osmanlinjtë erdhën në Ballkan, dhe pasi që vendet e tij i futën nën sundimin e tyre, nuk i kanë kushtëzuar nënshtetasit e tyre ballkanas në detyrimin e obligimeve financiare, sepse ata ishin bartës fetarë e jo koleksionarë, ngase ishin të përmbajtur në minimumin e asaj pagese, për t'i tërhequr ballkanasit në përqaftimin e fesë islame. Politika e osmanlinjve gjeti një mirëkuptim te shqiptarët e Kosovës, deri në atë shkallë sa që disa prijës fetarë, që i përmbaheshin politikës serbe feudale, hynë në fenë islame²⁴.

E dymbëdhjeta: Inkurajimi i njerëzve nga vendbanimet e ndryshme. Shteti osman bëri bartjen e një numri të të krishterëve në disa vendbanime, të cilat i kanë përgatitur më herët - në rajone të veçanta me myslimanë, për mundësimin e të krishterëve, që të njihen me islam si një sistem i jetës. Kjo bëhej për t'i tërhequr ata në fenë islame. Ku, për të realizuar po këtë synim, kanë zgjedhur disa

²¹ Po aty, fq: 56.

²² Po aty, fq: 56.

²³ Po aty, fq: 56.

²⁴ Ali Muhammed Muhammed Es-sal-labi: Ed-devletul uthmanij-jetu ..., fq: 77.

grupe prej fiseve osmane myslimane dhe i kanë vendosur në rajone të veçanta, të banuara me të krishterë²⁵.

E trembëdhjeta: Martesa me të krishtere. Martesa me të krishtere konsiderohet prej metodave të suksesshme, të cilat osmanlinjtë i kanë përdorur në thirrjen e fesë islame. Sepse fëmijët që kanë lindur nga kjo martesë, ndiqnin fenë e babait të tyre, në përputhje me dispozitat e sheriatit islam, në të cilat mbështetet kjo martesë. Ku, Kisha në Kosovë ndjeu këtë rrezik të kësaj martese në të ardhmen e saj dhe e ndaloi hyrjen në kishë, të atyre grave krishtere të cilat ishin martuar me myslimanë. Por, rezultati i reagimit të disa prej atyre grave të krishtera, ishte hyrja në fenë islame, fenë e bashkëshortëve të tyre²⁶.

E katërbëdhjeta: Zgjedhja e disa thirrësve (fetarë) prej shqiptarëve të Kosovës. Osmanlinjtë zgjodhën një grup nga kosovarët, të cilët kishin hyrë në fenë islame dhe të cilëve ua kishin mësuar fenë, si dhe më pas ua besuan detyrën e thirrjes islame të bashkëkombësit e tyre, sepse ata i bashkonte gjuha dhe kultura. Edhe pse myslimanët e rinj shqiptarë dallonin nga feja me bashkëkombësit e tyre, ata megjithatë kishin mundësi të shumta, për të gjetur një kohë të përshtatshme, që të depërtonin në zemrat dhe mendjet e tyre²⁷.

E pesëmbëdhjeta: Respektimi i marrëveshjeve dhe kontratave me jomyslimanët (EHLU DH-DHIM-METI). Osmanlinjtë kanë qenë të përmbajtur ndaj rregullave dhe parimeve islame, që myslimanët i kanë paraparë qysh prej kohës së Pejgamberit a.s., për paraqitjen e islamit të tjerët. Ato rregulla dhe parime islame u ofrojnë shansin të tjerëve për të zgjedhur njërin prej tri opsioneve: islamin, xhizjen apo luftën. Sa u përket **ehludh-dhimëve**, ata kishin zgjedhur opsionin e dytë, pra pagesën e xhizjes. Kurse shteti Islam, të krishterëve u ka dhënë privilegje të shumta, por ndërkohe i ka detyruar ata përveç pagesës së xhizjes edhe të jenë të

sjellshëm ndaj myslimanëve edhe ndaj vetvetes së tyre. Historiani britanik “Noel Malcolm” i potencon këto të drejta dhe detyra kur thotë: ... Mirëpo, të krishterët dhe jahuditë në përgjithësi janë konsideruar si nënshtetas - Dhim-mijjin - (jomyslimanët e mbrojtur), e ajo ka nënkuptuar se statusi i tyre ligjor mbrohet me ligj përderisa i nënshtroheshin shtetit osman. Osmanlinjtë, të krishterëve u ofronin privilegje të cilat i gëzonin, e që ishin të drejta ligjore të ndryshme, p.sh., u lejohej që t’i përmbahen jetës fetare të tyre, ruajtja e kishave të tyre dhe të posedonin gjykata të tyre fetare. Mirëpo, atyre - të krishterëve - nuk u lejohej bartja e armëve (kjo ndalesë absolutisht nuk është respektuar në tokat shqiptare), nuk lejohej veshja e disa rrobave të myslimanëve, ashtu siç ishte e ndaluar rreptësisht fyerja e fesë islame dhe përpjekja e ndërrimit të fesë myslimanëve²⁸. Si shtesë e asaj që u përmend është se bashkësive krishtere u lejohej që të ruanin godinat e kishave të tyre, kurse në rast se kanë dëshiruar t’i zgjerojnë ato, është dashur që të kërkojnë leje nga qeveria sunduese myslimane, ku këta të fundit shpesh i kanë lejuar ata që të zgjerojnë, bile edhe më shumë se kjo, ku në disa raste i kanë lejuar edhe të ndërtojnë kisha të reja²⁹.

Kurse ata të cilët kishin zgjedhur opsionin e luftës, raporti i osmanlinjve ndaj tyre dallonte, në krahasim me ata që kishin zgjedhur pagesën e xhizjes. Noel Malcolm e ka përmbledhur atë raport që u përket kosovarëve, kur thotë: Kurse qytetet në të cilat, osmanlinjtë kanë hyrë me forcë pas refuzimit për dorëzim të banorëve të atyre qyteteve, kishat e tyre janë shndërruar në xhamia, p.sh: kisha “saksone” e qytetit Novobërdë u shndërrua në xhami në vitin 865 h - 1460 m, po ashtu edhe dy kisha të Prizrenit janë shndërruar në xhami në kohën e hershme të sundimit osman, sikur që është shndërruar në xhami edhe një kishë në qytetin e Pejës³⁰.

²⁵ Po aty, fq: 77.

²⁶ Po aty, fq: 77.

²⁷ Po aty, fq: 77.

²⁸ Noel Malcolm: fq.: 112.

²⁹ Po aty, fq.: 112.

³⁰ Po aty, fq.: 112.

Vlerësimi i historianëve ndaj metodave të osmanlinjve në përhapjen e fesë islame

Pikëpamjet e historianëve bashkëkohorë janë të ndryshme përreth metodave, përmes të cilave osmanlinjtë e kanë përhapur islamin, në shtetet e Ballkanit në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti, gjithsesi në bazë të tendencave (drejtimeve) të tyre kulturore dhe pikënisjeve të tyre ideologjike dhe fetare. Ku, prej të cilëve ka, që është nisur nga kuptimet të cilat i bart vetë fjala “islam”, kur vëren se synimi themelor i islamit kudo që të jetë është, realizimi i sigurisë, paqes dhe stabilitetit, si dhe myslimanët osmanë i kanë realizuar këto domethënie në Kosovë, kanë shëruar (fashuar) plagën dhe kanë siguruar një atmosferë (klime) për bashkëjetesë paqësore mes popujve dhe feve, në kohën kur kishat në Evropë kanë qenë burim i ngacmimit të ngatërresave fetare, burim i sundimit dhe të presionit fetar³¹.

Kurse një grup tjetër pretendon, se osmanlinjtë nuk kanë ndjerë simpati ndaj kosovarëve dhe se kanë shtruar dhunë ndaj tyre, në mënyrë që t'i detyronin ata për të pranuar fenë islame. Mirëpo, njëri nga vetë perëndimorët, siç është Thomas W. Arnold i cili këto pretekste (pretendime) i ka studiuar dhe ka vërejtur se ato janë të pasakta (të pavlefshme), sepse nuk janë të dëshmuara me fakte, në të cilat duhet mbështetur³².

Ashtu siç e cek dr. Sherif Delvina atë, që e ka përmendur historiani Aristith Kola se, osmanlinjtë nuk e kanë detyruar me dhunë askënd, për ta ndërruar fenë dhe se, preteksti për ndërrimin e fesë me dhunë ndër shqiptarët është rezultat i fantazmave të priftërinjve dhe iluzioneve të tyre, pra nuk i ka hije historianëve që të pranojnë një gjë të tillë dhe e përshkruan këtë pretekst si gënjeshtër dhe qëllim të keq³³. Shqi-

ptarët e kanë pranuar fenë islame, sepse ajo përputhet me natyrën e tyre³⁴.

Si shtesë e asaj që u përmend është se, dhuna absolutisht nuk ka qenë pjesë e politikës osmane në Kosovë, e as në vendet tjera të shteteve të Ballkanit, në detyrimin e ndokujt të përqaimit të islamit, pra dhuna nuk ka ekzistuar as në periudhën e parë të thirrjes islame osmane në këto troje³⁵.

Myslimanët në tërë historinë e tyre, nuk e kanë përdorur dhunën në këtë drejtim, fiset arabe në kohën e Pejgamberit a.s. kanë hyrë në fenë islame pa asnjë dhunë dhe me këtë formë, feja islame ka filluar dhe ka vazhduar në të gjitha kohërat. Arabët nuk e kanë detyruar asnjë spanjoll ta pranojë islamin, përkundër asaj se arabët i kanë sunduar spanjollët nga shekulli i 8-të deri në shekullin e 15-të, ku të shumtë ishin ata, që e përqafulan fenë islame gjatë këtyre shekujve. Mirëpo, pasi që u kthye sundimi në duart e spanjollëve në vitin 898 H-1492 M, ai i cili nuk është kthyer në fenë e tij të vjetër nga spanjollët myslimanë është mbytur, vetëm ai cili arriti të ikë në Afrikë mundi të shpëtojë. Pra, në këtë rast mund të thotë çdo njëri se, kjo metodë e ndërrimit të fesë me plot kuptimin e fjalës është dhunë³⁶.

Sikur të kishin përdorur osmanlinjtë turq metodat e dhunës, për realizimin e synimeve të tyre - ashtu siç pretendojnë injorantët - kishin me arritur të formojnë një union të plotë, por ata nuk i kanë përdorur ato metoda, sepse feja islame nuk i ka lejuar³⁷. Argumenti që dëshmon për mospërdorimin e dhunës nga osmanlinjtë është, mundësia e përdorimit të bibliotekave, të cilat janë në dispozicion për të bërë në to kërkim shkencor, si mundësi të studimit të këtij fenomeni dhe testimit të tij. Për kundër kësaj dijetari “Robert Matrani” thotë: Nuk ka pasur synim dhe as plan nga ana e udhëheqësve osmanë për asimilimin e po-

³¹ Ali M Basha, fq.: 132.

³² Thomas W. Arnold: HISTORIA E PËRHAPJES SË ISLAMIT, përktheu nga boshnjakishtja: Nexhat S. Ibrahim, Shtëpia botuese “Dituria islame” - Prishtinë, 2004, fq.: 179.

³³ Muhidin Ahmeti: fq.: 43, 49.

³⁴ Po aty. Fq.: 49.

³⁵ Dr. Bekër Ismail El Kusufi: El-lugatul arebij-jetu ..., fq: 13.

³⁶ Muhidin Ahmeti: fq.: 51.

³⁷ Edwin Jacques: fq.: 241.

pujve të nënshtruar, ashtu siç nuk ka pasur presion e as detyrim sa i përket kalimit të njerëzve në osmanizëm apo islamizëm³⁸.

Dhuna fetare nuk ka qenë cilësi e lidhur me fenë islame, as në kohën e vjetër e as në kohën bashkëkohore, si dhe në historinë e saj e cila gati i kaluan 15-të shekuj, për fat të mirë, nuk mund të thuhet se dhuna ka qenë rrugë e përhapjes së kësaj feje të drejtë³⁹.

E vërteta dëshmon se nuk ka qenë e ndaluar as për të krishterët e as për çifutët, në Kosovë që të ushtrojnë jetën e tyre fetare, por përkundrazi, të drejtat dhe liritë fetare të cilat i kanë gëzuar jomyslimanët nën sundimin osman, nuk i kanë gëzuar as në vet shtetet e të krishterëve⁴⁰.

Ndërsa dr. Çiro Truhelka e vërteton këtë realitet, duke thënë se sikur të ishte përhapur feja islame me dhunë të ushtruar nga qeveria e osmanlinjve, në shekullin e 19-të në shtetet e Ballkanit s'kishte për t'u gjetur asnjë i krishterë, asnjë kishë, e asnjë manastir, si dhe fjala e historianit "Ali bin Maksud", i cili thotë se sikur të kishin dashur osmanlinjtë t'i detyronin popujt e shteteve të Ballkanit në pranimin e gjuhës dhe fesë, sot nuk do të gjeje asnjë të krishterë, madje nuk do të kishe hasur asnjë njeri të ketë folur përveç gjuhës turke-osmane, sepse osmanlinjtë, popujt e Ballkanit i sunduan 6 shekuj, do të totë, 20 gjenerata⁴¹.

Thirrësit myslimanë ishin prezentë në Kosovë, edhe para ardhjes së osmanlinjve, punonin për përhapjen e fesë islame përmes rrugëve paqësore. Dëshmia për këtë është vendosja e një familjeje nga Halepi i Sirisë, në fshatin kosovar "Mlikë" komuna e Dragashit, para vitit 690 h - 1291 m. Kjo familje është quajtur me emrin "Aga", e cila ndërtoi xhaminë në vitin 690h - 1291m, në fshatin që u përmend më lart, ku kjo xhami konsiderohet xhamia më e vjetër në trojet e Kosovës së sotme.

³⁸ Ali M. Basha: fq.: 164.

³⁹ Po aty, fq.: 165.

⁴⁰ Dr. Bekër Ismail El Kusufi: El-lugatul arebij-jetu ..., fq: 13.

⁴¹ Muhidin Ahmeti, fq.: 121.

Khizja, me të cilën osmanlinjtë myslimanë i obliguan kosovarët jomyslimanë, për shkak të sigurisë që Shteti Islam ua ofron atyre, ka qenë një taksë e cila qëndron përballë zeqatit, që këtë të fundit myslimanët duhet paguar Shtetit Islam. Të dyja këto taksa kanë pasur në konsideratë rrethanat e të varfërve dhe të ngratëve. Andaj, një grup historianësh xhizjen e kanë konsideruar si një taksë e lartë (e shtrenjtë), që përmes saj osmanlinjtë të kenë dashur të shfrytëzojnë kosovarët dhe t'i detyrojnë ata, në pranimin e fesë islame, gjë që ai, i cili hyn në fenë islame, xhizja për të shfuqizohet⁴².

Mirëpo, dr. Hysamedin Ferraj parasheh se, ky pretendim është i kotë, për shkak të mungesës së dëshmisë, sepse xhizja nuk është konsideruar dënim, për shkak se ka qenë e mundshme pagesa e saj, e cila ka qenë obligim vetëm për meshkuj. Ai që e ka paguar atë, ka qenë i liruar nga shërbimi ushtarak, e ky lirim ka qenë shumë i rëndësishëm në atë kohë, sepse familja është mbështetur shumë në meshkuj në sigurinë e jetës, e kjo e fundit është më e rëndësishme sesa pagesa e xhizjes. Kurse shkuarja për kryerjen e shërbimit ushtarak ka qenë shumë e vështirë, sepse ai që ka shkuar ushtar, nuk e ka ditur se a do të kthehet a jo, për shkak të luftërave të shumta. Përveç kësaj, jomyslimanët kanë pasur mundësi të zgjedhin, ose shërbimin ushtarak ose pagesën e xhizjes, pra mundësia e zgjedhjes e zgjeron lirinë e nuk e ngushton atë⁴³. Po në këtë drejtim shkon edhe historiani britanik "Noel Malcolm", i cili thotë: Xhizja në shtetin osman ka qenë një përbërje e një takse vjetore dhe e veçantë vetëm për jomyslimanët, nga të krishterët dhe çifutët, e të cilën taksë e kanë paguar për shtetin osman islam. Xhizja ka qenë e mbështetur në dispozitat e Kur'anit, e paraparë si obliguese për çdo kokë të njeriut të moshës madhore. Mirëpo, për kundër kësaj myslimanët kanë qenë të obliguar që të paguajnë sadakane vjetore, e cila ka qenë e veçantë vetëm për myslimanët, e ajo është "zeqati"⁴⁴, kurse dhimiu - i krishteri dhe çifuti - nuk ka paguar as ze-

⁴² Hysamedin Ferraj, fq.: 50.

⁴³ Ibid., fq.: 53.

⁴⁴ "Zeqati" është sadaka e obliguar për çdo musliman të pasur, po qëse pasuria e tij e ka arritur nisabin e caktuar, pasi që ajo pasuri të ketë pushuar një vit.

qatë e as sadaka. Dënimet në gjykata të shtetit osman kanë qenë të dyfishuara për myslimanët, do të thotë, myslimani i ka paguar dënimet edhe njëfish sa ka paguar dhimiu. Shteti osman nuk ka hartuar konvertimin e popujve të nënshtruar, për shkaqe ekonomike e as fetare⁴⁵. Kjo politikë e osmanlinjve ka qenë për të gjithë popujt, të cilët jetonin brenda kufijve të shtetit osman, pa marrë parasysh dallimin e gjuhëve dhe zakoneve të tyre, do të thotë, absolutisht pa përjashtime.

Pra, pse xhizja ka qenë presion fetar, vetëm te shqiptarët, e jo te popujt tjerë? Dhe si arritën shqiptarët të mbijetojnë me këtë presion dhe me këtë spastrim etnik gjatë sundimit osman? Sundim i cili nuk ka qenë më pak se pesëqind vjet, si mundën shqiptarët t'i ruajnë traditat dhe zakonet e tyre? Ka njerëz të tillë që thonë se shteti osman ka qenë i prapambetur, si mund të logjikohet që shteti më i fortë në botën e atëhershme të jetë i prapambetur?⁴⁶

Këto thënie janë të kota dhe të pabaza, sepse nuk përputhen me realitetin e asaj kohe. Një burim turk thotë se sulltan Mehmet Fatihu II, menjëherë pasi e kishte çliruar Kostantinopojën, kishte nxjerrë një dekret, që në te, me zotimin e tij kishte garantuar sigurinë e lirisë fetare për të krishterët brenda rrethit të sundimit osman, me kusht që t'u përmbahen ligjeve të shtetit osman, e kjo dëshmon për tolerancën e madhe fetare në shtetin osman⁴⁷.

Përktheu dhe përshtati nga arabishtja:

Mr. Samir B. Ahmeti

Literatura e konsultuar:

1. Ismail Sulejman Ahmedi: Eth-thekafetul arabij-jetu fi Makdunija ve Kusva - min evailil karnil hamis asher ila evahiril karni th-thamin asher-, (Risaletu maxhister tem-met munakeshetuha senete 1978m bixhamiatil Kuvejti gajru matbua).
2. Dituria islame: Revistë mujore fetare kulturore shkencore, NR.100, 154, 179, 182, 185, 186-187, 189, Prishtinë.
3. Historia e popullit shqiptar: grup autorësh, akademia e shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, Tiranë, BOTIMET TOENA, 2002 .
4. Ejub Sidki Selman: El isti'rabu fi Jugosllavija, (Risaletu maxhister, kud-dimet ila mexhlisi kul-lijetil adab fi xhamiati Bagdad, ve hiej xhuzun min mutetalibati derexheti maxhister adab fil lugatil arabij-jeti, Tishrinu th-thani / 1984m - Safer / 1405h, ve hije gajru matbua).
5. Dr. Bekër Ismail El Kusufi: El alakatu bejne l-lugatil arebij-jeti ve l-lugatil albanij-jeti ve etheru dhalike fi d-dirasati l-lugavij-jeti, et-tab'atul ula, 2003, Kajro.
6. Dr. Bekër Ismail El Kusufi: El-lugatul arebij-jetu ve etheruha fi l-lugatil elbanij-jeti, et-tab'atul ula, 2003, Kajro.
7. Ali M.Basha: Njëpër gjurmët e islamit - Përmbledhje studimesh, analizash, shënimesh historiko-kritike, refleksionesh..., Tiranë, 2005.
8. Dr. Rexhep Jashar Boja: El albanuj-june (el arnaut) vel islamu, (Risaletu maxhister fi xhamiati lalemi lislami bil Medineti lMunevvereti, fi kul-lijeti d-daveti, fi kismi d-dirasatil ulja, ver-risaletu matbuatun), et-tab'atul ula, 1424h - 2004m, Daru s-selami, Kajro.
9. Ali Muhammed Muhammed Es-sal-labi: Ed-devletul uthmanij-jetu Avamilun-nuhudi ve esbabu s-sukuti, et-tab'atul ula 1420h / 1999m, Darul bejarik, Bejrut, Lubnan.
10. Noel Malcolm - Kosova një histori e shkurtër, përktheu nga anglishtja dr. Abdullah Karjagdiu, Prishtinë, KOHA, Tiranë, 2001.
11. Ali M.Basha: Njëpër gjurmët e islamit - Përmbledhje studimesh, analizash, shënimesh historiko-kritike, refleksionesh..., Tiranë, 2005.

⁴⁵ Noel Malcolm: fq.: 111.

⁴⁶ Hysamedin Feraj., fq.: 58, 59.

⁴⁷ Muhamet Tërnavi: Studime për mesjetën. Pejë, 2000, fq.: 120.

12. Thomas W. Arnold: HISTORIA E PËRHAPJES SË ISLAMIT, përktheu nga boshnjakishtja: Nexhat S. Ibrahim, Shtëpia botuese "Dituria islame" - Prishtinë, 2004.
13. Muhidin Ahmeti: Rreth përhapjes së islamit ndër shqiptarët, PENDA, Prizren.
14. Edwin Jacques: SHQIPTARËT Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, përkthyer nga anglishtja: Edi Seferi, shtypi LAJMI I MIRË, Tiranë.
15. Hysamedin Feraj: Skicë e mendimit politik shqiptar, shtëpia botuese "KOHA", botimi i parë, Tirane, 1998.
16. Muhamet Tërrnava: Studime për mesjetën. Pejë, 2000.

Mr. Samir B. Ahmeti

THE OTTOMANS AND THEIR METHODS TO DISSEMINATE ISLAM IN KOSOVA

(Summary)

One of the issues that has not been properly dealt by historians is that of the spread of Islam in Kosova (following the arrival of the Ottomans). There are many issues that need to be clarified: Which were the methods that were used by the Ottomans to disseminate Islam in the Balkans in general and in Kosova in particular? What were the living conditions in Kosova before and after the arrival of the Ottomans (dissemination of Islam)? Did the living conditions change after the spread of Islam in Kosova? In order to answer these questions I have consulted the works of Muslim and non-Muslim historians (Albanians and non-Albanians). I have done so in order to come to the truth behind this issue.

سمير أحمدى

العثمانيون و طريقة نشر الدعوة الاسلامية في كوسوفا

(خلاصة البحث)

من الصعوبات التي تقابل المؤرخين في دراسة تاريخ كوسوفا في الحدود الحالية بلا شك تعتبر قضية انتشار الدعوة الاسلامية عن طريق العثمانيين لدى قدومهم لأول مرة في كوسوفا. هناك تساؤلات كثيرة حول انتشار الاسلام في كوسوفا مثل: ما هي الاجراءات و الطرق التي تم اتباعها في دول البلقان بصورة عامة و في كوسوفا بصورة خاصة؟ كيف كانت الطرق الاجتماعية و المعيشية لسكان المنطقة في تلك الفترة؟ للإجابة على هذه الاسئلة حاولت ان اعتمد على أقوال المؤرخين من المسلمين و غير المسلمين سواء كانوا البانيين أو غير البانيين و كان بؤدى أن تظهر الحقيقة على الملأ.

KUMTESA

Nehat Krasniqi

VROJTME TË REJA MBI JETËN DHE VEPRËN LETRARE TË NEZIM FRAKULLËS¹

Interesimi kërkimor shkencor për Nezimin dhe veprën e tij letrare, nisi në gjysmën e dytë të shek. XIX. Nismëtar i këtyre interesimeve qe albanologu gjerman Han. Ai në vitin 1854 botoi tetë këngë të Nezimit, të cilat ia kishte mbledhur Kristoforidhi, nga goja e popullit të Elbasanit, dhe njëherësh shfaq vlerësimet e para për krijimtarinë e tij poetike, me ç'rast hapi diskutimin dhe vlerësimin shkencor jo vetëm për Nezimin dhe krijimtarinë e tij, por edhe për dukurinë letrare shqipe alhamiada². Kështu Nezimi dhe vepra e tij letrare u ngritën në rrafshin ndërkombëtar të interesimit shkencor, përpara se të shtroheshin për diskutim në rrafshin kombëtar.

Frugën që hapi Hani e ndoqën edhe studiues tjerë të huaj dhe shqiptarë, si Auguste Dozon³, Louis Benloew⁴, Dhimitër Kamarda⁵,

Gustav Mejer⁶, Geatano Petrotta⁷, Zef Jubani⁸, Abdullah Ferhati⁹, Shefik Osmani¹⁰, Namik Resuli¹¹, Ettore Rossi¹², Osman Myderrizi¹³, Mahir Domi¹⁴, Shaban Çollaku¹⁵, Jup Kastrati¹⁶, Muhamed Mufaku¹⁷, Mahmud Hysa¹⁸, Robert Elsie¹⁹, Abdullah Hamiti²⁰ etj. Për veprën e Nezimit shfaq interesim edhe rilindësi shqiptar i mirënjohur, Sami Frashëri. Ai më 4 qershor të vitit 1882 kishte përfunduar përzgjedhjen dhe transkriptimin e 25 poezive të Nezimit, të cilat i kishte përmbledhur në një dorëshkrim që i kishte vënë titullin “Mbledhje e këngëve shqip të vjetra e të ra”²¹. Këtë përmbledhje, Samiu sikur e kishte për-

⁶ Meyer Gustav, **Della lingua e letteratura albanese**, “Nouova Antologia”, 15 aprile 1885, f. 585-607.

⁷ Petrotta Geatano, **Popolo, lingua e letteratura albanese**, Palermo, 1931, f.246-247.

⁸ Kastrati Jup, **Zef Jubani (jeta dhe veprat)**, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, 1987, f. 118.

⁹ Ferhati Abdullah, **Pak dritë mbi jetëshkrimin e Nezimit**, “Zani i naltë”, Tiranë, maj 1938, viti XIII, nr. 5, f. 155-159.

¹⁰ SHETOS /Shefik Osmani/, **Nezim Ibrahim Frakulla nga Berati**, “Kultura islame”, Tiranë, 1942, viti III, nr. 5-6-7, f. 159-165.

¹¹ Resuli Namik, **Nezim Berati (1754)**, “Shkrimtarët shqiptarë”, Pjesa I (1462-1878), Tiranë, 1941, f. 107-108.

¹² Rossi Ettore, **Notizia su un Manoscritto del Kanzoniere di Nezim** (Secoli XVII-XVIII) in caratteri arabi e lingua Albanese, “Rivista degli studi orientali”, Roma, vol. XXI (1946), fasc. III-IV, f. 219-246.

¹³ Myderrizi Osman, **Nezim Frakulla (1690 ? – 1750)**, “Buletin i shkencave shoqërore”, Tiranë, 1954, nr.4, f. 56-75.

¹⁴ Domi Mahir, **Nezim Frakulla**, “Historia e letërsisë shqiptare”, Universiteti i Prishtinës. Prishtinë, 1971, f. 195-204.

¹⁵ Çollaku Shaban, **Nezim Frakulla** “Historia e letërsisë shqiptare”, Prishtinë: Rilindja, 1989, f. 64-68; I njejtë, **Frakulla Nezim (1685-1760)**, “Fjalori Enciklopedik Shqiptar” Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985, f. 287.

¹⁶ Kastrati Jup, **Historia e Albanologjisë (1497-1997)**, Vëllimi i parë (1497-1853), Tiranë, 2000, f. 270-276.

¹⁷ Mufaku Muhamed, el-Thekâfetu el-Albānīje fi'l-Ebḫhedijjeti el-Arabīje. Kuvajt, 1983, f.112-119.

¹⁸ Hysa Mahmud, **Vepra poetike e Nezim Frakullës**, “Alamiada shqiptare I “, Shkup: Logos-A, 2000, f. 53-90. I njejtë, **Krestomaci e letërsisë së vjetër shqiptare**, Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 1987, f. 223-234.

¹⁹ Elsie Robert, **Histori e letërsisë shqiptare**, / Përktheu nga anglishtja: Abdurrahim Myftiu, Tiranë – Pejë: Dukagjini, f. 73-75.

²⁰ Hamiti Abdullah, **Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip**, Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, 2008.

²¹ Shuteriqi Dh. S., **Shkrimet Shqipe në vitet 1332-1850**. Tiranë 1976, f.108.

¹ Punimi është lexuar si kumtesë në Seminarin XXVII Ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, mbajtur në Prishtinë në vitin 2008.

² Hahn J. G. von, **Albanesische Studien**, Vëll.II, Jena, 1854, f. 142- 146. Cituar sipas: Robert Elsie, **Histori e Letërsisë Shqiptare**, Tiranë – Pejë: Dukagjini, 1997, f 73.

³ Dozon Auguste, Manuel de la langue Skipe on Albanaise, Paris 1878, f. 7.

⁴ Banloeë Louis, **Analyse de la langue Albanaise**, Paris 1879, f. 241.

⁵ Camarda Demetrio, Appendice al Saggio do Grammatologia comparata sulla Lingua Albanese, Prato, 1866, f. XIV-XV & 46-50, 155.

gatitur për botim, por ajo pa dritën e botimit vetëm tani vonë, falë interesimit dhe angazhimit të studiueses Genciana Abazi - Egro²².

Në vitet e 30 të shek. XX interesimi i studiuesve shqiptarë për Nezimin dhe veprën e tij letrare, shënoi rezultatet e para serioze, në radhë të parë, falë interesimit dhe punës kërkimore të beratasit Abdullah Ferhati (1889-1939)²³. Ferhati gjeti një kopje jo të plotë të Divanit shqip të Nezimit, të cilën e transkriptoi dhe e botoi pjesë-pjesë në revistën “Zani i Naltë”, në vitin 1938²⁴. Kështu që tetë këngët e Nezimit që kishte botuar Hani më herët dhe kopja e Divanit që e botoi Ferhati, qenë pikëmbështetja e vetme për studimin dhe vlerësimin e veprës së tij deri tani vonë. Ndërsa, kohë më parë u botua vepra e Abdullah Hamitit, Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip, e cila paraqet versionin më të plotë të Divanit të Nezimit që u botua deri tani²⁵.

Me gjithë interesimin e hershëm dhe të një numri relativisht të gjërë hulumtuesish e studiuesish, të dhënat e deritanishme për jetën dhe veprën letrare të Nezimit, kanë ngelur mjaft të varfra dhe aty – këtu të paqëndrueshme. Prandaj, me këtë punim synojmë t’i korrigjojmë dhe t’i plotësojmë disa të dhëna për Nezimin dhe veprën e tij letrare. Vrojtimet tona lidhur me këtë subjekt, mbështeten kryesisht në dy divanët osmanisht të Nezimit, në epitafin e Fejziut kushtuar Nezimit dhe në burime tjera të botuara e të pabotuara.

Qysh në vlerësimet e para që ka shfaqur Hani për Nezimin, respektivisht për krijimtarinë poetike të tij, ka pasur edhe keqkuptime dhe lajthime. Ky albanolog i shquar në vlerësimet e tij për Nezimin, përveç tjerash kishte shkruar: “Nezim beu ka qenë më i famshmi poet modern i gegëve myslimanë të qendrës, ndër të cilët vazhdimisht për-

²² Abazi – Egro Genciana, **Sami Frashëri dhe Letërsia e Bejtexhinjve: Një sprovë e parë për botimin e Divanit të Nezim Frakullës**. Në: Studime filologjike, nr. 1-2, Tiranë 2005, f. 119-164.

²³ Durdia Qeramudin, Mahqemeja Agim, Telegrafi Bedri, **Hapësira e Kulturës Islame: Berati, Berat**: “Mendimi i Lirë”, 1999, f. 130-133.

²⁴ Ferhati Abdullah, **“Divani” i Nezimit të Beratit**, “Zani i naltë”, Tiranë, shkurt 1938, viti XIII, nr. 1-2, f. 44-52; nr. 3, f. 93-96; nr. 4, f. 113-116; nr. 5, f. 155-156; nr. 8, f. 244-246; nr. 9, f. 281-282; nr. 10-11, f. 342-344; nr. 12, f. 380-381.

²⁵ Hamiti Abdullah, **Nezim Frakulla dhe Divani i tij shqip**, Shkup, Prishtinë, Tiranë: Logos-A, 2008, 481 f.

sëriten gojarisht këngët e tij. Sikur mos të ishin shëmtuar aq shumë këto këngë me fjalët e huaja arabisht, persisht e turqisht, Nezimi mund të mbahej, në një farë mënyre, si Anakreonti i Shqipërisë”²⁶. Edhe pse këto vlerësime dhe karakterizime të Hanit i kanë bërë jehonë të mirë Nezimit dhe krijimtarisë së tij shqipe, kanë nxitur kërshtërinë e shumë studiuesve për të dhe janë cituar vazhdimisht prej tyre, në segmente të veçanta ato tani më nuk mund t’i bëjnë ballë mendimit kritik. Së pari, siç ka vënë në dukje edhe Myderrizi²⁷, Nezimi ka shkruar në dialektin toskë dhe, së dyti, “ashku”, respektivisht dashuria dhe vera në veprën poetike të Nezimit janë simbole të poezisë orientale të divanit, prandaj karakterizimi i poezive të tij si poezi anakreontike është i paqëndrueshëm. Pikërisht sepse dashuria poetike e Nezimit është dashuri hyjnore²⁸, respektivisht dashuri sufiste islame, e shprehur ndaj “xhananit” respektivisht ndaj më të dashurit – Zotit të gjithësisë, i cili është burim i mirësisë, i bukurisë dhe i dashurisë së pafundme. Është dashuri e shprehur edhe ndaj udhërrëfyesit të ashikut drejt njohjes së këtij burimi. Se kjo dashuri nuk ka të bëjë fare me dashurinë e njeriut ndaj njeriut, e thekson disa herë Nezimi në veprën e tij:

*Hallku belqim ashkun tim,
ma pandehin mexhāzī.
Veç Ti e di jā Rrahīm,
për kë bëhetë nijāzi*²⁹.

Po ashtu edhe për faktin se vera, të cilën e përmend Nezimi më se një herë në veprën e vet poetike, simbolizon filozofinë apo mësimet e sufizmit dhe fuqinë magjike të dehjes shpirtërore që ka kjo filozofi. Ndërsa “sakiu” apo shërbyesi me verë, simbolizon udhërrëfyesin shpirtëror, respektivisht mësuesin e sufizmit (burimisht: tesavvuf)³⁰.

²⁶ Kastrati Jup, **Historia e Albanologjisë (1497-1997)**, Vep. cit. f. 271.

²⁷ Myderrizi Osman, **Nezim Frakulla**, Vep. cit. f. 56.

²⁸ Uludağ Süleyman, Aşk: **Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi**, cilt 4, İstanbul, 1991, f. 11-17.

²⁹ Hamiti Abdullah, **Nezim Frakulla dhe...** Vep. e cit. f. 341. “Ashki mexhazi” quhet dashuria njërezore; jā Rrahīm = o Mëshirëplot (o Zot); nijāz = devocion, lutje, falje.

³⁰ Akün Ömer Faruk, **Divan Edebiyatı: Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi**, cilt 9, İstanbul, 1994, f. 389- 427.

Është e qartë se vlerësimet e Hanit për krijimtarinë poetike të Nezimit janë mbështetur në ato poezi të tij, të cilat populli prej kohësh i kishte përvetësuar duke i kënduar si këngë, brez pas brezi dhe duke i transformuar e ndryshuar, jo vetëm në aspektin dialektor, por edhe më thellë.

Po ashtu disa lajthitje që i ka bërë fillimisht A. Ferhati në biografinë e Nezimit, i kanë keqorientuar edhe autorët e mëvonshëm që kanë shkruar për të. Këtu kemi parasysh, në radhë të parë, tarihin (epitafin) e Fejziut kushtuar Nezimit, të cilin e ka transkriptuar, e ka përkthyer dhe e ka botuar së pari Ferhati³¹. Transkriptimin dhe përkthimin e A. Ferhatit e ka ribotuar, pa ndryshime, SHETOS /Shefik Osmani/³². Ndërsa një variant të përkthimit të këtij epitafi e ka botuar O. Myderrizi³³. Mirëpo, të dy variantet e përkthimit të këtij epitafi janë bërë me gabime. Kështu që, ky epitaf me të dhënat që ofron për Nezimin, duke qenë burimi kryesor i shfrytëzuar për ndërtimin e biografisë së tij, ka bërë që gabimet e këtyre dy përkthyesve të epitafit, të cilët janë edhe studiuesit më të rëndësishëm të Nezimit, të barten dhe të përsëriten mekanikisht në të gjitha studimet e mëvonshme që janë bërë për të, përfshirë tekstet shkollore, universitare dhe enciklopedike. Prandaj, e pamë të nevojshme që ta ripërkthejmë dhe ta komentojmë paksa këtë epitaf. Teksti i epitafit të Nezimit, i transkriptuar me alfabetin e sotëm të turqishtes dhe i përkthyer shqip është si vijon:

Târîh-i vefât-i mîr Nazîm Arnaud

An karye-i Frakula kaddesal-lahu sir-rehu:

Server-i hayl-i efâdil, kutb-i erbâb-i sukkân

Mahlas-ı pâk-i “Nazîm”, mîr Ibrahim nâm

Vâris-i meydân-i fadl-u ma’rifet, kâmil hûner

Vâkif-i esrâr-i ma’nâ, ârif-i ‘âli mekâm

Çün felek gûrbet’te mescûn etti ani bî’cünâh

Oldu mat’ûnen şehîd-ü azmi dârus-selâm
Eylesun fadl-i Hüdâ, ol fâdil’ud-dehre nasîp
Rû’yet-i dîdâr-i hûrun maksûretun fî’l-hiyâm
Ağladi “Feyzi” dedi bu mu’cemi târihini
Sicn-i dünyâdan Nazîm sâkini dâr’is-selâm
1173

Përkthimi:

“Epitafi i Nazim beut, shqiptar

nga fshati Frakulla, Zoti ia shenjtëroftë sekretin:

Kryetar i të shumëvirtutshmëve, shtyllë e dijetarëve të vendit

Pseudonimi i ndershëm i tij është Nazim, emri Ibrahim bej

Trashëgimtar i sheshit të virtutit dhe njohurisë, artist i përkryer

Dijetar i kuptimeve të fshehta, njohës i rangut të lartë

Kur fati e burgosi në vend të huaj pa faj

Vdiq dëshmor nga murtaja dhe u nis për Parajsë

Mirësia e Zotit ia mundësoftë atij dijetari të kohës

Të sheh fytyrën e Tij, dhe hyrë në seprenë e tij në çadër

Qau “Fejziu” dhe tha këtë “tarihi mu’xhem”

Nga burgu i kësaj bote Nazimi banor i Parajsës”.

1759

Gabimet më të mëdha që janë bërë në dy variantet e përkthimeve të mëparshme të këtij epitafi, kanë të bëjnë me rrethanat e vdekjes së Nezimit dhe me vitin e vdekjes së tij, të pasqyruara në gjysëmvargun e shtatë, të tetin dhe të dymbëdhjetin të këtij epitafi. Të dy përkthyesit e përmendur, nuk e kanë përkthyer drejt fjalën **“mat’ûnen”** (në gjysëmvargun e tetë) domethënia e së cilës është: **me vdekur nga murtaja**³⁴. Kjo fjalë, në asnjë mënyrë, nuk mund të përkthehet “i torturuar”, siç e ka përkthye O. Myderrizi, apo “i përbuzur”, siç e ka përkthyer A. Ferhati. Rrjedhimisht, përkthyesit e epitafit duke mos e

³¹ Ferhati Abdullah, **Pak dritë mbi jetëshkrimin e Nezimit**, në: “Zani i Naltë”, nr. 5, Tiranë, 1938, f.155- 159.

³² SHETOS /Shefik Osmani/, **Nezim Ibrahim Frakulla nga Berati**, në: “Kultura islame”, Tiranë 1942, viti III, nr. 5-6-7, f. 159-165.

³³ Myderrizi Osman, **Nezim Frakulla**, Vep. cit. f. 63.

³⁴ Çdo fjalor i osmanishtes tregon domethënien e kësaj fjale, përfshirë fjalorin e Sami Frashërit: Sh. Sami, **Kāmûsi Türkî**, Derseadet: Ikdam Matbaası, 1317h./1899, f. 1323.

kuptuar se shkaku i vdekjes së Nezimit ka qenë epidemia e murtajës dhe duke mos iu shkuar ndër mend se autori i epitafit fjalën burgosje (në gjysëmvargun e shtatë) ka mundur ta ketë përdorur si shprehje figurative, meqë edhe i godituri nga epidemia e murtajës është dashur të izolohet e të mbahet si i burgosur, pa pasur asnjë argument, kanë paragjykuar se Nezimi paskësh vdekur nga torturat në burg. A. Ferhati për këtë epitaf thotë se ishte i gdhendur në gurin e varrit të Nezimit, por nuk e thotë se ku gjendet varri i tij³⁵. Ndërsa O. Myderrizi këtë e merr si lajthim të A. Ferhatit, duke thënë: "...Nezimi – me sa kuptohet nga kronogrami - u mbyt në një burg të Stambollit si kriminel dhe natyrisht u fut më ndonjë gropë të panjohur dhe u la pa varr e pa epitaf"³⁶. Është e qartë se po të ishte mbytur në burg Nezimi, apo kushdo tjetër, do të ishte pothuaj e pamundur t'i dihej varri, por nga epitafi, apo kronogrami, siç e quan Myderrizi, nuk mund të konstatohet se Nezimi qenkësh mbytur në një burg të Stambollit si kriminel. Fakti që autori i këtij epitafi, Nezimin e quan dëshmor apo martir (burimisht: shehid), nuk na jep të drejtë të supozojmë se ai qenkësh martirizuar nga torturimi në burg. Sepse, Nezimit i është dhënë epiteti i shehidit për arsye se ai vdiq nga murtaja³⁷, dhe të vdekurit nga murtaja në traditën islame janë trajtuar si shehidë³⁸. Po ashtu, me togfjalëshin "nga burgu i kësaj bote" nuk është e thënë të kuptohet burgu në kuptimin konkret të kësaj fjale, sepse në letërsinë orientale të Divanit përgjithësisht dhe posaçërisht në letërsinë e Tesavvufit, haset shpesh krahasimi i kësaj bote si burg për besimtarin sufist. Edhe Nezimi, duke qenë poet sufist, më se një herë e ka bërë këtë krahasim. Në fl. 8 të divanit të tij të dytë osmanisht ai thotë: "*Sicn-i mu'min, değil mi bu dünyâ // Anla manasın, eyleme şekvâ*". Domethënë: Burg i besimtarit a nuk

³⁵ Ferhati Abdullah, **Pak dritë** ... Vep. cit. f.158.

³⁶ Myderrizi Osman, **Nezim Frakulla**... Vep cit., f. 57.

³⁷ Robert Elsie, është i pari nga historianët e letërsisë shqipe që ka kumtuar informacionin se Nezimi ka vdekur nga kolera, por nuk e ka dhënë burimin e këtij informacioni. (**Histori e letërsisë** ... Vep. e cit., f. 74).

³⁸ Ka një varg hadithesh të cilat e trajtojnë çështjen e të vdekurve nga murtaja

është kjo botë // Kupto domethënien mos u anko. Po ashtu në divanin shqip thotë: "*Kjo dynja m'u bë sixhin // Ai Zot më bëftë emin*"³⁹.

Gabimi i dytë që kanë bërë A. Ferhati dhe O. Myderrizi në përkthimin e këtij epitafi, ka të bëjë me vitin e vdekjes së Nezimit. Vitin e vdekjes së Nezimit e përmban distiku i fundit i këtij epitafi të ashtu-quajtur "*tarihi mu'xhem*". Kështu që, kur i llogarisim, sipas sistemit ebxhedik, vetëm shkronjat me pika të këtij distiku: $\text{ح}=3 + \text{ن}=50 + \text{ن}=50 + \text{ي}=10 + \text{ن}=50 + \text{ن}=50 + \text{ط}=900 + \text{ي}=10 + \text{ن}=50$ del viti 1173 sipas hixhrës, i cili është ekuivalent me vitin **1759** sipas kalendarit tonë⁴⁰ dhe nuk i përgjigjet vitit 1754 që e ka dhënë A. Ferhati⁴¹, e as vitit 1750 që e ka dhënë O. Myderrizi⁴². Nuk qëndron gjithashtu as viti 1760 që është dhënë nga studiues tjerë të mëvonshëm.

Përkthimi i parë jo i saktë i epitafit të Nezimit, ka shkaktuar paqartësi edhe rreth çështjes së emrit të vërtetë të Nezimit, pseudonimit poetik dhe emrit të babës së tij. Edhe pse këto ngatërtime i ka sqaruar O. Myderrizi⁴³, edhe pas këtij sqarimi ka pasur studiues që kanë vazhduar ta ngatërrojnë emrin, pseudonimin poetik dhe mbiemrin e Nezimit, duke e trajtuar madje si dy persona të ndryshëm, njëri Nezim Frakulla⁴⁴, kurse tjetri Ibrahim Nezimi⁴⁵.

Konstatimi se Nezimi vinte nga një familje e vogël feudale nga fshati Frakullë, po ashtu është i pasaktë, sepse vetë Nezimi në dy divanët e tij osmanisht, na bën me dije se vjen nga familja fisnike Vlora. Kjo familje fisnike e lartë, i ka dhënë shumë njerëz të shquar jetës politike ushtarake dhe kulturore, gjatë periudhës osmane, duke filluar nga Sinan Pashë Vlora (vd.1503)⁴⁶ e deri te Ismail Qemal Bej Vlora

³⁹ Hamiti Abdullah, **Nezim Frakulla dhe**...Vep. e cit. f. 174.

⁴⁰ Vlerën numerike sipas llogaritjes ebxhedike e gjejmë me formulën: Viti hixhri x 0.97 + 622 = viti sipas kalendarit tonë.

⁴¹ Ferhati Abdullah, **Pak dritë** ... Vep. cit. f.156.

⁴² Myderrizi Osman, **Nezim Frakulla** ...Vep. cit. f. 63.

⁴³ Po aty, f. 57.

⁴⁴ Hasani Hasan, **Leksikon i Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990**. Prishtinë: Shkëndija, 1994, f.93.

⁴⁵ Po aty, f. 219.

⁴⁶ Gjejjgu, (apo, siç mbiemërohet në burimet turke, Güveği) Sinan Pashë Vlora, ka pasur një karrierë të bujshme ushtarake administrative, sidomos pas martesës si tij me prince-

(1844-1916), kryetari i parë i Shqipërisë së Pavarur. Ç'është e vërteta këtë informacion e pati publikuar Ekrem Bej Vlora, në kujtimet e tij⁴⁷, por ai sikur hasi në vesh të shurdhër dhe nuk qe marrë seriozisht nga opinioni shkencor shqiptar për arsye jashtëshkencore.

Të dhëna me interes për paraardhësit e vet dhe për personalitete tjera të familjes fisnike Vlora, por edhe për vetveten, na jep Nezimi në dy divanët osmanisht, të cilët janë koleksionuar në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë me signaturën An IX/10 F⁴⁸. Në këtë dorëshkrim autograf të Nezimit që numëron 152 fletë (304 fq.) janë lidhur dy Divanët e tij osmanisht dhe Divani persisht. Nga fl. 1b - 34a është divani i dytë i Nezimit në osmanishte i përfunduar dhe i sistemuar në vitin 1753. Fletët 34b-36a janë të pashkruara. Nga fl. 36b - 107a është Divani i parë osmanisht i Nezimit i përfunduar dhe sistemuar në vitin 1747. Divani i parë osmanisht i Nezimit përveç që është më vëllimor se i dyti, ka edhe shumë poezi të shkruara nga autori në margjina, jashtë kornizave të Divanit. Përfundimi i radhitjes së këtij divani është shënuar në fletën 102b, por meqë poeti ynë ka vazhduar të shkruajë

shën Hatixhe, e bija e sultan Bajezidit II, më 7 maj 1481. Brënda viteve 1491-1492 ka zënë pozitën Kryeadmiral i Flotës Osmane. Dy herë ka qenë sanxhakbej i Vlorës. Herën e para gjatë viteve 1485-1487 dhe herën e dytë pas shkarkimit nga pozita e Kryeadmiralit në vitin 1492 e deri kur u vra në luftë kundër një flote të huaj në gjirin e Vlorës më 26 qershor të vitit 1503 dhe u varros në një tyrbe të posaçme në oborrin e teqes bektashiane të cilën e kishte ngritur vet në Kalanë e Kaninës. Ka lënë dy djem. I madhi Sulltan-zade Mehmet Beu, ka qenë sanxhakbej i Vlorës në vitin 1505 dhe pas vitit 1522 deri kur vdiq në vitin 1533 dhe u varros pranë të et. Djali tjetër Ali beu, sanxhakbej i Vlorës prej vitit 1517 e deri kur u vra në rrethimin e kalasë së Rodosit në vitin 1522. Djali i madh i Sulltan-zade Mehmet Beut, Kara Sinan Pasha po ashtu ka qenë sanxhakbej i Vlorës pas vdekjes së të et. Ai e ka pritur Sulltan Sylejman Kanuniun në Kalanë e Kaninës në vitin 1538. Nga kjo familje fisnike shqiptare kanë dalur personalitete të ndryshme që patën arritur pozita të larta në hierarkinë drejtuese osmane, përfshirë edhe pozitën Kryeministrit të Perandorisë Osmane të cilën e pat zënë Ferid Pashë Vlora nga viti 1903 deri në vitin 1908. (Ekrem Vlora, **Kalaja e Kaninës**, estratto dalla rivista "Shejzat", (Le pleiadi). Roma: Arti Grafiche Editoriali A. Urbinati, 1961, f. 29-33).

⁴⁷ Vlora Ekrem Bey, **Lebenserinnerungen**, München, 1968, Vëllimi I f. 219.

⁴⁸ Një fotokopje të dorëshkrimit të Nezimit që përmbledh tre divanët e tij, dy osmanisht dhe një persisht, të realizuar teknikisht keq, ma ka huazuar për përdorim kolegu Abdullah Hamiti, për çka e falënderoj. Pasi të kemi në dorë një riprodhim më të mirë të këtij dorëshkrimi, besoj se do të nxjerrim më shumë informacione për Nezimin.

poezitë e tij edhe pas përfundimit të divanit, deri në fletën 107a, edhe poezitë e bashkangjitura pas përfundimit, i konsiderojmë si pjesë të Divanit të parë të Nezimit.

Fletët 107b-117a janë lënë të pashkruara nga autori, ndërkohë që ndonjëri nga pronarët e dorëshkrimit pas vdekjes së Nezimit, ka shënuar disa gjëra të parëndësishme në gjuhën arabe, të cilat nuk kanë të bëjnë me divanin. Në fletët 117b-137b është radhitur Divani persisht i Nezimit, të cilin e ka përfunduar në vitin 1747. Që të tre Divanët kanë unvanët (faqet e titujve) të iluminuar. Këto zbukurime artistike me motive florale, nuk dihet nëse i ka bërë ndonjë artist shqiptar, apo janë bërë në Stamboll. Se dorëshkrimi është autograf, e thotë vetë autori në përfundimin e Divanit të parë. Shkrimi i përket llojit të ashtuquajtur "rik'a" dhe është mjaft i bukur.

Dy divanët osmanisht të Nezimit, përveç vlerës së tyre letrare-artistike, kanë rëndësi edhe si burime informacioni të dorës së parë, si për vetë autorin dhe familjen e fafesisin e tij, po ashtu edhe për personalitete të shquara të shtresës drejtuese të vendit, si dhe për historinë e institucioneve të ndryshme fetare, arsimore dhe publike utilitare të ndërtuara gjatë kohës kur ka vepruar autori. Studimi i tyre do të ndryshojë dhe do të plotësojë shumëçka në jetëshkrimin e Nezimit. Po ashtu do të qartësojë më shumë historinë e në veçanti historinë e kulturës në Berat dhe më gjerë nga viti 1727 deri në vitin 1753, që është një periudhë qerekshekullore shumë e rëndësishme për zhvillimet e kulturës shqiptare.

Është me interes të veçantë për jetëshkrimin e Nezimit, kasideja që ia kushton Kapllan pashë Vlorës të birrit të Jusuf begut, për të cilin poeti ynë thotë se gjenealogjia e këtij personaliteti të ndritur është vezir bir veziri, që moti, kurse për veten e tij deklaroi se është bir i kësaj gjenealogjie të tyre të ndritur. "Zât-ı pâkın öte'den pâk vezîr ibni vezîr // Ben dâhî silsile-i pâkinizin zâdesiyim"⁴⁹. Vetëm prej këtyre dy gjysmë vargjeve nuk mund të nxjerrim përfundim se cili është i ati i Nezimit, mirëpo tarihi (kronogrami) i vdekjes së Islam Begut, djalit të

⁴⁹ Biblioteka Kombëtare në Tiranë, **An IX/10 F.**, fl.15,

Murat Begut në vitin 1727⁵⁰, për të cilin Nezimi thotë se ishte djali i axhës së tij, na çon te përfundimi se Nezimi ka qenë i biri i Kapllan Mehmet pashë Vlorës. Burimet osmane për Kapllan Mehmet pashë Vlorën thonë se është vrarë në betejën e Zentës në korrik – gusht të vitit 1697, duke qenë muhafiz i Vlorës dhe mirimiran⁵¹. Në pemën gjenealogjike të familjes fisnike Vlora, që ka publikuar Ekrem Vlora, shihet se Murat beu ka qenë vëllai i Kapllan Mehmet pashë Vlorës⁵².

Në fletën 89 të Divanit të tij të parë osmanisht, Nezimi ia kushton një kronogram të ëmës, e cila kishte vdekur në vitin 1735. Në këtë kronogram Nezimi nuk e përmend emrin e së ëmës, por sipas Ekrem bej Vlorës, ajo quhej Sadije dhe ishte e bija e Mahmut pashë Begollit të Pejës⁵³.

Në divanët osmanisht të Nezimit, gjejmë të dhëna me interes edhe për arsimimin dhe edukimin e Nezimit. Aty shohim se dy nga profesorët e tij më të çmuar në medresenë e Beratit, kanë qenë Sylejman efendiu i shquar me pseudonimin e tij poetik Shehdi, dhe Ali Efendiu, të cilëve Nezimi iu ka kushtuar poezi panegjirike. Me rastin e vdekjes së profesorit të tij myftiut të Beratit, Ali efendiut në vitin 1743, Nezimi në shenjë respekti ia kushtoi një elegji, duke e cilësuar atë si njeri të shkëlqyer e të nderuar (kamil, mykerem) duke thënë “Lindi i pari zotëri, vdiq i fundit zotëri // O dert i Nezimit, profesori nga ti u largua”⁵⁴. Duhet të theksojmë këtu se biografët e Nezimit, fillimisht Abdullah Ferhati dhe shumë të tjerë pas tij, e kanë paraqitur myftiun e Beratit, Mulla Aliun si rival të Nezimit në poezi, mirëpo askush prej tyre nuk ka botuar të paktën një bejt të Mulla Aliut. Po ashtu nuk kanë dhënë as një informacion se ku e kanë parë ndonjë poezi të tij. Ç’është e vërteta Nezimi ka pasur një mosmarrëveshje me Mulla Aliun, por ajo nuk ka të bëjë me krijimtarinë letrare, por duket se ka të bëjë me

çështjen e shkarkimit të Mulla Aliut nga posti i myftiut të Beratit. Në aktin zyrtar të shkarkimit të Mulla Aliut nga posti i myftiut përveç tjerash thuhet: “Myftiu i Beratit Aliu është hequr nga shërbimi i Fetfasë për shkak se është denoncuar se ka mbajtur qëndrim të keq ndaj disa çështjeve të panevojshme dhe është përzier në disa lëvizje kryengritëse të qytetit. (15 gusht 1738)”⁵⁵. Kjo mosmarrëveshje e tyre është pasqyruar edhe në Divanin shqip të Nezimit, te vargjet:

*Ç’faj iu paq o mulla Ali
Pse iu mburra me nasihat,
A ujdís ti bëhesh asi
Shejhut që ke marrë bejat*⁵⁶.

Nga këto vargje kuptojmë se Mulla Aliu paska qenë edhe shehu i Nezimit.

Nezimi gjatë studimeve në Stamboll ka vijuar mësimet te dijetari dhe profesori i shquar turk Davud-i Karsi⁵⁷, të cilit i këndon poezi panegjirike.

Është me interes të theksojmë një të dhënë që na jep Nezimi në divanin e tij të dytë osmanisht (fl. 9) lidhur me arsyet e ikjes së tij nga Berati, në vitin 1745, ku thotë: “Vatanım şerhi Belgrad idi , amma górdüm // Derk-i esfel-i bu zaman-ı, Halik-i bî-çün etti. Ben’de Istambula geldim vatanım terk ettim”. (Atdheu im ka qenë Berati, por e pashë // Kuptim mjerimi të kësaj kohe, Krijuesi i pashoq e bëri. Dhe unë kam ardhur në Stamboll, atdheun e kam lëshuar.)

⁵⁵ Ferhati Abdullah, **Pak dritë** ... Vep cit , f. 157. Përkthimin selektiv të këtij akti, e kemi bërë në bazë të dokumentit të transkriptuar nga A. Ferhati.

⁵⁶ Hamiti Abdullah, **Nezim Frakulla dhe** ... Vep. cit. f. 385.

⁵⁷ Davud el-Karsi, ka qenë dijetar dhe myderriz i famshëm turk. Ka punuar myderriz në Stamboll, pastaj në Kajro të Egjiptit, përsëri në Stamboll, pastaj në Birgi, pak kohë në Qipro dhe 15 vitet e fundit të jetës i ka kaluar në Birgi ku edhe ka vdekur në gusht të vitit 1756. Ka qenë një dijetar që ka parapëlqyer jetën askete. Ka lënë një dyzinë veprash në fushat e ndryshme, si: Tefsiri dhe shkencat kuranore 4 vepra, Hadith 4 vepra, Apologjetikë (Kelam) 4 vepra, Logjikë 5 vepra, gjuhësi dhe letërsi arabe 6 vepra, astronomi praktike 2 vepra etj. Gati të gjitha veprat e tij janë bërë për qëllime didaktike dhe shkencore. (Cemil Akpınar, Davud-i Karsi : **Islam Ansiklopedisi**, cilt 9, Istanbul 1994, f. 29-32.)

⁵⁰ Po aty, fl. 88.

⁵¹ Süreyya Mehmet, **Sicil-li Osmanî**, 3, Istanbul, 1996, f.867.

⁵² Vlora Ekrem **Kalaja e Kaninës**, vep. cit., f. 42

⁵³ Vlora Ekrem, **Kalaja e Kaninës**, vep. cit., Po aty; I njëjti, **Kujtime**, vëll. II, vep cit., f. 321.

⁵⁴ Biblioteka Kombëtare në Tiranë, **An IX/10 F.**, fl.92.

Në divanët e tij osmanisht, Nezimi ka demonstruar mjeshtri të rralle për përpilimin tarihëve (kronogrameve) kushtuar lindjes apo vdekjes së personave të ndryshëm, si dhe kushtuar ndërtimit të objekteve të ndryshme profane dhe sakrale.

Lindjes së nipit të vet, Ahmet beut djalit të Ali pashës në vitin 1747 Nezimi ia ka kushtuar dy kronograme⁵⁸. Lindjes së kushëritit të tij Ismail Pashë Velabishtit në vitin 1727 ia ka kushtuar një kronogram⁵⁹.

Kronograme me rastin e vdekjes, Nezimi iu ka kushtuar disa personave të dalluar nga të dy gjinitë, si: Mahmut pashës, vdiq në vitin 1738⁶⁰. Mustafa pashës, vdiq në vitin 1738⁶¹. Sylejman beut, djalit të Murat beut, vdiq në vitin 1738⁶². Mulla Ibrahimit, djalit të Ymer efendi Beratit, vdiq në vitin 1744⁶³. Mulla Dervish efendiut, vdiq në vitin 1745. Këtë person Nezimi e ka çmuar shumë duke e cilësuar si “personalitet i pasqor në fushën e diturisë”⁶⁴. Halil Efendiut, vdiq në vitin 1745. Suud Efendiut, vdiq në vitin 1746⁶⁵. Zonjës Rukije (Rukije kadën), vdiq në vitin 1746. Nga kronogrami kushtuar kësaj zonje, kuptojmë se ajo paska qenë: “Âkile hem âlime, din’de kaviyye âmile // Rah-ı hak’ta bezli mal-u mülk eyledi müdam”. (E mençur dhe e ditur, në fe veprimtare e fortë // Donatore e madhe e pasurisë në rrugë të Zotit). Nezimi e vlerëson zonjën Rukie si “ajkë të tërë grarisë që fati nuk e sjellë edhe një si ajo deri në ditën e kijametit”⁶⁶. Zonjës Ajshe, vdiq në vitin 1747⁶⁷. Zonjës Hatixhe, vdiq në vitin 1735⁶⁸.

Nezimi i ka kushtuar kronograme ndërtimit të disa objekteve të rëndësishme në Berat, si: Ndërtimit të Teqesë së Halvetive me ujësje-

⁵⁸ Biblioteka Kombëtare në Tiranë, **An IX/10 F.** fl. 26.

⁵⁹ Po aty, fl. 88.

⁶⁰ Po aty, fl. 89.

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty, fl. 90.

⁶³ Po aty, fl. 92.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Po aty, fl. 93.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Po aty, fl. 90.

⁶⁸ Po aty, fl. 89.

llës, nga Ismail Pashë Velabishti në vitin 1748⁶⁹. Ndërtimit të urës nga Ismail pashë Velabishti në vitin 1751⁷⁰. Ndërtimit të Shadërvanit, nga Ismail Pasha në vitin 1752⁷¹. Ndërtimit të dy çesmeve nga Ismail pashë Velabishti në vitin 1742⁷². Ndërtimit të faltores nga Sheh Hysejn Berati në vitin 1746 dhe renovimit të Teqesë nga Shejh Hyseni po në vitin 1746⁷³. Ka përpiluar edhe shumë kronograme të tjera.

Si përfundim mund të themi se **Ibrahim “Nezim” Bej Frakulla - Berati** lindi në Frakull, ku i ati i tij kishte çifllaqet familjare, në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Rrjedh nga familja fisnike Vlora. Studimet i filloi në medresenë e Beratit, ku vijoi mësimet te myderrizët Sylejman efendiu, i shquar me pseudonimin poetik Shehdi dhe te Ali efendiu (vd. 1743) myfti i Beratit dhe sheh i Nezimit. Studimet i plotësoi në Stamboll te myderrizi dhe dijetari i famshëm turk Hoxha Davud el-Karsiu (vd. 1756), i cili ka lënë mbresat më të mëdha në profilizimin e botëkuptimeve sufiste të Nezimit.

Pas mbarimit të studimeve, Nezimi u kthye në Berat, ku gjeti një mjedis të përshtatshëm për të zhvilluar veprimtarinë e tij letrare. Berati asokohe kishte një shtresë intelektuale mjaft aktive. Rol parësor dhe të pazëvendësueshëm në zhvillimin e jetës intelektuale dhe letrare, gjithsesi ka pasur fisnikëria vendëse, e cila në Berat sikundër dhe në qendrat tjera shqiptare, ka qenë avangardë e zhvillimeve politike, ekonomike dhe kulturore. Në Berat gjatë gjysmës së parë të shek. XVIII këtë rol e ka luajtur me shumë sukses familja fisnike Vlora, pinjoll i së cilës ishte poeti ynë. Nezimi një kohë që inkuadruar në shërbimin administrativ, mbase si sekretar i Divanit (këshillit administrativ), të sanxhakbeut Ismail Pashë Velabishti (l. 1722 - vd. 1763), poet që krijonte me pseudonimin poetik “Dervish”, donator dhe vakuf-lënës i madh, mecen dhe farefis i Nezimit.

⁶⁹ Po aty, fl. 24.

⁷⁰ Po aty, fl. 30.

⁷¹ Po aty, fl. 32.

⁷² Po aty, fl. 90-91.

⁷³ Po aty, fl. 93-94

Në vitin 1745 Nezimi e lëshon Beratin dhe vendoset në Stamboll, ku edhe ka vdekur, i goditur nga epidemia e murtajës, në vitin 1759. Pas vete ai ka lënë gjashtë vepra. 1) Divani persisht, i sistemuar në vitin 1747, 2) Divani I osmanisht, i sistemuar në vitin 1747, 3) "Mynsheat", vepër nga fusha e stilistikës (insha) në prozë 4) Divani shqip, pa vit përfundimi, 5) Fjalorthi shqip-turqisht i përpiluar në vargje dhe 6) Divani II osmanisht, i sistemuar në vitin 1753.

Vepra e Nezimit ka rëndësi të veçantë për historinë e letërsisë shqipe, si dhe për historinë e letërsisë shqiptare të divanit. Nezimi po ashtu është përfaqësuesi më i rëndësishëm i estetikës shqiptare të ashtut. Ai me shije të stërholluara dhe me ndjenja sublime ka trajtuar bukurinë e shumësisë së njëshme.

Nezimi e ngiti në nivelin më të lartë letërsinë shqipe alhamiado, në krijimtarinë e së cilës, për herë të parë në letërsinë tonë, u trajtuan gjithandej temat laike dhe u krijuan vepra me vlerë të mirëfilltë artistike. Ai në letërsinë Shqipe solli gjini, lloje e forma të reja shprehjeje. - Solli divanin e parë, satirat e para dhe personifikimet e para poetike të natyrës. - Solli po ashtu poezinë e parë nostalgjike, me motive të atdhedashurisë.

Duke vlerësuar lart misionin e poetit në shoqëri, Nezimi hodhi hapin e parë drejt ngritjes së poezisë shqipe në rrafshin e ligjërimit teorik letrar.

Nezim Frakulla me dashurinë e tij të madhe e të pastër, që rrezatoi për atdheun, për gjuhën shqipe dhe sidomos për diturinë dhe emancipimin, i hapi rrugën mendimit iluminist shqiptar.

Nehat Krasniqi

NEW OBSERVATIONS ON THE LIFE AND WORK OF NEZIM FRAKULLA

(Summary)

Scientific interest in the life and literary work of Nezim Frakulla grew in the second half of the XIX-th century. The first one to deal with Frakulla's work was the German Albanologist Han. In 1854, he published 8 poems belonging to Frakulla (which had been gathered by Kostandin Kristoforidhi – from the oral tradition in the Elbasani area). Han was the first one to discuss Frakulla's poetic work as well as the alhamiado literature. Thus, Frakulla's work first became an object of discussion internationally.

نهاد كراسنيكي

اسهامات جديدة عن حياة و اعمال نظيم فراكولا

(خلاصة البحث)

لقد بدأ الاحتمام بحياة و الاعمال الادبية لنظيم فراكولا في النصف الثاني من القرن التاسع عشر. و كان الباحث الالماني "هان" هو أول من بدأ العمل عن اعماله الادبية. و قد قام بنشر ثمانية اغاني له كان الكاتب الالباني كونستاندين كريستوفوريدي قد جمعها من الشعب الالباني بمدينة البسان و في نفس الوقت هو أول من أبدى راية عن اشعاره و اعماله الادبية. و هو ابدى رايه عن الادب الحامياو ككل. و بذلك تكون هذه أول دراسة عن تنظيم فراكولا و اعماله الاربية ترتقى إلى المتسوى العلمى قبل أن تدرس على المستوى القومى.

LËVIZJET ISLAME

Mirnes Kovaç

Islami përballë Islamizmit: Vëllezërit myslimanë

LËVIZJA JONË NUK NJEH KUFIJ GJEOGRAFIKË...

“Dhe veprimtaria jonë nuk do të pushojë gjithnjë deri në ditën e gjykimit” - parullë të cilën e ka thënë Hasan El Benna, themelues i Vëllezërve myslimanë, njëra ndër lëvizjet më të rëndësishme, e cila u paraqit në shekullin 20 në botën myslimane. Më 12 shkurt u bënë plot 60 vjet, nga atentati ndaj këtij lideri të myslimanëve, dhe me këtë rast për të dhe zhvillimin e lëvizjes po shkruajmë në këtë dhe numrin vijues (të gazetës “Preporod”, plot. përk.).

Njërën ndër lëvizjet islamike me më ndikim, Shoqërinë “Vëllezërit myslimanë” (Xhemaatul-Ihvanil-muslimin)¹ e themeloi Hasan El-Benna në qytetin Egjiptian në Ismaili, zona e Kanalit të Suezit në vitin 1928.² Ai tuboi një grup të vogël punëtorësh, të cilët punonin në një kamp ushtarak britanik, kurse me betimin e tyre për besnikëri, emrin organizatës ia dha vetë Hasani: “Ne jemi vëllezër në shërbim të Isla-

mit, andaj ne jemi vëllezër myslimanë”³ Kjo ka qenë periudhë shumë e rëndë në të gjithë botën Islame. Kështu që kishin kaluar vetëm katër vjet nga suprimim i institucionit klasik të fundit Islam - hilafetit, të cilin e suspendoi Ataturku, ndërsa tërë rajoni i lindjes së afërme ishte nën një formë të administratës koloniale.⁴ Misioni fillestar i vëllezërve myslimanë ka qenë fokusimi primar në reformimin e shoqërisë përmes komunikimit dhe predikimit të drejtpërdrejtë të njerëzve në vende publike dhe në rrethe private.

Hasan El-Benna



Hasan El-Benna u lind në tetor të vitit 1906, në qytezën Mahmudie, provincë e Buhajres, rreth 150 km. në veriperëndim të Kajros. Baba i tij, shejh Ahmed Abdurrahman El-Benna Es-Saatij, ka qenë imam dhe mësues lokal, i shkolluar në El-Ez’her. Nga rinia e hershme, ai mori pjesë në shumë asociacione të cilat kishin për qëllim punën për përmirësimin moral të shoqërisë. Ai lexoi shumë për sofizmin dhe mori pjesë në hallkat e tyre të dhikrit. Interesimin për sufizëm El-Benna, e theksonte posaçërisht përmes studimit të Gazaliut dhe pikëpamjeve të tij për arsimin të theksuara në Ihja. Shkollimin e vazhdoi në shkollën fillore për trajnim të mësuesve. Në moshën 16-vjeçare, në vitin 1923, u regjistrua në Darul-ulum në Kajro, e cila ishte një lloj akademie e mësuesisë. Deri në këtë periudhë, profili i tij intelektual dhe emocional, dukshëm u rrit. Ardhja e Bennas në Kajro u përputh me periudhën e vlimeve intensive politike dhe intelektuale, të cilat ndodhnin në skenën e Egjiptit. Për këtë shkak edhe përcaktimi i El-Bennas së bashku me shokët e tij në periudhën në vijim do të jetë aktivitet i cili do t’u kthente “besimin njerëzve” për shkak se, sipas

¹ Në këtë punim për shoqërinë “Vëllezërit myslimanë” do të shërbehemi edhe me emrat e shkurtuar: vëllezërit myslimanë, vëllazëria, shoqëria ose shkurtesën arabe Ihvan.

² Wendell, 1987.

³ Mitchell, 1998, 8.

⁴ Kepel, 2004, 27.

mendimit të tij, "vetëm xhamia nuk është e mjaftueshme" El-Benna organizonte grupe studentësh të Ez'herit dhe Darul-ulumit, të cilët shërbimet e tyre të mësimit dhe predikimit krahas xhamive, ua ofronin edhe kafeneve dhe vendeve tjera të popullarizuara. Pas diplomimit të tyre, këta studentë do të shpërndahen nëpër tërë Egjiptin dhe do të marrin role dhe funksione të ndryshme, ndërsa veprimtaria e tyre misionare do të jetë amzë nga e cila do të përhapet edhe ideja e shoqërisë "Vëllezërve myslimanë", me siguri, lëvizjes më të rëndësishme islame në shekullin 20.

Struktura e anëtarëve tregon se kjo organizatë ka qenë më tepër me orientim popullor, siç e quan atë Kedourie⁵ lëvizja ka rrjedhur së fundi, ngase as nuk ka qenë pasojë e ndonjë aksioni zyrtar, patronazhi ose inspirimi, as nuk u ka pasur borxh për fillimin e vet, në çfarëdo mënyre qoftë, liderëve politikë properëndimorë të Kajros. Për prapambetjen e botës Islame si fajtorë primar janë emëruar imperializmi evropian dhe elita myslimane. Mësimet, ideologjia dhe programi i lëvizjes përmbaheshin në mesazhet (resail) të Hasan Benna⁶. Mitchell⁷ përmend rreth tridhjetë mesazhe "zyrtare", autor i të cilave ishte Bennaja, të cilat përfaqësonin rrjetin themelor të përhapjes së lëvizjes së vëllezërve myslimanë. Me rritjen e organizatës, strategjia fillestare dhe struktura do të ndryshojnë sidomos me kalimin e aktivitetit në kryeqytet, në Kajro, në vitin 1932. Ajo me zbulimin e programit politik dhe të aktivitetit në fillim të Luftës së Dytë Botërore, do t'i përfshijë njerëzit nga spektri i gjerë i shoqërisë egjiptiane.⁸ Me ardhjen përsëri në Kajro, duke qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e komunikimeve dhe të përhapjes së misionit, tani në kuadër të rrethit të gjerë të metropolit, Bennaja në janar 1933 do të fillon me botimin e revistës së parë të shoqërisë me emrin: "Mexhel-letu ihvanil-muslimin - Gazeta e vëllezërve myslimanë"⁹

⁵ Kedouriu 1992, 392, 11.

⁶ Wendel 1978, 8.

⁷ 1993, Mitchell, 188.

⁸ Wandell, 1978. 10-11; Esposito, 2002. 51.

⁹ Mitchell 1993, 185.

Në programin e hershëm politik të vëllezërve myslimanë ndihej ndikim i doktrinës pan-islamike të Xhemaludin Afganisë dhe Muhammed Abduhus, mendimtarëve racionalë nga fundi i shekullit 19 dhe fillimi i shekullit 20. Vizioni i Bennas për botën Islame ka qenë i një lloj federate të shteteve islame, e cila do të shpinte në vendosjen e një bashkësie unitare fetare-politike, ummetul-Muhammedije (Bashkësia e Muhamedit) sipas modelit të shoqërisë së hershme Islame, të cilën e themeloi Pejgamberi¹⁰.

Mesazhet e Bennas trajtonin gati të gjitha aspektet e jetës së individit dhe të shoqërisë. Struktura e këtyre mesazheve me orientim misionar pasonte vijën e rëndomtë të argumentimit. Pas identifikimit të shoqërisë, për të ofroheshin mënyrat (ose thjesht një mënyrë) të rrugëdaljes përmes zgjedhjeve Islame. Myslimanët kanë qenë të lavdishëm kur e kanë respektuar Islamin, problemet kanë filluar me lërjen e praktikës të cilën Islami e ka edukuar, zgjidhja është kthimi tek ajo.¹¹ Këto koncepte ideale, me kohë do të ndryshojnë. Hedhja fillestare e demokracisë dhe nacionalizmit, për shkak të antagonizmit ndaj modernizimit dhe vesternizimit të pandjeshëm më vonë do të shndërrohen në qëndrime pragmatike: pranim i ndeshjes politike përmes formimit të aleancës me veprimtarët politikë, dhe më në fund dhe ofrim i kandidatëve të vet.

Vëllazëria në qendër të luftës së elitës për pushtet

Për ta kuptuar kontekstin shoqëroro-politik të Egjiptit në periudhën e formimit të vëllezërve mysliman, është e obligueshme t'i kush-tohet kujdes procesit të formimit të elitës në shoqërinë e Egjiptit. Shkurtimisht do të kthehemi në periudhën para-koloniale me qëllim që të kemi fotografinë më të qartë të këtij fenomeni, i cili edhe sot është faktor i rëndësishëm në të kuptuarit e fuqisë politike në Lindjen e Afërt.

¹⁰ Wendell, 1978, 5.

¹¹ Ibid, 103-131.

Para shfaqjes së kolonializmit perëndimor, gati i tërë rajoni i Lindjes së Afërme të sotme ka qenë nën administrimin e Perandorisë Osmane. Thuhet se 400 vjet nga 1517 deri në fund të Luftës së Parë Botërore, praktikat administrative dhe institucionet e saj i dhanë formën popujve të këtij rajoni që i ka gjurmët e veta madje edhe pas rënies së perandorisë osmane, e njëra ndër karakteristikat kryesore të ekonomisë politike të Perandorisë Osmane ka qenë mosekzistimi i seperacioneve, të drejtave politike dhe ekonomike në fushat e administratës së saj, në kuptimin i cili ka qenë i njohur në Perëndim¹².

Skema organizative shoqërore, të cilën e ka lënë Perandoria Osmane, përbëhej nga 5 grupe kryesore:

Guvernatorët ose organizatorët, pjesëtarët e armatës, nëpunësit fetarë, tregtarët dhe bujqit. Administratorët dhe ushtria i takonin klasës sunduese, kurse tregtarët u bashkuan në klasën e punëtorëve ruralë dhe urban (zejtarët dhe punëtorët në ekonomi) dhe me prodhuesit bujqësorë¹³. Njerëzit e fesë dhe (Ylemat) në këtë strukturë klasore merrnin pozicionin mesatar¹⁴. Edhe pse ka pasur raste kur klasa sunduese e ka shfrytëzuar këtë klasë, ajo ka mbajtur nivel shumë të lartë të pavarësisë dhe dinjitetit¹⁵. Para së gjithash, për shkak të autonomisë ekonomike, e cila ka qenë e siguar me legatat fetare (vakfët). Me modernizimin, i cili ka qenë në zhvillim e sipër në shekullin 19-20, posaçërisht pas shfaqjes së forcave nacionaliste dhe me nacionalizimin e këtyre pronave të mëdha, me statusin e pakënaqur të klasës së Ylemave u ndryshuan planet e elitës shoqërore, e që është pritur se ata do të jenë nën kontrollin më të madh, siç ishte në shumicën e vendeve në Lindjen e Afërt, ndërsa në sy të Islamistëve ata shikoheshin të nënshtruar plotësisht shtetit.¹⁶

Në kontekstin e njëjtë para-kolonial vërehet evitimi i pronarëve të tokave sipas modelit perëndimor. Ata me këtë rast kanë qenë pjesëtarë

të dy klasave të larta, kurse shteti ka pasur pronësi ekskluzive mbi të gjitha sipërfaqet bujqësore dhe ua jepte ato nëpunësve të vet dhe pjesëtarëve të armatës në mënyrë shumë të ngjashme, por jo identike të asaj në periudhën e feudalizmit perëndimor¹⁷. Toka ndahej në pronë me afate të përkohshme dhe në bazë të meritave.

Kjo gjendje filloi të ndryshojë në fund të shekullit 19 me të ashtuquajturën “Programet e reformës”(tanzimat) me ç’rast guvernatorët i ndanin tokën secilit që paguan taksën bujqësore paraprakisht për pesë vjet.¹⁸ Procesi nuk kishte përfunduar kur arritën fuqitë koloniale perëndimore por vetëm është përqësuar në kuptimin e ndarjes së pabarabartë dhe oportuniste, të cilat ishin intensifikuar. Për shkak të administratave të sapoformuara këto grupe të elitës kanë qenë të konsoliduar në forma klasore të mesjetës: Njerëzit e arsimuar në shkollat moderne, të cilat i themeloi administrata koloniale statusi i tyre nuk varej nga manipulimi me pronën private, por është bazuar në themelet e të arriturave private¹⁹. Gjatë kësaj periudhe shumica e bujqve e vazhduan ngritjen e tyre që ishte zhvilluar gjatë periudhës së fundit të Perandorisë Osmane.²⁰ Në rastin e Egjiptit ata kanë përfaqësuar bazën politike dhe ekonomike të monarkisë.

Kjo strukturë klasore do të ndryshonte pasi që Britania së pari i dha pavarësi të kufizuar Egjiptit në vitin 1922, e më vonë e pranoi me marrëveshjen e vitit 1936. Klasa e vjetër e pronarëve të tokave ishte ende në vend, ndërsa klasa e dytë kishte dalë papritur në skenë. Ajo u ngrit në lëvizje gjithnjë më militante të punëtorëve të cilën gjerësisht e përkrahte populli i Egjiptit, sidomos pas kryengritjeve në tërë vendin, të cilat kaluan me revolucionin e padhunshëm në vitin 1919. Këto forca i udhëhoqi partia Wefa, e cila synonte pavarësinë, e këto grupe siç konsideroi Bein²¹ përbënin komponentët e tërë lëvizjes nacionaliste. Përmendem lëvizjet në shoqërinë Egjiptiane për të skicuar dhe pozici-

¹² Wood 1995, 34, 37; Richards and Waterbury 1998, 37-40, Ayubi 1991, 28-2.

¹³ Gibb 1970, 221.

¹⁴ Ayubi in Potter et al 2000, 349.

¹⁵ Esposito and Woll, 2001, 2-10.

¹⁶ Zeghal, 1999, 371.

¹⁷ Gibb 1970, 222, Lewis, 2000, 105-106.

¹⁸ Richards and Waterbury, 1998, 40.

¹⁹ Ibid 42.

²⁰ Deegan, 1993, 121.

²¹ Bein 1989, 71.

onuar vendin e organizatës së vëllezërve myslimanë, në këtë kohë tepër të rëndësishme për vendin, i cili në kuptimin intelektual, politik dhe kulturor udhëhoqi botën myslimane posaçërisht Lindjen e Afërt.

Pjesëmarrja politike

Në periudhën nismëtare, vëllezërit myslimanë u dukën si platformë përfaqësuese kryesisht e klasës së ulët të mesme të marginalizuar politikisht dhe pasi që ishin më tepër të fokusuar në çështjet etike ringjalljen e ndjenjave fetare, ishin në marrëdhënie të mira me oborrin e mbretit Faruk, i cili në vëllezërit myslimanë shihte balancë të dobishëm të nacionalistëve shekullarë²².

Në këtë trekëndësh vëllazëria mund të konsiderohej si një lloj faktori balancues të klasës pro-britanike të mbretërisë dhe rretheve nacionaliste. Faktori vendimtar në koalicionin politik të vëllazërisë do të jetë ajo anë e cila ofron kushte më të mira për agjendën politike të islamit.

Ndërrimet kyçe në aktivitetin e vëllazërisë, do të pasojnë me fillimin e Luftës së Dytë Botërore, kur ajo megjithëse jo plotësisht haptazi hyri në skenën politike të Egjiptit.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore përkrahja e vëllazërisë e cila deri në fund të vitit 1940 tashmë kishte rreth gjysmë milioni anëtarë dhe një numër përafërsisht aq të simpatizuesve, kyçja e cilitdo fraksion politik ka qenë e rëndësishme²³. Vitet e luftës kanë qenë formale në kuptimin e pozicionit politik të shoqërisë e cila u adaptohej rrethanave kërkuese të periudhës së ndërtimit të kombit. Pragmatizmi fillestar i vëllezërve myslimanë, më së miri ka mundur të shihet në përshtatshmërinë e tyre, do të thotë mbajtjes së marrëdhënieve të mira me oborrin mbretëror të Farukut dhe njëkohësisht duke agjituar kundër pranisë koloniale britanike²⁴. Natyrisht në këtë periudhë vëllazëria do t'i provojë situatat e para konfliktuale. Në njërin nga mesazhet e Hasan Bennasë me të

cilën i paralajmëron vëllezërit për provokimet të cilat do të pasojnë, mund të fitohet edhe shikimi në natyrën e lëvizjes, ashtu siç e ka definuar themeluesi i saj:

“Ne nuk jemi parti politike, edhe pse politika e themeluar në rregullat e Islamit është e idesë sonë. Ne nuk jemi shoqatë bamirëse edhe pse ne punojmë në projekte bamirëse. Ne nuk jemi shoqatë sportive, edhe pse treningu i shpirtit dhe trupit është metodë e veçantë e jona esenciale. Ne nuk jemi as njëra nga këto formacione, sepse ato janë prodhim i qëllimeve të kufizuara dhe të përkohshme dhe themelimin e tyre e formon dëshira e thjeshtë për përfitimin e këtyre pozitave. Ne jemi mendim dhe bindje, sistem dhe rrugë të cilat nuk i kufizon as territori as raca. Lëvizja jonë nuk njihet kufij gjeografikë as veprimi jonë nuk do të pushojë deri në ditën e gjykimit.”²⁵

Me fillimin e luftës mund të hasim kontaktin e parë të vëllezërve myslimanë me grupin politik që kishte planifikuar revolucionin, i cili më vonë do të bëhet i njohur me emrin ‘Oficerët e lirë’. Ky bashkëpunim do të përforcohet kur ideja e revolucionit u bë më aktuale, përkatësisht arriti momentin e saj. Për analizën tonë është me rëndësi konferenca e gjashtë e vëllezërve myslimanë, e mbajtur në janar të vitit 1941, në të cilën u mor vendimi për zgjedhjen e kandidatëve për zgjedhjet kombëtare, me ç’rast Hasan El-Benna u zgjodh delegat për zonën zgjedhore të Ismailisë²⁶.

Ndonëse, pas intervenimit të qeverisë, El-Benna u tërhoq dhe vëllazëria fitoi disa lëshime, vërehej gatishmëria për përshtatje dhe kompromise, të cilat do ta karakterizojnë rrugën e zhvillimit të lëvizjes, posaçërisht në periudhën pas atentatit dhe vdekjes së themeluesit të saj, Hasan El-Bennas.

Nga fundi i vitit 1945 e deri më 1949, mosmarrëveshjet e brendshme kanë vazhduar në shoqërinë egjiptiane. Këto vite janë shënuar me demonstrata të vazhdueshme, me përleshje dhe atentate në personalitetet e larta shtetërore, me arrestime të cilat ishin drejtuar në pengimin

²² Kepel, 2004, 28.

²³ Mitchell, 1993, 328.

²⁴ Kepel 2004, 31.

²⁵ Mitchell, 1993, 30.

²⁶ Mitchell, 1993, 24-27.

e dërgimit të vullnetarëve në Palestinë dhe burgosjen e simpatizuesve të partive opozitare e gjithësesi edhe të ithtarëve të vëllezërve myslimanë. Situata e tillë e masave dhe hakmarrjes, do të krijojë klimë të përshtatshme për manipulim, kurse pushteti mbledhte fakte për hapjen e rastit kundër vëllazërisë dhe shpërndarjen e saj (vrasja e gjykatësit Hazindarit dhe konfiskimi i armëve në Ismaili etj). Vëllezërit myslimanë, rregullisht akuzoheshin për demonstrata dhe trazira, të cilat shpërthyen në fund të vitit 1948, në tërë Egjiptin kundër armëpushimit në Palestinë. Në dhjetor qeveria nxori dekretin për shpërndarjen e organizatës në të cilën në 13 pika sjell tekstin e akuzës kundër vëllazërisë, ndër të cilat më e rënda ka qenë tentimi për përmbysjen e rendit dhe terrorizëm. Vendorsmëria me të cilën kryeministri Nakrashi pasha filloi të udhëheqë politikën pas Dekretit ka mundur të barazohet vetëm me gjendjen e nderë e cila mbretëronte në Egjipt. Të gjitha burimet flasin për tentimet e Bennas për të shpëtuar situatën fillimisht përmes bisedimeve të drejtpërdrejta me kryeministrin, i cili refuzoi pranimin e tij. Nga ana tjetër, ndjekja e organizatës, burgosjet dhe izolimi i El-Bennas në tërësi, e shkatërroi sistemin e komunikimit dhe kontrollit brenda Vëllazërisë. Në hyrje të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Nukrashin, më 28 dhjetor 1948, e priti një djalosh i veshur në uniformë të oficerëve. Pasi e përshëndeti ia zbrazi një plumb në shpinë e pasi që ai u kthye për ta parë sulmuesin dhe një në gjoks. Nukrashiu vdiq pas disa minutave, kurse atentatori ishte Abdul Mexhid Ahmet Hasani, njëzetvjeçar, student i veterinarisë, anëtar i Vëllazërisë nga viti 1944.

Në varrimin e Nukrashit, madje u dëgjuan brohoritje “Vdekje Hasan el-Benas”²⁷. El-Benna edhe njëherë u përpoq që të bëjë marrëveshje me qeverinë, tani me pasardhësin e Nukrashit Ibrahim Abdul Hadiun. Për këtë qëllim u formua edhe komiteti special, kurse el-Benna botoi pamfletin me titull: Bejan lin-nas (Shpallje për opinion), në të cilin mohonte lidhjen me vrasjen e Nurkashit. Në kuadër të bisedimeve ka qenë edhe kërkesa e pushtetit që të lëshohen në liri anëtarët e

shquar të burgosur të organizatës, por pa sukses, kështu që situatën e solli deri te çrregullimet e skajshme dhe pasiguria.

Si u vra Hasan El-Benna?

Hasan el-Bena është vrarë në Kajro, më 12 shkurt 1949, para selisë së organizatës Shebbanul-muslimin (Myslimanët e rinj). Sipas dëshmisë së një pjesëmarrësi të ngjarjeve të atëhershme, bashkëpunëtorit të afërt të Hasanit, Sallah Shadiut, taktika e pushtetit ka qenë që el-Benna të lihet në liri, kurse të burgosen të gjithë njerëzit përreth tij. U burgosën të gjithë bashkëpunëtorët e afërt të el-Bennas madje edhe vëllai i tij, i cili iu kishte ofruar si mbrojtje. Të shumtë ishin ata që e këshilluan el-Bennan të shkojë në ilegalitet duke qenë se tradhtia e qeverisë kundër tij ishte tërësisht e qartë. Përgjigjja e tij ishte: “Nga cila vdekje të iki, nga ajo që nuk më është shkruar apo nga ajo që më është shkruar?” Më dymbëdhjetë shkurt 1949, kryetari i seksionit për rini pranë shoqatës Shebbanul-muslimin, Muhamed Jusuf Lejthij, shkoi në shtëpi të profesorit Hasan el-Benna me detyrë të prof. Nagiut, farefis i kryeministrit Abdulhadij, i cili besonte se prof. el-Benna do t’i propozonte kryeministrit diç që edhe atij do t’i ndihmonte në sigurimin e atmosferës pozitive për zgjidhjen e situatës kritike, e cila ishte paraqitur mes tij dhe qeverisë siç besonte dhe se në të njëjtën ditë e organizoi takimin në mes el-Bennas dhe ministrit shtetëror Zekkij Aliut, në selinë e “Shebbanul-musliminë”.

Profesori el-Benna shkoi në vendin për të cilin ishin marrë vesh, ku e priti ministrin deri në orën tetë në mbrëmje. Ministri nuk u paraqit... Pikërisht në atë kohë ishte paraparë kryerja e vrasjes, ngase rrethanat ishin të përshtatshme për të. Kur el-Benna e humbi shpresën se ministri do të vijë, bashkë me baballëkun e vet, AbdulKerim Mensuriun, doli në shkallë të shoqërisë Shubbanul-musliminë, me qëllim të hipjes në taksi të cilin e kishin thirrur më parë. Mirëpo, në atë moment u ndalën dritat në rrugën e Ramzesit, në të cilën gjendej selia e Organizatës “Shubbanul musliminë”. El-Benna me baballëkun e vet nisët në drejtim të taksisë, që qëndronte në afërsi të drejtpërdrejtë dhe

²⁷ Mitchell, 1933, 58-66.

posa hynë në taksi ishte mbuluar me plumba të cilët kriminelët i zbrazën në mënyrë të tërbuar dhe kuturu, e pastaj me një automobil të zi me nr. 9979, u arratisën. El-Benna duke qenë i plagosur, arriti të regjistrojë numrin e automobilit, e pastaj u kthye në selinë e organizatës për ta thirrur veturën e ndihmës së shpejtë, dhe me atë veturë është bartur në spitalin e syve “Pallat”. Njëri prej mjekëve nga radhët e vëllezërve myslimanë menjëherë u nis për atje për t’u kujdesur për të. Mirëpo, i ishte ndaluar hyrja... Shumë shpesh oborri mbretëror me telefon kontaktonte spitalin për të marrë lajmin për vdekjen e Hasan el-Bennas. Plagët e tij vazhdimisht kullonin gjak, kurse asnjë mjek nuk pati guximin t’i afrohet dhe t’i ofronte ndihmën e parë...”²⁸

Situatë e ngjashme, dhe tërësisht e papërshtatshme ndodhi kur Naseri e mori pushtetin me puçin ushtarak në korrik të vitit 1952. Në fillim vëllazëria e përshëndeti grushtshtetin e bërë nën udhëheqjen e oficerëve të lirë, madje e përkrahu edhe vendimin e këtij grupi për suspendimin e partive politike në vend. Kjo jo vetëm se do të shkatërronte pluralizmin politik në Egjipt; por shoqërinë e vëllezërve myslimanë, pas konfrontimit të nacionalizmit naserian me ideologjinë e Ihvanit do ta çonte deri në prag të shfarosjes.²⁹

Vetë kjo periudhë ka qenë e rëndësishme për disa shkaqe: Në një anë, kjo ishte koha kur vëllazëria kishte filluar për t’u zgjeruar, me anë të emigrantëve polikë, në vendet fqinje, të cilët i dëboi Naseri, kurse në anën tjetër ky dëbim do të shkaktojë, krahas internacionalizimit të vetë vëllazërisë, edhe ngushtimin politik të ideologjisë së saj, e cila do të shndërrohet në ideologji të shtypjës dhe të nëntokës së opozitës së ndaluar. Gjithashtu edhe rrethanat ekonomike ndryshuan, pasi që regjimi e miratoi reformën agrare në shtator të vitit 1952, e cila i shkatërroi pronarët e mëdhenj të tokave. Për vëllezërit myslimanë, vitet e sundimit të Naserit, në disa segmente kanë qenë katastrofike: problemet e brendshme organizative, ndarja e krahëve ekstremë, të cilët propozonin rezistencë të drejtpërdrejtë fizike kundër regjimit dhe

faktikisht pas rënies së pronarëve të tokave, vëllezërit myslimanë mbetën i vetmi rival i regjimit. Kulmi i ndërlikimi të këtyre marrëdhënieve ndodhi në tetor të vitit 1954, me përpjekjen e një atentati ndaj Naserit nga ana e një pjesëtari të shoqërisë.³⁰ Pasi një qerim hesapësh me shoqërinë myslimane, që përfshiu varjet dhe burgosjet e anëtarëve kryesorë në dhjetor, ndërsa në shkurt të vitit 1955, u mbajtën më tepër se një mijë gjykime. Michell, njëri ndër autorët më të cituar në Perëndim, në studimet për vëllezërit myslimanë, konstaton se organizata me këtë qerim hesapësh u soll deri te shkatërrimi i plotë.³¹

Radikalizimi

Vitet nën sundimin e Naserit do të shënojnë një kthesë të ashpër në ideologjinë dhe veprimtarinë e Ihvanit. Ndër vëllezërit e burgosur në qerimin e hesapeve në vitin 1954, ka qenë edhe Sejjid Kutbi, i cili u dënua me 15 vjet burg. Pas kthimit të tij nga SHBA-të në fund të vitit 1940, ky njeri i cili më parë kishte qenë simpatizues i kulturës perëndimore, iu bashkua shoqërisë dhe u bë njëri ndër ideologët udhëheqës të lëvizjes.³² Pas një përvoje shokuese me mënyrën liberale të jetës, ai hoqi dorë nga të gjitha shkrimet e tij të para vitit 1948, duke mos gjetur asgjë të vlefshme në kulturën perëndimore, përveç shkencës dhe teknologjisë.³³ Tregim i Kutbit, në realitet është një histori e pikëlluar në kuptimin e fatit të tij personal, për shkak se shumicën e jetës se tij produktive e ka kaluar në burg, nën tortura të rënda. Megjithatë, shumë më i rëndësishëm është roli i tij në zhvillimin e ideologjisë jo vetëm të vëllezërve myslimanë. Sot, në radhë të parë nga disa autorë perëndimorë, mësimet e Kutbit janë duke u lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me organizatat më ekstreme, të cilat sipas mendimeve të tyre, inspirimin e vet e kanë gjetur në përshkrimin e tij

³⁰ Michell, 1993, 154.

³¹ Ibid, 105-162.

³² Eksposito, 1998, 140.

³³ Akhavi, 1997, 378.

²⁸ Prljača, 2006, 18-20.

²⁹ Kepel, 2004, 29-30.

“bardh e zi” të botës; kurse Kutbin e quajnë ‘kumar dhe martir të radikalizmit Islam’.³⁴

Për këtë arsye është e nevojshme t’u bëjmë një vështrim të shkurtër pikave kyçe të ideologjisë së tij duke sinjalizuar në burimet të cilat ai i ka shfrytëzuar. Shembull krahasimi do të jetë çështja e “Sovranitetit të Zotit” për të cilën me shkas është diskutuar shumë në kampin kulturalistik siç do të shohim. Kutbi këtë ide e ka marrë nga Mevdudiu³⁵. Është interesant se koncepti i Mevdudiut nuk është ashtu i konceptuar jo-sofistik, siç duket ai në modifikimin e Kutbit. Mevdudiu nuk e shfrytëzon idenë e hilafetit në kuptimin klasik, si formë të sundimit që ka zëvendësuar rolin politik të Pejgamberit dhe më vonë u shndërrua në formën e teokracisë klasike. Në vend të kësaj ai mbron mendimin se hilafeti është ‘përfaqësim’, i cili është dhënë nga Zoti bashkësisë së përgjithshme të besimtarëve.

Sipas Islamit, sovraniteti i takon vetëm Zotit. Secili që mban pushtet dhe sundon në përputhje me ligjet e Zotit, padyshim ai arrin statusin e “përfaqësuesit” të Sundimtarit Suprem dhe nuk është i autorizuar të zbatojë as një formë tjetër të qeverisjes përveç atyre që i janë deleguar.³⁶ Në vend të sovranitetit të popullit (si parakusht për demokraci) ai zhvillon konceptin e përfaqësimit të popullit. Në këtë pikëpamje në raport me shoqërinë secili është një lloj halifi (përfaqësuesi) dhe sipas tij në një rregullim të tillë (qeverisës) nuk ka vend për diktaturë të cilitdo person mbi personin tjetër ose grup të njerëzve. Të gjithë myslimanët dërgojnë hilafetin e tyre (të drejtën në përfaqësim) të një njeriu i cili zgjidhet për t’i kryer punët e shtetit dhe është përgjegjës para Zotit dhe bashkëqytetarëve të cilët pushtetin (përfaqësimin) e tyre ia kanë deleguar atij.³⁷ Mevdudiu këtë e konsideron “demokraci superlative” dhe përmes këtij koncepti, Islami i ka vënë pikën individualizmit që kufizon organin politik dhe i ka siguruar ekuilibrin mes

³⁴ Ekspozito, 2002, 45.

³⁵ Akhavi, 1997, 386.

³⁶ Mevdudi, 1986, 149.

³⁷ Ibid, 150-151.

individualizmit dhe kolektivizmit.³⁸ Ky lloj i rregullimit shtetëror është një bazë për vendosjen e rendit politik të cilin Mevdudiu e emërtonte me termin “Hukumat-i-Ilahijje” (pushtet i besuar nga Zoti) në kuptimin se sovraniteti i takon Zotit (duke pranuar atë në kuptimin dogmatik) por në praktikë ai u është dhënë qenieve njerëzore me anë të institucionit të përfaqësimit.

Sfidat e veprimeve në sistemet autokratike dhe demokratizimi i Lindjes së Afërt

Problemi te versioni i Kutbit e ka fillin kur konceptin e Mevdudiut ai e konverton dhe emëron me termin hakimijjat-Allah (tek. Sovraniteti hyjnor) dhe nga kjo zhvillohet një sistem tepër rigoroz i mendimit³⁹. Pushteti i besuar nga Zoti është shumë më tepër hyjnor në kuptimin e pranimi doktrinar të besimit islam. Shkaku që ky koncept të komentohet në këtë mënyrë është fakti se Mevdudiu e rezervon përfaqësimin e popullit, i cili u takon të gjithëve, ai nuk është privilegj ekskluziv i çfarëdo individi, familje, fisi, klase, sektit, por i të gjithë atyre që e pranojnë Zotin si Sovran⁴⁰. Mirëpo, ky koncept i përjashton jomyslimanët dhe më në fund bie në kontradiktë me vetveten përmes dy aspekteve: Të drejtat e pakicave dhe statusi i grave (ngase edhe këto, gjithashtu, përfshihen në kuptimin ‘të gjithë’.⁴¹

Ideologjia e Kutbit

Kutbi e zgjeron konceptin e hakimijat-Allah, dhe në të e themelon sistemin e tij rigoroz duke e ndarë botën në dy kampe: njëri në të cilin është vendosur Sovraniteti Hyjnor, dhe në tjetrin të cilin e quan xhahilijet (gjendje, trevë e injorancës). Aq më tepër modeli i tij i shoqërisë ideale përfshin vetëm periudhën e shkurtër të Bashkësisë Islame në Medinë, të cilën Kutbi e quan ‘gjenerata e vetme kuranore’. Ndërkaq,

³⁸ Ibid, 152.

³⁹ Aklam 1997, 396.

⁴⁰ Mevdudi 1986, 173.

⁴¹ Shif Ibid, 274-299, 242-245.

të gjitha manifestimet historike të rregullimit shoqëror brenda Islamit, te Kutbi i përkasin kategorisë së xhahilijetit⁴².

Duke i emëruar të gjitha format e rregullimit të mëparshëm politik, të cilat kanë qenë në skenë, si xhahilijj, Kutbi njësoj i emëron të gjitha shoqëritë e kohës së tij, me të njëjtën gjendje, madje edhe ato që veten e quajnë islame ose myslimane: ‘...të gjitha shoqëritë të ashtuquajtura ‘myslimane’, gjithashtu, janë shoqëri xhahile... Islami nuk shikon në shenjat apo titujt të cilët i kanë marrë shoqëritë e tilla, të gjitha ato kanë një gjë të përbashkët, e ajo është se mënyra e tyre e jetesës nuk është e themeluar në përkushtim të plotë të Zotit. Në këtë kuptim ato ndajnë veti të njëjta me disa shoqëri politike me karakter të xhahilijetit⁴³.

Kjo shpie mendimin e Kutbit në kontradiktë. Në disa vende, ai e përshkruan Islamin si lëvizje, vitalitet, evolucion, zhvillim, aktualitet etj., ndërsa, në të njëjtën kohë e kufizon atë në periudhë tepër të shkurtër kohore të bashkësisë së hershme islame, do të thotë, në mënyrë që ‘porosinë e përhershme dhe universale të Islamit’ shpeshherë të theksuar në mendimin e tij e shpie në kontradiktë duke reduktuar të njëjtën porosi në kohë dhe vend specifik⁴⁴.

Në rastin e konceptit të Kutbit hakimijjat-Allah, Hasan Hudejbiu, udhëheqës suprem i vëllezërve myslimanë ndërmjet viteve 1951-1973, e ka numëruar si risi heretike (bid’at) duke u përcaktuar për mendime më tradicionale.⁴⁵ Hedhja e mendimit të Kutbit në diskursin e veprimit të vëllezërve myslimanë tregon për shenjat e periudhës së rëndë në të cilën ka vepruar lëvizja sikur që edhe e jep fotografinë e qartë të situatës së dëshpëruar personale të vetë Kutbit. Mendimi i Kutbit do të arrijë rëndësi më të madhe pas likuidimit të tij në vitin 1966⁴⁶. Radikalizmi i lëvizjes mund të shikohet si kundërefekt të shtypjes së pamëshirshme, të cilin e ka përjetuar lëvizja nën sundimin e

regjimit Naserian, e që ka arritur kulmin mes viteve 1965-1966, dhe që shumëkënd e ka shtyrë të besojë se lëvizja në mënyrë efikase është shuar⁴⁷.

Rehabilitimi

Ideologjia e Kutbit do të përhapet intensivisht sidomos pas luftës gjashtëditëshe në qershor të vitit 1967, si një lloj i shpjegimit alternativ të disfatës arabe, por edhe të pasuesve të projekteve nacionaliste dhe socialiste⁴⁸. Lëkundje do të ndodhin gjithashtu edhe në skenën politike të Egjiptit dhe se ato do të lehtësojnë rrethanat për rehabilitimin gradual të lëvizjes së vëllezërve myslimanë, pasi që pasardhësi i Naserit, Enver Sadati, filloi t’i lirojë nga burgu anëtarët e organizatës. Gjatë këtyre viteve shoqëria (myslimane) aktivitetin e tyre do ta orientojë në arritjen e mbështetjes më të madhe në mesin e studentëve në universitete dhe në mesin e qarqeve intelektuale⁴⁹. Politika e Sadatit ndryshonte nga politika e paraardhësit të tij në disa aspekte: ai u dha liri më të madhe islamistëve, filloi të shfrytëzojë më tepër religjionin për të arsyetuar politikën e vet, dhe se politikisht e braktisi versionin socialist të Naserit⁵⁰. Ndërsa, politika e tij ekonomike, sidomos politika e hapjes-liberalizimit (infitah) ka ndihmuar që të rritet frustrimi dhe zemërimi ndërmjet rinisë që anonte kah feja⁵¹. Gjatë kësaj periudhe janë formuar shumë organizata radikale e militante, nga të cilat shumë janë themeluar duke u ndarë nga ideologjia amë e vëllazërisë, e cila rekomandonte veprimtarinë paqësore brenda sistemit. Organizatat më të rëndësishme kanë qenë: Tekfir vel-hixhreh (Eskumunikimi dhe shpërngulja) dhe xhema’tul-xhihad (bashkësia e luftës), të cilat do të profilohen në forca kryesore të cilat qëndruan pas dhunës vendore kundër të krishterëve koptë në vitin 1980-1981 në Egjiptin e Epërm⁵².

⁴⁷ Ekspozita, 1998, 148.

⁴⁸ Kepel, 2004, 63.

⁴⁹ Ibid, 64-65.

⁵⁰ Ekspozita, 1998, 235-237.

⁵¹ Ajubi, 1994, 75.

⁵² Zubaida, 1992, 10.

⁴² Kutb 1988, 21.

⁴³ Ibid 152-155.

⁴⁴ Ibid. 86. Akhavi, 1997, 380.

⁴⁵ Ahkavi, 1977, 386.

⁴⁶ Tamimi, 2001, 185.

Përgjigja e Sadatit ka qenë aplikimi i masave represive në shtator të vitit 1981, kur më tepër se 1500 personalitete egjiptiane të të gjitha orientimeve politike bashkë me ekstremistët, u burgosen⁵³. Kjo krizë kulmin e saj do ta arrijë në atentatin dhe vrasjen e Sadatit. Sipas ‘Aju-bisë’, Sadati në një masë të madhe i ka kontribuar krijimit të këtij problemi, në përpjekjet e tij për ta shfrytëzuar ‘armën e religjionit’ për qëllime të veta personale, ka shkuar tepër larg, duke mos arritur për ta kuptuar derisa është bërë tepër vonë, se lëvizja islame ka arritur një jetë të saj të pavarur dhe logjiken e saj të pavarur.”⁵⁴

Ndërmjet hapjes dhe bllokadës

Lëvizja e vëllezërve myslimanë që nga formimi i saj është përpjekur të arrijë legalitet formal dhe të përgjigjet në natyrën hegjemoniste të regjimit Egjiptas, i cili deri në kohën e vdekjes së Sadatit, i largoi të gjitha forcat e rëndësishme të cilat e kërcënonin pushtetin e tij. Me qëllim të zvogëlimit të tensioneve, të cilat u krijuan me politikën e Sadatit në vitin 1981, kryetari i ri, Husni Mubarek, filloi me një politikë të re të krijimit të frontit kundër kërcënimit, të cilin e imponuan ekstremistët, dhe se përsëri e vendosi legalitetin e fundosur të regjimit. Kjo ka përfshirë shkallë të caktuar të autonomisë së organizatave kryesore siç ishte *vëllazëria myslimane*, por qeveria edhe më tej iu përmbajt principit të saj me të cilin ua pamundësonte pranimin zyrtar. Në krahasim me të gjitha periudhat tjera, sundimi i Mubarekut ishte më i rëndësishmi për *vëllazërinë* në kuptimin e hapjes ndaj pjesëmarrjes politike.

Edhe pse ajo nuk e realizoi pavarësinë e pjesëmarrjes si parti politike, megjithatë arriti mundësinë e koalicionit me partitë e pranuar juridikisht. Sipas kuptimit tepër të gjerë të Avadiut, vëllazërit myslimanë u fokusuan në ato segmente të shoqërisë në të cilat nuk kanë

ekzistuar restriksionet nga ana e regjimit qendrat universitare, sindikatat, organizatat humanitare dhe vullnetare etj.⁵⁵

Hapja - periudha para vitit 1995

Këndellja e organizatës u bë përmes transferimit të veprimtarive të saj në fushën e asaj që mund të përshkruhet si shoqëri qytetare egjiptiane në zhvillimin e saj të hershëm. Në realitet, fokusi i *vëllazërisë* ka qenë që të sigurojë spektër të gjerë të shërbimeve shoqërore e që i ka sjellë pranim të rëndësishëm, nëse jo nga ana e shtetit, atëherë me siguri nga ana e shoqërisë së gjerë. Brenda qendrave universitare, *vëllazëria* filloi t’u ndihmojë studentëve përmes përkrahjeve të gjëra programore, nga sigurimi i teksteve të lira deri te organizimi i orëve të mësimi pa pagesë. Personelit arsimor u është ndihmuar në çështjet më të rëndësishme, të cilat e kishin goditur këtë popullatë pas politikës së hapjes: shtimi i shpenzimeve jetësore, të banimit dhe problemet e mbrojtjes shëndetësore⁵⁶. Vëllazërit myslimanë organizuan skema të ndryshme të kredive banesore, lobuan për rritjen e të ardhurave plotësuese për veprimtari hulumtuese, si dhe për sigurimin e mbrojtjes sociale pa pagesë. Ndryshime kanë ndodhur gjithashtu edhe në strukturën organizative të *vëllazërisë* në kuptimin e aplikimit të menaxhimit të decentralizuar, i cili mundësoi më lehtë marrjen e vendimeve.

Për shkak të efikasitetit më të madh një shkallë e autonomisë u është dhënë edhe zyrave rajonale. Atyre u është besuar kujdesi dhe vendosja për çështjet e përditshme, kurse udhëheqja qendrore mbante fushën e drejtimit të politikës kryesore dhe marrëdhëniet me opinionin dhe mediet⁵⁷. Ky organizim do të tregohet jashtëzakonisht efikas dhe se më së miri u tregua pas tërmetit në vitin 1992, kur i parapriu shtetit në sigurimin e ndihmës së parë viktimave. Nga ky moment, siç pohon Eksposito⁵⁸ shteti do të vërejë një revolucion të qetë social, i cili

⁵⁵ Al-Awadi 2005, 62.

⁵⁶ Al-Awadi, 2005, 62.

⁵⁷ Al-Awadi 2005, 62.

⁵⁸ Eksposito 2002, 92.

⁵³ Cantory and Baynard in long and Reich, 2002, 355-356.

⁵⁴ Ayubi, 1991, 74.

ndodhte në qytetet e Egjiptit dhe në paralagjet e tyre. Natyrisht, madhësia e suksesit të *vëllazërisë* do ta lëvizë shtetin kah masat më të rrepta të pengimit me qëllim të sigurimit të hegjemonisë së vet.

Frenimi dhe bllokada - periudha pas vitit 1995

Për periudhën e Mubarekut lidhen dy tentime të *vëllazërisë* për të bërë invadim në fushën e politikës vendore. Tentimi i parë ka qenë suksesi i tridhjetë e gjashtë islamistëve (kryesisht anëtarë të vëllezërve myslimanë) për të fituar vende në Parlamentin egjiptian në vitin 1987, në kuadër të aleancës me partinë laburiste dhe me partinë djathtiste liberale⁵⁹). Mirëpo, një tentim i rëndësishëm ka ndodhur pasi që qeveria nxori ligjin për politikë frenuese, duke tentuar në çfarëdo mënyre të mundshme për të demontuar aktivitetin politik islam. Ky rast është interesant nga një pikëpamje tjetër ngase nuk ka qenë vetëm politika e qeverisë, e cila sabotonte hyrjen e islamistëve, por edhe vetë ndarjeve brenda gjeneratave të vjetra dhe të reja të anëtarësisë së vëllezërve myslimanë.⁶⁰ Si produkt i iniciativave brenda qarqeve të të rinjve të *vëllazërisë* u krijua Hisbul Wasat - Partia e Qendrës, e cila filloi pjesëmarrjen politike në zgjedhjet nacionale. Partisë së Qendrës i është refuzuar regjistrimi zyrtar pranë Komitetit për partitë, kurse vendimi është arsyetuar me paditjen se partia ka dashur që suksesin e vepri-tarisë në fushën e sindikatave ta hedhë në sferën formale politike.⁶¹ Ndërkaq, luftërat e brendshme gjithashtu kontribuan që ky projekt ambicioz të dështojë.⁶² Partia e pranoi lojën politike, me paraqitjen e qëndrimit të kompromisit lidhur me çështjen e theksimit të Sheriatit si “Përmbledhje e principeve”, që natyrisht nuk e ka kënaqur gjeneratën e vjetër brenda Lëvizjes.⁶³

⁵⁹ Flores, 1933, 36-37, Ayubi – 1991,85.

⁶⁰ Norton in Fawcett, 2005, 144.

⁶¹ Al-Awadi, 2005, 71.

⁶² Al-Gawharij 1996, 31.

⁶³ Norton in Fawutt, 2005, 145.

Provokimet e internacionalizimit të Lëvizjes

Kjo barrë e dëbimit të aktivitetit politik islam nga ditët fillestare të tij, më tepër bën pjesë në çështjet e formalizimit doktrinar dhe sipërfaqësisë dogmatike sesa që ajo është çështje e konotacioneve të vërteta praktike, sepse ajo vetëm e ndihmon izolimin dhe përjashtimin si dhe mbajtjen e vazhdueshme të formave autokratike të qeverisjes në Lindjen e Afërt.⁶⁴ Nga ana tjetër, faktorët ndërkombëtarë janë memecë në raste të tilla dhe me më dëshirë e pranojnë stabilitetin në dëm të reformave, por edhe nëse këtë veti e ndryshojnë, atëherë këtë e bëjnë në të njëjtën kohë duke injoruar forcat islame të aktivitetit politik. Për këtë është argument i qartë politika e jashtme e SHBA-së gjatë mandatit të Bushit (2000-2008) dhe refuzimi i çdo lloj bisedimesh me bllokun më të fuqishëm opozitar në Egjipt, konkretisht, edhe në botën islame në përgjithësi. Përveç shumë faktorëve tjerë të cilët në Lindjen e Afërt, që i kontribuojnë mbajtjes së regjimeve autokrate me siguri është edhe qëllimi i përjashtimit të partive, kandidatëve dhe personave të cilët kanë çfarëdo lidhjeje me aktivitetin politik islam, njërit nga faktorët vendimtarë në këtë botë. Pa marrë parasysh drojën që ekzistonte në Perëndim nga hyrja e islamistëve në procesin demokratik, për shkak të ndërtimit të frikës në paragjykime se islamistët do të shfrytëzojnë procesin demokratik përkohësisht për të ardhur në pushtet, e pastaj do të aplikojnë disa forma mitike të teokracisë, të tiranisë dhe të mesjetës, më në fund në Lindjen e Afërt ndryshime të rëndësishme nuk do të mund të ndodhin pa përfshirjen e këtyre forcave shoqërore në lojën politike.

Vërtetimi më i qartë i këtij pohimi janë ndodhitë rreth Hamasit, lëvizjes dhe partisë politike të krijuar në të njëjtin kallëp ideologjik të vëllezërve myslimanë. Izolimi total i tyre, pas refuzimit trimëror e sipas të gjitha gjasave fatal për t’iu nënshtruar kërkesave të fuqive të mëdha që të “tërhiqet” nga procesi politik në planin afatgjatë, vetëm reflektojnë ato përvoja të cilat islamistët tashmë i kishin provuar në planin shtetëror. Është për t’u pritur që në kohën e ardhshme në nivel

⁶⁴ Abou El-Fadl, 2004, 8.

ndërkombëtar, islamistët do t'i aplikojnë leksionet të cilat janë mësuar gjatë procesit afatgjatë të adaptimit dhe pragmatizmit politik, por tani gjithsesi në kornizat ndërkombëtare.

Mossuksesi i përfshirjes së grupeve më të fuqishme opozitare në botën myslimane ka shkaktuar toçitjen e indit shoqëror, vdekjen e milionave civilëve, jostabilitet ekonomik dhe politik në Afganistan, Irak dhe Palestinë, e që prapë u dërgon mesazhbërësve të mëdhenj të skenës politike ndërkombëtare se projekti i demokracisë dhe liberalizmit të "importuar" në Lindjen e Afërt, ka rënë në kolaps të plotë, nëse tashmë nuk ka humbur në mënyrë të pakthyeshme.

Islami politik

Aktiviteti politik i bazuar në konceptet e mësimave Islame ka marrë shumë emra. Veprimtaria politike e bazuar në mësimet Islame sot shikohet me një dozë të dyshimtë, ndërkaj në Perëndim, sidomos pas sulmeve terroriste në Nju-Jork, Londër dhe Madrid, ky kombinim, në shumicën e rasteve, ndërlidhet me "Islamin radikal" ose të atyre që në shumicën e rasteve përfundojnë në gjenezën e "terrorizmit Islam", sintagmat e mbathura bashkëkohore mësimave Islame dhe manifestimeve të tij.

Gjeneralizimet të cilat vazhduan (dhe që ende me të madhe vazhdojnë) sjellin deri te rreziku që vibracionet dhe idetë politike, të cilat u paraqitën në shekullin 20 në botën myslimane, në mënyrë selektive të radhitën në paraardhëse të asaj që në kohën e administratës së Bushit (2000-2008) në planin global u quajt "kërcënim Islam" kundër të cilit është ndërmarrë ekspedita, e cila në Perëndim quhet "lufta kundër terrorizmit" kurse në Lindje "lufta e re e kryqëzatave"

Përktheu nga boshnjakishtja:

Hajrullah Hoxha

Marrë nga Gazeta "Preporod", nr. 4, 15 shkurt
dhe nr. 5, 1 mars 2009, Sarajevë.

Shënime

- Abou EI-Fadl, Khaled (ed.) (2004), *Islam and the Challenge of Democracy*, New Jersey: Princeton University Press
- Akhavi, Shahrugh (1997), 'The Dialectic in Contemporary Egyptian Social Thought' in *International Journal of Middle East Studies*, 29(3):377-401.
- AI-Awadi, Hesham (2005), 'Mubarak and the Islamists: Why Did the "Honeymoon" End?' in *Middle East Journal*, 59(1): 62-80. Ayubi, Nazih (1991), *Political Islam*, London: Routledge.
- Beinin, Joel (1989), 'Labour, Capital, and the State in Nasserist Egypt, 1952-1961: in *International Journal of Middle East Studies*, 21(1):71-90.
- Deegan, Heather (1993), *The Middle East and Problems of Democracy*, Buckingham: Open University Press.
- Esposito, John L. (1998), *Islam and Politics*, New York: Syracuse University Press. Esposito, John L., (2002), *Unholy War: Terror in the Name of Islam*, New York: Oxford University Press.
- Esposito, John L. and Voll, John O. (2001) *Makers of Contemporary Islam*, New York: Oxford University Press.
- Flores, Alexander (1993), 'Secularism, Integralism and Political Islam' in *Middle East Report*, 183: 32- 38.
- AI-Gawhary, Karim (1996), 'We are a Civil Party with an Islamic Identity: An Interview with Abu 'lia Madi Abu 'lia and Rafiq Habib' in *Middle East Report*, 199: 30-32.
- Gbb, Hamilton A.R. (1970), 'The Heritage of Islam in the Modern World (II): *International Journal of Middle Eastern Studies*, 1 (3): 221-237.
- Kepel, Gilles (2004), *Jihad: The Trial of Political Islam*, London: 1.8. Tauris.
- Kedourie, Elie (1992), *Politics in the Middle East*, New York: Oxford University Press. Lewis, Bernard (2000), *The Middle East*, London: Phoenix Press.

- Mawdudi, Abul 'Ala (1986), *Islamic Law and Constitution*, Lahore: Islamic Publications. Mitchell, Richard P. (1993), *The Society of the Muslim Brothers*, New York: Oxford University Press
- Norton, Augustus Richard (2005) 'The Puzzle of Political Reform in the Middle East'in
- Fawcett, Louise, (ed.), *International Relations of the Middle East*, Oxford: Oxford University Press.
- Potter, David, Goldblatt, David, Kiloh, Margaret and Lewis, Paul (eds) (2000), *Democratization*, Cambridge: Polity Press. Prljaca, Mustafa (2006), *Pokret "Muslimanska braca"* Sarajevo: El-Kalem.
- Qutb, Sayyid (1988), *Milestones*, Delhi: Markazi Maktaba Islami.
- Richards, Allan and Waterbury, John, (1998), *A Political Economy of the Middle East*, Oxford: Westview Press.
- Wendell, Charles, (ed.ltrans.) (1978) *Five Tracts of Hasan Al-Banna (7906-7949): A Selection from the Majmu'at Rasa'il at-Imam al-Shahid Hasan al-Banna*, Berkeley: University of California Press.
- Wood, Ellen, M. (1995), *Democracy against Capitalism: Renewing historical materialism*, Cambridge: Cambridge University Press. Zeghal, Malika (1999), 'Religion and Politics in Egypt: The Ulema of Al-Azhar, Radical Islam and the State (1952-94): in *International Journal of Middle Eastern Studies*, 31 (3): 371-399.

Mirnes Kovač

Islam vs. Islamism: The Muslim Brotherhood OUR MOVEMENT DOES NOT RECOGNIZE GEOGRAPHICAL BOUNDARIES ...

(Summary)

"Our activities will not cease until judgment day" – was the slogan of Hasan Al Banna, the founder of the Muslim Brotherhood, one of the most important movements in the Muslim world during the 20th century. February 12 marked the 60th anniversary of the assassination of this Muslim leader.

مرنس كوفاتش

حركاتنا لا تعترف بالحدود الجغرافية

(خلاصة البحث)

"ان حركتنا لن تتوقف حتى يوم القيامة" هذا هو كان الشعار الذي رفعه حسن البنا، مؤسس حركة الاخوان المسلمين، إحدى أهم الحركات التي ظهرت في القرن العشرين في العالم الاسلامي. و كان يوم 12 فبراير 2009 ذكرى الستين على اغتيال هذا الزعيم الكبير للعام الاسلامي. و بهذه المناسبة سوف ينشر هذا المقال بجريدة "بريورود" الذي يتحدث عن الزعيم المؤسس المرحوم حسن البنا و كذلك عن حركة الاخوان المسلمين و تطورها حتى اليوم.

STUDIME EKONOMIKE

Muhamed Abdullah el-Shebani

PROBLEMI EKONOMIK DHE TRAJTIMI I TIJ NGA KËNDVËSHTRIMI ISLAM

Problemi ekonomik paraqet boshtin e interesimit nga ekspertët ekonomik, si dhe është boshti i interesimit të shteteve gjatë trajtimit të çështjeve të tyre ekonomike. Problemi ekonomik është i lidhur me ekzistencën e njeriut në tokë dhe ai është prej elementeve ndikues në rrjedhën historike të njeriut. Madje, edhe thirrja e një prej të dërguarve, Shuajbit a.s. është bazuar në konfirmimin e aspektit ekonomik dhe rëndësinë e reformimit ekonomik të lidhur me sigurinë e besimit. All-llahu xh.sh. na ka treguar ngjarjen e Shuajbit a.s. me popullin e tij dhe ka paraqitur pikat më të rëndësishme të mohimit të tij ndaj popullit të tij të paraqitura në procesin e lirit të shkëmbimit tregtar dhe ngrënien e pasurisë së njerëzve pa të drejtë përmes ndikimit në procesin e ndarjes, të cilat paraqesin aspektet më të rëndësishme të problemit ekonomik. All-llahu xh.sh. thotë:

"Edhe Medjenit (i dërguam) vëllain e tyre Shuajbin që ju tha: "O populli im, adhuron All-llahun, ju nuk keni Zot tjetër pos Tij, mos matni as mos peshoni mangët, unë po shoh se jeni në gjendje të mirë jetësore, pra unë po frikësohem për ju nga dënimi që do t'ju përfshijë një ditë! O populli im, veproni drejtë gjatë matjes

dhe peshimit, e mos dëmtoni njerëzit në asgjë dhe mos shkaktoni rrëmuje në tokë! Ata thanë: "O Shuajb, a namazi yt po të thotë të na urdhërosh që ta braktisim atë që adhuroan prindërit tanë ose (po të urdhëron) për të punuar në pasurinë tonë ashtu si të dëshirojmë? Vërtet, ti qenke i butë e i mençur" (Kjo ishte tallje e tyre). "O populli im, më thuani pra, nëse unë kam argumente të sigurta nga Zoti im dhe nga ana e Tij, Ai më furnizoi mua me të mira (si mund të mos ju udhëzoj në rrugë të drejtë)? Unë nuk dua t'ju kundërshtoj (duke punuar) për atë nga e cila po ju ndaloj, unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrijë vetëm me ndihmën e All-llahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam i drejtuar!". (Hud: 84, 85, 87, 88)

Ajetet e mësipërme aludojnë në ndikimin që ka padrejtësia në shpërndarjen e shkëmbimit tregtar, ngrënien e pasurisë së njerëzve pa të drejtë dhe se kjo ka ndikuar në gjendjen e keqe ekonomike të individit e të shoqërisë. Është përshkruar ngjarja e Shuajbit a.s. duke qenë tregtar që i përmbahej urdhrave të All-llahut xh.sh. Prandaj, All-llahu xh.sh. e ka furnizuar me një furnizim të mirë pasi që i përmbahej asaj me të cilën e thërriste popullin e tij e ajo ishte drejtësia në shitblerje.

Problemi ekonomik paraqitet në tri aspekte:

1 - Rrallësia, mungesa dhe pamjaftueshmëria e burimeve natyrore. Prandaj, problemi ekonomik në këtë aspekt paraqitet në zgjedhjen e asaj që prodhohet, e asaj që nuk prodhohet për shkak të ndryshimit e llojshmërisë së nevojave të shumta të njeriut, mënyrës së përcaktimit të burimeve të gatshme për përdorim apo përcaktimit të burimeve, të cilat mund të përdoren si dhe mënyrës së prodhimit të cilën duhet ndjekur. Prandaj, për të kuptuar këtë problem duhet studiuar teorinë e garantimit të këtyre burimeve, llojin e sasinë e të mirave, preferencat e prodhimit të tyre si dhe alternativat e tyre.

2 - Mënyra përmes së cilës bëhet shpërndarja e të hyrave publike për faktorët e ndryshëm të prodhimit apo mënyra e shpërndarjes së faktorëve të prodhimit për pjesëtarët e shoqërisë dhe pjesa e faktorëve të prodhimit në ato të hyra në bazë të detyrës që kryen çdo faktor në re-

alizimin e këtyre të hyrave. Ky aspekt i problemit ekonomik lidhet me caktimin e burimeve të të hyrave individuale dhe rregullat e fitimit e të shpërndarjes së tyre. Si dhe pjesëmarrjen e faktorëve të prodhimit në të hyra dhe kjo është fitimi nga toka, rroga për punëtorin, kthimi i kapitalit dhe fitimi për afaristin.

3 - Rëndësia relative për faktorët e prodhimit si dhe roli e rëndësia e çdo faktori në procesin e prodhimit. Rëndësia relative është e lidhur me konceptin filozofik të cilin e pranon çdo shoqëri. Rregullimi shoqëror me sistemet ekonomike që përmban ka ndikim të madh në caktimin e sasisë së prodhimit e llojin e tij, varësisht nga niveli i lirisë apo kufizimit të të drejtës së pronës apo të drejtës së punës e të konsumit, apo inkurajimit të përparimit teknik e teknologjik për përmirësimin e shtimit e prodhimit me qëllim të përfitimit nga burimet apo faktorët esencial të prodhimit të përfaqësuar në pasuritë natyrore, kapitalin dhe punën.

Këto tri aspekte të problemit ekonomik janë boshti i studimeve ekonomike, kanë rolin e tyre në mosmarrëveshjet mes popujve e shoqërive të ndryshme si dhe janë prej faktorëve që shkaktojnë luftërat e shkatërrojnë civilizimet.

Ekzistimi i problemit ekonomik është pjesë e traditës universale të All-llahut xh.sh. dhe sprovim nga Ai për njerëzimin që të dallohet i keqi prej të mirit, i dobishmi nga i padobishmi dhe besimtari nga pabesimtari.

Islami e pranon ekzistencën e problemit ekonomik dhe e konsideron prej fenomeneve universale e traditave hyjnore të shoqëruara me prezencën e njeriut në tokë si dhe sprovim i All-llahut xh.sh. për njerëzimin që të cakton destinacionin e tij për ahiret.

Mungesa e rrallësia në burimet natyrore është pjesë e dëshirës universale të All-llahut xh.sh. si dhe ajo nganjëherë është një lloj dënimi hyjnor për tiraninë e shkatërrimin e njeriut në tokë.

All-llahu xh.sh. ka përcaktuar shkakun e ekzistencës së këtij fenomeni, i cili kthehet në vet natyrën e njeriut në të cilën e ka krijuar All-llahu xh.sh., kjo natyrë e pabindur, rebeluese e tirane, e cila nuk ka

nevojë për askënd kur të ngopet. All-llahu xh.sh. për të sqaruar këtë të vërtetë thotë:

"Sikur All-llahu t'ua shumonte begatinë robërve të vet, ata do të kalonin kufijtë, por Ai i furnizon me masë që dëshiron, sepse Ai është i njohur hollësisht dhe i dijshtëm për robërit e vet". (esh-Shura: 27)

All-llahu xh.sh. duke përshkruar natyrën e shpirtit njerëzor kur të arrin mirëqenien dhe kur realizon kërkesat e nevojat e tij, duke u bërë arrogante e tirane thotë:

"Jo, është e vërtetë se ai i kalon kufijtë. Për shkak se e ndien veten të pavarur". (el-Alek: 6-7)

Shoqëria e cila bëhet e panevojshme, ajo praktikon atë që praktikon individ dhe këtë të vërtetë e ka shpjeguar All-llahu xh.sh. në ajetin vijues:

"Populli Sebe pati një begati në vendbanimin e vet: kishin nga të dy anët kopshte, nga ana e djathtë (e luginës) dhe nga ana e majtë. Hani (u thamë) nga begatitë e Zotit tuaj dhe falënderonju Atij. Qytet i mirë dhe Zot mëkatfalës. Po ata i kthyen shpinën, e Ne e lëshuam kundër tyre rrjedhën e pendës dhe dy kopshtet e tyre i shndërruam në dy kopshte me fruta të idhët, drunj të thatë dhe diçka pak bari të egër. Atë dënim ua dhamë atyre për shkak se nuk besuan, e Ne nuk dënojmë përveç mohuesit". (Sebe'ë: 15-17)

"All-llahu sjell si shembull një fshat (vendbanim) që ishte i sigurt dhe i qetë, të cilit i vinte furnizimi nga të gjitha anët me bollëk, kurse ata (banorët) i përbuzën të mirat e All-llahut. Atëherë All-llahu, për shkak të sjelljes së tyre, ua veshi petkun (ua ngjeshi) e urisë dhe të frikës". (en-Nahl: 112)

Rrallësia e burimeve natyrore ka një urtësi me të cilën dallohet. Mungesa e burimeve i nxit njerëzit që të ndërtojnë tokën dhe është nxitje për vazhdimësinë e njerëzimit në të deri në një moment të caktuar, me punë sipas fuqive e mundësive reale e mendore të shpërndara mes njerëzve. E tërë kjo shpie që faktori punë të këtë rolin e tij në përfitimin nga burimet natyrore dhe kontributin e tij në nxjerrjen e

thesareve të fshehura në tokë. E tërë kjo nuk do të arrihet nëse mu-
ngon e largohet problemi ekonomik. Kur'ani ka treguar për këtë urtësi
duke thënë se ajo pjesë e traditës universale të All-llahut xh.sh. dhe
shenjë prej shenjave hyjnore të Tij. All-llahu xh.sh. thotë:

**"Ne kemi dalluar disa në shkallë më të lartë se të tjerët që të
shfrytëzojnë njëri tjetrin për shërbime".** (ez-Zuhruf: 32)

Kur'ani e cakton mënyrën përmes së cilës njeriu mund të arrijë mi-
rëqenien dhe të arrijë begatinë e jetesës. All-llahu xh.sh. na garanton
me gjetjen e nevojave të njeriut të lidhura me komponentet e ekzisti-
mit të tij, duke na garantuar me plotësimin e tyre. Ky sistem që All-
llahu xh.sh. e ka bërë shkak të obligueshëm për plotësimin e nevojave
është besimi i njeriut në All-llahun xh.sh. me fjalë, me punë, me sjell-
je dhe me legjislacion. Devijimi i shoqërive njerëzore konsiderohet ar-
syë për mungesën në prodhim, qoftë ajo për shkak të dhënies së fuqisë
për disa krijesa nga All-llahu xh.sh. që të shkatërrojnë prodhimin apo
largimin e bekimit të së mirës e të furnizimit të cilën ua jep All-llahu
xh.sh. robërve të tij. All-llahu xh.sh. thotë:

**"E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të
ishin ruajtur, Ne do t'ju hapnim begati nga qielli e toka, por ata
përgënjeshtroan, andaj i dënuam me shkatërrim për atë që me-
rituan".** (el-A'rafë: 96)

Trajtimi i problemit ekonomik nga Islami dhe mënyra të cilën ur-
dhëron që ta ndjekim që t'i shmangemi problemit në formën që nuk
përkon me ekuilibrin e shoqërisë, ngrihet në atë mënyrë duke i trajtuar
të gjitha aspektet e problemit ekonomik në formë të plotë ku bashko-
hen të gjithë elementet ndikues në rregullimin shoqëror me punë, me
koordinim e integrim për të arritur shoqërinë e virtytshme ku jeta
zhvillohet sipas programit të All-llahut xh.sh., të cilin e ka shpjeguar
All-llahu xh.sh. në librin e Tij përmes të Dërguarit të Tij. Kur të arri-
het kjo gjë me lehtësi sipas ligjit të All-llahut xh.sh., atëherë problemi
ekonomik me të gjitha aspektet e tij nuk do të jetë pengesë për stabili-
tetin e njeriut dhe arritjen e qëllimit për hir të cilit e ka krijuar All-
llahu xh.sh. dhe e ka zbrit në tokë që të jetojë në të një periudhë të
caktuar kohore, ku pas kësaj do të kalon në jetën e përvetshme në të

cilën nuk ka lodhje e as mundim, por ajo është jetë e shpërblimit për
atë që ka punuar njeriu gjatë periudhës kohore që e ka kaluar në tokë.

Studimi i sistemit e i mënyrës përmes të cilave Islami e zgjidh
problemin ekonomik kërkon studimin e të gjitha gjërave të pjesshme e
më të gjëra të sistemit ekonomik nga këndvështrimi islam. Prandaj,
qëllimi i këtij artikulli e i atyre vazhdues nuk është paraqitja e plotë
për të gjitha zgjidhjet që i paraqet Islami gjatë trajtimit të problemit
ekonomik duke i dhënë koncept të plotë për programin e Islamit. Kjo
kërkon studime të gjata e të ndryshme të degëve të ndryshme të eko-
nomisë. Por në këtë artikull e në artikujt që pasojnë do të trajtojmë
problemin ekonomik duke i dhënë lexuesit koncept të përgjithshëm
për zgjidhjet të cilat i urdhëron Islami gjatë trajtimit të problemit eko-
nomik me të tri aspektet e tij të cilat i kemi përmendur në fillim të kë-
tij artikulli. Gjithashtu do të trajtojmë idenë që Islami nuk kufizohet
vetëm në trajtimin e marrëdhënieve me All-llahun xh.sh., por i trajton
problemet materiale të njeriut në përputhje me natyrën njerëzore dhe
traditat universale të cilat kanë qenë të nevojshme për krijimin e nje-
riut në tokë.

Rrallësia e burimeve natyrore është e lidhur me urtësinë e krijimit
të njeriut. Toka të cilën All-llahu xh.sh. e ka krijuar për njeriun që të
jetojë në të nuk është krijuar që të jetë vend rehatie e lumturie. Kur'ani
ka aluduar për këtë në ajetin vijues:

**"... e Ne u thamë: "Zbritni (dilni), jeni armik i njëri tjetrit, e ju
deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëfrim".** (el-Bekare:
36)

All-llahu xh.sh. të mirat e tokës nuk i ka bërë si ato të xhenetit, por
komoditetin e tyre e ka bërë të vogël dhe burimet e tyre të kufizuara.
Por All-llahu xh.sh. ka krijuar tokën dhe ka krijuar njerëzit në të. Në
të ka krijuar të mira e pasuri të cilat u mjaftojnë njerëzve nëse janë në
rrugën e drejtë dhe i binden urdhrit të All-llahut xh.sh. Por nëse devi-
jojnë, atëherë ligji i rrallësisë do të rëndojë problemin ekonomik dhe
do të prek njerëzit me dhimbje, mjerim, varfëri, uri dhe frikë.

Sistemi i Islamit në trajtimin e rrallësisë së burimeve natyrore pa-
raqitet në drejtimin e shoqërisë për shfrytëzimin e të gjitha burimeve

natyrore, përpjekjet për arritjen e tyre dhe përfitimin nga to. Shfrytëzimi i këtyre burimeve kërkon përpjekje. Prandaj kush dëshiron të përfitojë nga ajo që ka krijuar All-llahu xh.sh. në tokë apo në qiell, atëherë ai duhet të bëjë përpjekje. Burimet natyrore të cilat janë një prej arsyeve që shkaktojnë problemin ekonomik, qoftë ai nga aspekti i mangësisë në shfrytëzimin e tyre apo nga aspekti i mënyrës e teknikës së përdorur nga njeriu gjatë shfrytëzimit të këtyre burimeve. Prandaj, trajtimi i realitetit të rrallësisë së burimeve natyrore varet nga mënyra e shfrytëzimit të këtyre burimeve dhe përpjekja për zbulimin e tyre. Toka është burimi kryesor i furnizimit, dhe në brendi të saj fshihen lëndët e para për prodhimin e produkteve për të cilat ka nevojë njeriu në jetën e tij, si dhe ajo ruan burimet e zhvillimit si toka e uji. Dhe me bashkimin e këtyre arrihet plotësimi i nevojave të njeriut që kanë të bëjnë me ushqimin. Prandaj, trajtimi i mungesës së burimeve e rrallësisë së tyre nga Islami arrihet përmes shfrytëzimit të tokës, vëmendjen që duhet njeriu t'ia kushtojë tokës dhe domosdoshmërinë e shfrytëzimit të saj përmes bonifikimit të tokës, shfrytëzimit të saj dhe nxitjen e njeriut që të arrij këtë.

Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Kush e punon një tokë që nuk është e askujt, atëherë ajo i takon atij"*. Ky hadith shpjegon një aspekt prej aspekteve se si Islami e trajton mënyrën e sjelljes me rrallësinë, dhe atë përmes nxitjes së shfrytëzimit të tokës e investimit në të, duke nxitur njeriun që të shfrytëzoj tokën përmes përfitimit të ndjenjës së pronësisë, duke i nxitur njerëzit të aftë që të shfrytëzojnë tokën e papunueshme. Prandaj, Islami kujdeset t'i shtyjë faktorët e prodhimit në bashkëveprim me qëllim të zvogëlimit të efekteve të rrallësisë së burimeve në keqësimin e problemit ekonomik. Mos shfrytëzimi i tokës shpie në shkatërrimin e dy burimeve të prodhimit dhe ata janë toka e puna. Prandaj Islami, i ka dhënë rëndësi këtij aspekti prej aspekteve të trajtimit të rrallësisë duke i krijuar mjedisin ndihmës për shfrytëzimin e burimeve natyrore të disponueshme. Për këtë qëllim ka krijuar murin rregullues për mbrojtjen e grupit aktiv të njerëzve, duke i nxitur për shfrytëzimin e tokës përmes dhënies së të drejtës së pronësisë për atë që investojnë në tokë dhe mbrojtjen e kësaj pronësie nga zaptimi i

saj. Shprehja se nuk ka asnjë të drejtë mundimi i tiranit (djersa e tiranit) që ka ardhur në disa transmetime ka qëllim që nuk i takon askujt që të vijë në tokën që e ka gjallëruar dikush para tij të mbjellë në të me forcë, duke përfituar nga kjo mbjellje zotërimin e tokës. Nuk pranohet e drejta e tij dhe e ka ndaluar këtë të drejtë. Ndërsa udhëheqësit të myslimanëve i takon që të mbrojnë pronën.

Problemi i vendeve të pazhvilluara qëndron në pamundësinë e tyre për të shfrytëzuar burimet natyrore të disponueshme për njeriun, qoftë kjo për shkak të legjislacioneve jo të drejta të cilat pengojnë nxitjen për punë. Dhe historia bashkëkohore na jep argumente që legjislacionet jo të drejta si dhe përvetësimi i ideve të devijuara ka shpjer në shkatërrimin e sistemit komunist në Bashkimin Sovjetik, ku rregullimi ekonomik është bazuar në zvogëlimin e rolit të njeriut në shfrytëzimin e burimeve natyrore duke ia larguar ndjenjën e dashurisë ndaj pronës. E si rrjedhojë e kësaj largimin e nxitjes për punë, duke e ndaluar nga kryerja e rolit të tij ndikues duke mos përfituar maksimalisht prej burimeve natyrore.

Islami e ka drejtuar vëmendjen që burimet natyrore nuk kufizohen vetëm në atë që shfaqet në tokë, por që rrallësia mund të jetë për shkak të mos përpjekjes mendore e trupore, dhe që rrallësia mund të zgjidhet nëse njeriu përpiket e synon hulumtimin për burimet e furnizimit duke mos u mbështetur në burimet e dukshme. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Kërkoni furnizimin në fshehtësitë e tokës"*. Ky hadith na paraqet të vërtetën që toka fsheh shumë të mira, dhe që All-llahu xh.sh. që ka krijuar njeriun, do t'i sigurojë të gjitha nevojat e tij, por me kusht që të punojë në hulumtimin e gjurmimin e tyre. Ky hadith përmban tregues të qartë që furnizimi fshihet në brendësitë e tokës, por ka nevojë që të kërkohet.

Prej traditave universale të All-llahut xh.sh. është që e ka obliguar njeriun që të kërkojë në tokë, të përpiket e të lodhet. Kurse kënaqësia pa lodhje është në botën tjetër. Dhe kjo është prej fshehtësive që All-llahu xh.sh. ka bërë në rrallësinë e burimeve, por mungesa e plotë dhe pamundësia nuk janë plotësim i nevojave. Rrallësia sipas konceptit islam është relative, e nuk është absolute, apo që rrallësia ndodh kur

njeriu nuk përdor pasuritë e mundësitë e tij dhe nuk punon në shfrytëzimin e fuqive mendore.

Është detyrë e njeriut që të përdor procesin e mendimit e të zbulimit. Atë që zbulon njeriu apo e hulumton është krijuar nga All-llahu xh.sh. Prandaj, duhet kuptuar drejtë fjalën e All-llahut xh.sh.:

"E All-llahu ju krijoi juve e atë që punoni". (es-Safatë: 96)

Tërë atë që arrin njeriun prej zbulimeve e me atë që frymëzohet për njohjen e fshehtësive universale, e ka lejuar All-llahu xh.sh. në këtë periudhë me numrin e madh të njerëzve, dhe nuk e ka lejuar në historinë e mëparshme të njerëzimit për të konfirmuar një të vërtetë të sigurt që nuk ka dyshim që All-llahu xh.sh. garanton sigurimin e nevojave të njeriut dhe që burimet e disponueshme mjaftojnë për plotësimin e nevojave të njeriut me kusht që të kërkojë sipas traditave të All-llahut xh.sh. dhe përmes nënshtrimit ndaj Tij. Prandaj, devijimi nga ky sistem do të jetë shkak për rrallësinë e burimeve, ku do të jetë kjo mjet për zbritjen e dënimit të All-llahut xh.sh. ndaj padrejtësisë së njeriut.

Në artikullin e kaluar kemi diskutuar një aspekt se si e trajton Islami një pjesë të problemit ekonomik, e ajo është rrallësia e burimeve. Ndërsa në këtë artikull do të trajtojmë aspektet tjera të trajtimit të problemit ekonomik dhe ky aspekt lidhet me rolin e shtetit në trajtimin e rrallësisë përmes mënyrës së shfrytëzimit të burimeve natyrore e zhvillimit të tyre apo thënë ndryshe rolin e shtetit islam në zvogëlimin e ndikimit të ligjit të rrallësisë ndaj problemit ekonomik.

Prej obligimeve të shtetit është që të hulumtojë për burime natyrore. Në artikullin e kaluar kemi përmendur hadithin e Muhamedit a.s.: *"Kërkoni furnizimin në fshehtësitë e tokës"*. Ky hadith është sugjerim profetik për myslimanët dhe udhëheqësin mysliman, duke marrë parasysh që është përgjegjës për umetin islam. Rregulla të cilën e ndjek legjislacioni islam është adresimi i umetit në formë urdhrash

ashtu siç ka ardhë në Kur'an duke i drejtuar të gjithë pjesëtarëve të umetit, por përgjegjësia e zbatimit i takon vetë udhëheqësit.

"O ju të zotët e mendjes, kjo masë e dënimit është jetë për ju, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri tjetrit)". (el-Bekare: 179)

"(dispozitë obliguese është që) Laviren dhe lavirin t'i rrahni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të All-llahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve...". (en-Nurë: 2)

Siç vërehet kjo edhe në hadithet profetike kur mesazhi u drejtohet umetit, por autoriteti zbatues janë udhëheqësit myslimanë. Adresimi profetik në këtë hadith kërkon që shteti të hulumtojë për burimet e furnizimit të fshehura në brendësinë e tokës.

Hadithi profetik e shpjegon mjekimin:

Prej mënyrave të mjekimit të rrallësisë së burimeve sipas asaj që tregon hadithi janë çështjet vijuese:

1 - Domosdoshmëria e përpjekjeve të umetit të përfaqësuar në udhëheqësin mysliman për të punuar në hulumtimin e burimeve natyrore dhe përdorimin e fuqisë punëtore që të punojë dhe të përpiqet. Shprehja "kërkoni" tregon rëndësinë e gjetjes së burimeve natyrore të reja apo zbulimin e fushave të reja në shfrytëzimin e burimeve natyrore të disponueshme, që kërkon të gjitha përpjekjet trupore apo mendore. Prandaj, problemi i rrallësisë nuk do të zgjidhet pa bërë përpjekje dhe pa punë. All-llahu xh.sh. ka garantuar furnizimin e të gjitha krijesave të Tij. Dhe këtë të vërtetë e konfirmon ajeti vijues:

"Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj...". (Hudë: 6)

Por arritja e këtij furnizimi kërkon që të bëhen përpjekje, si dhe nuk kërkon sasi të madhe të disponueshme, por zbulimi i fushave të ndryshme të përdorimit të burimeve të disponueshme do të çon në plotësimin e nevojave të njeriut.

2 - Koncepti i furnizimit ashtu siç është përmendur në hadithin profetik nuk kufizohet në një gjë pa tjetrën, por përfshin çdo gjë që re-

alizon plotësimin e nevojave nëse çështja lidhet me prodhimin bujqësor apo mineral apo me ndonjë tjetër. Prandaj, është e domosdoshme që umeti islam i përfaqësuar në udhëheqësin e tij të hulumtojë burimet e furnizimit, pasi që këto burime janë të fshehura në brendësi të tokës. Nëse pakësohen apo zvogëlohen burimet e disponueshme në tokë kjo nuk do të thotë që furnizimi është ndërprerë. Zbulimet shkencore bashkëkohore janë argumenti më i madh që All-llahu xh.sh. çdo ditë i hap njerëzimit burime të reja të furnizimit qoftë kjo përmes gjetjes së burimeve të reja apo zbulimit të sasive shtesë apo zbulimit të fushave të reja për përdorimin e burimeve të disponueshme, të cilat ndihmojnë në plotësimin e kërkesave të njeriut.

3 - Hadithi i kushton vëmendje një të vërtetë të rëndësishme të cilën e kanë neglizhuar myslimanët dhe nuk i kanë kushtuar rëndësi, e kjo e vërtetë është që toka është e mbushur me të mira dhe se problemi qëndron te vetë njeriu. Toka posedon në brendi të saj shumë të mira, dhe njeriut nuk i duhet asgjë vetëm që të përdor mendjen e tij e të bëjë përpjekje në kërkimin e burimeve të furnizimit në brendësi të tokës. Dhe nuk do të ketë mungesë në burime për plotësimin e nevojave të njeriut vetëm se nëse njeriu përton për hulumtimin e tyre apo devijon mendja e sjellja e tij në shfrytëzimin e të mirave që All-llahu xh.sh. i ka dhënë, duke e përdor në fusha të dëmshme duke iu kthyer dëmi vetë atij. Praktikë bashkëkohore të shteteve janë argumenti më i madh që mungesa nuk qëndron në burime në shkallën që qëndron në llojin e shfrytëzimit e përpjekjes që kthehet si dëm në vet njeriun.

Domosdoshmëria e shfrytëzimit të burimeve të disponueshme:

Prej shkaqeve të ekzistencës së rrallësisë së burimeve janë mangësitë në shfrytëzimin e burimeve të disponueshme. Prandaj prej detyrave themelore për të cilat duhet të përkujdesen udhëheqësit myslimanë është shfrytëzimi i burimeve të disponueshme e mos shkatërrimi i tyre, të atyre që mundet përmes tyre plotësimi i nevojave të shoqërisë. Veprimi i Muhamedit a.s. me çifutët e Hajberit është argument i qartë për domosdoshmërinë e shfrytëzimit të burimeve të disponueshme. Është transmetuar se Muhamedi a.s. i ka dhënë Hajberin çifutëve që ta

punojnë e ta mbjellin e të kenë një pjesë nga ajo. E në një transmetim tjetër transmetohet që Bilal ibn Harith el-Muzni ka ardhur te Muhamedi a.s., për të kërkuar një tokë. E Muhamedi a.s. ia ka ndarë një tokë të gjërë. Kur u bë halife Omeri r.a. i tha: O Bilal, ti ke kërkuar nga Muhamedi a.s. një tokë të gjërë e të gjatë, e Muhamedi a.s. ta ka dhënë pasi që Ai a.s. nuk ka refuzuar tërë atë që është kërkuar prej tij. Por tani nuk mund ta mbash tërë atë që ke. Bilali ia ktheu: Po. Atëherë Omeri r.a. ia tha: Shiko atë që mundesh ta punosh mbaje, e atë që nuk mundesh ta punosh ktheje te ne që t'ua ndajmë myslimanëve. Bilali ia ktheu: Pasha Zotin nuk do të kthejë asgjë nga ajo që ma ka ndarë i Dërguari i All-llahut a.s. Por Omeri r.a. ia ktheu: Pasha Zotin do ta bësh dhe ia mori atë që nuk mund ta punonte dhe ia ndau myslimanëve.

Nga këto dy hadithe kuptojmë interesimin e përkujdesjen e Islamit për zgjidhjen e rrallësisë së burimeve përmes punës për shfrytëzimin e burimeve të disponueshme dhe punës për përfitimin maksimal nga burimet e disponueshme e mos shkatërrimin e tyre. Muhamedi a.s. ka synuar trajtimin e mungesës në fuqitë punëtore të afta për mbjellje e bujqësi duke u ndihmuar nga çifutët që myslimanët të kenë një pjesë të asaj të nxjerr nga toka. Ndërsa Omeri r.a. duke qenë halife i myslimanëve ktheu atë pjesë të tokës që ia kishte ndarë Muhamedi a.s. e që Bilali r.a. nuk mund ta punonte. Tërë kjo konfirmon të vërtetën që trajtimi i rrallësisë në një aspekt të tij është puna për shfrytëzimin e burimeve të disponueshme dhe ndërhyrja e shtetit sipas autoritetit që ka për të realizuar këtë. Për këtë gjejmë realitetin e keq të shoqërive islame në pamundësi për të shfrytëzuar burimet e saj e mos shfrytëzimin e tyre qoftë kjo përmes sistemeve e legjislacioneve financiare e administrative që pengojnë nismat personale, apo përmes përvetësimit të sistemeve në planifikimin ekonomik e shoqëror të cilat ndihmojnë në mos shfrytëzimin e burimeve e vendosjen e tyre në gjendje të paaftësisë së përhershme.

Ndërhyrja e udhëheqësit për interesin publik:

Prej detyrave të shtetit në rast të mosshfrytëzimit të një burimi prej burimeve natyrore për shkak të mos fuqisë së personit të realizojë dhe për shkak të mungesës në fuqinë e tij materiale është të ndërhyjë në menaxhimin e tij. Në veprimin e Omerit r.a. që ktheu atë që ishte ndarë nga Muhamedi a.s. dhe rindarjen e saj për myslimanët, paraqet zbatim të këtij aspekti në mos lënien e tokës të pashfrytëzuar. Prandaj është përgjegjësi e shtetit në vendosjen e sistemeve procedurale të cilat do të ndihmojnë në shfrytëzimin e burimeve natyrore të disponueshme e burimeve të tjera të pashfrytëzuara për shkak të ndonjë faktori të prodhimit. Në rast të mos punës së fabrikave prodhuese për shkak të pamundësisë së pronarëve të tyre për të shpenzuar për to, i takon udhëheqësit të myslimanëve që të ndërhyjë e të mos lejojë të vjen deri te mosshfrytëzimi i këtyre burimeve. Është transmetuar nga Muhamedi a.s. se ka thënë: *"Kush e gjen ndonjë kafshë të cilën pronarët e saj nuk mund ta ushqejnë dhe e lënë të lirë, e merr dhe e ushqen, atëherë ajo është e tij"*. Ky hadith është porosi për udhëheqësin e myslimanëve që të ndërhyjë në rast të pamundësisë së pronarëve për të shfrytëzuar një faktor prej faktorëve të prodhimit, e atë duke e shfrytëzuar. Është e drejtë e udhëheqësit të myslimanëve që të vendos rregulla procedurale që do të ndihmojnë në ndërhyrjen e shtetit në rast të ndaljes së fabrikave apo fermave të mëdha nga prodhimi për shkak të pamundësisë së pronarëve nga shfrytëzimi i tyre. Tërë këtë duke marrë parasysh interesin publik të ekonomisë së shtetit e të drejtat e pronarëve me kusht që të mos ndikojë negativisht në kontributin për rritjet e produktit kombëtar.

Mënyrat e zhvillimit të burimeve:

Prej shkaqeve të rrallësisë lidhur me burimet natyrore është edhe mënyra e keqe në shfrytëzimin e burimeve të disponueshme, pasi që kjo shpie në dobësimin e pamundësinë e burimeve për të prodhuar dhe plotësimin e nevojave. Prandaj, mënyrat e format e shfrytëzimit të burimeve natyrore luajnë rol të rëndësishëm në humbjen e pakësimin e fuqisë prodhuese të burimit natyror. Islami është kujdesur për këtë

aspekt dhe shumë hadithe profetike kanë ardhur për të na tërhequr vëmendjen për këtë. Dhe udhëheqësit e shoqërisë islame duhet t'i kushtojnë një rëndësi të veçantë këtij aspekti. Është transmetuar se Muhamedi a.s. ka thënë: *"O ju kurejshit, ju i doni bagëtitë por pakësoni ato pasi që jeni në një vend ku bie pak shi. Mbjellni pasi që mbjellja është më e bekuar se kafshët"*. Në një hadith tjetër transmetohet që Muhamedi a.s. ka ndaluar monopolin, përvetësimin, detyrimin dhe therjen e kafshëve femra".

Nga këto hadithe mund të kuptojmë politikën me të cilën Islami i porositi pasuesit e tij me atë që lidhet me mënyrat e ruajtjes së burimeve natyrore që është përpjekja për të ruajtur gjelbërimin, mos prerja apo heqja e drunjve, të trajtojmë burimet e disponueshme sipas natyrës së mjedisit dhe shfrytëzimi i burimeve sipas kushteve të mjedisit. Këtë e vërejmë nga fjalët e Muhamedit a.s. kur iu drejtohet muhaxhirëve kurejshit që të ndryshojnë mënyrën e investimit nga kultivimi i bagëtive që mbështetet në kujdesen për mbjellje. Pasi që natyra e mjedisit nuk lejon për këtë lloj shfrytëzimi, për ndryshim nga ambienti në Mekë që mbështetet në kultivimin e bagëtive e jo në bujqësi. Bujqësia në zonën medinase është më e dobishme e më fitimprurëse. Prandaj, duhet përdorë zëvendësimet e zgjedhjet kur të punojmë me burimet natyrore e të mos konsumojmë burimet prodhuese e të ruajmë ato me qëllim të shtimit të tyre ashtu siç na porositi hadithi i cili na ndalon që të therim delet pasi që me therjen e tyre ndeshemi me konsumim të një prej burimeve të disponueshme për plotësimin e nevojave të njerëzve. E tërë kjo vlen për çdo burim nga burimet e disponueshme të njeriut. Prandaj, obligohemi që të kujdesemi për zhvillimin e burimeve natyrore e shtimin e tyre përmes shfrytëzimit të mirë.

Ajo me të cilën na porosisin të gjitha hadithet e lartpërmendura është tregues i fortë për kujdesin e Islamit që të trajtojë aspektin që rezulton nga pamundësia e plotësimit të nevojave personale përmes trajtimit të shkaqeve të rrallësisë të lidhur me burimet natyrore.

Në dy artikujt e mëparshëm kemi diskutuar lidhjet e shpërndarjes me dy faktorët e prodhimit, faktorit punë e burimet natyrore dhe ndikimin e tyre në ekzistimin e problemit ekonomik, mënyrën se si Islami i ka trajtuar këta dy faktorë nga aspekti i rëndësisë së tyre relative në procesin e prodhimit dhe rolin e tyre në shfaqjen e problemit ekonomik.

Ndërsa në këtë artikull do të diskutojmë rolin e kapitalit duke qenë një prej faktorëve të prodhimit në procesin prodhues dhe rëndësinë e tij relative ndikuese në shfaqjen e problemit ekonomik.

Kuptimi ekonomik i kapitalit është: çdo pasuri që kursehet e përdoret për prodhimin e një pasurie tjetër. Dhe me këtë kuptim përfshinë shumë pasuri, madje duke përfshirë edhe pasuritë e harxhuara në prodhim si toka, mineralet, lëndet e para dhe mjetet e prodhimit si pajisjet, pronat industriale, bujqësore e tregtare. Kapitali ndahet në kapital fikse, i cili përdoret më shumë se një herë në prodhim dhe kapital të ndryshueshëm, i cili nuk përdoret se vetëm një herë siç janë farërat e lëndet e para.

Për formimin e kapitalit nevojiten tre elemente: burimet natyrore, puna dhe kursimi. Kursimi është i domosdoshëm për formimin e kapitalit, pasi që ndihmon në lëvizjen e faktorëve tjerë të prodhimit. Prandaj dallon nga grumbullimi (akumulimi), me të cilin kuptojmë ruajtjen e pasurisë duke mos menduar në investimin e saj.

Islami i ka dhënë kapitalit rol të rëndësishëm. Shumë prej porosive dhe praktikave të Muhamedit a.s. që janë bërë në kohën e tij e të sahabëve pas tij, konfirmojnë të vërtetën që kapitali ka rol të rëndësishëm në shfrytëzimin e faktorëve tjerë të prodhimit. Prandaj, sovraniteti i ndryshueshëm i shtetit islam merr drejtim të veçantë në lidhje me përdorimin e kapitalit në mobilizimin e ekonomisë dhe trajtimin e problemit ekonomik. Është transmetuar se Omerit r.a. kur i vinte dikush, nëse fara ishte e tij atëherë i takonte një pjesë, e nëse fara ishte e tyre atëherë atyre u takonte një pjesë". Kështu, Omeri r.a. me këtë politikë sistematike ka shpjeguar rolin e kapitalit në shfrytëzimin e dy faktorëve të prodhimit, faktorit punë dhe burimeve natyrore, dhe kapitalit në

dispozicion, qoftë përmes pjesëmarrjes së shtetit në dhënien e kapitalit të ndryshueshëm apo të kapitalit fikse.

Metoda të cilën e përdorë Islami gjatë trajtimit të kapitalit mbështetet në kritere e rregulla të cilat ndihmojnë që kapitali të ketë rol në trajtimin e problemit ekonomik nga aspekti i përdorimit të tij, duke pasqyruar që është prej mjeteve më të rëndësishme në shfrytëzimin e investimin e faktorëve tjerë të prodhimit. Dhe si rezultat i kësaj, zvogëlimin e ndikimeve negative të problemit ekonomik në produktin kombëtar duke arritur ekuilibrin në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave kombëtare.

Kriteret dhe rregullat mbi të cilat mbështetet Islami gjatë trajtimit të tij se si të përdoret kapitali, duke qenë faktorë prej faktorëve të prodhimit dhe mjet për trajtimin e problemit ekonomik paraqiten në pikat vijuese:

Së pari: Inkurajimi për kursim duke qenë një prej mënyrave të krijimit të kapitalit dhe një prej shkaqeve të mungesës së varfërisë. Është transmetuar se Muhamedi a.s. ka thënë: "Kush e mëson dike është shoqëruar në jetesën e tij". Me fjalën mësim në hadith është për qëllim mirëkuptimi dhe sjellja e mirë. Ndërsa shoqërimi në jetesë është për qëllim harxhimi dhe inkurajimi për kursim. Këtë hadith e mbështet ajo që transmetohet nga Muhamedi a.s. se ka thënë: "Sa i lartë është ai që kursen". Qëllimi me lartësi këtu është mosekzistimi i varfërisë për atë që kursen në shpenzimet e tij, nuk është koprrac e as nuk e tepron. Vetë veprimi i Muhamedi a.s. e konfirmon këtë. Transmetohet se Muhammedi a.s. i shiste hurme fisit beni Nadhir dhe për familjen e tij blinte ushqim që i mjaftonte për një kohë". Ky veprim i Muhamedi a.s. është porosi për tërë umetin që të kursejmë, të kemi pasqyruar ditët e ardhshme dhe mos të grumbullojmë nga ajo që tepron prej nevojave të prodhimit, pasi që kjo ndihmon në ekzistimin e të mirave në tregje.

Së dyti: Interesimi për ruajtjen e kapitalit të patundshëm, jetëgjatësinë prodhuese të tij dhe shmangien e mënyrave të dëmshme të konsumimit, të cilat do të ndikojnë në zvogëlimin e jetëgjatësisë së tij prodhuese. Kapitali i patundshëm është kapitali fikse i prodhuesit, i cili

paraqet mjetin që i vënë në lëvizje faktorët tjerë të prodhimit. Prandaj, Islami i jep rëndësi interesimit për kapitalin e patundshëm. Është transmetuar se gota e Muhamedit a.s. është thyer dhe janë shpërndarë pjesët e thyera. A'simi thotë: e kam parë gotën dhe kam pirë në të". Ky hadith na jep porosi të qartë për domosdoshmërinë e interesimit e përkujdesjen për kapitalin prodhues dhe të përdoret me qëllim të përfitimit sa më të gjatë prej tij. Prandaj, mund të krahasojmë mjetet e pajisjet e përbëra nga kapitali fiks me gotën duke bërë përpjekje për mirëmbajtjen e tyre, për shtimin e jetëgjatësisë së tyre prodhuese dhe që të mos përdorim ato mbi fuqinë e tyre prodhuese në mënyrë që të mos vjen te prishja apo shkatërrimi para se të përfundojë jetëgjatësia e tyre.

Së treti: Konsiderimin e kapitalit fiks si shtyllën themelore për formimin e kapitalit shoqëror, dhe si rezultat i kësaj mbajtjen e tij dhe mos abuzimit me të. Në rast të shitjes së kapitalit fiks duhet bërë zëvendësimi i tij me kapital fiks prodhues tjetër, me qëllim të zgjerimit të bazës së kapitalit të patundshëm. Rëndësia relative për ruajtjen e kapitalit të patundshëm fshihet në konfrontimin e mungesës në vlerat reale të kapitaleve monetare dhe kundërshtimi i idesë së investimit në aktivet monetare si blerja e aksioneve e obligacioneve qeveritare, obligacioneve për huadhënie me qëllim të tregtimit me këto, pasi që këto aktive nuk janë aktive prodhuese. Prandaj prej problemeve me të cilat ndeshen shtetet islame të cilat investojnë kamatat monetare në letrat me vlerë përmes tregtimit në tregjet monetare botërore është mungesa në vlerat reale të këtyre pasurive si rezultat i inflacionit monetar. Prandaj, porosia profetike për kujdesin ndaj kapitalit të patundshëm duke qenë shtylla kryesore në formimin e kapitalit dhe konfrontimin e mungesës në vlerat reale të monedhave konsiderohet si ilaç për shumë prej problemeve ekonomike me të cilat përballen sot shoqëritë islame bashkëkohore. Kështu na porosit edhe hadithi vijues. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Kush shet shtëpi duke mos e vendos çmimin sipas vlerës që i takon nuk do të bekohet në të".

Ky hadith i drejtohet umetit islam me domosdoshmërinë e përqendrimit në formimin e kapitalit fiks dhe mos abuzimin me të apo mos

ndryshimin e tij vetëm se me të. Do të thotë dhënies rëndësi për kapitalin fiks duke qenë baza mbi të cilën bazohet puna me faktorët tjerë të prodhimit dhe shtimi i produktit kombëtar.

Së katërti: Dhënia e rëndësisë për zëvendësimin dhe rifreskimin e kapitalit fiks. Do të thotë puna për vazhdimësinë e kapitalit fiks të prodhuesit duke i zëvendësuar aktivet e përhershme e të mirat me aktivet e konsumuara dhe përqendrimi i vëmendjes në përkujdesjen për fuqinë absorbuese të kapitalit prodhues në mënyrë që zgjerimi i kapitalit prodhues të mos shpie deri te vështirësimi i procesit prodhues duke u ndikuar apo duke u zvogëluar. Për këtë koncept na porosit hadithi që transmetohet nga një prej sahabëve: isha përfaqësues i fisit beni Muntefik... pastaj vazhdon: ishim ulur me Muhamedin a.s., kur bariu futi delet në stallën e tij dhe me vete kishte qengj. I tha: çka dëshiron të na presh o filan? Tha: qengj. Tha: Shko e në vend të tij na prej një dele. Pastaj vazhdoi: Mos mendoni se për shkak teje e kam prerë. Kur bariut i pjell qengji në vend të tij therim dele".

Nga ky hadith kuptojmë dy gjëra:

Së pari: zëvendësimin e aktivitetit të vjetër me aktiv të ri. Prandaj deleje e cila theret ka zënë vendin e qengjit të vogël, pasi që ky do të prodhojë, ndërsa deleje e therur zakonisht është prej tufës që ka filluar prodhimi i saj të zvogëlohet.

Së dyti: hadithi ka treguar që fuqia absorbuese e stallës dhe fuqia e bariut për të ruajtur tufën janë dikund 100 copë dele. Përndryshe shtimi mbi këtë numër është dobësim i fuqisë prodhuese të faktorëve të prodhimit, të vendit e të fuqisë punëtore (bariut). Nga kjo porosi profetike kuptojmë domosdoshmërinë e vendosjes së rregullave e procedurave, të cilat duhet t'i ndjekin pronarët e kapitalit fiks me tërë përbërjen e tyre dhe obligimin e udhëheqësit të shtetit mysliman të mbikëqyrë e të përcjell zbatimin e këtyre procedurave pasi që në tërë këtë ka interes e tërë shoqëria.

Në artikullin e kaluar kemi diskutuar çështjen e shpërndarjes së faktorëve të prodhimit. Saktësisht, faktorin punë duke marrë parasysh se është prej faktorëve më të rëndësishëm të prodhimit që ndikon në *ekzistencën* e problemit ekonomik dhe mënyrën se si Islami e trajton këtë faktor nga aspekti i rëndësisë së tij relative në procesin e prodhimit. Ndërsa në këtë numër do të diskutojmë faktorin e burimeve natyrore duke marrë parasysh se është prej faktorëve të prodhimit, lidhjen e këtij burimi me shpërndarjen e të ardhurave publike, ndikimin e tij në paraqitjen e problemit ekonomik dhe trajtimin e këtij faktori nga aspekti Islam.

Me burime natyrore, sipas konceptit ekonomik kuptohet çdo gjë që gjendet mbi sipërfaqe të tokës si toka, detënat e lumenjtë, atë që është sipër saj si drita e erërat dhe çdo gjë që gjendet në thellësi të saj si pasuritë minerale. Ky faktor prodhimi është fusha e shfrytëzimit, në të cilën njeriu praktikon rolin e tij përmes punës për të përfituar nga ajo që All-llahu xh.sh. ka depozituar në tokë e qiej nga të mirat për të plotësuar nevojat e njerëzve.

Burimet natyrore dhe ekonomia

Lidhja e burimeve natyrore me problemin ekonomik paraqitet në mundësinë e përfitimit nga të mirat e tokës dhe hulumtimin e faktorëve tjerë të prodhimit për shfrytëzimin e këtyre burimeve. Mos shfrytëzimi i burimeve natyrore në dispozicion në mënyrë ekonomike të duhur që realizon të mirën publike dhe lehtësimin e nevojave të individëve ndihmon në paraqitjen e problemit ekonomik. Neglizhenca ndaj burimeve natyrore dhe mosshfrytëzimi i tyre do të shpie në mos përdorimin e faktorëve tjerë të prodhimit që do të ndikon në keqësimin e problemit ekonomik. Si dhe mënyra e shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe mos ekuilibrimi gjatë shfrytëzimit do të shpie në konsumimin e burimeve apo humbjen e tyre dhe si rezultat i kësaj do të vjen deri te keqësimi i problemit ekonomik.

Kriteret e rregullat:

Islami ka vendos kriteret dhe ka shpjeguar mënyrat e shfrytëzimit të burimeve natyrore në mënyrën që do t'i shërbejë ekonomive të shoqërisë, të arrin ekuilibrin në shfrytëzimin e burimeve natyrore, të eliminon e të largon mënyrat që ndikojnë në humbjen e burimeve duke zvogëluar ndikimin e faktorëve të burimeve natyrore në keqësimin e problemit ekonomik.

Kriteret me të cilat Islami ka trajtuar faktorin e burimeve natyrore bazohen në pikëpamjen e tij, që çdo gjë që është në qiej e tokë, All-llahu xh.sh. e ka vënë në interes të njeriut e jetesës së tij dhe që njeriu duhet të bënë përpjekje për të përfituar nga ajo që All-llahu xh.sh. u ka dhënë nga burimet për të plotësuar nevojat materiale të njeriut. Rregullat të cilat urdhëron Islami që të përvetësohen gjatë trajtimit të faktorit të burimeve natyrore mund të përcaktohen në çështjet vijuese:

Së pari: Nxitja për shfrytëzimin e burimeve natyrore të pashfrytëzuara duke i porositur udhëheqësit myslimanë që të ndërhyjnë në vendosjen e kriterëve e rregullave, që do të ndihmojnë në shfrytëzimin e këtyre burimeve të pashfrytëzuara. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Kush e gjen ndonjë kafshë të cilën pronarët e saj nuk mund ta ushqejnë dhe e lënë të lirë, e merr dhe e ushqen, atëherë ajo është e tij"*. Ky hadith, na porosit që të mos lëmë burimet e pashfrytëzuara pa i përdor dhe se shoqërisë myslimane i takon e drejta që të ndërhyjë në shfrytëzimin e këtyre burimeve të pashfrytëzuara edhe nëse janë pronë individuale. Sipas këtij hadithi shteti islam mund të vendos rregullat procedurale për ndërtesat industriale, apo pronat bujqësore apo pajimet tjera fikse prodhuese në rast të pamundësisë së pronarëve të tyre që t'i shfrytëzojnë, pasi që kjo gjë do të ndikojë në zvogëlimin e keqësimit të problemit ekonomik e atë përmes vazhdimin të prodhimit e shfrytëzimit të fuqisë punëtore në këto projekte. Mund të themi që realiteti i problemit ekonomik në botën islame qëndron në pamundësinë e shteteve në realizimin e rolit të tyre në shfrytëzimin e burimeve natyrore. Përkundrazi, humbja e burimeve natyrore është tipari më i spikatur në praktikat ekonomike të shumicës së shteteve islame.

Së dyti: Dhënia e koncesionit nëse gjenden lidhje mes burimeve natyrore dhe paraqitet nevoja e njerëzve për një grup të shoqërisë në llogari të grupeve tjera. Burimet natyrore për të cilat kanë nevojë njerëzit nuk i takon askujt zotërimi i tyre dhe nuk i takon shtetit që t'i jep të drejtën e koncesionit ndonjë individ apo grupi, e si rezultat i kësaj monopolizimit e dobive të tyre. Zotërimi i ndonjë burimi natyror, për të cilin kanë nevojë njerëzit dhe vendosja e tij në duar të ndonjë grupi të caktuar të njerëzve janë prej shkaqeve të ekzistimit të problemit ekonomik, qoftë përmes mos përfitimit nga ky burim apo përmes monopolizimit e privimit të grupeve të njerëzve nga përfitimi prej tij për shkak të pamundësisë së tyre që të paguajnë çmimin e kërkuar në këmbim të drejtës së koncesionit. Por, e drejta e dhënies së këtij koncesioni është kompetencë e udhëheqësit të myslimanëve në rast mungese të burimit natyror në mënyrë që të mundësohet shfrytëzimi i tij apo që burimi natyror me natyrshmërinë e tij në të cilën është krijuar nga All-lahu xh.sh. ka nevojë për përpjekje dhe pasuri për të përfituar nga ai. Ndërsa ndalimi i koncesionit i kthehet burimeve natyrore të dukshme prej të cilave mund të përfitojnë të gjithë njerëzit si kripa apo gjelbërimi apo dheu apo rëra si dhe gjërat tjera të dukshme që gjenden në tokë, prej të cilave mund të përfitojnë njerëzit drejtpërdrejtë. Është transmetuar se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Myslimanët janë ortak në ujë, gjelbërim e zjarr dhe çmimi i tyre është i ndaluar"*. Ndërsa në një transmetim tjetër Muhamedi a.s. thotë: *"Tri gjëra nuk ndalohen: uji, gjelbërimi dhe zjarri"*. Nga përmbledhja e këtyre haditheve kuptojmë kujdesin për nevojat e njerëzve të dukshme, për burimet natyrore dhe që nevojat e përgjithshme për burimin natyror e ndalon udhëheqësin e myslimanëve nga dhënia e koncesionit për çdo grup shoqëror që kjo të mos shpie te monopolizimi i tij, dëmton njerëzit dhe ndikon në ofertën e kësaj materie, e cila përfitohet nga marrja e saj drejtpërdrejtë nga burimi natyror. Dhënia e të drejtës së koncesionit për shfrytëzimin e saj nga një grup i njerëzve apo nga një individ apo grup individësh do të ndikon në zvogëlimin e ofertës, rritjen e çmimit të saj dhe pamundësinë e njerëzve për të zotëruar atë me gjithë nevojën e tyre të

ngutshme për të dhe blerjen e saj nga grupi monopolist që i është dhënë kjo e drejtë.

Së treti: Ndërhyrja e drejtpërdrejtë e shtetit për shfrytëzimin e burimeve natyrore të pa shfrytëzuara sipas planeve prodhuese investuese, të cilat i vendos udhëheqësi mysliman sipas kushteve e të dhënave në dispozicion, e në një mënyrë që i shtyn pjesëtarët e shoqërisë të shfrytëzojnë këto burime natyrore të pa shfrytëzuara. Islami i nxit njerëzit të punojnë në shfrytëzimin e kursimeve të tyre, dhe si rezultat i kësaj të japin kontributin e tyre në zgjidhjen e problemit ekonomik përmes gjetjes së kapitalit të veçantë nga ana e shtetit për shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe ofrimin e kushteve për fuqinë punëtore që të kontribuojë në shfrytëzimin e këtyre burimeve. Transmetohet se Ebi Xhaferi ka thënë: "Nuk ka asnjë familje muhaxher në Medinë që nuk ka mbjell në këmbim të një të tretës e një të katërtës. Kështu ka vepruar Aliu, Sa'd bin Malik, Abdullah bin Mes'ud, Omer ibn Abdul Azizi, Kasimi si dhe familja e Ebu Bekrit, familja e Omerit, familja e Aliut e familja e ibn Sirinit. Ndërsa Omeri r.a., nëse fara ishte e tij, atëherë i takonte një pjesë, e nëse fara ishte e tyre atëherë atyre u takonte një pjesë". Nga kjo kuptojmë politikën e shpërndarjes së faktorëve të prodhimit, e cila mbështetet në shtyrjen e faktorëve tjerë të prodhimit për arritjen e ekuilibrit ndërmjet faktorëve të ndryshëm të prodhimit dhe shpërndarjen e të ardhurave kombëtare për këto burime për trajtimin e aspektit të prodhimit në problemin ekonomik.

Së katërti: Shfrytëzimin e burimeve natyrore përmes ndërhyrjes së udhëheqësit të myslimanëve në rishpërndarjen e tepricës së shfrytëzimit përmes vendosjes së sistemeve të veçanta e kriterëve rregulluese, të cilat ndihmojnë në përfitimin nga komponentët e produktit kombëtar duke marrë parasysh të drejtat e pronës individuale. Kjo arrihet duke ndërhyrë për realizimin e interesit publik duke rritur produktin kombëtar dhe zvogëlimin e ndikimit të faktorëve të lidhur me burimet natyrore ndikuese në ekzistimin e problemit ekonomik e keqësimin e tij. Muhamedi a.s. i ka shpjeguar mënyrat se si të arrihet kjo përmes porosisë profetike për umetin islam. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: *"Mos e ndaloni mirësinë e ujit pasi që me këtë do*

të ndaloni gjelbërimin". Ndërsa në një transmetim tjetër: "Askush mos të ndalojë mirësinë e ujit pasi që me këtë ndalon gjelbërimin". Ndërsa në një hadith tjetër ka ndaluar nga shitja e mirësisë së ujit. Nga këto hadithe të lartpërmendura mund të kuptojmë porosinë profetike për mënyrën e përfitimit në rast të mos gjetjes së ujit. Prandaj në rast se dikush posedon një pus të mbushur me ujë, atëherë atij i duhet që të lejojë të tjerët të përdorin këtë pus, nëse i plotëson nevojat e tij në mënyrë që të përfitohet nga ai për ujitje në pjesët e afërta me pusin. Ashtu siç kuptohet që në rast se gjendet ujë që tepron për nevojat e pronarit të pusit, që t'i lejojë të tjerët që nuk kanë ujë të përdorin pjesë shtesë të ujit për bujqësi. Pronarët e tokave të afërta mund të shfrytëzojnë atë por duke pas parasysh që të mos dëmtojnë pronarin e pusit. Kjo vlen në rast të prishjes së mjeteve për bartjen e ujit të ndonjë bujku që do të ketë nevojë për pjesën shtesë të ujit të fqinjit të tij në mënyrë që të mos humb prodhimin e tij. Këtë mund ta krahasojmë në rastet kur lidhet me mos shfrytëzimin e ndonjë burimi natyror dhe mundësinë e shfrytëzimit të këtyre burimeve qoftë edhe me ndërhyrje në rregullimin shtesë të burimeve natyrore.

Në dy artikujt e mëparshëm kemi diskutuar për një aspekt prej aspekteve të problemit ekonomik e që është aspekti i rrallësisë së burimeve natyrore dhe kemi shpjeguar mënyrën se si Islami e trajton këtë problem. Ndërsa në këtë artikull do të diskutojmë aspektin e dytë të problemit ekonomik që paraqitet në mënyrën e llojin e shpërndarjes së faktorëve të prodhimit ndaj pjesëtarëve të shoqërisë, do të thotë caktimin e burimeve të të ardhurave personale, kriteret për fitimin e shpërndarjen e tyre dhe pjesëmarrjen e çdo faktori të prodhimit në të ardhura.

Zgjidhja e problemit ekonomik lidhet me parimin përmes të cilit caktohen të hyrat më të mira për shpenzimet e harxhuara për faktorët e prodhimit dhe nivelin e ndikimit të kësaj ndaj ofertës së mjeteve të prodhimit. Prandaj, problemi ekonomik lidhet me mënyrën e progra-

min përmes të cilëve trajtohet shpërndarja e shpenzimet për faktorët e ndryshëm të prodhimit.

Koncepti i teorisë së shpërndarjes:

Teoria e shpërndarjes sipas kuptimit ekonomik cakton nivelin e shpenzimeve për faktorë të ndryshëm të prodhimit. Prandaj, teoria e shpërndarjes përmes kuptimit ekonomik bashkëkohor i kushton interes të veçantë mënyrës së arritjes së të hyrave më të mira për shpenzimet e harxhuara për faktorët e prodhimit, që me rolin e tij ndikon në ofertën e mjeteve prodhuese.

Konceptet dogmatike e organizative ndërhyjnë në caktimin e vështirimit të sistemit ekonomik për marrëdhëniet ndikuese të faktorëve të prodhimit në krijimin e teorisë së shpërndarjes në aplikimin praktik. Prej koncepteve të tilla që kanë ndikim në dallimin mes sistemeve të ndryshme ekonomike është mënyra e shpërndarjes së prodhimit neto të të ardhurave mes faktorëve të ndryshëm të prodhimit.

Kriteret e rregullat të cilat vendosen përmes sistemeve ekonomike kanë ndikim në lëvizjen e faktorëve të prodhimit. Për shembull pikëpamja të cilën e përvetëson sistemi ekonomik ndaj faktorit punë dhe roli i tij në procesin e prodhimit dhe mënyrat e përdorura në nxitjen e tij e kështu edhe të faktorëve tjerë të prodhimit, përcaktojnë dallimin dhe ndryshimin mes sistemeve të ndryshme ekonomike në lidhje me shpërndarjen e prodhimit kombëtar për faktorë të ndryshëm të prodhimit.

Aspektet më të rëndësishme të problemit ekonomik paraqiten në mënyrat të cilat i përvetëson teoria e shpërndarjes për totalin e produkteve neto të të ardhurave të paraqitura në sasinë e të ardhurave personale (apo pjesës së tij) të cilën e fiton duke pas parasysh pjesëmarrjen e tij në prodhim, qoftë me punën e tij apo pronësinë e tij apo me të dyja së bashku. Këto mënyra të cilat i ndjek sistemi ekonomik i çdo shoqërie ndikohen me filozofinë që sistemi ekonomik synon të rrënjos kuptimet e tij në lidhje me pikëpamjen për çdo faktorë prej faktorëve të prodhimit.

Synohet me konceptin e shpërndarjes përmes pikëpamjes ekonomike procesi i përcaktimit të pjesëve të faktorëve të prodhimit në të ardhurat e shoqërisë, e të cilat përfshijnë dy aspekte:

- 1 - Shpërndarjen personale apo shpërndarjen e pronësisë së faktorëve të prodhimit për pjesëtarët e shoqërisë.
- 2 - Shpërndarjen në bazë të punës. Qëllimi i kësaj është përcaktimi i pjesëve të faktorëve të prodhimit në të ardhurat kombëtare në bazë të punës që e kryen çdo faktorë në realizimin e këtyre të ardhurave.

Problemi ekonomik në aspektin e tij të shpërndarjes bazohet në përcaktimin e burimeve të të ardhurave personale. Sistemi kapitalist që është bërë sistemi dominues pas rënies së sistemit komunist përcakton burimin e të ardhurave përmes punës dhe nga të hyrat e pronësisë, megjithë mangësitë e sistemit kapitalist në vendosjen e rregullave të caktuara për fitimin e pronësisë apo shpërndarjes së tyre që ka shpjer në keq shpërndarjen e pronësisë mes pjesëtarëve të shoqërisë që me rolin e tij ka shpjer në keq shpërndarjen e të ardhurave mes tyre në lidhje me shpërndarjen personale. Ndërsa shpërndarja që ka rezultuar nga pjesëmarrja e faktorëve të prodhimit (apo shpërndarja në bazë të punës), sistemi kapitalist e kufizon këtë shpërndarje në fitimin nga toka, rroga nga puna, interesi nga kapitali dhe fitimi për menaxhim apo administrim.

Ndërsa sistemi komunist e anulon pronën personale të faktorëve të prodhimit plotësisht apo e kufizon në një shkallë të madhe. Prandaj shpërndarja kryhet në bazë të punës dhe sipas planit ekonomik të cilin e vendos shteti, dhe me këtë bie në kundërshtim me sistemin kapitalist. Praktika e ka sqaruar pamundësinë e këtij sistemi për të zgjidhur problemin ekonomik, por madje ka ndikuar në keqësimin e tij dhe pamundësinë për të realizuar ëndrrat me të cilat i ka përgëzuar ndjekësit e pasuesit e tij. Ndërsa sa i përket sistemit kapitalist, teoritë e tij kanë filluar të dështojnë dhe aspektet e problemit ekonomik kanë filluar të keqësohen që paralajmëron për rënien e afërme të sistemit kapitalist të bazuar në kamatë. Dhe kjo do të shpie në një katastrofë botërore, pasojat e së cilës nuk i din askush tjetër përveç All-llahut xh.sh. Pjesët

e problemit ekonomik janë zgjeruar, zhvilluar dhe janë ndarë, gjë që i ka shty teoricienët e sistemit ekonomik kapitalist t'i kushtojnë rëndësi këtyre pjesëve dhe të punojnë që t'i shmangin dëmet që i bashkëngjiten pjesëve tjera të problemit ekonomik.

Teorinë islame në lidhje me aspektin e shpërndarjes nuk e ka përvetësuar askush në realitetin e aplikimit. Prandaj, tezat që do të paraqiten në lidhje me trajtimin e problemit ekonomik në aspektin e saj të shpërndarjes, do të mbështeten në supozimin që këto teza bazohen në faktin që ekziston integritet në pikëpamje të administrimit të ekonomisë së shtetit dhe i cili lidhet me sistemet tjera shoqërore të mbetura të marra nga sheriatu islam apo që këto teza nuk mund të kenë rol në trajtimin e këtij aspekti të problemit ekonomik nëse izolohehen nga mjedis i saj rrethues. Qëllimi i paraqitjes së këtyre tezave për trajtimin e aspektit të shpërndarjes nga këndvështrimi islam gjatë trajtimit të problemit ekonomik është prezantimi që Islami posedon mënyrën e programin, që nëse punojmë me të e së bashku edhe me sistemet tjera të Islamit, të zgjidhim tërë atë që vuan njeriu në kohën bashkëkohore prej problemeve ekonomike që rezultojnë nga devijimi prej natyrshmërisë së All-llahut xh.sh. në të cilën i ka krijuar njerëzit.

Lidhjet mes faktorëve të prodhimit dhe shpërndarjes së të ardhurave kombëtare janë lidhje reciproke e ngërthyese. Dhe këto lidhje përqendrohen në përcaktimin e faktorëve të pronësisë e burimeve të tyre dhe mënyrën të cilën duhet ndjekur gjatë shpërndarjes së të ardhurave kombëtare mbi faktorët e prodhimit. Prej burimeve të paraqitjes së problemit ekonomik në çfarëdo sistemi ekonomik ekzistojnë kufijtë, sisteme dhe burime të pronësisë dhe mënyra e realizimit të ekuilibrit mes faktorëve të ndryshëm të prodhimit në ndarjen e pjesës së të ardhurave kombëtare dhe kjo ndikohet nga rregullat, sistemet dhe legjislacionet të cilat përcaktojnë burimet e të ardhurave dhe mënyrat e fitimit, nivelin e fushën e përdorimit të tepicës së kursyer nga fitimi.

Çështjet më të rëndësishme të cilat preokupojnë ekonomistët është mënyra e trajtimit të mos ekuilibrit në specifikimin dhe shpërndarjen e të ardhurave për faktorë të ndryshëm të prodhimit.

Islami ka koncept të caktuar dhe sistem të veçantë që caktojnë mënyrat e fitimit dhe fushën e tij. Gjithashtu trajton mënyrën e shpenzimit duke nxitur për kursim dhe investim, duke e ruajtur ekuilibrin e shoqërisë.

"...që ajo të mos ndahet ndërmjet pasanikëve tuaj...". (el-Hashr: 7)

Islami insiston në arritjen e ekuilibrit mes faktorëve të ndryshëm të prodhimit duke ndërhyrë në rast domosdoshmërie me vendosjen e rregullave me të cilat udhëhiqet. Faktorët e prodhimit të cilat i pranon Islami dhe punon në arritjen e ekuilibrit mes tyre janë tre faktorë themelorë: puna, burimet natyrore dhe kapitali, ndërsa faktori i menaxhimit apo administrimit konsiderohet prej faktorit punë. Islami i jep rëndësi të veçantë punës, pasi që ka rol të dalluar në procesin prodhues. Ai është faktor ndikues në formimin e kapitalit, por nuk neglizhohet roli i kapitalit në pjesëmarrjen në procesin prodhues.

Prishja e ekuilibrit të faktorëve të prodhimit kontribuon në ekzistimin e problemit ekonomik. Prandaj, Islami ka vendos rregulla për ndalimin e këtij dallimi mes faktorëve të prodhimit. Në vazhdim do të diskutojmë mënyrën se si Islami i trajton çdo faktorë prej faktorëve të prodhimit në lidhje me trajtimin e shpërndarjes së të hyrave kombëtare. Këtë do ta pasojë paraqitja e trajtimit të përgjithshëm për arritjen e ekuilibrit mes faktorëve të ndryshëm të prodhimit sipas sistemit ekonomik islam.

Islami faktorin punë e konsideron si kriterin themelor në pronësi. Ai është dominues dhe ndikues në caktimin e shpenzimeve të prodhimit, pasi që prodhimi i të mirave apo ofrimi i shërbimeve është i lidhur me punën e bërë, nëse kjo fuqi manifestohet në përpjekjen mendore apo trupore. Prodhimi i të mirave apo ofrimi i shërbimeve nuk arrihet vetëm se me fuqinë e punës. Dhe me këtë Islami e njeh rolin e punës në procesin prodhues.

Transmetohet se Muhamedi a.s. është pyetur për fitimin më të mirë. Dhe ka thënë: "Shitja e pranuar dhe puna (fitimi) e njeriut nga dora e vet". Ndërsa në një transmetim tjetër është pyetur Muhamedi a.s.: "Cili është fitimi më i mirë?" Muhamedi a.s. thotë: "Puna (fitimi) i njeriut nga dora e tij dhe çdo shitje e pranuar".

Nga këto hadithe dhe të tjera kuptojmë që Islami i jep rëndësi punës në procesin e prodhimit dhe se puna është mënyra më e mirë e fitimit, për shkak të rëndësisë që ka në aktivitetin ekonomik dhe ndikimit të tij në ciklin ekonomik. Në paraqitjen e problemeve ekonomike, Islami ka synuar trajtimin e problemeve në të cilat mund të ndikojë puna. Nga trajtimet e tilla, Islami i ka dhënë rëndësi vendosjes së zgjidhjeve të tyre dhe ka porositur që çështjet vijuese të merren parasysh:

1 - Vendosja e parimeve për caktimin e rrogave

Gjatë vendosjes së politikës së rrogave duhet vendosur parime për caktimin e rrogave në shoqëri. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Kush ka punëtor le të merr punëtor, e nëse nuk ka shërbëtor le të merr shërbëtor, e nëse nuk ka shtëpi le të merr shtëpi". Ky hadith vendos rregull të përgjithshme për politikën e rrogave dhe pjesën e punës nga të hyrat publike. Kjo rregull manifestohet në faktin që duhet të ketë minimum të rrogave, duke mos lejuar që të jepet më pak se ajo. Dhe ky minimum është i lidhur me mjaftueshmërinë në arritjen e domosdoshmërive themelore. Prandaj, problemet të cilat ndikojnë në rëndimin e problemit ekonomik janë zvogëlimi i rrogave dhe dobësimi i pjesës së tyre nga të hyrat publike, pasi që dobësimi i tyre do të ndikojë në shpenzime. E tërë kjo do të ndikojë në ciklin prodhues.

2 - Domosdoshmëria e caktimit të rrogave dhe pagesa e tyre me realizimin e punës

Kjo rregull ndihmon në gjetjen e tregut të stabilizuar të punës dhe ndalimin e çrregullimeve të punëtorëve që është tipari dallues në shoqëritë kapitaliste. Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Nëse dikush prej jush merr një punëtor, atëherë le t'ia bën me dije rrogën e tij". Gjithashtu transmetohet se Muhamedi a.s. ka ndaluar që të merret punëtori deri sa t'ia sqarojë rrogën e tij dhe ka ngalur nga ngacmimi, prekja e hedhja e gurit". Transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Jepjani punëtorit rrogën e tij para se t'i thahen djersët dhe tregoni rrogën e tij derisa është në punë". Të gjitha këto hadithe profetike na porosisin për pagimin e asaj që i takon punëtorit në kohën e duhur dhe

domosdoshmërinë e caktimit të rrogës, duke synuar me këtë krijimin e marrëdhënieve të reja mes punëdhënësve e punëtorëve, e me këtë stabilizimin e tregut të punës.

3 - Përpjekja për stabilizimin e tregut të punës

Dhe atë duke punuar për vendosjen e parimit të stabilitetit dhe mbetjen e punëtorit në punën e tij dhe mos transferimin e tij në ndonjë punë tjetër. Çrregullimi i tregut të punës dhe mos vazhdimësia e punëtorëve në çdo aktivitet ekonomik do të ndikojë në shpenzimet e produktit për shkak të kurbës së ofertës punëtore, që do të ndikojë në ndodhjen e çrregullimit në tregun e punës. Prandaj Islami synon nxitjen e stabilitetit të punëtorëve dhe mos transferimin e tyre. Transmetohet nga Nafi'e: Udhëtoja për në Sham e Egjipt. Dhe u përgatita njëherë për t'u nisur në Irak. Shkova te nëna e besimtarëve, Aisheja r.a. dhe i thashë: Oj nëna e besimtarëve, udhëtoja për në Sham, por kësaj here u përgatita të shkoja në Irak. Dhe më tha: Mos e bën këtë sepse kam dëgjuar Muhamedin a.s. duke thënë: "Kur ndokujt prej jush All-llahu xh.sh. ju sjell furnizim nga një anë, mos t'a len derisa të ndryshon apo të largohet". Transmetohet gjithashtu se Muhammedi a.s. ka thënë: "Nëse ndokujt i ndodh ndonjë gjë, atëherë le t'i përmbahet asaj". Të gjitha këto porosi profetike tregojnë interesimin për domosdoshmërinë e punës në stabilizimin e punëtorëve e mbetjen e tyre apo punën për të ruajtur ekuilibrin e ofertës dhe kërkesës të fuqisë punëtore.

4 - Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve

Strategjia e organizimit të punës ashtu siç na porosisin urdhrat islame, bazohet në ruajtjen e të drejtave të punëtorëve dhe obligimin e punëdhënësve për të siguruar kushtet e përshtatshme të ambientit, mos shfrytëzimin e fuqisë punëtore mbi fuqinë e tij dhe domosdoshmërinë e mjaftueshmërisë së rrogës për të realizuar nevojat e tij themelore. Shumë prej haditheve na kanë porositur që të kemi parasysh këtë dhe të punojmë me këtë. Ebu Hurejrja r.a. transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: "Robit duhet siguruar ushqimin e veshjen e tij dhe nuk duhet të

ngarkohet me punë që nuk mund të përballojë". Gjithashtu transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "All-llahu xh.sh. vëllezërit tuaj i ka lënë nën kujdesin tuaj. Nëse vëllai juaj është nën kujdesin tuaj le ta ushqen nga ajo që han, le ta vesh nga ajo që vesh dhe mos ta ngarkojë mbi fuqinë e tij. E nëse e ngarkon mbi fuqinë e tij atëherë le ta ndihmon".

Nga këto hadithe mund të vendosim politikë të përgjithshme për marrëdhëniet mes punëdhënësve dhe punëtorëve, që paraqitet në dhënien punëtorëve rroga të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të tyre, duke vendosur kritere të cilat ndalojnë punëdhënësit të ngarkojnë punëtorët mbi fuqinë e tyre, duke obliguar punëdhënësin për përgatitjen e kushteve, të cilat nuk do të shpijnë në lodhjen e punëtorit fizikisht e psikikisht. Në të gjitha këto çështje interesi i punëtorit nuk duhet të fitojë mbi interesin e punëdhënësit, e as interesi i punëdhënësit mbi interesin e punëtorit, por duhet që kur të vendosim politikat e punëtorëve të marrim parasysh konceptin që të gjithë jemi vëllezër që na lidh lidhja e besimit.

Përktheu nga arabishtja:

Fuad Morina

Marrë nga revista "El-Bejan" nr 77- 81.

Muhamed Abdullah el-Shebani

ECONOMIC PROBLEMS AND THE ISLAMIC POINT OF VIEW REGARDING THEM

(Summary)

Economic problems are in the focus of interest of experts and states. Economic problems affect our lives and the history of mankind. The message of Shu'aib (PBH) confirms the importance of economic reforms and their relation to faith. Allah the Almighty has revealed to us the story of Shu'aib and his people (in order to present the most important aspects of economic problems).

محمد عبد الله الشيباني

المشاكل الاقتصادية و معا لمجتها من المنظار الاسلامي

(خلاصة البحث)

المشاكل الاقتصادية تعتبر المحور المهم الذي يهتم به خبراء الاقتصاد و كذلك هو بمثل العمود الفقري لاية دولة معاصرة. و ذلك لان المشكلة الاقتصادية تتعلق بوجود الانسان على سطح الارض و من العناصر المؤثرة في مسيرة الانسانية. و هذا يبدو جليا حتى أن أحد الانبياء و هو النبي شعيب عليه السلام و دعوته اعتمدت على التحول الاقتصادي فيما يختص بضمان الجانب الدعوى.

VËSHTRIM

Emine A. Vezaj

TË SHKRUASH HISTORINË ME AVERSION

“Një person i krisur dhe inteligjent mund t’i bëjë gjërat më të dhunshme. Nevojitet një dorë e gjeniut dhe shumë guxim për t’i lëvizur gjërat në drejtim të kundërt”

Ernst Friedrich Schumacher

Në një fushë propagandistike parimi se “secili” është i pafajshëm përderisa nuk dëshmohet e kundërta” është i pafuqishëm para formulës së njohur goebbelsiane: “Një gënjeshtër e madhe që përsëritet shpesh, në fund besohet si e vërtetë”. Si duket historitë përsëriten dhe këtë denjësisht e ka thënë edhe Ibn Halduni qysh në shekullin XIV. Gjithsesi, se kjo ndodh në dy raste, ose atëherë kur njeriu nuk e shikon të kaluarën detyrohet ta përsërisë atë, ose kur ka lakmi nga e kaluara.

Më katërmëdhjetë prill 2009, në Hotelin Grand në Prishtinë, kishte filluar Simpoziumi Ndërkombëtar “Kosova dhe Perandoria Osmane në dokumentet arkivore”, me moton “Ta shkruash historinë me tolerancë”. Ky simpozium ishte organizuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës dhe Agjencia Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar “TIKA”. Meqenëse Arkivat shumë herë shërbejnë edhe si urë lidhëse për një komunikim miqësor mes dy shteteve, dhe

se dokumentet arkivore janë thesare të vetme të memories njerëzore edhe ky simpozium krijoi një rast të volitshëm madje edhe të mirëseardhur për të nxjerrë në pah atë “miqësi” që i ka karakterizuar këta dy popuj të cilët për një kohë të gjatë patën “bashkëpunuar” madje më shpesh të acaruar. Në ditën e dytë të këtij simpoziumi historianët patën rastin të shpalosin referimet mbi të dhënat arkivore rreth marrëdhënieve të Perandorisë Osmane me popujt tjerë të Ballkanit. Njëri ndër referuesit më të spikatur të këtij simpoziumi ishte edhe Kristaq Prifti, i cili në një farë forme solli fakte të “reja” dhe dokumente rreth krijimit dhe aktiviteteve politike të Pashko Vasës: “Vasa i ritit të krishterë asokohe kishte pasur një ndër privilegjet më të larta të sundimit osman dhe gjithnjë sipas Priftit “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët (1879)” për traktatet publicistiko-politikë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, të shkruara nga Pashko Vasa, janë shkrime me një qasje shumë pozitive ndaj administratës dhe diplomacisë turke të asaj kohe”.¹ Duket ka ardhur çasti i duhur që të paraqitet ai realitet i “ri” nga vetë kundërshtarët e kësaj Perandorie, ai raport acarues i cili ka ekzistuar prej kohësh mes dy popujve ballkanas - shqiptarëve dhe turqve

Rrjedhimisht, do të dukej shumë i ngjashëm ky titull i imi me moton e këtij simpoziumi, ose thënë ndryshe tip plagjiati, por thënia latine “Uti, non abuti” (përdore, por mos e keqpërdor)! shpresoj të ma justifikojë këtë rast. Ndryshimi i vogël në titull më shumë *ad hoc* se sa i paramenduar prezanton në vijim se historia shqiptare, jo që nuk është shkruar me tolerancë, por ajo është shkruar me aversion dhe përbuzje të tepruar. Si gjithmonë në Ballkan, por në fakt edhe gjetkë, nuk është e vërteta ajo që ka rëndësi, por ajo që njerëzit besojnë se është e vërtetë. Dhe çka njerëzit besojnë, mund të vihet në përdorim të përditshëm. Për ata prej nesh që jetojnë në Kosovë ose në Shqipëri, fakti se kush jetoi apo kush luftoi për mbijetesë në shek. XVI, nuk duhet të ketë ndonjë lidhje me të sotmen.

Nga ana tjetër, është naive të mendohet se turqit janë armiq të shqiptarëve. Këtë aversion ndaj popullit turk unë e kam mësuar qysh

¹ Gazeta “Express” E enjte, 16 Prill 2009, fq. 22.

kur fillova ta mësoj përkufizimin definicionin e shkencës së historisë, edhe atë në çaste të caktuara kur identiteti im ishte në formësim e sipër dhe unë dhunshëm duhet të pranoja atë që më mësohej nga mësuesi im. Atëherë, ku përpos asaj se dija të thosha; feja ime është feja Islame (mësim nga familja), kombi im është shqiptar dhe “shteti” im është Kosova, m’u imponua, gjithnjë në arsimin e asaj kohe se turqit dhe Perandoria Osmane ishin armiq të më të mëdhenj të popullit shqiptar, sepse nga prindërit e mi dhe edukata që kisha marrë si fëmijë më ishte ngulitur në shpirt dhe në zemër se populli turk gjithmonë ishte mik i popullit tonë. Me këtë moto vetë Mbretëria Serbe nguliti kthetrat e saj dhe sundimin e saj më të ashpër me përmasa gjenocidale kudo ku flitej shqip dhe kishte kulturë islame.

“Inati” në Perandorinë Osmane - Turqit

Sa herë flitet për Perandorinë Osmane, krijohen paragjykime tmerruese ndaj turqve. Po pse ekziston gjithë ky mllef ndaj kësaj Perandorie, pse të mobilizohemi i madh e i vogël për të bërë propagandë antiturke?

Në shumicën e vendeve ballkanike, botëkuptimi popullor për sundimin osman është pothuajse tërësisht negativ. Osmanët përshkruhen si barbarë aziatikë, të cilët shkatërruan në çdo vend që pushtuan... ata kishin imponuar një sistem plotësisht të huaj sundimi; shtypën në mënyrë vrazhdë të gjitha ndjenjat e identitetit kombëtar; kolonizuan vise të mëdha të Ballkanit me banorë turq; ata i shndërruan fshatrat e krishterë në një pozitë të bujkrobërisë së plotë... ata ushtruan presion të padurueshëm në kishat krishtere vendëse dhe i detyruan njerëzit që të kalonin në fenë islame; treguan një përkushtim fanatik ndaj parimeve të Sheriatit. Kështu na thuhet. Të gjitha këto pohime apo mëtime janë në rastin më të mirë çoroditëse, përndryshe krejtësisht false”, sqaron studiuesi Noel Malcolm, duke vazhduar më tutje Malcolm pohon: “Në vend që të vendoste një sistem plotësisht të huaj, Perandoria Osmane, në të vërtetë, ruajti dhe zhvilloi shumë karakteristika të jetës administrative, shoqërore, ceremoniale etj. - ashtu siç i kishte gjetur në shtetet

e krishtera të pushtuara... me këtë, sidoqoftë, nuk duam të themi se Perandoria Osmane ishte veçse një variant më i madh e më i mirë i një shteti të Evropës Perëndimore të periudhës së Rilindjes. S’do mend se kishte disa dallime të thella. Disa nga këto dallime rridhnin nga lidhja osmane me Islamin; mirëpo, shumica e karakteristikave fundamentale të Perandorisë Osmane nuk kishin të bënin me fenë, por me luftën.²

Do të duhej studiues të huaj dhe objektiv të trajtonin historinë shqiptare. Ndërsa për mungesë të teksteve valide në gjuhën shqipe, të gjitha gjeneratat e reja kanë fituar aversion ndaj Perandorisë Osmane, e që të tillët (studiuesit të huaj me qëllime kamufluese) kohë pas kohe bënin mbindërtimin e një historie krejtësisht false, duke sajuar hipoteza të ndryshme, të cilat nuk kanë kurrfarë baze me realitetin. Madje përpos shqiptarëve të cilët konsiderueshëm kanë qenë tendencioz karshi Perandorisë Osmane, edhe të huaj në këtë drejtim kishte mjaft. Do përmend studiuesin gjerman Peter Bartl. Bartli është i mendimit se “në historiografinë shqiptare sundimi gati pesë shekullor turk gjykohej pothuajse negativisht. Pushtimi i Shqipërisë në pasojat e tij nuk mund të krahasohet me pushtimin e Bullgarisë apo Serbisë; aty turqit rrënuan kultura të larta mesjetare”.³ Bartli edhe në këtë pohim hipotetik nuk sjellë fakte veçse mjaftohet të hamendësojë në stilin “thuhet se...ose gati...”

Pse gjithë ky inat?

Po të bëhemi dëshmitarë të shtypit ditor, do të vërenim se çdo ditë në ndonjë shtyp vendor mund të hasësh në ndonjë artikull që flet për raportet midis dy vendeve mike, në këtë rast Kosovës dhe Turqisë, dhe sikur të bënim një balancim nga e kaluara, kjo e tashmja thuhet tregon një antagonizëm karshi të kaluarës sonë tendencioze në raport me popullin mik - Turqinë. Marrë shkas nga kjo të them, se edhe përkundër një aversioni të tepruar karshi kësaj Perandorie sërish nuk fshehim emocionin e atij momenti kur pikërisht Turqia ishte Shteti i

² Malcolm, Noel, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë, 2001, fq. 96-97.

³ Bartl, Peter, *Shqipëria nga mesjeta deri sot*, Prizren, 1999, fq. 49.

dytë në botë që njohu sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës, ishte po ky shtet që i pari hoqi vizat për shtetasit e Kosovës. Madje me rastin e vizitës së zv/kryetarit të Parlamentit të Turqisë zt. Nevzat Pakdilli, i cili para pak kohësh i bëri një vizitë Kosovës, presidenti i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu, në këtë takim miqësor theksoi: “Mbështetja e Turqisë është në shumë dimensionë, në shumë fusha, duke filluar nga proceset e hershme, me prezencën e KFOR-it - me investime në fushën e biznesit, në arsim, në shëndetësi etj. Me vizita dhe kontakte, me këmbime përvojash, vetëm se shtojnë edhe më tepër mundësinë e bashkëpunimeve bilaterale edhe në fusha të tjera”.⁴ Po të përmendim edhe raporte tjera bilaterale midis këtyre dy vendeve, kam përshtypjen se kjo pjesë do të stërzgjetet, por nuk do të bënte pa u përmendur edhe angazhimi shumë i sinqertë dhe i vazhdueshëm i shtetit turk për njohjet sa më të shpejta nga Konferenca Islamike në veçanti, po edhe nga shtete tjera.

Nga anën tjetër, na gëzon fakti, madje edhe marrë guxim të shprehem, se Turqia çdoherë në raport me shqiptarët ka kontribuar vetëm në kontest pozitiv në rrugë të prosperitetit dhe avancimit të Kosovës në drejtim të shkencës dhe teknologjisë bashkëkohore. Këtë të fundit mbase e ka treguar qysh në të kaluarën e lashtë. Jo pa qëllim për mbase këtë së fundi sepse edhe vetë sistemi devshirmes siç është i njohur te ne shqiptarët, ka qenë pothuajse i kësaj natyre, aspak aksidental, spontan dhe jo sporadik. Perandoria Osmane ka praktikuar këtë sistem në mënyrën më të kujdesshme në provincat e mbikëqyrura. Ata edukuan breza të ndryshëm duke përfshirë edhe jomyslimanët, ata edukuan prijës më të dobët pa kurrfarë presioni. Në këtë rast Perandoria Osmane ishte veç se një variant më i mirë i mundshëm për shqiptarët, të cilët tashmë kishin pranuar mbikëqyrjen e kësaj Perandorie.

Dy format më të shpeshta të pranimi të Islamit ndër shqiptarët dhe tek tjerët në kohën e Shtetit Osman kanë qenë me anë të sistemit të devshirmes dhe në mënyrë vullnetare. Pranimi i Islamit me anë të devshirmes-së, ishin fëmijët e vegjël meshkuj të krerëve aristokratë ve-

ndës, të cilët u morën peng nga shteti osman. Qëllimi i marrjes peng të këtyre fëmijëve, dukuri e njohur edhe te shtetet e tjera të asaj kohe, ishte që të njëjtit të përgatiten për një detyrë të tillë. Dhe kjo është bërë më dëshirën e prindërve të fëmijëve në fjalë.⁵ Djem të familjeve feudale vendase u morën dhe u edukuan si “iç-ogllanë” në pallatin e sulltanit ose si “gulamë” te bejlerbeu i Rumelisë ose te sanxhakbejlerët ku, pasi kalonin në fenë islame, ktheheshin në funksione të ndryshme administrative ose ushtarake në vendin e tyre.⁶

Tani, po të krahasojm atë sistem si “totalitar-turk” (asnjëherë sipas meje), me mënyrën propagandistike të të huajve “tjerë” të cilët kanë shtrirë pushtetin e tyre në Kosovë me qëllime dhe synime të caktuara në fusha të ndryshme të jetës sociale, politike, shkencore e sportive, nuk shoh se ka ndonjë ndryshim në esencë, vetëm se këta të fundit për dallim nga të parët, veprojnë në formë shumë kamufluente dhe dinake. Ndërsa nëse vetëm pak të vetëdijshëm për aftësimin dhe profesionalizmin e kuadrove të rinj me njohuri të ndryshme nga shtete të fuqishme me më shumë eksperiencë, nëse vetëm për një moment të caktuar do të merrnim ndonjë ofertë studimi ose avancimi profesional, jam më së e bindur se nuk do të kishte asnjë që do t’i thoshte JO kësaj oferte - mbase mund të jetë edhe e pazezistueshme.

Në shqyrtimet tona sistemi devshirme, e që për shqiptarët është halë në sy nga sistemi osman, vazhdon të mbetet i vetmi sistem që shqiptarëve vetëm se u krijoi mundësi se si t’i konsolidojnë radhët e tyre në ushtri, administratë, si të udhëheqin me politikë të jashtme e me radhë. Realisht, kjo Perandori me veprimet e saj tolerante, kulturës shqiptare dhe elitës në përgjithësi nuk ia mbylli zhvillimin evropian, por mbi të gjitha i la mundësi dhe hapësirë për t’u zhvilluar, madje me një përgatitje dhe eksperiencë të mirë të marrë mbi shtratin e kësaj Perandorie. Zëra të tillë të cilët Perandorinë Osmane e paraqesin Perandori me një sistem totalitar, sa janë të pabaza, të ngjashmet edhe janë

⁵ Bozborra, Nuray, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptarë në Perandorinë Osmane*, përktheu Dritan Egro, Dituria, Tiranë, 2002, fq. 57-59.

⁶ Historia e popullit shqiptar, për shkollat e mesme, Grup autorësh, Prishtinë, 2003, botimi i pestë fq. 117.

⁴ Gazeta “Kosova Sot”, E enjte, 23 Prill 2009. fq. 4.

propagandistike, por gjithsesi se mbeten të padëgjueshme para pikëpamjeve të mbështetura shkencërisht e që konsiderueshëm edhe u paraqitën brenda këtij teksti.

Emine A. Vezaj

WRITING HISTORY WITH AVERSION

(Summary)

“Any intelligent fool can make things bigger, more complex, and more violent. It takes a touch of genius -- and a lot of courage -- to move in the opposite direction”

Ernst Friedrich Schumacher

In the field of propaganda the saying that no one is guilty until proven otherwise yields to the notorious Goebbelsian formula: "If you tell a lie big enough and keep repeating it, people will eventually come to believe it." The cycle of history seems to repeat itself. Such a thing was stated by Ibn Khaldun as early as the XIV-th century. It happens on two occasions (when people do not learn from history they are forced to repeat it or when they envy the past).

أمنية وزاي

ان تكتب التاريخ بالكراهية

(خلاصة البحث)

هناك مبدأ في الحروب الاعلامية بان الكل يعتبر بريئاً حتى يتم اثبات عكس ذلك، الا أن هذه المقولة من الصعوبة ان تتفق امام مقولة غوبلس المعروفة: "ان الاكذوبة الكبيرة التي تتكرر يمكن اعتبارها حقيقة. كما يبدو فان التاريخ يتكرر و لقد اكد ذلك عالم الاجتماع المشهور ابن خلدون في القرن الرابع عشر.

fe dhe e kishte bërë të aftë që të hapte çdo debat fetarë para moshatave të veta.

Në shtratin e trëndafilave, mu në afërsi ku ishte Isabela me dy shoqet e saj, erdhën dy myslimanë dhe zunë një diskutim.

Njeriu i parë foli (Umer Lahmi): “Shën Pali, në letrat e tij ka shkruar se ligji i fesë është i mallkuar dhe se Jezu Krishti ka ardhur për të na liruar nga ky mallkim! Çfarë do të thotë kjo?”

Njeriu i dytë (Maazi), duke u qeshur tha: “Ti kërkon ta mësosh nga unë... madje as priftërinjtë e krishterë...”

Isabela që po qëndronte aty afër, u alarmua kur dëgjoi këto fjalë, dhe u tha shoqeve: “Këta myslimanet duket se po flasin për fenë tonë. Ejani të afrohem pakëz e të dëgjojmë ç’kanë për të thënë”

Njëra nga shoqet, duke iu drejtuar Isabelës tha: “Qëkur myslimanët kanë ardhur këtu, feja jonë është e rrezikuar”

Atëherë Isabela, duke i bërë me gisht shoqes i tha: “Shshshhttttt... mbaj qetësinë që t’i dëgjojmë çarë flasin...”

Umer Lahmi: “Ti the se as priftërinjtë nuk e kuptojnë? Do të thuash se ata e ndjekin krishterimin verbësisht, pa e kuptuar...?”

Maazi: “Vetëm shtroje këtë pyetje te ndonjë prift eminent dhe shiko çfarë përgjigje do të marrësh! Por më thuaj më parë, ku është kundërshtimi yt në atë që Shën Pali ka thënë?”

Umer Lahmi: “Në fakt, unë nuk kam ndonjë kundërshtim. Unë vetëm po përpiqem të kuptoj dhe meqenëse ti flet shpesh me të krishterët, dhe ke lexuar literaturën e tyre, thashë se mos po e kuptoj këtë prej teje! Në qoftë se ligji është i mallkuar dhe Jezusi ka ardhur t’i shpëtojë të krishterët prej këtij mallkimi, atëherë vjedhja, kurvëria dhe mosrespektimi i prindërve duhet të jenë të lejuara në krishterim, kurse në këtë lejim nuk beson asnjë i krishterë?!”

Maazi: “Si mundet që vjedhja dhe kurvëria që janë të ndaluara me Ligjin e Zotit të mallkohen... unë s’e kuptoj dot...”

Umer Lahmi: “Dua të them se ‘Beslidhja e Vjetër’ është ligj religjioz që ndalon të vjedhurit, ndalon kurvërinë, urdhëron për mirësjellje me fqinjët, respekt për prindërit... e kështu me radhë. Por, nëse i gjithë ligji i Zotit është i mallkuar, është mallkuar njëkohësisht edhe

ESE

Hajrudin S. Muja

ISABELA

(Sipas novelës me të njëjtin titull
të shkrimtarit Maulana Muhammed Said)

Nju-Jork 2008

I

Në lulishten e famshme të Spanjës, të njohur për bukuritë e rralla të luleve shumëngjyrëshe, që nga shumë vizitorë quhej “Kopshti i Edenit”, ishte bërë gati të perëndojë dielli, bashkë me cicërimat e bilbilave që shoqëronin zhurmën e fëmijëve lozonjarë.

Isabela - vajza e priftit më të famshëm të Spanjës, e cila ende nuk i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat, me dy shoqet e saj të shkollës, ishin ulur në një kënd të lulishtes dhe po soditnin bukuritë e rralla, që vetëm Zoti kishte pasur mundësi t’i tubojë në këtë vend.

Pamja e saj ishte aq e përsosur sa mendoje se Perëndia e kishte cilësuar me të gjitha bukuritë që mund ta pajisë krijesën e Vet. Mu për këtë arsye, ata që e njihnin e quanin ‘hyri e parajsës’. Të gjithë lute-shin që e ardhmja e saj të ishte e lumtur dhe e begatshme, por babai i saj dëshironte që ajo të bëhej model i ‘Marijes Virgjëreshë’! Ai, duke shpresuar se vajza e tij nuk do të martohej kurrë, e kishte edukuar në

ndjekja e këtyre ligjeve. Nëse ajo që thotë Shën Pali është e saktë, atëherë të krishterët duhet të vjedhin, të kurvërojnë e të bëjnë mëkate të tjera... dhe të krishterët që mund të kundërshtojnë këto mëkate, konsiderohen si të jenë thyes të Ligjit Hyjnor...

Maaz: “Qesharake, apo jo?! Ti do të ma sqarosh kundërshtimin e madh që e kam shtruar sa herë para të krishterëve!?”

Ummer Lahmi: “Para të krishterëve, e ç’thonë ata?”

Maaz: “Ata përpiqen ta zhgatërrojnë lëmshin, por e ngatërrojnë edhe më shumë”.

Vetëm pasi thirri ezani për të lajmëruar faljen e akshamit, ndërpre në diskutimin dhe u nisën për në xhami. Isabela që kishte dëgjuar gjithë bisedën kishte mbetur shumë e interesuar për subjektin e temës. Ajo ishte e interesuar në çështjet teologjike. U përpoq që vetë t’i japë një sqarim këtij lëmshi të ngatërruar, por meqë nuk qe e zonja, vendosi ta diskutonte me të atin, posa të mbërrinte në shtëpi...

II

Duke hyrë nga dera lindore e Kordovës, bukuroshja Isabelë u drejtua në rrugën që e shpinte te ‘Pallati i Martirëve’. Qeveria myslimane nga viti 711 e deri në vitin 1492, e kishte zbukuruar gjithë Spanjën. Rrugët e Kordovës ishin të shtruara e të gjëra, të konstruktura mirë e të pasuruara me llamba ndriçuese, të cilat në distanca të afërta të merrnin pamjen. Siç kishte sqaruar dr. Dyer, njeriu mund të bënte udhëtime të gjata njëzetmilëshe në rrugë të ndriçuara.

Isabela përshkonte gjatë rrugën e ndriçuar që e shpinte te ‘Pallati i Martirëve’, tek e cila nuk u ndal si zakonisht të qëndrojë edhe pak me shoqet e saja, por vazhdoi udhëtimin. Pas një gjysmë ore rrugëtimi arriti në shtëpi, në hyrjen e së cilës e pritë me përshëndetje shërbëtorja e shtëpisë. Pasi i dha asaj një arsyetim për vonesën e shkurtër, shkoi në kthinën e saj, mori një libër dhe filloi të lexojë.

Megjithëse shërbëtorja kishte bërë gati darkën dhe e ftonte Isabelën, ajo kishte humbur në radhët e shkrimit dhe nuk dëgjonte gjë. Po përpiquej të zgjidhte lëmshin e ngatërruar në ‘Letrat e Palit’. Kishte

gjetur ‘ligjin e vdekur’ të romakëve 7:6, ‘ligjin e mallkuar’ të galatasve 3:10 dhe ‘ligjin e vjetruar’ të hebrenjve 8:13. Ishte zhytur në dyshime e paqartësi...

Fillimisht, ajo nuk kishte menduar se problemi mund të ishte kaq i komplikuar. Por, edhe nëse ajo s’mund ta zgjidhte, sigurisht që për babanë e saj, si njeriu më i ditur i gjithë Spanjës, do të mund ta zgjidhte pa ndonjë problem. Me këto mendime, ajo darkoi dhe sërish u kthye për të studiuar Biblën, derisa e molisi gjumi.

Të nesërmen në mëngjes, shkoi në meshën e së dielës, në kishën e afërme të lagjes. Pasi kishte mbaruar mesha, prifti e anoi dhe e pyeti çfarë kaptine të Biblës kishte studiuar natën e kaluar dhe a kishte hasur në ndonjë pakuftueshmëri gjatë studimit.

Isabela, duke i puthur duart tha: “At, kam lexuar kaptinën e Jonës dhe në versionin e tretë kam hasur në një paqartësi që vetëm ju mund të ma ndriçoni...”

Prifti: “Sigurisht, bija ime, ti vetëm pyet se unë do ta shlyej çdo paqartësi”.

Isabela: “Dymbëdhjetë urdhrat me të cilat Zoti na ka ngarkuar në ‘Beslidhjen e Vjeter’, përmes profetit Mojsi, a nuk janë ligje fetare edhe për ne?”

Prifti: “Po, janë...”

Isabela: “Çështja tjetër, është çështja e Shën Palit që në njërin prej letrave të tij mallkon këto ligje...”

Prifti: “Po, ligji i fesë është mallkuar dhe për këtë arsye, që të na lirojë neve nga ky mallkim, Jezu Krishti erdhi në botë dhe u kryqëzua...”

Isabela: “Nëse ligji u mallkua dhe Jezusi u kryqëzua, atëherë edhe ndjekja e këtij ligji është e mallkuar, apo jo?!”

Prifti: “Sigurisht është mallkuar dhe të krishterët, në vend që të ndjekin ligjin e fesë, ata shprehin bindjen dhe besimin në Jezusin, sepse ligji ishte efektiv vetëm derisa nuk u kryqëzua Zoti jonë...”

Isabela: “Pra tani vjedhja dhe kurvëria janë të lejuara për ne!”

Prifti: “Ç’ka të bëjë kjo me ligjin e fesë? Bija ime, duhet të mendosh me kujdes para se të shtrosh pyetjen, sepse ata që mund të dëgjojnë pyetjet tua, mund të mendojnë se je e çmendur...”

Isabela: “Më fal, ndoshta nuk jam qartësuar mirë. Ajo që unë desha të them është se brenda ligjeve të Zotit që ti i përmende pak më parë e që janë pjesë të ligjit fetar, është urdhër i prerë ‘mos vidh’, ‘mos kurvëro’, ‘respekto prindërit’, ‘mos bëj padrejtësi ndaj fqinjit’, etj. Tani këto urdhra janë gjithnjë pjesë e Ligjit Hyjnor, të cilat sipas Shën Palit janë të mallkuara. Pra, ndjekja e ligjeve të ‘Besëlidhjes së Vjetër’ është anuluar dhe në këtë kontest, respektimi i prindërve dhe anulimi nga vjedhja janë të mallkuara...”

Prifti: “Bija ime, ti ende nuk e ke kuptuar pozitën e Ligjit Hyjnor... Por, më thuaj më parë nga të erdhën këto pyetje djallëzore në kokën tënde?”

Për t’i sqaruar gjithçka priftit, Isabela i tregoi gjithë bisedën ndërmjet Umer Lahmit dhe Maazit, që e kishte dëgjuar në mesin e lulishtes, te ‘Kopështi i Edenit’. Pasi e dëgjoi Isabelën, u bë një pauzë e shkurtër. Pastaj nisi shpjegimet.

Prifti: “Bija ime, ti e di mirë se këta myslimanët e mallkuar janë mosbesimtarë dhe gjithmonë kanë qenë shkelës të fesë sonë të shenjtë. Kritikata e librit tonë të shenjtë janë rezultat i mendimeve djallëzore. Ti duhet të pendohesh dhe në të ardhmen të mos ua dorëzosh dëgjimin tënd bisedave të tyre. Ata janë afetarë dhe mundohen ta shmangin fenë e pastër nga të tjerët. A e di bija ime, cili është religjioni i tyre? Gjakderdhja është kredibiliteti i tyre! Vetëm shiko pak, ata e kanë okupuar vendin tonë Spanjën, kanë vrarë qindra njerëz të pafajshëm dhe tani dhunshëm duan të na imponojnë fenë e tyre. Sikur këto paqartësi t’i kishe pasur nga vetë ndërgjegjja dhe mësimet tua, do t’i kisha sqaruar pa ndonjë problem, por çfarë qartësimi pret t’u bëjmë atyre?”

Isabelës i erdhi keq që përmendi myslimanët, ndryshe problemi i saj do të ishte zgjidhur. Por në mendje i lindi një ide tjetër. Këto pyetje do t’ia shtronte mësuesit të saj, që gjithherë tregonte gatishmëri për t’i sqaruar asaj çdo të dyshimtë nga mësimet fetare.

Të nesërmen, të njëjtën pyetje i shtroi mësuesit Miçelit, por kur edhe ai nuk mundi ta kënaqë me përgjigjen, Isabela kuptoi se kjo do të paraqiste problem edhe për dijetarët më të mëdhenj të krishterimit. Kështu, dyshimi për mangësitë e doktrinës së krishterë u bë edhe më i madh në mendjen e saj.

III

Ca ditë më vonë, Isabela me dy shoqet e saj sërish dolën në parkun e luleve, në atë vendin ku pati dëgjuar bisedën e dy myslimanëve. Sapo u vendosën në një ulësë të lulishtes, Umer Lahmi me Maazin erdhën dhe u ulën jo larg tyre, dhe si zakonisht filluan diskutimin në një subjekt tjetër.

Umer Lahmi: “Dëgjova një lajm të çuditshëm sot!”

Maazi: “Çfarë?”

Umer Lahmi: “Ai problemi që diskutove ti para ca ditësh, lidhur me letrat e Shën Palit, kishte hyrë në veshët e kryepriftit dhe kishte lindur një debat i madh ndërmjet priftërinjve lidhur me të. Bile thuhet se disa persona sensibilë janë bërë skeptikë!”

Maazi: “Vërtet qenka bërë problem, por... athua, kush mund ta ketë dëgjuar bisedën tonë atë ditë...?”

Umer Lahmi: “Hë pra... kush mund t’i ketë dëgjuar, edhe priftërinjtë i paska rrokur alergjia për hiçgjë! Ata edhe më parë e kanë dëgjuar kundërshtimin tonë lidhur me këtë, por nuk janë alarmuar kaq! Ajo që s’po mund të kuptoj unë është se kjo punë u bë e madhe, priftërinjtë kanë mbajtur disa mbledhje për të gjetur zgjidhje. Këtë e mësova nga burimet e krishtera”

Maazi: “E shikon, vetëm një kundërshtim krijon një lëmsh të ngatërruar në mesin e priftërinjve, e në të njëjtën kohë, i gjithë religjioni është i ngatërruar brenda atij lëmshi. Shembull, Ademi (a.s) mëkatoi dhe ngarkoi të gjithë me mëkatin e tij, pra edhe i pafajshmi do të dënohet për fajin që nuk e ka bërë! ‘Biri i Zotit’ erdhi në botë dhe u kryqëzua, Kjo është edhe një fije e ngatërruar brenda atij lëmshi. Po të ketë ndonjë të krishterë të ditur që mund të mi shpjegojë...”

Umer Lahmi (duke qeshur): *“Nëse të krishterët nuk do ta kalojnë kufirin e absurditetit, kush tjetër do ta kalonte? Çdokush mund të flasë me arsye, por duhet dikush të flasë edhe pa pasur shkak për të folur...”*

Maazi: *“Më duket se ka ardhur koha të sqarohen ca gjëra”.*

Umer Mazi: *“Ke të drejtë, në këtë kohë do ishte mirë të publikonim një gazetë muri, ku do të shënoheshin absurditetet e kredos së krishterë...”*

Maazi: *“Ashtu do të krijohej një huti ndërmjet të krishterëve të Spanjës”.*

Isabela dhe dy shoqet e saj të klasës që ishin ulur jo larg dhe po dëgjonin me shumë kujdes gjithë bisedën dhe përdridhnin gishtërinjtë në shenjë hidhërimi. Isabela, duke e humbur durimin, sugjeroi dy shoqet e saj t’u afroreshin myslimanëve dhe t’u jepnin sqarimet e duhura. Mbase Krishti do t’ua ndriçonte mendjen dhe do t’i udhëzonte në krishterim. Po të arrinin që t’i bindnin dhe t’i konvertonin këta dy myslimanë, do të kishte qenë një fitore e madhe për krishterimin, kurse myslimanët nuk do të mund të ngrinin më kokën në këtë vend. Isabela, para se t’i hyjë këtij misioni të rëndësishëm, ngriti duart lart dhe iu lut Zotit t’i udhëzojë këta jobesimtarë dhe armiq të krishterimit në udhën e drejtë të Jezusit.

Shoqet e Isabelës (pasi dëgjuan dhe menduan thanë): *“Motër Isabelë, këta jobesimtarë janë shumë gjaknxehtë. Si do ta refuzojnë ata djallin që të kapen për dorën e Krishtit? Por edhe priftërinjtë tanë kanë frikë prej tyre! Dje, duke parë interesimin tënd në temën e hapur të debatit, unë e shtrova çështjen te prifti i lagjes sime dhe ai, duke injoruar pyetjen time, vetëm më tha t’u mos ua vejmë veshin çka thonë myslimanët. Kjo nuk kënaq si përgjigje dhe nuk jep rezultat pozitiv! Hë pra, kur priftërinjtë tanë janë në këtë gjendje injorante, atëherë pse myslimanët të mos bëhen arrogantë?”*

Isabela: *“Problemi është se priftërinjtë tanë nuk kanë dëshirë të flasin me këta mosbesimtarë dhe heshtin. Por heshtja e tyre nuk do të thotë se ata janë injorantë e nuk kanë përgjigje për ta. Po të jenë ata të sigurt se mbasi të jenë të mundur debatësisht, shumica e myslimanëve*

do të jenë të gatshëm të konvertohen në krishterim, jam e sigurt se priftërinjtë do të gjejnë përgjigje bindëse për to!”

Një shoqe: *“Unë mendoj se këta myslimanë duhet të detyrohen të pranojnë debat me priftërinjtë tanë publikisht. Kështu, besimi i krishterë do të forcohet, kurse myslimanët do të humbin logjikisht dhe do të konvertohen në të krishterë...”*

Isabela: *“Kjo është gjë e mirë, por... a do të pranojnë myslimanët debate të tilla publike?”*

Një shoqe: *“Pse jo, ti vetë i ke dëgjuar të kenë propozuar diçka të tillë!”*

Isabela: *“Atëherë pse të presim, le t’i informojmë që tani, që të përgatiten për debat me priftërinjtë tanë. Unë që tani po ua shkruaj një pustëll dhe do t’ua çosh e të shohim reagimin e tyre!”*

Një shoqe: *“Le të mendojmë mirë më parë, po sikur këta mosbesimtarë të jenë të gatshëm e të pranojnë, por priftërinjtë tanë ta refuzojnë një debat të tillë?”*

Isabela: *“Pse të refuzojnë, nëse këta na japin me shkrim se pasi të munden në debat do të pranojnë krishterimin, atëherë nuk kanë asnjë arsye të mos e pranojnë debatin, sepse ashtu ata fitojnë dhe nuk humbin...”*

Pasi u konsultuan mirë e mirë, dhe u bindën se kjo do të shkonte në favor të krishterimit, Isabela, shkroi:

“Kërkoj falje nga ju. Kam dëgjuar gjithë bisedën tuaj sekrete me shumë kujdes, dhe meqë edhe ne jemi të interesuara në çështje teologjike, shpresoj ta merrni në konsideratë kërkesën tonë. Në bisedën tuaj thatë se po të kenë aftësi të krishterët t’u bindin në çështjen e ligjit dhe të mallkimit, ju do të pranoni krishterimin. Gjithashtu keni thënë se jeni të përgatitur të hapni një debat të tillë. Pra, si shërbëtore e Jezu Krishtit, ne me dëshirë e pranojmë debatin me ju, po që se na i jepni këto premtime me shkrim...”

Shoqja e Isabelës ia dorëzoi letrën Umer Lahmit, dhe ai, pasi e diskutoi me Maazin, i shkroi përgjigjen Isabelës:

“Ne ju falënderojmë dhe pajtohemi plotësisht, në qoftë se dijetarët tuaj do ta zgjidhin dilemën tonë në lidhje me ligjin e fesë dhe mallki-

min e këtij ligji, unë dhe shokët e mi që do të më shoqërojnë në debat, do të heqim dorë nga Islami dhe do të pranojmë fenë tuaj të krishterë. Ju vetëm na lajmëroni ku dhe kurë do të takohemi...”

Isabela pasi e lexoi letrën ndjeu një gëzim, mbase po bëhej shkatërtare për një gjë të mirë, që do të shkonte në favor të fesë që kishte ndjekur e studiuar. Ua shkroi edhe një pusëll sa t’ua bënte me dije se për kohën dhe vendin e debatit do t’i lajmëronte të nesërmen pasi të merrej vesh me të tjerët.

Duke dalë nga lulishtja e Kordovës, detyra e parë e Isabelës ishte që të gjejë një dijetar që do të ketë aftësitë e duhura të debatit me myslimanët. Këtë ndihmë do ta merrte më së miri nga mësuesi i saj Miçeli, të cilit i shkoi në shtëpi dhe i tregoi gjithë ngjarjen. Mësuesi që vetë ishte prift dhe njohës i mirë i problemeve religjioze, i premtoi Isabelës se do ta merrte përsipër këtë punë, dhe se të nesërmen do t’i caktonte vendin dhe kohën e takimit.

Atë natë, Isabela nuk vuri gjumë në sy. E kishte kapur ankthi i mendimeve. Po qe se të krishterët do të fitonin debatin, atëherë myslimanët do të pranonin krishterimin, kështu krishterimi do të fitonte, ndërsa islami do të pësonte keq. Dhe për këtë fitore të madhe, një pjesë e meritës i binte Isabelës. Por, ishte edhe ana tjetër e mendimit, nëse dijetarët e krishterë nuk do të gjejnë përgjigje që të kënaqin myslimanët, atëherë krishterimi do ta pësojë keq, kurse fajin kryesor do ta mbajë vetë ajo.

Pas dreke, Isabela mori dy shoqet e saj dhe shkoi në shtëpinë e priftit, ku për befasinë e saj gjeti një numër të madh priftërinjsh, të cilët ishin rreshtuar dhe po prisnin dikë që po vinte. Kur ai erdhi, i ofruan një karrige dhe pasi iu luten Jezu Krishtit, i shpjeguan qëllimin e ftesës dhe u përgatitën për dialogun me myslimanët, duke inkurajuar njëri-tjetrin të përfitojnë nga rasti që të konvertojnë myslimanët në krishterim.

Një prift: “Unë u shqetësova kur dëgjova ftesën për këtë tubim. Thashë diçka e madhe do të ketë ngjarë. Por tani që e shpjeguat, e kuptoj se problemi është fare i parëndësishëm dhe i lehtë. Ju ftoni ata

myslimanët që tani po të doni, dhe ata me siguri do të marrin përgjigjen që kërkojnë dhe të konvertohen...”

Një prift tjetër: “E vërtetë, çështja nuk është edhe aq e rëndësishme, sepse edhe më parë ne kemi pasur debate me myslimanët, por meqenëse zëri ka marrë dhenë se të krishterët nuk kanë përgjigje në lidhje me këtë çështje, kjo ka rëndësinë e vet dhe ne tani na ka mbetur vetëm një zgjidhje, të caktojmë kohën dhe vendin e takimit...”

Një nga të prezentuarit: “Nesër është e diel, të gjithë të krishterët do të tubohen në kishën e madhe, pra edhe myslimanët të vijnë aty e ne të shpresojmë se Jezu Krishti do t’i udhëzojë ata në rrugën e shpëtimit...”

Prifti: “Sugjerim i mirë (Isabelës) babai i juaj i respektuar që lutet në atë kishë, do të jetë gjithashtu i nevojshëm të marrë pjesë në debat”.

Një tjetër: “Baba i saj është koka e gjithë priftërinjve të Spanjës, dhe nuk ka ndonjërin më të ditur se ai në çështjet e besimit të krishterë, prandaj pjesëmarrja e tij këtu është esenciale!”

Miçeli (mësuesi i Isabelës): “Sigurisht”.

Pra, propozimi njëzëri u pranua dhe e diela u caktua për dialog. Me kërkesën e Isabelës, Miçaeli shkroi fletëhyrjen për Umar Lahmin dhe kompanionin e tij, që do ta lehtësonte hyrjen e tyre në kishë.

Vonë pas dite, Isabela me dy shoqet e saj shkuan sërisht në parkun e luleve, ku gjetën Umer Lahmin dhe Maazin të shoqëruar edhe me ca të tjerë. Vetë Isabela i dorëzoi Maazit letërhyrjen e shkruar nga Miçaeli, që ishte e hapur dhe mund ta lexonte kushdo që dëshironte.

Maazi (Isabelës): “Ne të jemi mirënjohës për gjithë mundin tënd në organizimin e këtij debati, dhe për çdo të mirë që do të sjellë ky debat, merita e parë është jotja...”

Umer Lahmi (shokëve): “Kjo është studiuese e filozofisë së krishterë, por e zonja edhe në teologji. Qëllimi i saj kryesor është të na ndajë ne nga ‘mosbesimi’...”

Isabella: “Unë jam në shërbim të Jezu Krishtit dhe u falënderoj që pranuat ftesën tonë”.

Umer Lahmi: “Do t’i lajmërosh priftërinjtë, se ne do të vijmë në mëngjes në kishë”.

Isabela dhe shoqet e saj nuk ndenjën më në lulishte si zakonisht. Detyra të mëdha kishin përpara në përgatitje të ditës së nesërme, sepse dëshironin që gjithçka të jetë në vendin e vet para se të fillonte ky debat, nga e cila do të ndahej ‘shapi prej sheqerit’.

IV

Pasi u largua Isabela, Umer Lahmi dhe Maazi shkuan në shtëpi, dhe studiuan Kur’anin e Biblën duke nënvizuar aty-këtu ndonjë paragraf që do t’u vlente për diskutim.

Të nesërmen në mëngjes, lajmi mbi debatin kishte marrë gjithë qytetin. Të krishterët kishin vendosur që veç myslimanëve të caktuar, të mos lejojnë prezencën e të tjerëve. Kështu që një numër i madh i myslimanëve të tjerë që donin të ndiqnin debatin, u kthyen të zhgënjyer. Umer Lahmi dhe Mazi pasi treguan fletëhyrjet, hynë në kishë dhe vetëm aty morën vesh se aty ishin prezentë priftërinjtë më eminentë të të gjithë Kordovës. Aty ishte e pranishme edhe Isabela, e cila bashkë me shoqet e saj po bënte lutjet e së dielës.

Në fund të lutjes, të gjithë morën pozitat e veta për të filluar diskutimin.

Miçaeli: “Kemi mësuar se ju keni ca paqartësi rreth krishterimit dhe se keni ardhur këtu për sqarimet tona, pas të cilave keni thënë se do të braktisni islamin e do të pranoni krishterimin?!”

Umer Lahmi: “Ne nuk dyshojmë në besimin dhe mësimet e krishtera, por njëkohësisht jemi të bindur se shumëçka nga kjo fe nuk ka bazë të shëndoshë. Sidoqoftë, nëse ju do të na jepni sqarime të kënaqshme mbi subjektin që është paratreguar, ne u kemi premtuar dhe do ta realizojmë premtimin e bërë lidhur me konvertimin tonë”.

Pastaj, Miçaeli ia dha fjalën një të moshuari që ta hapë debatin. Ai ishte At Pjetri, një prift shumë i njohur për zotësinë e tij, njohës i mirë i gjuhës arabe, studiues i literaturës islame dhe autor i disa shkrimeve

anti-islame. Ai mund të ishte debatuesi më i zoti përballë myslimanëve.

Pjetri (duke iu adresuar Umer Lahmit): “Më kanë thënë se subjekti dhe paqartësia që ju keni shtruar e që ne duhet të diskutojmë sot është në lidhje me Shën Palin dhe me mallkimin që ai i ka bërë ligjit të fesë? Por, kjo është një temë anësore pa ndonjë rëndësi të madhe. Ju jeni myslimanë dhe besoni në Kuran, prandaj edhe diskutimi lidhur me krishterimin në përgjithësi apo Krishtin në veçanti, do të duhej të bëhej mu nga ky Kur’an...”

Umer Lahmi: “Unë e kam sqaruar shumë mirë subjektin e temës së diskutimit, madje edhe me shkrim, siç e thatë edhe vetë, kurse ju tani doni të bëni diskutime të tjera. Unë mendoj të mbarojmë më parë me sqarimin e duhur lidhur me temën e shtruar...”

Pjetri: “Ne do t’i përgjigjemi edhe pyetjes suaj dhe do ta sqarojmë më siç është më mirë, por le të diskutojmë më parë gjërat themelore, bile mu nga Kur’ani i juaj. A nuk thotë Kur’ani se Jezusi është ‘Ruhullah’ (shpirt i Zotit) dhe ‘Kelimatullah’ (fjalë e Zotit)? A nuk përmend se Jezusi i ka prurë vdekurit në jetë? Prandaj, nëse e beson Kur’anin, si mund ta refuzosh Jezusin si ‘Bir i Zotit?’

Umer Lahmi: “Ju keni filluar një diskutim krejt ndryshe nga tema e shtruar. Arsyeja që ne kemi ardhur këtu sot është të na sqaroni që të kuptojmë ‘gërshetimin’ ndërmjet Ligjit të fesë dhe mallkimit që Shën Pali i ka bërë këtij ligji. Nëse doni të diskutoni brenda kësaj teme, bëjeni, nëse jo na jepni leje të largohemi...”

Pjetri: “Unë vura Kur’anin para jush sepse desha më parë të diskutojmë mbi çështjet themelore, çështjet fillestare, bazamentin... Nëse ju doni të leni çështjet më të rëndësishme e të hyni në tema që nuk janë të rëndësishme, atëherë do të thotë se ju nuk keni përgjigje për to”.

Umer Lahmi: “Nëse ju vërtet doni të bëni diskutime mbi çështjet themelore, mbi ato fillestare, duke lënë anash Biblën që të fshiheni pas Kur’anit, atëherë le të fillojmë diskutimin me Ademin (a.s), a e ka bërë ai mëkatin apo jo, a është transferuar mëkati i tij në të gjitha krijesat njerëzore. Nëse kjo ka ngjarë le të diskutojmë për pozitën e

Jezusit në Bibël, dëshmitë se ai është ‘Zot’, se vetëm ai mund t’i falë mëkatet që nuk i kanë bërë kurrë njerëzit?! Kur ta dëshmoni edhe këtë, atëherë duhet të sillni dëshmi mbi ‘kryqëzimin’ e Jezusit, se ai ka qëndruar tre ditë në ferr... Nëse vërtet jeni të interesuar të diskutoni bazamentet e fesë, këto do të ishin për diskutime dhe jo çfarë thuhet për Jezusin në Kur’an që ju, nuk e besoni fare...

Pjetri: “Të gjitha këto janë irrelevante. Ajo për të cilën dua të diskutoj unë është dëshmia Kuranore se Jezusi është ‘Shpirt i Zotit’ dhe ‘Fjalë e Zotit’ dhe se ai ka kthyer të vdekurit në jetë. Për këtë arsye, religjioni i krishterë është e vetmja fe e drejtë dhe e plotë.

Umer Lahmi (Isabelës): “Unë këtë çështje do ta lija në gjykimin e Isabelës. Për ç’arsye na ka ftuar këtu dhe sipas kërkesës së saj të bërë me shkrim, cili ka qenë subjekti i diskutimit për sot?”

Isabela: “Në fakt, subjekti i caktuar ka qenë në lidhje me ligjin e fesë, nëse është i mallkuar ose jo. Por edhe subjekti lidhje me Kur’an-in, që shtrori At Pjetri duhet të diskutohet. Prandaj unë mendoj të fill-ojmë me të parën, sepse ajo ka qenë tema për të cilën kemi organizuar këtë takim sot.

Umer Lahmi: “Gjithsesi, për sqarime të tilla e keni derën e hapur, por jo para se ta mbyllim diskutimin për subjektin e parë, për ç’gjë na keni ftuar. Premtimin tonë lidhur me konvertimin po të na jepni përgjigje e kemi bërë në çështjen e parë, prandaj duhet të mbarojmë me të parën. Po të na jepni përgjigjen që kërkojmë, edhe ashtu ne do të konvertohem dhe s’do të ketë nevojë të diskutojmë Kur’anin...”

Pjetri: “Mirë zotërinj, shtrojeni pyetjen tuaj”.

Umer Lahmi: “Nëse ju do t’u përgjigjeni pyetjeve të mia një nga një, çështja vetvetiu do të zgjidhet e do të qartësohet. Së pari më thuaj ‘mos vidh’, ‘mos u bëj vrasës’, ‘respekto prindërit’, etj, a janë të gjitha këto urdhra fetare të lidhura me ligjin hyjnor?”

Pjetri: “Sigurisht, të gjitha këto janë në kuadrin e ligjeve hyjnore, pra ligjeve të fesë”.

Umer Lahmi: “Dhe, ku është mospajtimi i Shën Palit me këto ligje?”

Pjetri: “Cili mospajtim... nuk po kuptoj...?!”

Umer Lahmi: “E kuptoni ju mirë, vetëm doni t’i bishtëroni përgjigjes... A e mallkoi Shën Pali ligjin?”

Pjetri: “Shën Pali e mallkoi ligjin në respekt të trupit religjioz që ka ardhur në formën e Jezu Krishtit dhe do të ishte marrëzi e madhe të lihet trupi e të ndiqet lëkura!”

Umer Lahmi: “Kështu mendova edhe unë, Shën Pali flet për Jezusin si shpirt, kurse trupin që është ligji e ka mallkuar. Sipas kësaj logjike, tani të shmangurit nga vrasja, nga kurvëria, nga vjedhja, janë gjithashtu të mallkuara...?!”

Pjetri: “Kjo është misteri dhe nuk mund ta kuptoni pa ndihmën e ‘Shpirtit të Shenjtë’ dhe nuk është e arsyeshme që një problem që nuk keni aftësi ta kuptoni, ta quani të gabuar. Shën Pali e ka quajtur të mallkuar ligjin fizik dhe jo të gjitha ligjet hyjnore!”

Umer Lahmi: “Ashtu është, ju keni plotësisht të drejtë, ‘mos vidh’, ‘mos kurvëro’, ‘mos mbyt’, ‘mos keqtrajto prindërit’... të gjitha këto ligje fizike janë, apo jo?”

Pjetri: “Ju silleni rreth të njëjtës pyetje, e rëndësishme është ajo që ka thënë Jezusi dhe jo ajo që ka thënë Shën Pali! Pra, ajo që ka thënë Jezusi, ajo duhet të ndiqet”. Ja çka thotë Mateu në versionin nëntëmbëdhjetë të kaptinës së pestë: “Kushdo që do ta shlyejë njërin ndër këta urdhra, qoftë edhe më të voglin, dhe do t’i mësojnë njerëzit të bëjnë ashtu, do të jetë më i vogli në Mbretërinë e qiellit, ndërsa ai që do t’i mbajë e do t’i mësojë do të jetë i madh në Mbretërinë e qiellit”. Pastaj në vazhdim kemi edhe versionin njëzet e pesë të kapitullit të dhjetë: “Mjaft është për nxënësit të bëhet si mësuesi i tij dhe për shërbëtorin, si zotëria i tij...”

Umer Lahmi: “Nëse është kështu, përse duhej të kryqëzohej ‘Biri i Zotit’? A nuk shpjegohet se mu për këtë shkak ai u kryqëzua, që të mos ketë nevojë të ndiqet ligji i Besëlidhjes së Vjetër? Tani, pas kryqëzimit të Krishtit, nuk ka nevojë të ndiqet ligji i vjetër...?!”

Pjetri: “Ne nuk dimë tjetër veç asaj që Zoti na ka udhëzuar të ndjekim ‘Besëlidhjen e Vjetër’, por salvimi nuk mund të ndiqet, vetëm me të ndjekurit e ligjit pa shëlbësë!”

Umer Lahmi: “Pra, profeti Musa (as), Daudi (as), Sulejmani (as), Jusufi (as), Nuhi (as), e profetët tjerë, janë jashtë salvimit, sepse për të gjithë ato Salvimi ishte të ndjekurit e ligjit, si për komunitetet e tyre.

Pjetri: “Jo, para se të vinte Jezusi, e vetmja mënyrë e salvimit ishte të ndiqet ligji, pa shëlbësë...”

Umer Lahmi: “Së pari ti refuzove mallkimin që Shën Pali i ka bërë ligjit, tani po thua se përmbajtja e ligjit të fesë është baza për salvim! A mund të paraqesësh qoftë vetëm edhe një dëshmi tjetër që ndonjë i shenjtë e ka bërë, se mallkimi që i ka bërë ligjit Shën Pali nuk është i vërtetë?”

Një person tjetër: “Zotërinj. Është mosbesim dhe mëkat të diskutohet për të këtilla çështje! Të gjitha këto janë mister të papara. Me ‘salvim’ ne kuptojmë “Hyjninë e Krishtit” dhe shëlbësën. Sepse Jezusi ishte i pamëkate që erdhi me mëshirën e vet, u sakrifikua në kryq për të na dhënë neve salvimin. Është e vërtetë se Shën Pali e ka mallkuar ligjin, por kjo mbetet një mister që ju nuk jeni në gjendje ta kuptoni....”

Umer Lahmi: “Dhe pikërisht kjo është arsyeja që kemi ardhur këtu, që të na i shpjegoni gjërat që nuk i kuptojmë...”

Një person tjetër: “Ju jeni duke denigruar Shën Palin...!”

Umer Lahmi: “Ne nuk lejojmë shpifje, ky më parë solli subjektin e shenjtërisë dhe të shëlbësës, por, le të mbarojmë më parë me ligjin dhe me mallkimin e tij...”

Pjetri: “Ju morët ligjin që keni kërkuar. Tani keni 8 ditë të mendoni dhe nëse ende nuk e keni të qartë do të caktojme edhe një takim tjetër pas 8 ditësh”.

Umer Lahmi: “Ju nuk e pranuat ligjin e fesë si të mallkuar, ndërsa ky kolegu i juaj tha se është mallkuar dhe se Shën Pali ka qenë korrekt. Tani, cili prej jush e ka me vend?”

Pjetri: “Ata që nuk pajtohen me misteret religjioze, mos t’u vihet veshi ç’thonë”

Umer Lahmi (Isabelës): “Më thoni ju, cili prej tyre gënjen dhe cili thotë të vërtetën dhe a ka qenë gabim Shën Pali që ka mallkuar ligjin...?”

Isabela: “Unë kam ardhur këtu të dëgjoj debatin tuaj dhe nuk dua të ndërhyjë në diskutim. Por unë kërkoj prej mësuesit tim Miçael të na sqarojë këtë problem sepse deri tani nuk u sqarua asgjë...”

Fjalët e Isabelës ranë si plumba mbi gjithë asamblenë e kishës dhe çuditshëm e frikshëm filluan të shikojnë njëri-tjetrin. Pas një pauze të shkurtër, mësuesi u çua për të vazhduar.

Miçeli: “Vëllezër, ne jemi tubuar këtu të mësojmë për fenë. Por e vërteta kërkohet vetëm me sinqeritet në zemër. Çështja e fesë është e atillë që asnjëri nuk është në gjendje ta kuptojë vetvetiu pa ndihmën hyjnore. Për këtë arsye, ne duhet t’i lutemi Zotit që ai të manifestojë të vërtetën te ne përmes ndihmës së ‘shpirtit të shenjtë’ dhe që të reulojë në ne misteret e fesë së krishterë. Është e vërtetë se myslimanët nuk kanë njohuri për kredon dhe principet e krishtera dhe prandaj kanë hyrë në polemika. Esenca e religjionit të krishterë është e përmbledhur vetëm në dy fjalë fare të thjeshta: ‘Shenjtëria e Krishtit’ dhe ‘shëlbimi’. Ai që të ketë kuptuar këto dy fjalë, ka kuptuar gjithë sekretet e fesë së krishterë. Sa i madhërishtë është Zoti kur ka dërguar djelin e Tij të vetëm për salvimin tonë. Ka hequr të gjitha mundimet e botës dhe më pas u vu në kryq për mëkatet tona. Prandaj, unë kërkoj prej Umer Lahmit dhe asociacionit të tij t’i lënë diskutimet mbi ligjin dhe mallkimin dhe të mendojnë me sinqeritet në personalitetin e Jezu Krishtit dhe të pranojnë fenë e krishterë...”

Umer Lahmi: “Ne nuk kemi ardhur këtu për biseda të tjera. Jemi duke u përmbajtur rregullave të diskutimit mbi principet themelore. Subjektin e diskutimit e kemi sqaruar me shkresë dhe dëshmitare për këtë kemi Isabelën. Nëse dëshira e juaj është që ta lëmë subjektin e diskutimit për të cilën jemi tubuar, dhe të diskutojmë tema të tjera, ne jemi të gatshëm, por më parë e duam me shkrim se në subjektin e parë nuk keni përgjigje”

Pjetri: “Ne nuk po themi se duhet të dorëzohemi në diskutimin e këtij problemi, por po themi t’i lëmë anash diskutimet anësore që të diskutojmë thelbin e problemit...”

Umer Lahmi: “Atëherë, përse na keni ftuar këtu? Kishat dhe xhamitë nuk janë ngritur për diskutime. Nëse ju nuk doni të diskutoni për gjëra të këtilla të cilat janë tejet thelbësore, atëherë mos na humbni kohën kot.

Miçeli: “Ju e keqkuptuat At Pjetrin. Ai nuk tha se duhet të mbyllet diskutimi. Ai vetëm tha se diskutimi duhet të bëhet brenda problemeve themelore. Por tani ka ardhur mesdita dhe ndoshta keni nevojë për drekë. Kurse ne na thoni kur e keni më konveniente një takim tjetër?”

Umer Lahmi: “Tani, mu këtu, pse të kërkojmë takim tjetër kur veç jemi të takuar dhe mund të vazhdojmë?”

Miçael: “Por, tani ka hyrë edhe koha për faljen e namazit tuaj!”

Umer Lahmi: “S’ka problem, falemi këtu në kishë ne...”

Miçeli: “Unë mendoj ta lëmë një takim tjetër për të dielën...”

Umer Lahmi: “Unë mendoj që diskutimi të mos ndërpritet”

Miçeli: “Unë mendoj që ta vazhdojmë debatin nesër në mëngjes, deri në mesditë”

Isabela: “Nëse ky diskutim duhet të ndërpritet këtu, unë mendoj që nesër të vazhdohet derisa të mbërrihet te një përfundim, qoftë edhe deri në mbrëmje...”

Miçeli: “Po... pse nuk kemi ne punë të tjera më të rëndësishme...”

Isabela: “Unë mendoj se asnjë punë tjetër nuk është më e rëndësishme se kjo...”

Megjithatë, u vendos që biseda të vazhdonte të nesërmen nga mëngjesi deri në drekë. Për sot këtu u ndërpre në diskutimet. Umer Lahmi me asociacionin e tij u larguan. Në kishë kishin mbetur vetëm priftërinjtë dhe Isabela.

Një prift: “Kemi bërë një gjest të shëmtuar që kemi lejuar këta mosbesimtarë të vijnë në kishën tonë e të tallen me krishterimin. E vetmja mënyrë që të mposhten këta të poshtër është që t’u vëmë Kur’anin përpara. At Pjetri e bërë këtë që në fillim, por ata u dredhuan përgjigjeve duke u fshehur pas ligjit e mallkimit... Nëse edhe nesër do

të lejohen të bëjnë të njëjtën gjë, ne sërish nuk do të kemi përgjigje për to, sepse kjo është çështje që vetëm shenjtorët mund ta kuptojnë...”

Miçael: “Në fakt, diskutimi mori kahe të gabueshme që në fillim. Ndryshe ata do të poshtëroheshin mu nga Kur’ani. A nuk thotë Kur’ani se Zoti Jonë Jezusi është jetëdhënës, se ka kthyer të vdekurit në jetë, se është quajtur ‘shpirt i Zotit’ dhe ‘fjalë e Zotit’...?!”

Pjetri: “Por subjekti i diskutimit për nesër është i hapur dhe ne nuk kemi mundësi ta ndryshojmë... Unë fillimisht desha t’i shmangem temës por Miçeli e solli sërish temë të diskutimit...”

Miçeli: “Mua nuk ke pse më akuzon, kjo është krejt ngatërresë e juaja...”

Një tjetër: “Nuk ka nevojë tu hyjmë ngatërresave mes njëri-tjetrit. Nesër do t’i shohim ata kur të diskutojnë shenjtërinë e Jezusit. Feja jonë nuk është lodër që të luajë me të kushdo si të dëshirojë...”

Mbas kësaj të gjithë u shpërndanë. Edhe Isabela me shoqet e saj nisën rrugëtimin për në shtëpi. Gjurmët e tri shoqeve tokërrinin nëpër kalldrëmin e Kordovës. Asnjëra nuk fliste. Secila përshkonte në mendje bisedat që dëgjuan në kishë. Gjithsesi mendonin por asnjëra nuk kishte kuptuar gjë prej asaj që ishte thënë aty.

Isabela: “Shikoni si flasin priftërinjtë me ne dhe na thonë se myslimanët nuk kanë asnjë përgjigje për to, por kur janë ballë për ballë, ata mbesin krejtësisht pa fjalë, nuk japin asnjë përgjigje bindëse. Më erdhi keq që babai im nuk ishte sot aty, sepse kam bindjen që çështja do të përfundonte sot me ta dhe nuk do të kishte nevojë për takime tjera”.

Një shoqe e Isabelës: “Unë mendoj se çështja është aq e ngatërruar sa as babai i juaj nuk do mundet ta qesë në fije...”

Shoqa tjetër: “Në fakt, mua më duket se dogma e besimit tonë është shumë e varfër”. Ndryshe, prijësit tanë nuk do ishin mposhtur ashtu si u mposhtën”.

Isabella: “Zoti na ruajt. Ishte vetëm një diskutim i vogël që u mbushi me dyshime. Besimi jonë është shumë i drejtë, por duhet di-

kush që di ta shpjegojë. Nesër kur të diskutohet rreth shenjtërisë së Jezusit, do të shihni sa keq do të thyhen ata...”

Në fund, duke i dëshiruar njëra-tjetrës të mira, u ndanë dhe shkuan në shtëpitë e veta.

V

Të nesërmen, në kishën e madhe të Kordobës, priftërinjtë u tubuan sërish. Shumë gra kishin shoqëruar Isabelën dhe shoqet e saj për të marrë pjesë në vazhdimin e diskutimit. Priftërinjtë i kapi paniku kur panë se erdhën Umer Lahmi, Maazi dhe ca myslimanë të tjerë.

Umer Lahmi: “Sikurse u morëm vesh dje, hyjnia e Jezusit dhe Salvimi kanë mbetur tema që do të diskutohen sot dhe meqë të dyja temat janë problematike, ne duhet t’i marrim me radhë një nga një”

Pjetri: “Në fakt, të dy temat janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe ju mund të merrni për diskutim cilën të doni”

Umer Lahmi, fillimisht recitoi ca vargje kuranore të kaptinës “Furkanë”. Zëri i Umer Lahmit gjatë recitimit, shkaktoi një të skuqur në fytyrën e Isabelës. Ajo u duk si e turbulluar dhe gati e pavetëdijshme ra në tokë. Pjetri dhe Miçaeli e ngritën dhe e pyetën për arsyen e këtij turbullimi, por ajo duke mos mundur të kontrollojë sytë që i rridhnin lot, u arsyetua se diçka e tillë i kishte ngjarë shpesh muajin e fundit. Disa prej priftërinjve mendonin se kjo gjendje tregonte një infektim të sajën me ‘virusin’ e Islamit. Por, shpejt u qetësua gjendja për të filluar diskutimin.

Umer Lahmi: “Zotërinj! Na është thënë se principet themelore të krishterimit janë hyjnia e Jezusit dhe shëlbimi. Unë dua të shtroj këtu një pyetje, që njëkohësisht do të zbardhë edhe çështjen e shenjtërisë së Krishtit. Ku qëndron domosdoshmëria që ‘Biri i Zotit’ të sakrifikohet për shëlbim, kur secili njeri i devotshëm do të mund ta zëvendësojë si shëlbues për të gjithë mëkatarët. Thjesht, Pse ‘Biri i Zotit’ u kryqëzua?”

Pjetri: “Shëlbimi i Birit të Zotit ishte i domosdoshëm sepse sakrifikimi i ndonjë njeriu tjetër, qoftë profet apo apostull nuk do të ishte

me vend për shkak të mëkatëzimit. Meqë Biri i Zotit ishte edhe njeri, ai ishte edhe i pamëkat, prandaj u sakrifikua për të gjithë mëkatarët e njerëzimit.”

Umer Lahmi: “Mirë, por na del edhe një problem tjetër këtu! A u kryqëzua pjesa hyjnore e tij për salvim, apo pjesa njerëzore në Krishtin? Nëse u kryqëzua pjesa hyjnore, d.m.th., Zoti si njësi i vetëm i pashoq, hoqi mundimet e mëdha dhe vdekja erdhi në personalitetin e Zotit, pra ‘Zoti vdiq’! Nëse u kryqëzua njerëzorja në Krishtin, atëherë përgjigja e juaj do ta humbë forcën, sepse në këtë rast, kryqëzimi i njerëzores nuk ka qenë hyjnorja, pra nuk ka qenë e Zotit por ana njerëzore në Krishtin.

Pjetri: “Sigurisht, Zoti Jezus ka qenë ‘hyjnore e përsosur’ dhe ‘njerëzore e përsosur’. Pra të dyja këto kanë qenë të prezantuara në të. Por edhe ana njerëzore e tij, ashtu si ajo hyjnore, ka qenë e pamëkate dhe kryqëzimi i kujtdo tjetër nuk do të ishte pranuar për salvim”.

Umer Lahmi: “Pra, asnjë njeri në botë nuk kishte të pamëkat dhe tani ‘Vetë Zoti’ duhej të zbriste. U kryqëzua ana e tij njerëzore dhe jo ajo hyjnore? A nuk kishte mundësi ajo ‘hyjnorja’ e Zotit ta krijojë një njeri të pamëkate, nëse vërtet duhej të ishte i tillë për salvim?”

Pjetri: “Vetëm Zoti i di sekretet e Tij! Ne nuk mund të themi pse Ai e bëri një gjë të tillë. Ne e dimë vetëm atë se Zoti erdhi në këtë botë për shëlbim, që na jep të kuptojmë dashurinë e madhe që ka Ai për njerëzimin, se Ai i do krijesat e Tij dhe dërgoi ‘Birin e Tij të vetëm’ sakrificë për të tjerët. Kjo nuk do të arrihej me kryqëzimin e kujtdo tjetër.

Umer Lahmi: “Nëse Zoti ka dashuri aq të madhe për krijesat e veta, pse nuk e dërgoi ‘Birin e vet’ ta kryqëzojë që në fillim, kur krijoi botën? Ne e dimë se edhe para Krishtit kanë jetuar njerëz, pse u manifestua dashuria e Tij pas mijëra vjetësh?

Pjetri: “Ne nuk dimë, kjo është misteri. Misteret e Zotit janë të njohura vetëm për Zotin”.

Umer Lahmi: “Pyetja ende nuk ka përgjigje. Pse nuk u kryqëzua ndonjë tjetër në vend të ‘Zotit’ Krisht?”

Pjetri: “Unë thashë njëherë, njeriu si mëkatar nuk ishte i denjë për shëlbim. Njerëzorja e Krishtit shërbeu si shëlbim sepse kishte në vete simbolin e pafajësisë, ishte i pamëkat...”

Umer Lahmi: “Nëse njerëzorja e Krishtit ishte e pamëkate, çfarë nevojë kishte të ngarkohej me mëkatet e njerëzimit? Me përgjigjet tuaja ju nuk mund të bindeni as veten tuaj. Ç’të keqe kishte bërë ky ‘Biri i Zotit’ që duhej të dënohej për mëkatet e të tjerëve? A u ngarkua me mëkatet e të tjerëve?”

Pjetri: “Ne nuk mund t’i japim Zotit këshilla, Ai ka bërë atë që ka dashtë, e jotja është ta njohësh Atë!”

Umer Lahmi: “Ju e dini se Jezusi u lind nga barku i virgjëreshës Marije. Kjo lindje, a ishte lindje e njeriut apo lindje e Zotit?”

Pjetri: “Zoti është i pafillim, ka qenë ajo njerëzorja në Krishtin që ka lindur”.

Umer Lahmi: “Cili vdiq në kryq, Zoti apo njeriu?”

Pjetri: “Zoti është i pavdekshëm”.

Umer Lahmi: “Pra, edhe lindja edhe vdekja kanë qenë te njerëzorja dhe jo te hyjnorja në Krishtin?!”

Pjetri: “Sigurisht”

Umer Lahmi (duke mbajtur Biblën në dorë): “Është shkruar në Librin e Jobit se ‘gjithkush që lindë nga gruaja është mëkatarë’ dhe meqë lindja ishte e anës njerëzore dhe jo asaj hyjnore, sipas logjikës së Jobit, edhe Jezusi ishte mëkatar, sepse edhe ai u lind nga gruaja’. Tutje, sipas letrave drejtuar ‘Romakëve’ (6:23): ‘Pesha e mëkatit është vdekja’, provon faktin se njeriu është mëkatar. Pyetja lind së- rish, përse Zoti nuk kryqëzoi ndonjë mëkatar tjetër që me shëlbimin e tij të shpëtojë të tjerët prej mëkateve, sepse siç thatë edhe ju mëkatari nuk mund të ‘paguajë’ për mëkatet e të tjerëve, pra Krishti nuk mund të shërbente për shëlbim?!”

Pjetri: “Unë gjithashtu thashë se të gjitha këto janë mistere hyjnore. Zoti ka vepruar ashtu si ka dashur. Si mundemi ju ose unë t’i japim kritika?”

Umer Lahmi: “Në qoftë se religjioni juaj është i bazuar në miste- ri hyjnore, përse na keni ftuar këtu që të humbisni kohën tonë dhe të tuajën?”

Meqë Isabela ishte e interesuar në çështjet teologjike, gjatë gjithë kësaj kohe kishte dëgjuar diskutimin e bërë me shumë kujdes. Tani ajo ishte edhe më e sigurt se të gjithë priftërinjtë e tubuar këtu nuk ki- shin asnjë përgjigje dhe se të vetmen zgjidhje që dinin ata ishte mis- teri hyjnor, por a mjaftonte kjo?

Një qetësi e shkurtër zotëroi në sallën e kishës. Vetëm atëherë më- suesi i Isabelës e mori fjalën.

Miçeli: “Vëllezër, sot është konfrontimi ndërmjet Krishterimit dhe religjionit Muhamedan. Ju e dini ç’është religjioni Muhamedan? Ky religjion lejon martesën me katër gra. Urdhëron diskriminimin dhe vrasjen e jomyslimanëve. Vetë profeti i tyre ka qenë i martuar me njëmbëdhjetë gra.....”

Umer Lahmi: “Nëse ju nuk keni përgjigje në pyetjet e mia, thojeni të qartë e pastaj për gjithë kritikën që mund të keni për Isla- min, unë jam i gatshëm të jap sqarime. Ma merr mendja, në vend që të jepni përgjigje e të sqaroni pyetjet e shtruar, tani merreni me fye- rjen e të tjerëve në ‘shtëpinë tuaj’, kjo nuk hyn në asnjë kod moral. Tani i drejtohem Isabelës, le të më thotë ajo vetë nëse sjellja e priftërinjve sot është sjellje korrekte?”

Isabela: “Unë e dëgjova diskutimin me shumë kujdes që në fillim dhe jam e befusuar që as Pjetri as Miçaeli, nuk u dhanë përgjigje pyetjeve tuaja. Kërkesa e Umer Lahmit është plotësisht e arsyeshme, t’u përgjigjeni pyetjeve ose të pranohet humbja e debatit. Unë mendoj se ju nuk do ta bëni as njërën as tjetrën, prandaj është më mirë që tani të përfundohet diskutimi dhe në mënyrë që religjioni i krishterë të mos mposhtet edhe më shumë dhe të mos e tregojë edhe më shumë paaftë- sinë e vet, qoftë nga mosdija e juaj, qoftë nga...”

Pjetri: “Isabelë, duket se je hidhëruar që ke ardhur në një konkluzion të tillë të pakuptimtë. (Duke iu adresuar audiencës) Kjo vajzë është e infektuar me djallin, është larguar nga Krishti dhe nuk ka dy- shim se ka humbur mendjen”

Isabela: “Nuk ke arsye ta hedhësh inatin tënd në mua. Ju më mirë përgjigjuni pyetjeve që shtruan myslimanët, ose mbylleni diskutimin dhe pranoni humbjen. Unë nuk dua që të më ngarkoni me akuza, por nëse ky është shpërblimi për gjithë interesimin tim për fenë, unë prapë jam e gatshme”.

Miceli: “A nuk mund të heshtësh? Ti flet dhe vetëm flet. Ne u jemi përgjigjur të gjitha pyetjeve të tyre. Nëse ju keni guxim dhe njohuri më të mëdha, eja këtu dhe përgjigju pyetjeve të tyre.”

Një prift: “Duket se kjo vajzë fshehtësisht ka dal prej besimit. Si do t’u përgjigjet ajo pyetjeve të myslimanëve. Babai i saj duhet të informohet për këtë, kurse ajo duhet të dënohet ashpër”.

Katherina (shoqja e Isabelës): “Është e qartë se ju të gjithë bëtë të padrejtë para Isabelës. Disa e quajtën nervoze, të tjerët e kërcënuan, por asnjëri nuk e vuri mendjen te çështja kryesore për ç’gjë jemi tubuar sot. Isabela ka të drejtë të thotë se ju sot nuk kishit përgjigje në pyetjet e shtruara nga myslimanët, dhe kjo nuk do të thotë se ajo mohoi krishterimin. Ju sot u treguat të pavlerë dhe i dhatë krishterimit një emër të keq në llogari të paaftësisë tuaj”.

Pjetri: “Nxirrni jashtë këto vajza nga këtu, kush i lejoji ato të ndërhyjnë në bisedat tona?”

Umer Lahmi: “Nëse më lejoni, do ta sqaroja unë ç’deshi Isabela të thoshte”.

Miceli: “Ju nuk mund të hyni në bisedat ndërmjet nesh”.

Një prift tjetër: “Po në qoftë se Isabela dhe Katherina kanë dalë prej besimit?”

Miceli: “Këtë nuk mund ta themi tani në këtë moment. Këto janë çmendur dhe nuk e dinë se për sqarimet lidhur me këto pyetje, duhen muaj ndoshta edhe vite për t’i kuptuar”.

Duke folur e duke hedhur akuza mbi dy vajzat, priftërinjtë u shtatën tek dëgjuan zërin e Umer Lahmit, që nisi të recitojë një pjesë nga kaptina Kur’anore “Merjem”. E gjithë asambleja mbeti e habitur. Priftërinjtë vendosën gishtërinjtë në veshë, për të mbyllur veshët që të mos ‘infektoheshin’ zemrat e tyre me ‘virusin’ e Islamit! Që Kur’ani të mos efektonte zemrat e tyre! Meqë aty bëhej fjalë për Jezusin dhe

nënë e tij, duke i liruar ata nga akuzat që i bënin çifutët te të krishterët patën efektin e vet. Isabelës, me të dëgjuar recitimin i vinte një pamje tjetër dhe i dobësohej fuqia. Por, kësaj here u tregua më e fuqishme për ta fshehur në vete këtë ndikim. Pasi Umer Lahmi mbaroi recitimin, ajo u çua e foli.

Isabela: “Zotërinj, unë mbetem dëshmitare se unë jam e krishterë dhe nuk dua të lejoj të mposhtet krishterimi. Unë nuk mendoj se pyetjet e shtruara nuk kanë përgjigje, por dëshmoj paaftësinë e priftërinjve. Përsëritja e vazhdueshme e tyre se vetëm ‘shpirti i shenjtë’ mund të na ndihmojë në kuptimin e kredos së krishterë, nuk është përgjigje e logjikshme, kurse myslimanët përfitojnë nga dobësia e tyre. Shpresoj që përgjigjet tuaja ta heqin dyshimin tim dhe kërkoj që diskutimet të vazhdojnë”.

Një prift: “Ne nuk na duhen diskutimet me këto jobesimtarë! Diskutimet me ta veç kanë luhatur besimin tonë. Ajo që dua të them unë është se këta jobesimtarë duhet që tani të përjashtohen nga kjo kishë!”

Një prift tjetër: “Unë mendoj që sugjerimet të bëhen me gjakftohtësi. Dhe se çështja duhet të vendoset pasi të shqyrtohet mirë. Por, gjithsesi mendoj që diskutimet duhet të ndërpriten këtu, sepse janë fare të panevojshme...”

Umer Lahmi: “Zotërinj, ju jeni shumë krenarë dhe lavdëroheni me mësimet e ‘Zotit tuaj’ se ‘ati që të bjerë në një rënfaqe t’ia ktheni edhe tjetrën’! Por ajo që po shoh e po dëgjoj këtu është krejt diçka tjetër! As nuk u kemi ardhur me dhunë, as nuk kemi kërkuar të vijmë këtu. Ju vetë na keni ftuar! Tani na thoni të ndërpresim diskutimin dhe ne menjëherë do të largohemi. Por, më duhet t’ju bëj me dije se ne e kemi kryer obligimin tonë dhe se Allahu nuk do të na çojë mundin kot. Tani më thoni, të shkojmë apo të vazhdojmë diskutimet?”

Pjetri: “Të respektuar, puna është se ju nuk mund të kuptoni realitetin e fesë së krishterë dhe as që keni ardhur këtu për këtë qëllim! Nëse dëshironi që të vazhdoni diskutimin, ju duhet t’u përgjigjeni pyetjeve të mia”

Umer Lahmi: “Shumë mirë, jemi të gatshëm të dëgjojmë pyetjet tuaja, e ne me ndihmën e Allahut do t’u kënaqim me përgjigjet tona”.

Pjetri: “A e vërteton Kur’ani Biblën, pra a besoni në Bibël?”

Umer Lahmi: “Sinqerisht, Kur’ani vërteton Biblën dhe të gjithë myslimanët besojnë në ‘Teuratin’, ‘Inxhilin’, ‘Psalmet’... pra të gjitha librat që u kanë zbritur profetëve”.

Pjetri: “Atëherë pra, pse nuk besoni në Biblën tonë?”

Umer Lahmi: “Sepse ajo që keni ju nuk është Bibla! Ne nuk besojmë në aso Biblash, vetëm pse dikujt ja është mbushur mendja ta quaj Bibël! Meqë ju më pyetët për Biblën që vërteton Kur’ani, kjo që keni ju, nuk është ajo Bibël!”

Pjetri: “Nëse Bibla që përmend Kur’ani është ndryshe nga kjo që kemi ne, jepe dëshminë”.

Umer Lahmi: “Sepse Kur’ani, kur vërteton Biblën origjinale, e falsifikon këtë duke paraqitur të metat dhe falsifikimet...”

Pjetri: “Po, cilat janë të metat dhe falsifikimet e Biblës sonë?”

Umer Lahmi: “Për shembull, Bibla thotë se Jezusi ka qenë ‘i mallkuar’ dhe për këtë shkaku kryqëzua. Kurse Kur’ani e ka quajtur ‘Fjalë e Zotit’ dhe ‘Shpirt i Zotit’ dhe se ai ka qenë ‘i nderuar’ në këtë dhe në jetën tjetër...”

Një zë: “Jeni gabim, në Bibël është thënë se ai është Zot?!”

Umer Lahmi: “Aq më e çuditshme, që sipas jush ‘Zoti’ të jetë mallkuar! Edhe më keq, ju e mallkoni Jezusin duke e njohur për ‘Zot’, duke mos menduar e duke mos pyetur si mundet Zoti që është Superior i çdo gjëje të meritojë mallkimin?! Është djalli ai që meriton mallkimin, jo Zoti. Kurse islami e identifikon Krishtin si njeri të pamëkat dhe të pafajshëm. Tani përdoreni logjikën tuaj nëse është më i meritueshëm ‘Zoti’ i mallkuar, apo njeriu i ruajtur prej mëkateve?”

Pjetri: “Pyetja ishte përse nuk besoni në Bibël, kurse ju sërish u hodhët në pyetje! Nëse ju keni ndonjë Bibël origjinale për të cilën flet Kur’ani, na sillni neve ta shohim!”

Umer Lahmi: “Ju nuk keni të drejtë ta kërkonti këtë prej nesh. Nëse ju do të pajtoheni me ne, se Bibla që keni nuk është Bibla origjinale, atëherë kërkojeni Biblën origjinale nga ne. Unë vetëm ua tre-

gova se Kur’ani nuk vërteton Biblën aktuale, por falsifikimin e tij, duke paraqitur shumë qartë të metat dhe falsifikimet e Bibës aktuale. Si pra mundet që Bibla ta paraqesë Krishtin si provokues dhe të vritet në kryq e të jetë Bibla që vërteton Kur’ani? Kur’ani citon Krishtin të ketë thënë ‘Unë jam shërbëtor i Allahut’ dhe pastaj ka thënë për të ‘As nuk e vranë, as nuk e kryqëzuan’. Kështu pra, Kur’ani nuk po e vërteton, por po e dëshmon të falsifikuar.”

Pjetri: “A nuk e ka quajtur Kur’ani Jezusin ‘Fjalë e Zotit’ dhe ‘Shpirt i Zotit’? A nuk është kjo dëshmi se ai ka qenë përmbi njerëzoren?”

Umer Lahmi: “Është e vërtetë se Kur’ani e ka quajtur Jezusin ‘Fjalë e Zotit’, por gjithashtu ka thënë që po të shndërrohen të gjithë oqeanet në ngjyrë dhe të gjitha pyjet në lapsa, nuk do të shtereshin fjalët e Zotit, pra Jezusi ishte vetëm njëra nga këto fjalë. As edhe konsiderimi i Jezusit ‘Shpirt i Zotit’ nuk e ngrit atë në nivelin mbinjerëzor, sepse të njëjtën shprehje Kur’ani ka përdorur edhe për Ademin (as) ‘Kam futur shpirtin tim në të’, pra në këtë pikëpamje edhe Ademi (as) është si Jezusi. Nëse Krishti është Zot, edhe Ademi është Zot!”

Pjetri: “Nëse Kur’ani e ka quajtur edhe Adamin Zot, atëherë Kur’ani është i gabuar sepse asnjë tjetër nuk është ‘Shpirt i Zotit’ veç Jezusit”.

Umer Lahmi: “Ti po thua se Kur’ani është i pavërtetë, por kur ishte puna ta definosh shenjtërinë e Krishtit, kërkoje dëshmitë Kur’anore! Dhe unë t’i dhashë dëshmitë se ai nuk ishte ‘hyjnor’. Nëse ai ishte ‘Zot’ vetëm pse i është thënë ‘Shpirt i Zotit’, atëherë edhe Ademi (as) është ‘Zot’. Dhe nëse ju e mohoni Kur’anin, pse kërkuat dëshmitë Kur’anore mbi Jezusin?”

Isabela: “Por, ju besoni në shenjtërinë e profetit Muhamed, megjithëse ai ka qenë shkaktar i gjakderdhjeve të mëdha dhe ka urdhëruar vrasjen e jobesimtarëve?”

Umer Lahmi: “Allahu na ruajt. Kërkoj Mbrojtjen e Allahut prej të gjitha këtyre shpifjeve dhe prej këtyre besimeve të gabuara. Ne e konsiderojmë profetin tonë vetëm si njeri – Profet. Esenca e besimit tonë është ‘Nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është

profet i Tij'. Çdonjëri që mund ta veçojë profetin tonë si 'Zot', është mosbesimtar dhe i ka shpallur luftë Islamit. Edhe ai mendimi se profeti Muhamed ka qenë shkaktar i gjakderdhjeve është plotësisht e gabuar. Është e vërtetë se ai luftoi mosbesimtarët, por vetëm ata që e luftuan atë dhe fenë që ai solli nga Zoti. Kurani këshillon luftë me ata që sulmojnë besimtarët, pra në vetëmbrojtje..."

Një pauzë e shkurtër në sallë. Kishte mu këtu në këtë takim priftërinj të tillë, që si gjithëherë, për ta luftuar Islamin përdornin shpifje të llojllojta. Ishin këto priftërinj, që për të mposhtur Islamin, gënjenin besimtarët e tyre se myslimanët e konsiderojnë Muhamedin për Zot! Pyetja e Isabelës ishte rezultat i kësaj propagande.

Miceli: "Ju thatë disa herë se Bibla është e falsifikuar dhe se kjo që kemi ne nuk është ajo që është shpallur prej Zotit, megjithëse ato janë sjellë përmes dishepujve me frymëzimin e "Shpirtit të Shenjtë", të cilët edhe Kur'ani i paraqet si besimtarë. Pra edhe të krishterët i kanë pranuar si të tillë.

Umer Lahmi: "Kjo është vetëm një pyetje, nëse Bibla aktuale ka qenë e përmbledhur nga Dishepujt që u atribuohen, apo nga ndonjë mosbesimtar që i ka shkruar në emrin e tyre. Madje as vetë të krishterët nuk pajtohen që ato i kanë përmbledhur dishepujt! Kur'ani nuk vërteton ndonjë Bibël të përmbledhur nga dishepujt, Kur'ani vërteton Bibën e shpallur nga Vetë Zoti. Pra në këtë kontekst vërteton Biblën që i është shpallur Krishtit (as) drejt nga Zoti, siç thuhet në Kur'an 'ne i kemi zbritur librin Isaut (a.s)'. Kurse vetë Krishti thotë 'Zoti më ka zbritur librin'. Nga ana tjetër, ju vetë po thoni se bibla është përmbledhur nga dishepujt, ndërsa ajo Bibla që vërteton Kur'ani i është zbritur Krishtit".

Vetëm atëherë u ngrit kryepriifti (babai i Isabelës) dhe foli.

Kryepriifti: "Çka na shërbejnë këto diskutime këtu? Ju keni ftuar jobesimtarët në kishë dhe po mposhtni besimin e krishterë. Çdo ditë më vijnë besimtarët e krishterë tek unë dhe më thonë se të krishterët janë luhatur në besimin e tyre. Më thonë edhe që vajza e juaj Isabela dyshon në fenë e saj! Ty Isabelë kush të ka lejuar të marrësh pjesë në këto diskutime? Ti studion fshehtësisht Kur'anin?! Unë e di ç'bën ti, e

di edhe atë që ke filluar të çmendesh. Kështu do të ndodhë edhe me ju të tjerët që hyni në debate e në diskutime me këta mosbesimtarë. Nëse në të ardhmen lejoni sërish një gjë të tillë, të gjithëve do t'u shërojë"

Një priift: "Ati ynë i shenjtë, ajo që thatë ju është e vërtetë. Sigurisht, kjo që po bëhet këtu është një diskutim fare i panevojshëm. Por, a do që krishterimi të vdesë në gjithë Spanjën? Nëse pra ne nuk u dalim përballë këtyre mosbesimtarëve, ne nuk do të kemi më vend këtu. Dua të përmend edhe atë se asnjëri nga ne nuk jemi në gjendje t'u përgjigjemi akuzave të myslimanëve. Dhe nga sinqeriteti po them, se vetëm ndihma e juaj do të na nxjerrë nga ky problem, meqë ju jeni njeriu më i meritueshëm që ka aftësitë e duhura t'u përgjigjeni këtyre pyetjeve të shtruar. Shpresoj që ju, me sinqeritetin dhe me njohuritë tuaja maksimale për fenë e shenjtë të krishterë, do t'i kënaqë myslimanët dhe kjo do të jetë hera e fundit që këto të ngrenë probleme të këtilla.

Kryepriifti: "Ju vetë e keni shkaktuar problemin duke i ftuar këta myslimanë këtu. Është e vërtetë që ju nuk keni qenë në gjendje t'u përgjigjeni as pyetjeve më të thjeshta që kanë ngritur myslimanët dhe jeni treguar shumë injorantë, edhe pse jeni studiues të teologjisë.

Miceli: "Po, ne kemi pranuar një gjë të tillë, sepse ata janë treguar të gatshëm e na kanë premtuar se pas përgjigjeve të arsyeshme që ne do t'u japim, ata do të mohojnë Islamin e do të pranojnë fenë tonë të krishterë. Premtimin e tyre e kanë bërë me shkrim, prandaj kemi pranuar diskutime me ta.

Kryepriifti (Umer Lahmit): "Thuaj, cila ishte pyetja e juaj?"

Umer Lahmi: "Mënyra se si u paraqitet, na bën të ndërpresim diskutimet me ju, por meqë ne jemi kërkues të vërtetës, unë do të pranoj diskutimet vetëm në qoftë se ju dëgjoni me vëmendje atë që ne themi".

Kryepriifti: "Ju nuk duhet t'i merrni për të madhe fjalët që thashë unë, dhe nëse ndiheni të ofenduar, kërkoj falje. Po duket se ju vërtet jeni kërkues i së vërtetës dhe nuk kam dyshim se do të gjeni ndihmën e Jezu Krishtit për ta kuptuar atë. Pra, ju mund të vini nesër në shtëpinë time, ku të gjitha dyshimet e moskuptimet tuaja do të eliminohen.

Edhe ju të tjerët (priftërinj) mund të merrni pjesë në diskutim, në mënyrë që në të ardhmen, të mësoni të flisni me myslimanët. Pra, nesër që në mëngjes jeni të mirëpritur në shtëpinë time”.

VI

Kishte ditë që Isabela e ndjente veten të shqetësuar. Mentalisht ishte e okupuar me pikëpyetjet e mëdha lidhur me krishterimin dhe islamin. Pas diskutimeve ndërmjet Umer Lahmit e priftërinjve, besimi i saj ishte luhatur, sepse priftërinjtë nuk kishin përgjigje mbi çështjet që kishin ngritur myslimanët.

Kishte një muaj që ajo kishte bërë takime të fshehta me Umer Lahmin dhe kishte marrë informata mbi esencën e besimit islam. Përmes tij, ajo kishte takuar edhe këshilltarin e fesë Islame të Kordovës Ziad bin Umer, që kishte marrë famë në gjithë Spanjën, jo vetëm si njohës i mirë i çështjeve fetare, por edhe për devotshmërinë që posedonte.

Përmes këshillave dhe mënyrës se si ai i qartësonte çështjet e fesë, Isabela kishte fituar një simpati ndaj islamit, por gjithsesi nuk donte të braktiste krishterimin, megjithëse e kishte një bindje se ato mësimet ishin të përziera dhe kontradiktore.

Kryepriifti e kishte caktuar takimin me Umer Lahmin të nesërmen në shtëpinë e tij, ku kishte pranuar edhe asociacionin e tij, por kishte ftuar edhe priftërinjtë e tjerë.

Që në mëngjes, Umer Lahmi me kompaninë e tij kishte mbërritur në shtëpinë e Kryepriiftit, që njëkohësisht ishte edhe shtëpia e Isabelës. Fillimisht u trajtuan me respektin e duhur. Aty kishin ardhur më shumë se 40 priftërinj e dijetarë të tjerë të cilët do të vazhdonin rundin e tretë të bisedimeve në çështjet e islamit dhe krishterimit.

Kryepriifti: “Unë e di pyetjen që do ta shtroni sot, por nuk e kam për qëllim të hyjë në detaje e biseda të gjata. Unë sot, bisedimet e gjata do t’i shkurtoj në një ose dy fjalë që do të tregojnë gjithë esencën e besimit të krishterë. Pastaj do të bëni edhe ju diçka të tillë dhe pa diskutime të gjata do të definojmë se cila nga fetë që posedojmë është më e drejta? A pajtoheni edhe ju me këtë?”

Umer Lahmi: “Unë nuk kam asnjë kundërshtim dhe pajtohem në cilindo subjekt dhe mënyrë të diskutimit që ju dëshironi të zgjidhni. Vërtet, vetëm duke mësuar e diskutuar mbi islamin e krishterimin, e vërteta do të dalë në shesh.

Kryepriifti: “Bravo, ndihma e Shpirtit të Shenjtë do të jetë me ju dhe shpresoj që kësaj radhe ta definoni lehtësisht besimin e gabuar prej besimit të drejtë. Tani që u pajtuat me mënyrën dhe temën e lirë të diskutimit, ju patjetër do të pajtoheni me mendimin tim se çdo religjion bazohet mbi principet themelore. Unë dua të shtroj para jush esencën e krishterimit që nuk është më shumë se një fjalë e vetme, dhe pastaj të ma jepni edhe ju esencën e islamit në një fjalë të vetme... pajtoheni?”

Umer Lahmi: “Plotësisht, si të doni ju...”

Kryepriifti (priftërinjve): “Vetëm shikoni, kjo është mënyrë e veçantë e diskutimit, kur me një fjalë të vetme zbulon gjithë çështjen. (Umer Lahmi) Dëgjo me kujdes, esenca e krishterimit është e bazuar në ‘dashuri’, pra ‘Zoti është dashuri’. Në këtë fjalë të vetme janë themelet e krishterimit. Tani është radha e juaj të jepni esencën e islamit në një fjalë të vetme.”

Umer Lami: “Unë jam krenar të them se edhe islami e paraqet esencën e besimit në një fjalë të vetme që mbulon gjithë principet themelore dhe kjo quhet Tauhidi – Njëni”.

Kryepriifti: “Nëse ‘Njësia’ është rrënja e Islamit, atëherë dashuria është e përjashtuar. Veç kësaj edhe ne themi se njësia është esenca e besimit tonë.”

Umer Lahmi: “Nëse ‘Njësia’ është esencë e besimit tuaj, atëherë atë do të duhej ta vëni përpara, pse thotë se dashuria është esencë e besimit tuaj? Kur e pranoni ‘Njësia’ për esencë, dashuria është e përjashtuar prej saj. Nëse ‘Njësia’ është ndarë nga dashuria, atëherë e ka humbur kuptimin e duhur. Kur e pranoni dashurinë për esencë të besimit ke përjashtuar Njësia për esencë të saj!”

Kryepriifti: “Çështja është se dashuria është burim i ‘Njësia’ dhe jo ‘Njësia’ burim i dashurisë!”

Umer Lahmi: “Kjo mund të jetë vetëm një logjikë e juaj. Nëse ‘Njënia’ vjen prej dashurisë, atëherë vetë fjala ‘Njëni’ është e pakuptimtë, sepse pa ‘Njëni’ që është veçori e Allahut, përjashtohet dashuria e Allahut që varet nga njohuritë e hyjnore dhe ‘Njënisë’, pra pranimi i hyjnore, prandaj ‘dashuria’ nuk provon dashurinë e Allahut”.

Kryepriifti: “Ju filluat me diskutime të gjata. Ajo që desha të them unë është se dashuria nuk ka vend në islam!”

Umer Lahmi: “Nëse dashuria nuk ka vend në islam, atëherë del se dashuria nuk ekziston fare në botë. Nga ana tjetër në krishterim nuk mund të gjesh asnjë gjurmë nga dashuria. Fjala dashuri në këtë rast mund të jetë vetëm një fjalë verbale e zhveshur krejt prej standardeve.”

Kryepriifti: “Shiko... është i njohur slogani i shkrimeve tona se ‘Zoti është dashuri’, a nuk është kjo një dëshmi e dashurisë?”

Umer Lahmi: “Këtu nuk ka asnjë dëshmi... derisa standardet e dashurisë të vihen në praktikë, në zbatim, dashuria mbetet vetëm një shprehje verbale...”

Kryepriifti: “Tani dëgjo standardet e dashurisë, a e kanë quajtur shkrimet tona Zotin si At, a nuk i do Ati fëmijët e vet?”

Umer Lahmi: “Përsëritja e shpeshtë e fjalës ‘dashuri’ nuk i shton kuptimin e saj, në qoftë se nuk plotësohen konditat e saj. Në qoftë se një njeri e do një tjetër, ai duhet ta dëshmojë këtë me sakrificë dhe jo vetëm me një shprehje ‘të dua’, sepse shprehja ‘të dua’ është vetëm një fjalë. Prandaj, islami e ka shfaqur shërbimin dhe devotshmërinë si krishterim të dashurisë që është vetëm një emër për sakrificën e jetës. Kur’ani i Shenjtë i thotë profetit ‘O profet, nëse pretendon se dashuron, më adhuro Mua. Kur ta kesh kaluar këtë test, Zoti do të dojë ty’. Këtu janë të shfaqura standardet e dashurisë dhe ka bërë klasifikimin ndërmjet dashurisë së sinqertë dhe dashurisë së falsifikuar. Në religjionin tuaj, dashuria nuk ka kriter, secili mund të ngrihet e të thotë se e do Zotin”.

Kryepriifti: “Ju sërish me diskutime të gjata. Unë desha që me pak fjalë të përmbledh çështjen dhe të mbyll diskutimin. Sidoqoftë, të

pyes, nëse Kur’ani do ta quante Zotin ‘At’, cili do të ishte pozicioni i dashurisë atëherë...?”

Umer Lahmi: “Po të përdorte Kur’ani shprehjen ‘At’ për Zotin, do të ishte dëshmia më e madhe për të metat e tij. Islami nuk përdor asnjëherë këtë shprehje të pakuptimtë për Zotin?”

Kryepriifti: “Ju jeni shumë mendjeshkurtër kur e quani shprehjen ‘At’ të gabuar. Tani më thuaj shkurt, cilën shprehje më të mirë ka përdorur islami në vend të shprehjes At?”

Një pauzë e vogël. Një shenjë nervoze paraqitej në personalitetin e kryepriiftit, athua se donte të eksplodonte.

Umer Lahmi: “Unë nuk mendoj se ka ndonjë arsye për të humbur durimin. Shprehja ‘At’ mendoj se është e gabuar për shkak se i atribuon bij Allahut, gjegjësisht i atribuon Allahut rolin e prindit, në çka ka çuar mendimin se Zoti ka fëmijë. Ju gjithashtu besoni në hyjninë e Krishtit. Një shprehje më të mirë, islami ka përdorur fjalën ‘Rab’ - Gjallërues, që implikon qenshmërinë e gjallërimit prej fillimit deri në fund, dhe kujdesi për këtë gjallërim nuk ka fund! Pra, me përdorimin e shprehjes ‘gjallërim’ islami dëshmon se gjallëria e Allahut kurrë nuk mbaron. Por, koncepti i Atit implikon se Ati do të kujdeset për fëmijën e tij deri në një kohë, e pastaj do ta braktisë atë. Veç kësaj, Ati do të kujdeset për fëmijën e vet vetëm në çështjet fakultative, por jo edhe në çështjet jashtë kontrollit të Tij. Pra, nëse fëmija sëmuret, ati s’mund ta kurojë sëmundjen e tij. Ndërsa, gjallërimi i Tij është nuk është i njëjtë, sepse Ai ka forcë mbi gjithçka dhe asgjë nuk është e pamundur për Të. Kjo provon faktin që në vend të ‘Atit’ të përdorë ‘Gjallërinë’, është më e përshtatshme për Allahun dhe veç kësaj, gjallëria është indikative për ‘Njëninë e Zotit’, ndërkohë që ‘At’ përbën partnershipin e Zotit në botë”.

Kryepriifti: “Efekti për ‘gjallërim’ siç thoni ju, nuk dëshmon asgjë përderisa mbyllë sytë ndaj dashurisë së Atit, pra si mund ta pranosh shprehjen që nuk ka dëshmi dhe nga ana tjetër nuk mund të injorosh faktet e dashurisë së Atit.”

Umer Lahmi: “Duket se kredoja e shëlbesës ka ngushtuar vizionin tuaj, ndryshe nuk do të kishe menduar kështu. Ne shohim çdo ditë

se fëmija gjallëron në barkun e nënës, pastaj në fëmijërinë, në rininë e në pleqërinë e tij gjallërimi i qëndron në kontinuitet”.

Kryepriifti: “Në shkrimet tona thuhet, se Zoti ka dashuri të atillë ndaj njerëzve, sa ka sakrifikuar djalit të vetëm për njeriun. Çfarë dëshmie tjetër ju duhet juve, që të bindeni për dashurinë e madhe, kur Ati sakrifikon atë që e do më shumë për dashurinë?”

Umer Lahmi: “Ju mendoni se Ati është Ai që ka sakrifikuar birin e Tij të pastër e të pafajshëm, për hir të njerëzve të prishur e mëkatarë, dhe kështu dashuria e Atit është manifestuar përmes vrasjes së të birit të Tij të pafajshëm?! Por, Gjallëruesi nuk bën padrejtësi tek askush! Kur’ani thotë se ‘askush nuk jep llogari për mëkatit e të tjerëve’. Tani, Ati juaj vret ose lejon vrasjen e fëmijës të Tij të vetëm! Në qoftë se kryqëzimi dhe mbytja e djalit të Tij të pafajshëm të ju quhet ‘dashuri’ atëherë ne nuk kemi të drejtë as ta shqiptojmë këtë shprehje...”

Kryepriifti (priftërinjve): “Fillimisht mendova se ky njeri është shumë afër besimit të drejtë dhe mëshirës së Jezusit. Por tash po e shoh se ky është vetëm një mosbesimtar. (Umer Lahmit) Ju keni zemrën e zezë dhe Jezu Krishti nuk ju pranon. Tani dilni jashtë nga këtu, unë nuk dua të flas më me ju. Ju keni ardhur vetëm të na ngrini nervat tona. (Priftërinjve) Ju nuk duhet të keni konsideratë për këta njerëz, ju e patë edhe vetë sa kokëfortë që janë. Ata nuk pajtohen në asnjë rast me ne...”

Umer Lahmi: “Zotëri...”

Kryepriifti: “Dilni jashtë, e shoh dhe e kuptoj se me çfarë qëllimesh keni ardhur... jashtë...”

Nuk kishte mbetur asnjë shteg për vazhdimin e diskutimeve. Umer Lahmi dhe kompania e tij dolën nga shtëpia e kryepriiftit, duke iu lutur Allahut që fitorja të jetë në anën e tyre.

Isabela bashkë me shoqet e saj kishin dëgjuar me kujdes gjithë diskutimet e bëra. Në mbrëmje, ato u takuan bashkë dhe diktuan e analizuan bisedat që ishin bërë ndërmjet kryepriiftit e Umer Lahmit. Pasi kishte analizuar diskutimet, Isabela kishte humbur besimin dhe kishte ardhur në përfundim se krishterimi ishte fe që i mungonte edhe kre-

doja edhe principet. Fillimisht kishte fituar bindjen dhe shpresonte se nuk është fajtorë feja e krishterë, por Miçaeli, Pjetri e ndonjë tjetër që ishin treguar krejt injorantë para Umer Lahmit. Ai gjithnjë shpresonte se kryepriifti që ishte edhe babai i saj, do të kishte përgjigje në çështjet që ngrinin myslimanët. Por, pasi kishte dëgjuar diskutimin e fundit në shtëpinë e saj, nuk i kishte mbetur alternativë tjetër vetëm të bjerë konkluzionin e saj se krishterimit nuk kishte mbetur gjë tjetër veçse një pezhishkë merimange.

Tani kishte kaluar një muaj, që një zgjim mental kishte zënë vend në mendjen e Isabelës. Ajo ilegalisht bënte takime me Umer Lahmin dhe përmes tij edhe me njerëz tjerë të ditur si Zijad bin Umer dhe njerëz tjerë të ditur të Kordovës. Ajo kishte fituar devotshmëri në studimin e Kur’anit dhe e vërteta islame kishte lëshuar rrënjë në mendjen e saj. Ajo bënte studime komparative për Kur’anin dhe Biblën që të definonjë të vërtetën nga e pavërteta. Merrej me studimin e ‘Unitetit të Zotit, profetësisë, Kur’anit, salutimit, shëlbësës, domethënies së mëkatit dhe akteve njerëzore si dhe konsekuencat e tyre.

Tashmë ajo kishte pushuar së qeni një krishtere e devotshme dhe ishte anuar tërësisht kah Islami. Nuk ishte e largët dita që përfundimisht do ta braktiste fenë që kishte mbajtur qëkur kishte lindur.

Po sa do t’i kushtonte asaj një gjë e tillë. Çfarë provash do të jepte e me çfarë vështirësish do të përballej? Ajo duhej të refuzonte babanë, nënën motrën dhe miqtë e familjes. Si do të vinte e ardhmja e saj? Po, sikur ta mbante këtë të vërtetë të fshehur, atëherë ajo do të ishte fajtorë para Allahut - mendonte.

Umer Lahmi e kishte këshilluar, që në çdo mëngjes të recitojë dhjetë herë lutjen ‘O Zot, më mbush mua me bindjen e të vërtetës dhe më mbaj mua në mbrojtjen Tënde’.

- vijon -

Hajrudin S. Muja

ISABELA

(Based on the novel "Isabella" - by Maulana Mohammad Saeed)

(Summary)

New York 2008

The sun was about to set in one of the most famous gardens of Spain, which was renowned for the beauty of its flowers, which was frequently called "the Garden of Eden" by its visitors. The song of the nightingales accompanied the sounds of the children playing there.

Isabela – the daughter of the most famous Spanish priest, who had still not turned 17, together with two friends of her, were sitting in a corner gazing at the beautiful things God had assembled there.

خير الدين موييا

إساييلا

(حسب الرواية بنفس العنوان للكاتب مولانا محمد سعيد)

(خلاصة البحث)

نيويورك 2008

بالحديقة المشهورة في اسبانيا، المعروفة بجمال زهورها ذات الالون المتنوعة و التي كانت تسمى من كثير من الزوار "حديقة أدن" كادت الشمس أن تغيب مع اغاني البلابل و ضجة الاطفال اللاعبين.

و كانت اساييلا – ابنة أشهر قسيس في اسبانيا و التي لم نتم سبعة عشر ربيعا من عمرها كانت تجلس مع زميلتين لها بالحديقة و كانت تنظر إلى الجمال البارع الذي وهبه الله جل و علا.

Tajib Salih - (Sudan)

KOHA E SHPËRNGULJES NË VERI - (6)

- 9 -

Bota për një çast u kthye mbrapsht. Dashuria? Dashuria nuk bën një gjë të këtillë. Kjo është urrejtja. Unë jam urrejtës, hakmarrës dhe armik në brendi, patjetër duhet të ballafaqohem me të. Megjithatë, në mendjen time ekziston diçka që e kupton ironinë e gjendjes. Unë do të filloj prej aty ku përfundoi Muastafa Seidi, por ai së paku e zgjodhi, kurse unë nuk kam zgjedhur asgjë. Rrezet e diellit qëndruan për një çast në horizont mbi anën perëndimore pastaj shumë shpejt humbën. Vendin e tyre e zunë ushtritë e errësirës që ishin vendosur aty afër, të cilat e vërshuan botën. Po t'i thosha asaj të vërtetën ajo nuk do të vepronte ashtu siç veproi. E humba luftën sepse unë nuk e dita dhe nuk e zgjodha atë. Për një kohë të gjatë qëndrova para derës së hekurt. Unë tani jam vetëm. Nuk ka shpëtim dhe nuk ka strehim, nuk ka siguri. Bota ime ishte e gjerë jashtë. Tani është ngushtuar dhe zvogëluar sa që unë tani jam bota dhe nuk ka botë tjetër përveç meje. Ku janë pra ato rrënjë të lashta? Ku janë kujtimet e jetës dhe të vdekjes? Çka i ka ndodhur karvanit dhe fisit? Ku shkuan britmat e dhjetëra dasmave, vërshimeve të Nilit, aromave të erërave të verës e të dimrit prej veriut në jug? Dashuria? Dashuria nuk vepron kështu. Kjo është urrejtja. Ja

unë tani po qëndroj në shtëpinë e Mustafa Seidit, para "derës së hekurt". Derës së dhomës drejtkëndëshe e të zgjatur, tavani trekëndësh me dritare të gjelbra. Çelësi është në xhepin tim, kurse rivali brenda. Në fytyrën e tij ka një gëzim djallëzor pa dyshim? Unë jam kujdestari, dashnori dhe rivali.

E solla çelësin në derë, ajo u hap pa vështirësi. U ndesha me një lagështi dhe një aromë e kujtimeve të vjetra. Unë e di këtë aromë. Aromë e drurit sandal dhe temjan. Kërkova rrugën me majat e gishta-ve të mi në mur. U ndesha me qelqin e dritares. Hapa krahët e dritares si dhe krahët e kapakëve prej druri. Hapa dritaren e parë, të dytë të tretë. Mirëpo, prej jashtë hyri vetëm errësirë më e madhe. Ndeza një qiri. Drita më ra në sy si një lloj eksplodimi. Prej errësire doli një fytyrë e ngrysur me buzë të rrudhura, të cilin e njoh, por nuk më kujtohej. U nisa drejt tij me urrejtje. Ai është rivali im, Mustafa Seidi. Fytyra ka qafen, qafa ka dy krahë, kraharori pastaj trupi dhe këmbët. E gjeta veten duke qëndruar para vetes sy me sy. Ky nuk është Mustafa Seidi. Kjo është fotografia ime e ngrysur në fytyrën time nga pasqyra. Fotografia u zhdruk rastësisht, qëndrova në errësirë për një kohë nuk e di për sa duke mos dëgjuar asgjë. Ndeza edhe një qiri tjetër dhe buzëqeshi një grua me një buzëqeshje të hidhur. U ula në oazën e dritës shikova rreth meje, kur pashë një llambë të vjetër në tavolinë, që për pak e preka me dorën time. E lëviza pak dhe kur pash se në të kishte vaj. Çfarë habie. E ndeza llambën dhe ja u largua hija, u larguan muret e u ngrit tavani. Ndeza dritën dhe i mbylla dritaret. Aroma duhet të mbetet e mbyllur këtu. Aroma e tullave, drunjve, temjanit të djegur dhe drurit sandal... dhe librave. O Zoti im! Të katër muret prej tokës e deri në tavan. Raftë, raftë, libra, libra, libra. Ndeza një cigare dhe mbusha mushkëritë e mia me një aromë të mahnitëse. Çfarë i marri. A është kjo punë e një njeriu që deshi të fillojë një faqe të re? Do t'i hedh të gjitha këto mbi kokën e tij. Do t'i djeg të gjitha. E ndeza zjarrin në një tepih të butë nën këmbët e mia dhe fillova ta shikoj se si po ndizej. Një mbret persian hipur në një kalë si kishte drejtuar shigjetën e tij në drejtim të një gazele (dreni), që dukej se ishte larg. E ngrita llambën dhe kur pashë se e tërë dysHEMEJA ishte e

shtruar me tepih persian. Vërejtja po ashtu se muri që ishte kundruall meje mbaronte në zbrazëti. Shkova deri aty, në dorë po mbaja llambën, kur e pashë.....ja çfarë marrëzie, një ngrohëse, paramendoni ngrohëse angleze me të gjitha pjesët dhe pajisjet e saj, mbi të një çadër prej bakri para saj një katror me pllaka të mermerit të gjelbër. Rafti i ngrohëses prej mermeri të kaltër, në dy anët e ngrohëses dy karrige viktoriane të mbuluara me mëndafsh i qëndisur me lule, në mes tyre një tavolinë e rrumbullakët në të kishte libra dhe fletore. Aty pash fytyrën e gruas, e cila më buzëqeshi mua para pak çastesh. Një pikturë e madhe prej vaji në një kornizë të arit në raftin e ngrohëses, nënshkrimi në këndin e djathtë (M. Seid). Më shkoi mendja te zjarri në mes të dhomës, i cili tash më gati ishte kthyer në zjarr të madh. Hapërova në drejtim të tij, numërova trembëdhjetë hapa, e shkela me këpucët e mia derisa u shuajt. Unë jam hakmarrës, por nuk mund ti rezistojë dëshirës për zbulim. Do t'i shikoj dhe t'i dëgjoj në fillim, pastaj do t'i djeg sikur të mos ishin fare. Librat Në dritën e llambës i shoh të klasifikuar të radhitura. Librat e ekonomisë, historisë, letërsisë, zoologjisë, gjeologjisë, matematikës, astronomisë, enciklopedia britanike, Gibon, Makoli, Twinbi. Veprat e Bernard Shout të gjitha, Keinz, Toni, Smith, Robibson, ekonominë e konkurrencës pjesërisht, Hibsenin, Imperializmin, Robinsonin, një artikull për ekonominë marksiste, Sociologjinë, Antropologjinë, Psikologjinë, Tomas Hardi, Tomas Man, Tomas Mur, Ajnshtajni, e shumë tjerë. Libra, për të cilët kisha dëgjuar, por edhe libra që nuk kisha dëgjuar. Përmbledhje poezish të autorëve për të cilët nuk kisha dëgjuar asnjëherë. Ditari Gordonit. Udhëtimet e Galfer Kling Hosman. Historia e Revolucionit Francez. Tomas Karlajl. Ligjëratat për Revolucionin Francez. Lord Akten. Libra të lidhura në lëkurë. Libra me lidhje të butë. Libra të vjetër të shqyer. Libra sikur të kishin dalë prej shtypi tash. Vëllime të mëdha si gurë mbivarrezor. Libra të vegjël të praruar me ari në madhësi të letrave. Nënshkrime. Dhurata. Libra në dollap. Libra në karrige. Libra në tokë. Çfarë propagande është kjo? Çfarë qëllimi ka? Oven, Ford, Shtefan Cvajg, Hazelt. A nuk është kjo toka e çudirave. Richards. Kur'ani në gjuhën anglishte. Bibla në anglisht. Gilbert Mer, Platoni. Ekonomia e koloni-

alizmit, Mustafa Seid. Kolonializmi dhe monopoli, Mustafa Seid. Kryqi dhe baruti, Mustafa Seid. Uzurpimi i Afrikës, Mustafa Seid. Nuk gjendet asnjë libër në gjuhën arabe. Varrezë. Përmendore. Ide e çmendur. Burg. Shaka e madhe. Thesar. Hape o bukurosh dhe na lë ta ndajmë arin mes njerëzve. Tavani është prej dërrasave të bungut dhe në mes është një hark, i cili e ndan dhomën në dysh, të cilën e mbajnë dy shtylla mermeri me ngjyrë të verdhë që anon kah e kuqja. Harku ka një cipë shumëngjyrëshe. Unë jam në krye të një tavoline të rrumbullakët, nuk e di se prej çfarë druri është, mirëpo sipërfaqja e saj është e mbyllët por që shndrit. Në të dy anët janë pesë karrige të mbështjella me lëkurë. Në anën e djathtë një kolltuk me një mbështetëse e mbështjellë me kadife të kaltër. Në të djathtë pashë ngrohësen, kurse në të majtë pashë disa gjëra që nuk i kish parë më parë. Në të majtë një tavolinë e gjatë me dy qirimajtëse prej argjendi, ku ishin të vendosur dhjetë qirinj, që nuk ishin ndezur më parë, po ashtu edhe në të majtë. I ndeza një nga një, së pari ndriçuan një pikturë të vajit në raftin e ngrohëses. Një fytyrë të gjatë të një gruaje me sy të zgjeruar, vetullat e së cilës bashkoheshin mbi ta. Hunda ishte pak më e madhe se që duhej, kurse goja pak e madhe. Kuptova se raftet e librave prej qelqi në murin përpara derës, nuk arrijnë deri në tokë, por ata përfundojnë në të dy anët e ngrohëses me dollap të ngjyrosur me ngjyrë të bardhë të dukshme nga raftet e librave prej një këmbë apo tri. Kështu vazhdonte edhe në anën tjetër në të majtë. Shkova te fotografitë e radhitura në raft. Mustafa Seid qesh, Mustafa Seidi shkruan, Mustafa Seidi noton, Mustafa Seid në ndonjë vend në fshat, Mustafa Seidi me uniformë universitare, Mustafa Seidi në dramën e Krishtlindjeve, mbi kokë ka kurorën e njërit prej tre mbretërve që i kanë sjellë aromën dhe gëzim Jezui Krishtit, Mustafa Seidi në mes një gruaje dhe një burri. Mustafa Seidi nuk kishte lënë asnjë rast pa e regjistruar për kujtim dhe histori. E mora fotografinë e një gruaje dhe e shikova me vëmendje. Lexova dhuratën me një shkrim të bukur: "Nga Shila me tërë dashurinë time". Shila Grinud, padyshim. Fshatare nga rrethina e Helit. E mashtroi me dhurata, fjalë të ëmbla dhe me shikimin që shikon gjërat dhe nuk gabon. E kishte mahnitur aroma e drurit sandal të djegur dhe tejmanit.

Me fytyrë të bukur, buzëqeshte në fotografi, në qafë ka një zinxhir të fildishtë me siguri. Dy krahët e zbukuruar dhe gjoksi i saj janë të dukshëm. Gjatë ditës punonte shërbëtores në një restorant, kurse natën vazhdonte studimet në Kolegjin Politeknik. Ishte e zgjuar, besonte se ardhmëria do të jetë për shtresën punëtore. Do të vijë dita kur do të zhduken dallimet dhe të gjithë njerëzit do të jenë vëllezër. I thoshte atij: "Nëna ime do të çmendej e babi do të më vriste nëse e di se unë po e dua një njeri të zi. Por, unë nuk merakosem". Më tha: "Më këndonte mua këngët e Mari Lojd. Kaloja me të mbrëmjet e së enjtes në banesën e saj në Kamden Taun, kurse nganjëherë kalonte natën me mua në banesën time"

Ajo bëri vetëvrasje. Përse bëri vetëvrasje Shila Grinod zotëri Mustafa Seid? Unë e di se ti je duke i fshehur në një vend të caktuar në këtë varrezë faraonike, të cilën do ta ndez mbi kokën tënde. Përse e mbyti Hasna, e bija e Mahmudit, të birin e kryetarit plak, pastaj mbyti edhe vetveten, në këtë fshat në të cilin nuk mbyti njeri njeriun?

Mora një fotografi tjetër, lexova dhurimin me një shkrim të gjerë që anonte përpara: "Ty deri në vdekje - Izabela". E gjorë, Izabela Simor. Unë kam një simpati të veçantë ndaj Izabela Simor. Fytyrë rrumbullake, pak e plotë, vishej me rroba të shkurtra sipas rrethanave të asaj kohe. Nuk ishte një skulpturë prej bronzi ashtu si e përshkroi, por në fytyrën e saj shihej mirësia e qartë dhe optimizmi për jetë. Buzëqeshëj. Ajo po ashtu buzëqeshëj. Thoshte se ishte bashkëshorte e një kirurgu të suksesshëm, nënë e dy djemve dhe një vajze. Kaloi njëmbëdhjetë vjet në një jetë familjare të lumtur. Shkonte në kishë rregullisht çdo të diel, kontribuonte në shoqatat bamirëse. Pastaj u takua me të dhe zbuloi në thellësinë e saj anë të errëta, që ishin të mbyllura më parë. Me gjithë këto, atij ia la një letër në të cilën thotë: "Nëse në qiell ka një Zot, unë jam më se e bindur se Ai do të shikojë me dhembshuri mendjelehtësinë e një gruaje të mjerë, që nuk ka mundur ta pengojë lumturinë të hyjë në zemrën e saj, edhe pse kjo ishte në kundërshtim me traditën dhe nënçmimin i nderit të bashkëshortit. Le të më fal Allahu dhe të dhëntë ty lumturi ashtu siç më dhurove ti mua".

Unë e dëgjoja zërin e tij atë natë të turbullt, ngrihej dhe ulej, nuk kishte pikëllim e as pendim, nëse në zë ka diçka aty kishte vetëm tingëllim gëzimi. "Dëgjova atë duke më thënë me një zë lutës e të dorëzuar: Të dua. U përgjigj zëri i saj një britmë e dobët në thellësinë e vetëdijes sime, i cili më thirri të qëndroj. Mirëpo, maja ishte në një distancë prej një hapi, pastaj marrë frymë dhe relaksohem. Kur ne ishim në kulmin e dhembjes mbi kokën time kaluan një mori reshë kujtimesh të largëta e të vjetra si avulli që ngrihet nga një liqe i njelmët në mes të shkretëtirës. Atëherë kur bashkëshorti i saj iu afrua podiumit të dëshmisë në gjykatë, të gjithë të pranishmit përqendruan shikimin e tyre tek ai. Ishte njeri fisnik, si nga pamja e jashtme dhe nga qëndrimi i tij. Me flokë të thinjura që tregonin pjekurinë e tij. Ishte njeri po të matej në peshojë me mua do të më kalonte dhjetëra herë. Ishte në rolin e dëshmitarit e jo të akuzuesit. Foli në mes të heshtjes që po mbretëronte në gjykatë. Drejtësia më obligon mua të them se Izabela, bashkëshortja ime e dinte se është e sëmurë me kancer. Kohëve të fundit, para vdekjes, vuante nga një gjendje depresioni të thellë. Pak ditë para se të vdiste, para meje pranoi për marrëdhëniet e saj me të akuzuarin. Më tha se ajo është dashuruar në të dhe se ai nuk është fajtor. Gjatë tërë jetës së saj ka qenë shembull i një bashkëshorteje besnike e të singertë. Megjithëkëtë, unë nuk ndiej kurrfarë zemërimi në vetvete, as ndaj saj e as ndaj të akuzuarit. Unë, vetëm ndiej dhembje për shkak të humbjes së saj".

Në botë nuk ka drejtësi. Unë ndiej zemërim dhe urrejtje. Pas të gjithë këtyre viktimave, kurorëzoi jetën e vet me një viktimit tjetër, Hasna të bijën e Mahmudit, gruan e vetme që e dashurova e mbyti të birin e kryetarit të mjerë si dhe e mbyti vetveten për shkak të Mustafa Seidit. Dhe e ndërpreva...Çfarë krimi. Fotografia është në një kornizë prej lëkure. Kjo është An Hamend pa dyshim, edhe pse ajo ka të veshur fustan arab dhe shami, dhurimi në fund të fotografisë me një shkrim arab të shtrembëruar: "Nga robëresha e jote Sevsen".

Një fytyrë e gjallë gati sa nuk pëlçiste prej shëndeti. Në çdo faqe nga dy vija, buzë të holla dhe dy sy që ndriçojnë. E tërë kjo pamje edhe pse kishte kaluar një kohë e gjatë. "Ishte oponent imi, i donte

vendet e nxehta ekuatoriale, diellin me rreze të forta dhe horizontet e purpurta. Në sytë e saj isha simbol i tërë kësaj dashurie. Unë isha jugu i dashuruar në veriun dhe acarin. Posedonte një banesë në Hamstad që shtrihej mbi Hamstad, kur vinte prej Oksfordi në fund javë. Kalonim ditën e shtunë tek unë, kurse ditën e diel tek ajo. Nganjëherë rrinim edhe të hënën e ndonjëherë tërë javën. Pas pak nisi të mos shkojë në universitet një muaj edhe dy derisa u përjashtua. E shtinte fytyrën e saj nën sqetullën time dhe merrte erë sikur ajo të thithte erën duhanit të opiumit. Fytyra e saj i zvogëlohej prej kënaqësie. Thoshte sikur ajo të recitonte rituale fetare në një faltore: "Dashuroj djersën tënde. Dua aromën tënde të tërën. Aromën e gjetheve të ndyra të maleve të Afrikës. Aromën e mangave dhe të erëzave të ekuatorit. Aromën e shiut të shkretëtirave arabe". Ishte një gjah i lehtë. Atë e takova pas një ligjërate që e mbajta në Oksford për Ebu Nevas. Ju thashë atyre se Omer Hajami është baras me zero nëse krahasohet me Ebu Nevasin. Të pranishmëve u recitova disa poezi të Ebu Nevasit lidhur me verën, me një metodë recitimi qesharake. Duke pretenduar se ajo ishte metoda me të cilën recitohej poezia arabe në kohën e Abasidve. Në ligjëratë u thash se Ebu Nevasi ishte mistik dhe se ai verën e bëri simbol nëpërmes së cilës barti të gjitha dashuritë e tij shpirtërore dhe se dashuria e tij për verë në poezinë e tij, në realitet ishte dëshira për t'i kënduar qenies së Zotit. Fjalë të trilluara që fare nuk kanë kurrfarë baze të shëndoshë. Mirëpo, unë isha i inspiruar atë natë, po ndjeja se gënjeshttrat po qarkullonin në gjuhën time sikur ato të ishin kuptime të larta. Po ndjeja se dehja prej meje po shkonte te masa e njerëzve, dhe kështu unë po vazhdoja të gënjej. Pas ligjëratës rreth meje u tubuan nëpunës që kishin punuar në Orient, gra në moshë të shtyrë, burrat e të cilave kishin vdekur në Egjipt, Irak, Sudan, burra që kishin luftuar me Kitchnerin e Alenbin, orientalistë, nëpunës në Ministrinë e Kolonive si dhe nëpunës në Departamentin e Lindjes së Mesme në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Rastësisht, vëreja një vajzë në të tetëmbëdhjetat apo nëntëmbëdhjetat po vinte në drejtim timin, duke depërtuar radhët. Më përqafoi me krahët e saj, më puthi dhe më tha në gjuhën arabe: "Ti je i bukur sa nuk mund ta përshkruaj. Unë të dua aq shumë sa që nuk

mund ta përshkruaj". I thash me një simpati që më frikësoi ndjeshmëria e saj: "Dhe më në fund të gjeta oj Sevsen. Unë të kërkoj ty në çdo vend dhe u frikësova se nuk do të gjej kurrë". -A të kujtohet? Më tha me një simpati që nuk ishte më pak se simpatia ime: "Si të harroj shtëpinë tonë në lagjen al-Karh të Bagdadit, në bregun e lumit Tigër në kohën e Memunit? Unë po ashtu hulumtova gjurmët tua gjatë shekujve, por unë isha më se e sigurt se ne do të takohemi. Dhe ja unë jam i dashuri im Mustafa, nuk paske ndryshuar prej kohës që kur jemi ndarë. Më dukej sikur unë dhe ai jemi në një teatër dhe rreth neve artistë po luajnë role të vogla. Unë jam yll edhe ajo është yll. U fikën dritat dhe mbizotëroi errësira rreth nesh mbeta unë dhe ajo vetëm në mes të tetarit ku përqendrohej një dritë e vetme. Megjithëse unë isha i vetëdijshëm se po gënjej, në një farë mënyre unë po kuptoja se çka po them, edhe ajo me gjithë gënjeshtren e saj atë çka tha ishte e vërtetë. Ai moment ishte prej momenteve të rralla të dehjes, në të cilën e shes tërë jetën time. Moment, në të cilin gënjeshttrat para syve tu kthehen në të vërtetë, në të cilin historia kthehet në komandantë kur shakaxhiu kthehet në sulltan. Në kulmin e asaj ëndrre më mori më veturën e saj për në Londër. Veturës i grahte me një shpejtësi marramendëse, kohë pas kohë lëshonte vallonin dhe më përqafonte mua me dy krahët e saj e më thoshte: "Sa e gëzuar jam sot dhe së fundi të gjeta. Unë jam aq e gëzuar sikur edhe të vdisja në këtë moment nuk më dhimbset jeta". Gjatë rrugëtimit ndaleshim nëpër disa kafe dhe pinim verë molle nga një herë, e nganjëherë birrë, verë të bardhë apo të kuqe. Nganjëherë pinim uiski. Për çdo gotë i recitoj poezitë e Ebu Nevasit. Recitova:

"Lehtësia jote se toka është lule, vera me bollëk, vajza flokë hiri e virgjëresha"

Ne kaluam kështu, kurse ajo kënaqej me poezinë dhe kënaqej me pije. Më jepte mua të pi kënaqësitë e gënjeshtrave të ëmbla, kurse unë thurja penj të hollë prej imagjinatave. Më thotë se ajo sheh në sytë e mi vezullimin e vegimit të shkretëtirës së nxehtë. Në zërin tim dëgjon

britmën e bishave të egra nëpër male. Unë i them asaj se në kaltërimin e syve të saj shoh liqene të largët të veriut që nuk kanë brigje. Në Londër, në shtëpinë time, ia përsërita gënjeshttrat e mëdha, që kisha përgatitur me qëllim, gënjeshtër pas gënjeshtre. Drurin sandal dhe temjan, penda struci, statuja të fildishta dhe abenusi, fotografi dhe piktura të maleve me palme në brigjet e Nilit, barka në sipërfaqe të ujit me vela sikur ato të jenë krahët e pëllumbave, pamje të perëndimit të diellit në kodrat e Detit të Kuq, karvanë devesh duke ecur shpejt nëpër kodra me rërë në kufi me Jemenin. Pamje drunjsh të shpeshtë nga Kurdufani, vajza lakuriqe nga fiset Zandi, Nuvejra dhe Shelek. Ara të bananeve e të kafesë në Ekuador. Tempuj të vjetër në Nube, libra arabë me kopertina të zbukuruar të shkruara me shkrimin kufik të dekoruar, tepihë persianë dhe perde me lule, pasqyre të mëdha në mure si dhe drita me ngjyra nëpër kënde. U përul, i puthi këmbët e mia dhe më tha: Ti je Mustafa, padroni dhe zotëriu im, dhe unë jam Sevensi skllave (robërësja) jote. Kështu, secili prej nesh zgjodhi rolin e vet në heshtje. Ajo luante rolin e skllaves, kurse unë luaja rolin e zotërisë. Më përgatiti banjën, pastaj më lau me ujin, të cilit i kishte shtuar ujë të luleve. Ndezi dy shufra temjan, pastaj ndezi drurin sandal në një skarë bakri maroken e varur në hyrje. Veshi një fustan dhe shami, unë isha i shtrirë në krevat. Erdhi pranë meje më bëri masazh kraharorin, këmbët, qafen dhe krahët e mi. I thashë me një zë urdhërues: Eja, u përgjigj me një zë të ulët: të dëgjoj dhe të përgjigjem zotëria im. Në kulmin e fantazisë, dehjes dhe marrëzisë, e mora dhe e putha atë, sepse ajo që ishte në mes nesh ishte para një mijë vjetëve. E gjetën të vdekur në banesën e saj në Hamstid. Kishte bërë vetëvrasje me gaz. Aty pranë kishte lënë një letër në të cilën shkruante: "Zotëri Seid, mallkimi i Zotit qoftë mbi ty".

Vendosa fotografinë e An Hamand në vendin e saj në të majtë të fotografisë së Mustafa Seidit, ku ai po qëndronte mes zonjës Robinson dhe burrit të saj. Dhurimi në fund të fotografisë: "Mozit të dashur, Kajro, 17 prill 1913". Si duket ajo po e thërriste me këtë emër përkëdhelës, sepse ajo në letrën e saj po ashtu i drejtohet me emrin "Mozi".

Mustaf Seidi paraqitet si një fëmijë, mirëpo fytyra e tij është e ngrysur në fotografi. Zonja Robinson qëndron në të majtë të tij dhe kishte vendosur krahun e saj mbi shpatullat e tij, kurse burri i saj kishte përqaftuar të dy me krahët e tij, atë dhe gruan e tij, buzëqeshnin një buzëqeshje të natyrshme të lumtur, fytyrat e tyre dukeshin fytyra dy të rinjve që nuk kishin kaluar të tridhjetat. Megjithatë, dashuria e zonjës Robinson ndaj tij, asnjëherë nuk është luhatur. Ajo prezantoi gjykimin e tij prej fillimi deri në fund, dëgjoi çdo send, megjithatë, ajo thotë në letrën e saj: "Nuk mund të shpreh mirënjohjen time të thellë që ti më ke shkruar për Mozin e dashur. Mozi ishte njeri më i dashur për mua dhe për burrin tim. I gjori Mozi. Ai ishte një fëmijë i vuajtur. Por, ai futi në zemrën time dhe të burrit tim lumturinë që nuk mund të përshkruhet. Pas asaj çështje të dhembshme dhe braktisjen e Londrës, u ndërpre në lidhjet e mia më të. Bëra çmos që përsëri t'i vendos lidhjet me të, por nuk pata sukses. I gjori Mozi. Por, ajo që ma lehtësoi dhe mbjen ishte se ai kishte kaluar vitet e fundit të jetës së tij i lumtur në mesin tuaj dhe ai ishte martua me një grua të mirë dhe me të kishte pasur dy djem". Dashuria ime ndaj zonjës së Seidit u shtua edhe më tepër, sepse ajo ka mundur mua të më konsiderojë nënë. Nëse kam mundësi t'ua bëj ndonjë shërbim asaj dhe dy djemve të dashur. Të lutem thuaj asaj. Mos hezito të më shkruash për të. Sa do të isha e lumtur sikur ata të gjithë të vijnë për t'i kaluar pushimet me mua në verën e ardhshme. Unë këtu jetoj vetëm në Ajal of Wait. Në janarin e vitit të kaluar udhëtova për në Kajro për ta vizituar varrin e burrit tim. Roki e donte pa masë Kairon. Deshi fati që ai të varroset mu në qytetin që ai e dashuroi më shumë se çdo qytet tjetër të botës.

"Unë kam angazhuar veten në përpilimin e një libri për jetën tonë - Rokit, Mozit dhe timen - ishin njerëz të mëdhenj, secili në mënyrën e vet. Madhështia e Rokit ishte në sjelljen e lumturisë për të tjerët. Ishte i gëzuar me kuptimin e fjalës, lumturia e përshkonte gjithkënd që ishte në kontakt me të. Mozi ishte një gjeni, por ai ishte i pamatur. Ishte i papërgatitur për të pranuar lumturinë apo dhënien e saj, përveç atyre që i donte dhe e donin më të vërtetë, sikur unë dhe Roki. Unë ndiej se dashuria dhe obligimi ma imponojnë që të njihen njerëzit me

tregimin e këtyre dy burrave të mëdhenj. Në realitet, libri ka të bëjë me Rokin dhe Mozin. Unë nuk kam bërë diçka me të cilën meritoj të përmendem. Do të shkruaj për shërbimet e mëdha që Roki i bëri kulturës islame, siç është zbulimi i tij i një numri të madh të dorëshkrimeve të rralla, shpjegimin dhe mbikëqyrjen e botimit të tyre. Do të shkruaj për rolin e madh që ka luajtur Mozi në tërheqjen e vërejtjes këtu për gjendjen e mjerueshme në të cilën jetojnë banorët e vendit të tij nën protektoratin tanë si okupues. Do të shkruaj gjerësisht për gjykimin dhe do t'i mënjanoj të gjitha dyshimet që kanë të bëjnë me të. Unë do të falënderoj shumë nëse mund të më dërgosh çdo send që mund ta ketë lënë Mozi që mund të më hyjë në punë lidhur me shkrimin e librit. Me siguri, Mozi të ka informuar se më ka autorizuar mua për çështjet e tij që kanë të bëjnë në Londër. Janë tubuar disa mjete nga e drejta e tij autoriale apo përkthimet e disave nga librat e tij, do t'i transferoj menjëherë, posa të më dërgosh adresën e bankës në të cilin dëshiron t'i transferoj. Me këtë rast shfrytëzoj nga rasti të falënderoj shumë për mbikëqyrjen dhe kujdesin e familjes së Mozit të dashur. Dëshiroj të më shkruash vazhdimisht dhe të më shkruash për lajmet tua gjerësisht dhe të mi dërgosh fotografitë e tyre në letrën vijuese.

Me respekt, Elizabeta

Vendosa letrën në xhepin tim dhe u ula në karrige, në të djathtë të ngrohëses. Më ranë në sy disa numra të gazetës "Times", të datës, e enjte, 26.09.1927. Të lindurit, martesat, të vdekurit. Bëri ceremoninë e martesës prifti Samson, magjistër i letërsisë. Sot bëhet ceremonia e vdekjes në kishën Stenti, në ora 14:00 pas dite, ditën e mërkurë. Letra personale. "E dashura ime për gjithmonë, deri kur do të mbetemi të ndarë?" - Zemra e dashur. Kolonia Kenia - Zotëri, kontrollor ligjor - kthehet në Najrobi më 5 tetor. Deri në atë kohë nuk kishte kurrfarë korrespondence për raportet e patundshmërisë në tokat në koloni, që duhet dërguar nëpërmes shpalljeve për mësimin e kalërimit. Maçokë të kaltër për shitje. Një vajzë 17-vjeçare nga një familje e respektuar kërkon punë. Një zonjë trashëgoi llagapin lady (30-vjeçare) kërkon punë jashtë vendit. Lajme nga sporti. West Hel e mund Per Hell. West

Ham fiton. Xhin Tini fiton ndaj Xhak Demsi. Letër nga Dhafrallah Hani në të cilën demanton mendimet e Sir Shmalnal Stalfad lidhur me konfliktin mes myslimanëve dhe hindusve në Penxhab. Një letër thotë: "Xhazi muzikë e bukur në një botë të errët". Filani ka arritur prej Rangoni dhe ka ecur në këmbë prej Morsi Tilberi deri në kopshtin zoologjik. Një ka e sulmoi bujkun dhe ia çau barkun në stallën e tij. Një njeri vodhi katër banane dhe u dënua tre vjet burgim. Lajme të jashtme të Perandorisë. Ofertë e re nga Moska për pagesën e borxhit rus ndaj Francës. Vërshime në Zvicër. Deskferi anija që u kthye nga deti jugor. Herstersman mbajti një fjalim për çarmatim në Gjenevë ditën e shtunë. Po ashtu Hrestersman deklaroi për gazetën "Matin", në të cilën përkrahu fjalimin e kryetarit Von Handenberg në Ton Brixh, në të cilin refuzoi përgjegjësinë e Gjermanisë për fillimin e luftës. Artikulli redaksional mbi marrëveshjen e Xhedes, të cilën e nënshkroi Sir Gilbert Kliten në emër të Britanisë së Madhe dhe princi Fejsal Abdul Aziz Al-Suud në emër të babait të tij, mbret i Hixhazit dhe Nexhdit. Moti në Angli dhe Vels, me erëra të shumta nga perëndimi dhe veriperëndimi, të fuqishme në vende të hapura. Periudha të qeta, por me periudha me erëra me shi e nganjëherë shira lokale.

Si duket kjo ishte gazeta e vetme. A ka ndonjë kuptim të caktuar ekzistimi i kësaj gazete? Apo është rastësi? Hapa një fletore dhe lexova në faqen e parë: "Tregimi i jetës sime - shkruar nga Mustafa Seid". Në faqen vijuese dhuruar: "Atyre të cilët shohin me një sy, flasin me një gjuhë, shohin gjërat bardh ose zi, lindore apo perëndimore".

Shfletova faqet tjera, por nuk gjeta asgjë, asnjë rresht të vetëm, asnjë fjalë të vetme. A mund të ketë edhe kjo kuptim, apo është rastësi? Hapa një dosje ku gjeta shumë fletë, shënime dhe vizatime. Si duket kishte të bënte me çështje të shkrimit dhe vizatimit. Vizatimet ishin të bukura që tregonin për talentin e tij. Vizatime me ngjyra, pamje nga fshati anglez, ku përsëriteshin pamjet e drunjve e të shotave. Vizatime me laps të thjeshtë të pamjeve dhe të njerëzve nga fshati ynë. Pa marrë parasysh të gjitha këto më duhet të pranoj për talentin dhe shkathëtsinë e tij. Beqiri, Mahxhubi, gjyshi im, i biri i kryetarit, Hasna,

xhaxhai im Abdul Kerimi e të tjerë. Fytyra e tyre paraqiten me shprehje të thella, të cilat po i ndieja, por nuk isha në gjendje t'i caktoja ato. Ato i kishte vizatuar Mustafa Seidi me një pamje tejet të qartë, të dashur që anonte kah dashuria. Fytyra e birit të kryetarit përsëritet më shumë se të tjerët. Tetë vizatime të birit të kryetarit në pamje të ndryshme. Përse i kushtoi të birit të kryetarit tërë këtë rëndësi?

Shikova tregimet e fletëve dhe lexova: "T'i mësojmë njerëzit të hapin mendjet e tyre dhe t'i lirojnë fuqitë e tyre të mbyllura. Por, ne nuk mund ta parashikojmë rezultatin - lirinë. T'i lirojmë mendjet nga besytëritë. T'i japim popullit çelësat e ardhmërisë që ai të veprojë si të dojë vetë". "Po e lë Londrën dhe Evropë filloi të koncentrojë ushtritë e saj përsëri për një dhunë edhe më të madhe". "Nuk ishte për shkak të urrejtjes. Ishte për shkak të dashurisë, të cilën nuk mundi ta shprehë. E dashurova në mënyrë të dredhur, ajo po ashtu". Kulmet e shtëpive i lag riga e shiut. Lopët dhe delet në fusha janë sikur gur të bardhë e të zi. Lagështi e lehtë në muajin qershor. Të lutem zonjë. Udhëtimet me tren janë monotone. Si je? Prej Birminghami deri në Londër. Si i përshkruan pamjet? Drunj dhe kullosa. Grumbuj të kashtës mes fushave. Drunj dhe kullosa në çdo vend. Libër i Nigajo Marsh. Hezitova. Nuk tha po ose jo". A po përshkruante ndodhi të vërteta apo shtjellonte një tregim? "Unë zotëri i im duhet t'i kundërvihem mbështetjes së prokurorisë në një dredhi logjike të hapur. Ai dëshiron të vërtetojë përgjegjësinë e të akuzuarit në ndodhi për të cilat ai nuk ishte përgjegjës, në bazë të ndonjë veprimi që ka ndodhur, pastaj kthehet dhe vërteton supozimin që ka ndodhur në të vërtetë duke u mbështetur në supozime të mëparshme. I akuzuari pranon se e ka mbytur gruan e vet, por kjo nuk e bën atë përgjegjës për të gjitha ndodhitë e vetëvrasjeve të grave në Mbretërinë e Bashkuar gjatë dhjetë vjetëve të fundit". "Atij që i lind e mira i ka lindur një zog që fluturon nga gëzimi. Atij që i lind e keqja i ka mbirë një dru, gjembat janë dhembje dhe fryti i tij është pendimi. Allahu e pastë mëshiruar një njeri që ngrihet mbi gabimet dhe kënaqet me pamjen e jashtme".

Gjeta një vjershë të shkruar me dorën e tij. Kjo do të thotë se ai merrej edhe me poezi. Shihet qartë prej ndryshimeve të shumta që ki-

shte bërë në të, duke shlyer, apo shtuar, shihej se ai ndjente frikë para artit. Ja kjo është:

Patjetër duhet që Muastafa Seidi të ketë hulumtuar orë të tëra për të gjetur fjalë që i përshtaten rimës. Më interesoi formula dhe mendova për disa minuta. Nuk zgjati të menduarit. Ajo është një poezi e dobët për çdo eventualitet që është e përqendruar në krahasime. Në të nuk ka ndjenjë të singertë e as afekt të vërtetë. Ky varg nuk është më i dobët se vargjet tjera. Shleva vargun e fundit dhe shkrova në vend të tij:

"Faqe të përulura dhe balle të devotshëm"

Vazhdova në shfletimin e faqeve dhe hasa numra dh tregime, në të cilat kishte shprehje si: "Tre promilë vaj". "Komisioni shqyrtoi bazën e forcimit të makinës". "Teprica e cementit mund të shitet me një herë". Pastaj gjeta këtë paragraf: "Ishte domosdoshmëri të ballafaqohet fati im me fatin e saj, të kalojë në burg disa vite ta ndjek hijen e saj dhe të më ndjek hija e saj mua. Kjo është ndjenja ime kur unë për një çast jam jashtë kufijve të kohës duke përqafuar zotat e vdekjes dhe zgjata të çarën e syve të saj në xhehenem. Kjo është ndjenjë e një njeriu ta parafytyroj. Shija e asaj nate mbeti në gojën time dhe më pengoi nga çdo shije tjetër.

Isha mërzhitur nga leximi i letrave. Nuk ka dyshim se ekzistojnë edhe shumë letra tjera të fshehura në këtë dhomë, si pjesë enigmës në llogarinë time, që Mustafa Seidi dëshiron t'i zbulojë dhe vendosi njërrën pranë tjetrës dhe prej tyre të nxjerrë një pamje të plotë që të jetë në interesin e tij. Ai dëshiron të zbulohet si një gjurmë historike që ka vlerën e vet. Nuk ka dyshim në të. Unë e di se ai më zgjodhi mua ta luaj këtë rol. Nuk ishte rastësi se ai ngjalli tek unë dëshirën për kërkim, pastaj tregoi tregimin e jetës së tij jo të plotë, që pastaj unë vetë ta zbuloj pjesën tjetër të tregimit. Nuk ishte rastësi që ai kishte lënë letrën e mbyllur me dyllë të kuq, me qëllim të zgjimit të imagjinatës sime. Caktimi im si testament për dy bijtë e tij kishte për qëllim obligimin tim direkt me familjen e tij po ashtu edhe lënia e çelësit të muzeut të mbyllur me dyllë. Nuk ka kufi egoizmi dhe vetëbesimi i tij. Ai para së gjithash dëshiron të mbetet i pavdekshëm në histori. Mirëpo,

unë nuk kam shumë kohë të vazhdoj me këtë farsë. Duhet ta përfundoj këtë farsë para se të gdhij mëngjesi. Tash është ora dy pas mesnate, me agimin e mëngjesit zjarri do t'i marrë me vete të gjitha këto gënjeshtër.

U ngrita shpejt në këmbë dhe ngrita një qiri mbi një pikturë vaji në raftin e ngrohësës. Çdo send në dhomë është i sistemuar, rregulluar dhe i vendosur në vendin e vet. Përveç fotografisë së Xhin Morisit. Sikur ai të mos dinte çka të bëjë me të. Të gjitha gratë tjera kishte rrajtur fotografitë e tyre, mirëpo Xhin Moris kjo ashtu siç e kishte parë ai e jo ashtu siç e kishte parë aparati i fotografimit. Shikova pikturën me habi. Fytyrë e gjatë e një gruaje me sy të gjerë, vetullat e saj bashkohen mbi ta. Hunda është pak e madhe, kurse goja pak e gjerë, shprehja e fytyrës është vështirë të përshkruhet me fjalë. Shprehje e tmerrshme e çuditshme. Dy buzë të holla të kapura sikur ato t'i kafshonin dhëmbët e vet, nofulla anon përpara me krenari. Shprehja në sy a mund të jetë hidhërim apo buzëqeshje? Pastaj, diçka erotike paraqitet në tërë fytyrën. Ky pra është feniksi që e ka grabitur gogolin? Zëri i tij atë natë ishte i plagosur, i pikëlluar i penduar. Për shkak se ai kishte humbur? Apo për shkak se ajo e kishte poshtëruar?

E gjeja në çdo manifestim që shkoja. Sikur ajo këtë e bënte me qëllim për të më poshtëruar mua. Desha të vallëzoj me të e ma ktheu: “Nuk do të vallëzoja me ty sikur të ishe mashkulli i vetëm në botë”. I mëshova një shuplakë në faqen e saj. Ma ktheu me një shkelëm me këmbën e saj dhe më kafshoi në krahun tim me dhëmbë sikur ata të ishin të luaneshës. Nuk punonte asnjë punë dhe nuk di si jetonte. Prindërit e saj ishin prej Lidzit. Nuk jam takuar me ata edhe pas martesës me të. Babai i saj ishte tregtar nuk di me çfarë materiali bënte tregti. Sipas fjalëve të saj, kishte edhe pesë vëllezër, ajo ishte vajzë e vetme. Të gënjente edhe për gjërat më të thjeshta. Në shtëpi kthehej me tregime të çuditshme për gjëra që i kishin ndodhur dhe njerëz që kishte takuar saqë mendja nuk mund t'i besonte. Nuk është larg mendsh që ajo nuk ka pasur askënd prej familjes. Ishte një Shehrezadë lypëse.

Por, ajo ishte shumë e zgjuar si dhe tepër e dashur kur donte. Kudo që shkonte e shoqëronin shumë simpatizantë sikur të ishin miza.

Kisha një ndjenjë të brendshme edhe pse ajo paraqitej se më urrente mua, ajo interesohej për mua. Kur gjendeshim në shoqëri të përbashkët më vëzhgonte mua me bisht të syrit duke përcjellë të gjitha lëvizjet e mia, nëse sheh ndonjë interesim timin për ndonjë vajzë ajo nxiton ta nënçmojë atë dhe të sillet keq ndaj saj. Ishte shumë e vrazhdë me gojë dhe me sjellje. Nuk përtonte të bënte çdo send, të vjedhë, të gënjejë, të mashtrojë. Me gjithë këto, unë e doja atë dhe nuk mundesha ta mbizotëroj veten. Kur i shmangesha më tërhiqte dhe kur ngarendsha pas saj ajo ikte prej meje. Njëherë e frenova veten për dy javë, duke ia shmanngur çfarëdo kontakti me të. Vendosa t'u shmangem vendeve, të cilat ajo i frekuentonte. Nëse ftohesha për ndonjë manifestim, së pari e vërtetoja se ajo nuk do të jetë prezent aty. Mirëpo, ajo e gjeti rrugën për shtëpinë time dhe në mbrëmje të ditës së shtunë më erdhi në shtëpi, kur An Hamend ishte me mua. E ofendoi An Hamend me lloj-lloj ofendimesh. E qortova dhe e rraha, por ajo nuk morri vesh (ndikoi). An Hamend doli duke qarë, kurse ajo vazhdoi të qëndrojë para meje si një shejtan i mallkuar. Në sytë e saj sfidë dhe thirrje që shpalosi dashuri të vjetra në zemrën time. Nuk i fola e as nuk më foli. Mirëpo, ajo i zhveshi rrobat e saj dhe qëndroi lakuriq para meje. I tërë zjarri i xehene mit u ndez në kraharonin tim, patjetër duhej të fikej zjarri në kodrën e borës që ishte pengesë në rrugën time. U afrova pranë saj duke u dridhur, më dha shenjë në drejtim të një luleje të çmuar që gjendej në raft. Më tha: Ma jep atë dhe më merr mua. Sikur të kërkonte prej meje jetën time në atë moment do t'ia jepja. I dhashë shenjë me kokë se jam i pëlqimit. E mori lulen e gjuajti në tokë dhe pjesët e saj i shkeli me këmbë derisa i bërë copë e termi. Më dha shenjë në drejtim të një dorëshkrimi të rrallë në gjuhën arabe mbi tavolinë. Më tha: ma jep këtë po ashtu. Fyti im ishte terur. Unë isha i etur gati sa nuk më mbyti etja. Kisha nevojë për një gotë uji me akull. I dhashë shenjë me kokë se pajtohem. E mori dorëshkrimin e vjetër e të rrallë dhe e shqeu e bëri copë-copë. Fletë e shqyera i futi në gojë i përtypi pastaj i pështyu. M'u duk sikur po përtypte mushkëritë e mia. Por, unë nuk shqetësohesha. Pastaj më dha shenjë në drejtim të një sexhadeje persiane prej mëndafshi të Isfahanit, të cilën ma kishte dhuruar zonja Robinson pas

largimit tim nga Kajroja. Dhurata më e çmuar tek unë dhe dhurata më e dashur tek unë. Më tha: “Ma jep këtë e pastaj më merr mua”. Hezitova për një çast, mirëpo unë e shikova atë duke qëndruar drejt, e gatshme para meje. Sytë e saj paralajmëronin shkëndijën e rrezikut, buzët e saj dukeshin si pemë e ndaluar që patjetër duhet hëngër. Drodha kokën time duke i dhënë pëlqimin. E mori sexhaden e hodhi në zjarrin e ngrohësës dhe qëndroi e kënaqur duke e parë se si po digjej. Flaka e zjarrit po reflektohej në fytyrën e saj. Kjo grua më kërkoi mua dhe unë do ta përcjell atë deri në xhehenem. Shkova pranë saj, vendosa krahët e mi rreth belit të saj dhe u afrova ta puth. Befas ndjeva një të shkelmuar të fuqishme me gjurin e saj në mes kofshëve. Kur më erdhi vetëdija nga alivanosja pashë se ajo ishte zhdukur.

"Vazhdova ta ndjek tre vjet me radhë. Varganët e mi, etja dhe vegimi shndrisin para meje në labirintet e dashurisë. Një ditë më tha ti je ka (dem) i egër nuk lodhesh nga vrapimi. Unë jam lodhur prej ndjekjes sate dhe vrapimit tim të vazhdueshëm para teje. Më kurorëzo. Bëmë kurorë në një zyrë në Folam. Në ceremoninë e kurorëzimit mori pjesë një shoqe e saj dhe një shok imi. Kur ajo deklaroi para sekretarit: "Unë Xhin Vanferd Moris, pranoj këtë njeri, Mustafa Seid Osman, bashkëshort timin legal në të mirë dhe në të keq, në varfëri dhe pasuri, në sëmundje dhe shëndet" - dhe befas ia filloi të qajë me dënesje. U habita për këtë emocion nga ana e saj. Sekretari u step, ndërpreu vazhdimin e ceremonisë dhe iu drejtua asaj me butësi: Ke kujdes. Unë i kuptoj ndjenjat tua. Vetëm edhe pak çaste dhe përfundon çdo send. Pas kësaj e ndërpreu të qarit, por kur përfundoi ceremonia ia filloi vajin përsëri. Erdhi sekretari ia rrahu krahët, pastaj më përshëndeti mua duke më thënë: “Bashkëshortja jote po qan për shkak të gëzimit të madh. Unë kam parë shumë gra duke qarë me rastin e ceremonisë së kurorëzimit, por asnjëherë nuk kam parë duke qarë në këtë mallëngjim. Si duket ajo të do shumë. Kujdesu për të. Unë jam i sigurt se ju do të jeni të lumtur”. Ajo vazhdoi të qajë derisa dolëm nga zyra e regjistrimit. Befas vaji i saj u kthye në qeshje, më tha duke mos mundur ta ndalë të qeshurit: Ja çfarë farse.

Kaluam pjesën tjetër të ditës të dehur. Nuk pati gosti e as të ftuar. Unë, ajo dhe verë. Kur shkuam në shtrat desha ta përqafoj, por ma ktheu shpinën duke më thënë: “Jo tash. Unë jam e lodhur”. Vazhdoi dy muaj nuk më la t'i afrohem. Çdo natë më thoshte: “Unë jam e lodhur. Unë jam e sëmurë”. Nuk munda të vazhdoj më tepër. Një natë qëndrova mbi të dhe në dorë po mbaja thikën. I thash: “Do të pres”. Shikoi thikën me një shikim sikur të kishte keqardhje dhe më tha: “Ja kraharoni im është hapur para teje ngule thikën në të”. Shikova trupin e saj lakuriq, që ishte në dispozicionin tim dhe nuk po e shfrytëzoja. U ula në skaj të krevatit kokulur dhe i poshtëruar. Vendosi dorën e saj në faqen time dhe më tha me një të folur të butë. “Ti o bukuroshi im nuk je prej atyre që mbysin”. Ndjeva poshtërim, vetmi dhe humbje. Rastësisht m'u kujtua nëna ime. Pashë fytyrën e saj të qartë në imagjinatën time dhe dëgjova atë duke më thënë: “Ajo është jeta jote dhe ti je i lirë në të”. Kujtova lajmin e vdekjes së nënës sime, që më arriti para nëntë muajve. Mua më kishin gjetur të dehur në kraharonin e një gruaje. Nuk më kujtohet tash se cila grua ishte ajo. Por, mua më kujtohet se unë nuk ndjeva kurrfarë pikëllimi. Sikur çështja nuk kishte të bënte me mua fare. Kujtova këtë dhe qava nga thellësia e zemrës sime. Qava aq shumë sa që mendova se unë kurrë nuk do të ndalem së qari. Ndjeva se Xhin po më përqafonte me krahët e saj dhe më thoshte disa fjalë që nuk mund t'i dalloja. Mirëpo, zëri i saj tingëlloi keq në veshët e mi, nga i cili u rrëqeth trupi im. E shtyva me dhunë dhe bërtita: “Unë të urrej ty. Të betohem se unë do të vras ty një ditë”. Në kulmin e pikëllimit tim nuk mungoi të shprehurit në sytë e saj. Sytë e saj u magjepsën më shikoi mua me habi. A është kjo mahnitje? A është kjo frikë? A është kjo dëshirë? Pastaj më tha me një zë në të cilin kishte shprehje artificiale: “Unë po ashtu të urrej deri në vdekje”.

Unë nuk kisha hile. Isha gjuetar dhe tash u ktheva në viktimë. Dënohesha me një mënyrë që nuk e kuptoja. Vetëm njëmbëdhjetë ditë pas kësaj ndodhie, më kujtohet se unë shijova në fyt ashtu siç ndodh me atë që agjëron. Ishim në parkun Tashmen para perëndimit të diellit. Parku ishte përplot njerëz. Dëgjonim zëra të njerëzve dhe shihnim njerëzit duke ecur para perëndimit të diellit. Këmbyem vetëm pak fja-

lë. Nuk folëm për dashurinë. Pa ndonjë shkas vendosi krahët e saj rreth qafës sime dhe më puthi me një puthje të gjatë. Ndjeva se kraharori i saj po bënte presion në kraharorin tim. Vendosa krahët e mi rreth belit të saj dhe e tërhoqa pranë meje. Filloi të rënkojë (ofshaj) aq shumë sa që nuk çau zemrën time dhe më bëri të harroj çdo send. Nuk isha në gjendje të kujtoj asgjë. Nuk mund të shihja e as të mbaj në mend përveç këtë fatkeqësi të madhe me të cilën më ballafaqoi fati. Kjo grua ishte fati im dhe në të ishte fundosja ime. Mirëpo, për mua e tërë bota nuk vlen asgjë për hir të saj. Unë jam pushtues që ka ardhur prej jugut dhe ky është sheshi i betejës së akullit nga i cili nuk do të kthehem i gjallë. Unë jam kapiten pirat, kurse Xhin Moris është bregu i shkatërrimit. Por, unë nuk brengosem. E kam marrë atje në shkretëtirë. Nuk më intereson nëse ajo është para syve të njerëzve. Ky moment i dehjes është baras me tërë jetën time.

Në realitet momentet e dehjes ishin të rralla, kurse pjesën tjetër të jetës e kalonim në luftë të vazhdueshme dhe të pakompromis. Lufta mernte fund gjithherë me disfatën time. I mëshoj shuplakë dhe ma mëshon. Thonjtë e saj gërvishtin fytyrën time. Në qenien e saj shpërthen një vullkan dhune dhe thyen çdo send që duart e saj arrijnë prej enësh apo shqyen çdo libër apo fletë. Kjo ishte arma më e rrezikshme që ajo posedonte. Çdo betejë përfundonte me shqyerjen e ndonjë libri me rëndësi apo djegien e ndonjë teme në të cilën kisha humbur javë të tëra duke hulumtuar. Nganjëherë hidhërimi im arrinte deri në shkallën e marrëzisë dhe vrasjes dhe e shtrëngoja dorën rreth qafës së saj. U qetësua rastësisht dhe më shikoi me një shikim të paqartë, të përzier mes habisë, frikës dhe dëshirës. Sikur unë të bëja një shtypje paksa më të madhe do t'i jepja fund luftës. Lufta mes nesh kalonte jashtë. Kur ne ishim në një bar, ajo befas bërtiti: "I biri i Kajros po më dashuron mua". U ngrita në këmbë e kapa për fyti dhe ajo më kapi mua. Njerëzit na rrethuan nga të gjitha anët. Befas e dëgjova duke qeshur pas shpinës sime. Njëri nga të pranishmit që kishte ardhur të na ndajë më tha: "Më vjen keq nëse kjo është bashkëshortja e jote, ti je i martuar me një lavire". Ky njeri nuk i foli asaj asnjë fjalë. Si duket kjo grua jeton në pamjen e dhunës. I tërë hidhërimi im u kthye në të. Pas pak

shkova tek ajo. Ajo ende po qeshte. I mëshova një shuplakë, kurse ajo m'i vuri thonjtë e saj në fytyrën time. Munda ta çoj në shtëpi vetëm pas një mundi të madh.

Kur dilnim së bashku dëshironte t'i shfaqte dashuri secilit që e shihnte dhe e takonte. U shfaqte dashuri kamarierëve të restoranteve, shoferëve të autobusëve dhe çdo kalimtar i rasti... Disa prej tyre i përgjigjeshin, kurse të tjerët ia kthenin me fjalë ofenduese. Kjo sjellje e saj më bënte të hyja në konflikt me njerëz. Më detyronte ta rrihja dhe më binte mua në mes të rrugës. Sa shumë herë ia kam shtruar vetes pyetjen çka është ajo që më lidh me të? Përse nuk e braktis dhe të shpëtoj prej sherrit të saj? Por, unë e dija se unë nuk kam hile në tërë këtë dhe se patjetër duhet të ndodhë tragjedia. E dija se ajo po më tradhtonte mua. Shtëpisë po i vinte era e tradhtisë. Një herë e gjeta mindilin e një njeriu të huaj. E dija se nuk ishte mindili im. Më tha: "Po nuk është mindili yt. Çka do të bësh"? Një herë gjeta një kuti të cigareve e herën tjetër një stilograf. I thashë: "Ti po më tradhton mua. Ma ktheu: "Supozo se unë po të tradhtoj ty". I bërtita: "Betohem se unë do të vras". Buzëqeshi me ironi dhe më tha: "Ti vetëm po thua kështu. Çka të pengon të më vrasësh tash? Çka po pret? Ndoshta ti po pret ta gjesh ndonjë burrë mbi mua? Edhe atëherë besoj se nuk do të bësh diçka. Do të ulesh mbi krevat dhe do të qash".

"Një mbrëmje të errët të muajit shkurt, temperatura ishte nën dhjetë gradë celsius. Mbrëmja ishte sikur mëngjesi, sikur nata e errët. Die-lli nuk kishte rrezuar për njëzet e dy ditë. I tërë qyteti ishte kthyer në një fushë akulli. Akull kishte në rrugë, në parqe në hyrje të shtëpive. Uji ishte ngrirë në gypat e ujësjellësit. Fryma nga goja e njerëzve dilte sikur të ishte avull. Degët e drunjve të lartë, ishin lakuar nga pesha e borës. Mua gjaku po më vlonte, kurse në kokë kisha temperaturë. Në një natë si kjo ku ndodhin vepra të mëdha. Kjo është nata e llogarisë. Udhëtova prej stacionit deri në shtëpi duke bartur pallton nën sqetull. Trupi im është i nxehtë. Djersët po rridhnin prej ballit tim. Akulli po kërciste nën këpucët e mia e unë po kërkoja të ftohtin. Ku është të ftohtit? E gjeta atë lakuriq të shtrirë mbi krevat. Buzëqeshja e saj e plotë, kurse në fytyrën e saj diçka si pikëllim, në një gjendje gatish-

mërie për të dhënë dhe marrë. Në shikim të parë pashë se zemra ime shikoi me dashuri. Ndjeva një lloj ngrohjeje djallëzore nën mbulesë. Kur e ndiej këtë e di se unë mbisundoj veten. Ku ishte e tërë kjo ngrohtësi në vitet e kaluara? I thashë asaj me një zë të besueshëm, të cilin për pak sa e kisha harruar prej kohës së gjatë që kisha humbur: “A ka qenë dikush me ty”? Mu përgjigj me një zë në të cilin kishte ndikuar zëri im: “Jo nuk ishte askush me mua. Kjo natë e tëra është e jotja. Vetëm e jotja. Unë jam duke të pritur që një kohë të gjatë”.

Ndjeva se ajo është e singertë me mua për herë të parë. Kjo natë është nata e singëritetit dhe e tragjedisë. E nxora thikën prej këllëfit. U ula në skaj të krevatit duke e shikuar atë. Shihja reflektimin e shikimeve në fytyrën e saj. Shikova sytë e saj dhe ajo shikoi në sytë e mi. Shikimet tona u bashkuan dhe u konfrontuan. Sikur ne të ishim dy orbitë në qiell u konfrontuan në një moment fatkeq. Shikimet e mia e larguan fytyrën e saj prej meje. Mirëpo, efekti u paraqit në mesin e trupit të saj. E lëvizti atë djathtas e majtas dhe e ngriti pak mi krevat. Pasi u stabilizua i hodhi krahët e saj lirshëm. Përsëri u kthye të më shikoj. Shikova kraharrin e saj, e shikoi edhe ajo, derisa dy shikimet tona u takuan në të njëjtin vend. Më dukej se ajo nuk kishte më vullnet. Lëvizjet e saj lëviznin sipas dëshirës sime. Hodha një shikim në barkun e saj, pashë se ajo më përcolli mua, dukej sikur një dhembje e lehtë u shfaq në fytyrën e saj. Unë po shikoja ngadalë ashtu shikonte edhe ajo. Unë ngutesha ngutej edhe ajo. Zgjata shikimin tim në dy kofshët e saj të bardha derisa më në fund, shikimi im u zhvendos në depot e sekreteve. Aty ku lind e mira dhe e keqja. Vëreja se fytyra e saj kishte filluar të skuqej dhe vetullat e saj po thyheshin sikur ajo të mos mundej të mbizotëronte në to. Ngrita thikën me ngadalësi dhe ajo përcolli madhësinë me sytë e saj. Bebezat e syrit iu zgjeruan befasisht. Fytyra e saj sikur e përshkoi një dritë e shpejtë sikur ajo të ishte ndriçim i vetëtimës. Vazhdoi të vështrojë madhësinë e thikës që kisha në dorë me një përzierje të habisë, frikës dhe erotizmit. E kapa thikën dhe e putha. Befasi, ajo mbylli sytë, u shtri në krevat duke e ngritur pak mesin e saj. Ofshani thellë dhe më tha: “Të lutem i ëmbli im eja. Unë jam e gatshme tash”. Nuk iu përgjigja thirrjes së saj. Ofshani

edhe një herë me më shumë dhembje. Priti. Qau. Zëri i saj doli i dobët gati sa nuk dëgjohej: “Të lutem i dashuri im”.

“Ja këto janë anijet e mia. Po lundrojnë në drejtim të brigjeve të shkatërrimit, o e dashura ime. U ula mbi të dhe e putha. I vura majën e thikës mu në mes të kraharorit. Ajo i vendosi këmbët e saj rreth shpinës sime. Shtypa thikën ngadalë, ngadalë. I hapi sytë e saj. Çfarë dehje në këta sy? Mua m’u duk më e bukur se çdo send në këtë gjithësi. Më tha me dhembje: “I dashuri im. Kam menduar se nuk do ta bësh një gjë të këtillë asnjëherë. Isha e dëshpëruar në ty”. Shtypa thikën me kraharorin tim derisa ajo u ngul e tëra në kraharorin e saj. Ndjeva se gjaku i saj i ngrohtë shpërtheu nga gjoksi i saj. Fillova ta afroj krahararin e saj me kraharorin tim dhe ajo po bërtiste duke u lutur: “Eja me mua. Eja. Mos më lë mua të shkoj vetëm”.

Ajo më tha: “Të dua” - i besova. I thashë: “Të dua edhe unë” - isha i singertë. Ne jemi një flakë zjarri, buzë shtratit flaka e zjarrit të xhehenemit. Erën e duhanit e nuhati me hundën time, e ajo më tha: “Të dua i dashuri im”. Unë ia kthej: “Të dua e dashura ime”. Bota me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e saj është bashkuar në një pikë të vetme, para dhe pas saj nuk ka asgjë.

- 10 -

Hyra në ujë lakuriq. Ashtu siç më kishte lindur nëna ime. Ndjeva një dridhje posa preka ujin e ftohtë. Dridhja pastaj u kthya në syçeltësi. Lumi nuk ishte përplotë ujë sikur ditëve të vërshimit e as i vogël sikur ditëve të verës. Fika qirinjtë. Mbylla derën e dhomës. Mbylla edhe derën e oborrit duke mos bërë asgjë. Një zjarrëvenie e qëllimshme nuk çon përpara e as nuk çon mbrapa. E lashë të flasë duke mos e lënë ta përfundoj tregimin. Mendova të shkoj dhe të qëndroj pranë varrit të saj. Desha ta gjauij çelësin ku nuk mund ta gjejë më aaskush. Por për një çast ndrova mendimin. Veprime që nuk kanë kuptim, megjithatë duhet kryer. Këmbët më çuan deri në breg dhe pashë shenjat e agimit në lindje. Do ta qetësoj veten me not. Gjërat në dy brigjet ishin gjysëm të qarta, dukeshin dhe zhdukeshin, në mes dritës dhe errësirës.

Lumi ushtonte me zërin e tij të vjetër të zakonshëm, duke lëvizur sikur ai të jetë i qetë. Nuk ka zë përveç ushtimës së lumit si dhe kërcitjes së makinave të ujit që nuk ishin larg. Nisa të notoj në drejtim të bregut të veriut. Vazhdova të notoj të notoj derisa u qetësuan lëvizjet e trupit tim me fuqitë e ujit në një harmoni të qetë. Nuk mendoja kur unë po lëvizja përpara mbi sipërfaqe të ujit mbi pozitën e krahëve të mi në ujë. Lëvizjen e këmbëve, zërin e frymëmarrjes, ushtimën e lumit dhe zërin e makinës që kërcente në breg, nuk kishte zëra tjerë përveç tyre. Vazhdova të notoj, të notoj derisa vendosa të arrij bregun verior. Ky ishte qëllimi. Bregu para meje herë ngritej e herë ulej, Zërat ndëpriteshin në tërësi pastaj bënin zhurmë. Ngadal, ngadal më nuk mund të dëgjoja përveç ushtimën e lumit. Pastaj u bëra sikur unë të isha në një sall të gjerë ku reflektohet jehona e zërit. Bregu ulej dhe ngritej. Ush-tima e lumit zhdukej dhe paraqitej. Para meje po shihja një gjysëm rrethi. Pastaj u bëra në mes verbërisë dhe të pamurit. Isha i vetëdijshëm dhe nga një herë jo. A jam unë fjetur apo zgjuar? A jam unë i gjallë apo i vdekur? Megjithatë isha kapur në një pe të hollë e të dobët: Ndjenja ime ishte se qëllimi im është para meje e jo nën mua. Unë duhet të lëviz përpara e jo nën. Mirëpo, peni u dobësua derisa për pak nuk u këput. Arrita në një pikë ku ndjeva se fuqia e lumit në thellësi po më tërhiqte mua. E pimja shkoj në këmbën dhe në krahun tim. Korridori u zgjërua korridori jehonat dhe ushtimat nxituan dhe u përgjigjen.. Tash, befasi një fuqi nuk e di se prej nga erdhi dhe e ngriti trupin tim mbi sipërfaqe të ujit. Dëgjova ushtimën e lumit dhe kërcimet e makinave në ujë. U ktheva në të majt dhe në të djathtë dhe pashë veten se isha në mes të rrugës, rrugës, në mes veriut dhe jugut. Nuk mund të vazhdoj më tutje, por edhe nuk mund të kthhem. U ktheva në shpinë. Mbeteja i qetë, duke lëvizur krahët dhe këmbët e mia me vështirësi deri në atë masë sa të qëndroja mbi sipërfaqe të ujit. Ndieja se si fuqitë shkatërruese të ujit po më tërhiqnin në fund, kurse valët më shtynin në bregun jugor në një kënd të lakuar. Nuk mund ta mbajë drejtpeshimin për një kohë të gjatë. Herët a vonë, fuqitë e lumit do të më tërheqin në fund të tij. Në këtë gjendje në mes jetës dhe vdekjes pashë një galeri të shpezeve që ishin drejtuar kah veriu. A jemi ne tash

në stinën e dimrit apo të verës? A është ky udhëtim i verës? A është ky udhëtim apo shpërngulje? Ndjeva se unë po i dorëzohesha fuqive shkatërruese të lumit. Ndjeva se këmbët e mia po e tërhiqnin trupin tim në thellësi. Në një moment nuk e di se a zgjati apo u shkurtua ushtima e lumit. Ajo u kthya në një zhurmë të gjarpinjve me zile dhe në të njëjtin moment ndriçoi një dritë e fuqishme, si të ishte shkëndi e vetëtimës. Përsëri mbizotëroi qetësia dhe errësira për një periudhë që nuk e di gjatësinë e saj. Pas saj pashë qiellin duke u afruar dhe larguar. Pashë bregun duke u ulur dhe ngritur. Befasi, ndjeva një dëshirë të madhe për një cigare. Nuk ishte vetëm një dëshirë. Ishte uri, ishte etje. Ajo ishte momenti i zgjimit nga ankthi, ku u qetësua qielli, u qetësua bregu. Dëgjova kërcimen e makines së ujit dhe ndjeva ftohësinë e ujit në trupin tim. Mendja ime atëherë u kthjellua. Marrëdhëniet e mia me lumin u sqaruan. Unë po notoja mbi sipërfaqen e ujit, por unë nuk isha pjesë e tij. Mendova, po të vdisja në atë moment, unë do të vdisja ashtu si kam lindur, pa vullnetin tim. Gjatë tërë jetës sime nuk kam pasur zgjidhje dhe nuk kam vendosur. Unë tash po vendosi. Unë po e zgjedhi jetën. Dua të jetoj, sepse një numër i vogël i njerëzve, dua të mbetem me ta dëshiroj të mbetem me ta të mbetem me ata për një kohë më gjatë të mundur, dhe unë kam disa obligime që më duhet ti kryejë. Nuk më intreson mua nëse jeta ka kuptim apo jo. Nëse nuk mundem të falë do të përpiqem të harroj. Do të jetoj me fuqi dhe me dinakëri. Lëvizja këmbët dhe krahët e mi me vështirësi, derisa i tërë trupi im doli mbi ujë. Dhe me tërë fuqinë që më kishte mbetur bërtita, sikur unë të isha një aktor komik që po bërtiste në teatër: "Ndihmë! Ndihmë!"

- fund -

Përktheu nga arabishtja:
Qemajl Morina

Tayeb Salih - (Sudan)

SEASON OF MIGRATION TO THE NORTH - (6)

- 9 -

The world has turned suddenly upside down. Love? Love does not do this. This is hatred. I feel hatred and seek revenge; my adversary is within and I needs (sic) must confront him. Even so, there is still in my mind a modicum of sense that is aware of the irony of the situation. I begin from where Mustafa Sa'eed had left off. Yet he at least made a choice, while I have chosen nothing". For a while the disk of the sun remained motionless just above the western horizon, then hurriedly disappeared. The armies of darkness, ever encamped near by, bounded in and occupied the world in an instant.

الطيب صالح

موسم الهجرة إلى الشمال (6)

(خلاصة البحث)

العالم فجأة انقلب رأساً على عقب الحب. الحب لا يفعل هذا. انه الحققد. أنا حاقد و طالب ثأر و غريمي في الداخل و لا بد من مواجهته. و مع ذلك ما تزال في عقلي بقبة تدرك سخرية الموقف. انني ابتدئ من حيث انتهى مصطفى سعيد، الا انه على الاقل قد اختار و أنا لم اختر شيئاً. قرص الشمس طل ساكناً فوق القف الغربي زمناً ثم اختفى على عجل و جيوش الظلام المعسكرة ابدأ غير بعيد وثبت في لحظه و اعتلت الدنيا.

RECENSIONE

Dr. Ihsan Sureyya Sirma

SJELLJA E VENDIMIT PËR SHKATËRRIMIN E SHTETIT OSMAN*

Shteti i Osmanlinjve, përkundër gjitha problemeve dhe mynxyrave me të cilat gjatë shekullit 18 ajo ballafaqohej, si dhe kur misionarët dhe agjentët anglez e filluan aktivitetin e tyre, ishte shteti më i madh dhe më i fortë mysliman. Në të njëjtën kohë, ajo përfaqësonte, mbrojtjen dhe përkrahjen e drejtimit të ehli-synetit. Në anën tjetër, Irani përfaqësonte dhe trashëgonte drejtimin e shiizmi-t.

Megenëse shteti i Osmanlinjve ishte më i madh se Irani, atëherë ajo u zgjodh për cak të parë. Ministria Angleze për kolonizim sjelli dekretin në të cilën thuhej se shtetin Osman duhet shkatërruar gradualisht në një periudhë kohore prej një shekulli.

Shkatërrimi i shtetit Osman ishte shkaktari i vërtetë i dërgimit të një numri të madh të misionarëve dhe spiun-

nëve të cilët ishin aftësuar në kryerjen e obligimeve të tyre, anë e mbanë territoreve që ishin nën administratën osmane. Për realizimin e qëllimeve të shtruara nuk kurseheshin as paratë as mjetet tjera të nevojshme.

Misionarët dhe spiunët dhanë të gjitha prej veti për të qenë sa më afër zyrtarëve të lartë shtetëror, që t'i shohin se në ç'mënyrë ata e kalojnë jetën dhe si udhëheqin me punët shtetërore.

Në lidhje me këtë misionari dhe spiuni Hatirati Hempher në librin e tij "Agjentët Anglez nëpër vendet islame", mes tjerash shkruan:

"Në vitin 1871, Ministria Angleze për kolonizim më caktoi përgjegjës për spiunim në Egjipt, Irak, Hixhaz dhe qendrën e Kalifatit Stamboll. Mua më dhanë për detyrë që ta dobësoj forcën e myslimanëve dhe të grumbu-

llojë sa më tepër informata në lidhje me kolonizimin e tyre. Asokohe ma dhanë në shfrytëzim një regjistër-drejtues në të cilën gjendeshin emrat e të gjithë ministrave, komandantëve dhe kryekomandantëve, zyrtarëve të lartë, ulemave dhe të kryeparëve të fiseve të cilët në atë kohë kryenin detyra të larta dhe gjendeshin në pozita të rëndësishme anë e mbanë shtetit Osman."

Këta misionar dhe spiun të gjitha situatat dhe ngjarjet i kthenin për interesa të veta, natyrisht se këto i arrinin duke fut përçarje në mesin e myslimanëve dhe duke i përkrah të gjithë ata që me çfarëdo mënyre ishin opozitë e shtetit Osman. Hemherin që e cekëm më lartë në kujtimet e veta shkruan edhe këtë:

"Kryetari i bashkësisë së misionarëve në Londër kishte deklaruar: për tu na mundësuar që ne anglezët të jetojmë në harmoni dhe prosperitet, gjithsesi duhet që në mesin e myslimanëve na ta mbjellim farën e ngatërresave dhe të hipokrizisë. Po ashtu, neve na duhet që sa më tepër ta vejmë në theks dallimin e cila ekziston në mesin e myslimanëve. Do të fusim ngatërresa në të gjitha vendet e shtetit osman, në atë mënyrë që ajo të shkatërrohet. Nëse ne, këtë nuk mund ta bëjmë, atëherë si popull i vogël që jemi si do të arrijmë të jetojmë në harmoni dhe prosperitet. Për këtë arsye z. Hempher mos u kthe prapa, për deri sa nuk arrin që botës islame dhe myslimanëve tua futsh flakën e ngatërresave dhe

të çrregullimeve tjera si bie fjala t'i sjellësh ata në një gjendje ku dominojnë fraksionet e mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve. Shteti osman dhe Irani po kalojnë nëpër fazën e dekadencës, dhe çdo ditë e më tepër janë duke u dobësuar. Prandaj për aq sa ke mundësi, përpiku që popullin e thjeshtë ta orienton kundër pushtetit dhe kundër atyre që u sillen rreth e rrotull. Dhe assesi mos harro që të gjitha revolucionet dhe kryengritjet në historinë njerëzore kanë lind si pasojë e mos kënaqësisë së popullatës së rëndomtë, ndaj atyre që sundojnë me ta. Kudo që të gjendesh fol, për ngatërresat dhe fraksionet. Dhe drejtoje njërin kundër tjetrit!"

Dallimi kryesor në mes myslimanëve qëndron në relacionin syni dhe shii, ndërsa misionarët duke i shfrytëzuar këto dallime bënë që ato dyja të kthehen njëra kundër tjetrës. (Osmanlinjtë kundër Iranit dhe anasjelltas), duke e dëshiruar konfliktin e drejtë për drejtë të tyre mes veti. Kryetari i bashkësisë së misionarëve dhe të spiunëve në lidhje me këtë theksonte:

"Nëse ti arrin të inicosh që në botën islame të filloi grindja dhe konflikti në mes synive dhe shiive, do t'i bësh nderin dhe respektin më të madh Britanisë së Madhe", (këto fjalë i drejtohen spiunit dhe misionarit Hempher që e cekëm më lartë, SH.V).

Në vijim sipas fjalëve të Hempherit do të shohim se sa rëndësi të madhe i

kanë kushtuar konfliktit në mes të synive dhe shiive:

“Një ditë në një mbledhje të kleri-këve, theksova sikur të kishin pakës mend myslimanët ishte dashtë që këto ndasi në mes synive dhe shiive t’ia lënë së kaluarës, ndërsa të fillojnë të punojnë në drejtim të bashkimit të tyre. Ndërsa kryetari duke mu drejtuarit me këto fjalë më ndërpreu shumë ash-për: “detyra juaj është t’i fryni zjarrit të përçarjes e jo tu tregosh atyre si të bashkohen.”

Divergjencat dhe dallimet në mesin e myslimanëve u renditën në këtë mënyrë”

1. Ndasitë fisnore;
2. Lokalizimet, dallimet rajonale;
3. Dallimet fetare;
4. Nacionalizmi.

Çdo gjë flijohej për realizimin e interesave Angleze dhe të krishtere

Si thamë edhe më lartë, se qëllimet themelore të aktiviteteve spiuno-misionare ishin realizimi i interesave Angleze dhe të krishtere në tërë botën. Sipas tyre, këto qëllime do të arriheshin vetëm me një mënyrë-shkatërrimin e islamit.

Në mbledhjen e Ministrisë për kolonizim në të cilën morën pjesë ministri e mëdhenj dhe klerikët më të njohur të Londrës dhe Anglisë, njëri prej folësve, duke i përsëritur vendimet e marra deklaroi: “Bëhuni këmbëngulës dhe të durueshëm në zbatimin

e detyrave të juaja. Veç tre shekuj krishterimi gjendet në një kaos dhe çrregullim total. Dëboni jo besimtarët nga vendet ku ka jetuar Isusi (Isa a.s. Sh.V.). Ne medoemos duhet të bëjmë çmos dhe t’i përdorim të gjitha mjetet në mënyrë që të arrihen qëllimet e realizimeve tona në mesin e myslimanëve, e veçanërisht nëpër qendrat e mëdha. Për realizimin dhe ngadhënjimin e fitores mos ngurroni të shfrytëzoni të gjitha potencialet e juaja, flijohuni për këtë. Për këtë çështje ne duhet të jemi të gatshëm. Ndoshta këto qëllime tona do të zgjasin me shekuj, por ajo nuk paraqet kurrfarë dëmi. Prindërit punojnë për fëmijët e tyre.”

Organizohen konferenca për çështjen e kolonizimit

Aktivitetet e misionarëve dirigjoheshin dhe udhëhiqeshin nga qendrat më të larta kishtarë të përmasave botërore. Të gjitha qëllimet e tyre bashkoheshin në një pikë-të shkatërrohet shteti i fundit dhe më i madhi mysliman, që ne përsëri ta marrim Stambollin në duart tona. Në njërin prej këtyre konferencave që ishin organizuar për këtë qëllim, Hempheri në vijim shkruante:

“Me një rast tjetër në Ministrinë për kolonizim u organizua një konferencë në të cilën murën pjesë përfaqësuesit e lartë të Rusisë, Britanisë së Madhe dhe Francës. Në konferencë ishin të pranishëm liderët fetar dhe njerëz nga udhëheqësit e lartë kishtar,

si dhe personalitete tjera të njohura dhe të rëndësishme. Në këtë konferencë po ashtu edhe unë isha prezent, por ishte pasojë e një kënaqësie dhe argëtimi të rastësishëm. Tema për të cilën u diskutua në këtë konferencë ishte: Kolonizimi i vendeve islamike dhe pengesat që na paraqiten në këtë rrugë!”

Në fund të konferencës u arrit ky konkludim:

“Sidoqoftë, dhe çfarëdo që kërkohet, ne duhet gjithsesi që forcën e myslimanëve ta shkatërrojmë, ndërsa metoda më e lehtë për këtë është që të futen grindjet dhe konfliktet fraksioniste të cilat duhet t’i prodhojmë dhe t’i përkrahim. Për ta dobësuar fenë në mesin e myslimanëve, duhet shfrytëzohen të gjitha mjetet. Kur tua nxjerrim fenë, atëherë do t’i bëjmë të krishterë në mënyrë të njëjtë siç kemi veprua në Andaluzi (Spanjë).“

Me këtë qëndrim armiqësor ndaj myslimanëve dhe islamit, krishterët me shekuj qëndruan galiç dhe të mallëngjyer për hakmarrje. Hempheri në librin e tij tejet haptazi dhe qartë shkruante: “Tani myslimanët gjenden në krizë, sepse janë duke kaluar nëpër fazën e dekadencës. Dhe kjo është koha më e përshtatshme që të hakmerremi.”

Politika kolonialiste Angleze përqendrohej në dy paragraf:

1. Në vendet të cilat janë akoma koloni Angleze, apo në ato vende ku ende gjenden gjurmët e fuqishme të

kolonializmit Anglez, duhet të zbatohet kultura politike Angleze dhe të zhvillohen ndjenjat e përkatësinë së kurorës.

2. Ato vende të cilat nuk gjenden nën koloninë Angleze duhet përgatitur planet dhe programet për kolonizimin e tyre.

Vegla e kolonializmit-imoraliteti

Imoraliteti ishte njëra nga armët më të forta të cilën bota imperialiste përdimë e shfrytëzoi për të sjellë botën myslimane në gjendje koloniale. Çdo gjë u ndërmor që imoraliteti dhe e keqja të shpërndahen në të gjitha anët. Për këtë çështje u shfrytëzuan femrat, të cilave u dhanë petkun “e një veshje speciale” në mënyrë që sa më shumë t’ua tërheqin vëmendjen meshkujve për punë të ndyta dhe imorale. Ministria e kolonizimit Anglez misionarët dhe spiunët e vet, nëse paraqitet nevoja i urdhëronte, të bëhen edhe homoseksual.

Shtetet vasale marionete

Në këtë mënyrë këto lloje të shteteve ishin ndihmëtare më të mëdha të imperializmit anglez. Në këto shtete kultura Angleze përhapej nëpërmes disa funksionarëve shtetëror të cilët duke i ndihmuar projekteve imperialiste i realizuan disa interesa personale të niveleve të ulëta me çka arritën përfitime materiale. Nëse një vend bie

nën ndikimin kulturor të një vendi tjetër, atëherë ajo i humb veçoritë dhe identitetin kulturor të sajën. Shteti i takon atij kultura e të cilit është superiore, dhe dominuese. Për këtë çështje Anglia ishte e vetëdijshme dhe mu për këtë ajo të gjitha aktivitetet e saja i realizoi në këtë rrugë me këtë njohuri. Në lidhje me këtë Hempheri shkruante: “Nëpër disa shtete në shikim të parë, duket se qeveria është në duart e njerëzve vendorë. Por, dhe në të vërtetë, ajo që sundon në ato vende është politika koloniale e cila i realizon qëllimet e veta. Shumë pak mbetej që vendet myslimane të këtij lloji të bëhen plotësisht të lidhura dhe të varura nga Anglia.” Në vende të kështilla myslimane misionarët i shfrytëzojnë dobësitë e myslimanëve dhe vazhdimisht i mbajnë me dallime fraksioniste, që në këtë mënyrë vazhdimisht myslimanët t’i mbajnë të përçarë. Kur këto përçarje dhe ndasi arrin në majë të saj atëherë shteti veç e nënshkruan dorëzimin me çka edhe shndërrohet në vend kolonialist.

Arma që i stoponte misionarët

Nuk ka dyshim se këta misionar-agjent gjatë veprimtarisë së tyre janë ballafaquar me pengesa dhe vështirësi të shumta. Ato probleme dhe pengesa të cilat ata i kanë parapa gjatë aktivitetit të tyre Hempheri kështu i rendit:

1) Besnikëria dhe zgjuarsia e myslimanit të rëndomtë ndaj fesë, për

dallim nga njerëzit që bartin funksione shtetërore. Është e mundur të thuhet për një mysliman mesatar që në çështje të akaidit, postulateve fetare pa kurrfarë probleme dhe mundime mund të garojë me klerikun e krishterë. Ata kur nuk do ta lëshojnë fenë e tyre. Kjo është njëra prej armëve drejtuar kundër nesh.

2) Sikurse që e kemi vërejtë gjatë historisë, islami është fe e lirisë dhe barazisë. Mu për këtë myslimani i vërtet kur nuk mund ta pranojë robërinë. Grupit të tillë të myslimanëve në asnjë mënyrë nuk kam sukses që tua imponoj teorinë se mënyra e jetës islame është retrograde, se nuk duhet të ju kthehemi principeve të prapambetura, që rrethanat kanë ndryshuar, që e kaluara të harrohej, dhe se duhet t’i përshatemi situatave dhe kërkesave të reja kohore.

Rrugët e përvetësimit të myslimanëve që të punojnë për interesat Angleze

Anglia nuk i shfrytëzonte vetëm misionarët e vetë për realizimin e qëllimeve të tyre, por edhe nga mesi i njerëzve vendas të cilëve këta misionarë u kishin premtuar forcime materiale si dhe pozita të mira në shoqëri. Këta misionarë duke jetuar në mesin e myslimanëve, dhe duke u sjellë si mysliman, kanë arrit që të zbulojnë asi njerëz të cilët gradualisht i kanë futë

në radhët e veta që të punojnë për interesa Angleze.

Ja se si e përshkruan Hempheri taktikën e tij në këtë shikim: “me bashkëpunëtorët e mi nuk bisedoja gjatë. Kisha frikë se mos po i zbulojnë qëllimet e mija të vërteta, sepse unë veç kisha depërtuar në mesin e myslimanëve dhe dukesha sikurse ata.”

Në çfarë mënyra ata arritën që t’i përvetësojnë myslimanët për të punuar në anën e tyre do të sjellim në vazhdimin e këtij punimi.

Rekrutimi i personave të caktuar

Misionarët Anglez për këto dhe çështje të ngjashme ishin shumë të kujdesshëm dhe asnjëherë haptazi nuk i parashtronin propozimet e tyre. Ata kërkonin njerëz të cilët i pranonin teoritë e tyre, ndërsa teoritë tjera i hidhnin poshtë, njerëz të cilët i kundërshtonin idetë dhe mendimet e dijetarëve (ulemave) islam. Me këtë qëllim misionarët veçanërisht inkorporoheshin nëpër shkollat fetare, medrese, teqe, dhe atje kërkonin njerëz të përshtatshëm për këtë lloj të veprimtarisë. Me mysliman të thjeshtë të rrugës nuk merreshin sepse, ata nuk ju interesonin. Ata “depërtonin” nëpër vende ku mbaheshin tubimet dhe konferencat fetare, dhe ku zhvilloheshin debate për çështjet fetare dhe mu nga ato vende bënin zgjedhjen e personave të përshtatshëm për punët e tyre. Pas caktimit të personave të përshtatshëm,

misionarët me çdo kusht iu afroheshin atyre njerëzve, lidhnin shoqëri me ta dhe i përvetësonin për qëllimet dhe interesat e veta.

Më poshtë do të paraqesim rrëfimet e Hempherit-spiunit Anglez, për një person të cilin kishte arrit ta përvetësojë. Do ta paraqesim tekstualisht ashtu si vet Hempheri e ka shkruar me dorën e tij. Ai kështu shprehet:

“Pasi që u njoftova me Muhamedin dhe krijova shoqëri të ngushtë me te, kuptova se ai ishte një tip ideal për të vepruar në realizimin e interesave Angleze nëpër shtetet myslimane. Muhamedi ishte mendjemadh, e donte shumë pozitën dhe respektin, kishte një qëndrim tejet armiqësor ndaj dijetarëve (ulemave) islam, ndërsa dashuria ndaj vet vetes ishte aq e madhe sa që i nënçmonte dhe i zhvlerësonte Hulefai rashidinët. Sipas tij dobësia jonë qëndron në atë se ne nuk po i dhamë përparësi burimeve tjera përveç atyre të Kuranit dhe hadithit. Hempheri vazhdon duke theksuar kështu: “Shejh Muhamedi e nënçmonte Ebu Hanifen, duke mos ia pranuar madhësinë e tij dhe duke mos e pranuar si figurë të rëndësishme të fesë islame. Ai thoshte: “Unë shumë më mirë dhe shumë më tepër di se Ebu Hanifja. Ai gjithashtu shprehej edhe për koleksionet e haditheve të Buhariut për të cilat thoshte se gjysma e tyre janë të pa vlefshme dhe pa përmbajtje.”

Spiuni dhe misionari Hempher do t’i shfrytëzonte këto dobësi të Muhamedit që tërësisht ta kthej në anën e tij

duke e rreshtuar pranë veti. Muhamedi ishte nën ndikim total të tij. “Dhe me të vërtetë unë duke e shfrytëzuar egon dhe mendjemadhësinë e Muhamedit fillova, gradualisht ta kthej në anën time dhe t’ia “mbjelli” (shiti) idetë e mija. Ashtu që arrita deri te një shkallë e madhe e afrisë me te i cili gjeti mbështetje të madhe te unë. Pastaj i drejtohem njëri tjetrit me ‘ti’ dhe ishim vazhdimisht bashkë, dhe të pa ndashëm’, shkruan Hempheri.

Muhamedi bëhet viktimë e Anglezëve, ndërkaq që për këtë as që ishte i vetëdijshëm

Muhamedi i gJORë as që kishte lidhje për këto lojërë të tmerrshme Angleze. Hempherin ai e pranoi si një mysliman të singertë, dhe si i tillë sillej ndaj tij. Atij as që i kishte shkuar mendja se Anglezët në Basra në këtë mënyrë do ta “gjatnin”. Dhe në fund ra në kurthin e Hempherit.

Të shohim më tutje çka tregon Hempheri: “Nën rrezet e dritave të reja bashkë me Muhamedin vendosëm që të merremi me tefsirin e Kuranit. Duke u marrë me këtë çështje, ne plotësisht i lamë pas dore mendimet e sahabëve; dijetarëve të mëdhenj të pranuar dhe të njohur në komentimet e Kuranit, dhe ne të dy e bëmë komentimin e Kuranit. Unë e lexoja Kuranin dhe jepja komentimet dhe shpjegimet e përmbajtjes. Qëllimi im ishte ky: “që në çdo mënyrë dhe me çdo kusht

të mundohem ta zë në “grackën” e Ministrisë Angleze për kolonizim.”

Zhvillimi i ambicieve udhëheqëse

Njëra prej taktikave kryesore të cilën e shfrytëzonin misionarët Anglez ishte premtimi që këtyre personave tua siguronin pozitën dhe rolin që e dëshironin. Në gjurmët e realizimeve të interesave të tyre është shumë e natyrshme që ata ndërmorën çdo gjë në mënyrë që ata persona t’i fusin nëpër pozita të larta shtetërore, e deri te fronet. Me këto pretendime Hempheri e bindi Muhamedin se do të bëhet lider i të gjithë myslimanëve. Sërish i kthehem tekstit të kujtimeve të Hempherit: “Që nga ai moment qëllimi im u bë që Muhamedi të “bëhet” lider dhe udhëheqës i tërë botës islame. Atij ia besova rolin e themelimit dhe udhëheqësit të një drejtimi (rruge) të re të tretë, diku në mes të ehli-synetit dhe shiizmit. Diçka morëm prej shiizmit dhe këtë rrugë të re ja paraqitëm Muhamedit i cili duhej të bëhet përfaqësues dhe komandant që do tu printe myslimanëve. Por, para realizimit të këtij qëllimi mua mu dashke që kokën e tij ta mbushi me ide dhe mendime kontroverse, që pastaj të pranohet dhe të veprohet në mënyrë të verbët. Prandaj në vend të ideve dhe mendimeve të lira, si dhe të shqyrtimeve dhe problemeve fetare, bëra që të zhvillohen ambiciet për lider, dëshira për pozitë madhështi dhe egoizëm.

Rrezikimi i themeleve të fesë

Pas një shoqërimi të gjatë, dhe pasi u bë shumë i afërt me Muhamedin, Hempheri filloi që te ai të krijojë dyshime për besimin e tij të deritanishëm në themelet islame. Është shumë interesante se atë pjesë të aktivitetit të tij nga spiuni e filloi me problemin institucional të xhihadit. Në lidhje me këtë misionari Hempher shkruan:

“Ja se çka i thashë një ditë Muhamedit: ‘A është e vërtetë se, xhihadi është obligim/vaxhib?’ ‘Si nuk është, kur Allahu thotë: ‘Allahu urdhëron të luftohen ata që nuk besojnë’, ishte përgjigja e tij. Atëherë unë i thash: ‘Allahu urdhëron të luftohen pabesimtarët dhe mynafikët. Nëse lufta është obligim/vaxhib që të luftohen pa besimtarët dhe mynafikët, përse Muhamedi a.s. nuk luftoi kundër tyre.’ Ai u përgjigj: ‘Xhihadi nuk është luftë vetëm në fushë beteja. Muhamedi, a.s. luftoi kundër tyre edhe me vepra edhe me fjalë.’

Pastaj në vazhdim unë i thash: ‘Atëherë xhihadi me fjalë dhe vepra qenka obligim/vaxhib.’ Ai mu përgjigj: ‘Jo, nuk është ashtu, sepse i Dërguari i Allahut edhe në fushëbeteja ka luftuar kundër tyre.’ Përgjigja ime ishte: ‘I Dërguari i Allahut ka luftuar kundër pa besimtarëve, por, ajo ka qenë luftë për tu mbrojtur. Sepse pa besimtarët donin ta vritnin. Me atë rast Muhamedi e tundi kokën sikur donte të pajtohej me mendimin tim, dhe unë

atë e kuptova që po e ndajmë mendimin e njëjtë.”

Duke vazhduar në realizimin e qëllimeve të veta Hempheri do ta marrë pëlqimin e Muhamedit për lejimin e martesave të përkohshme (muta). Por, as këtu nuk do të ndalet, dhe pas një kohe do ta martoj me një grua në bazë të këtij lloji bashkëshortor.

Misionarët i shfrytëzojnë gratë dhe alkoolin

Myslimanët të cilët njëherë u rekrutuan për interesa të misionarëve dhe që iu bënë besnik atyre, nuk mundën më të largohen nga ata. Hempheri duke na shpjeguar se si kishte arrit të krijojë një lidhje bashkëshortore të përkohshme (mut’a) në mes Muhamedit dhe një femre, thua se i lexonte lidhjet e tyre me misionarë.

“Mendoj se kjo ishte rasti më i mirë që nga koha kur e pranova këtë mision. Vendosa ta martoja sipas principeve të martesës së përkohshme (mut’a). Qëllimi im ishte që ta largojë nga përkatësia e tij e drejtimit sunni në Basra të cilët ishin kundërshtar të flaktë të martesave të tilla. I garantova që këtë punë do ta bëjë në fshehtësinë më të madhe, dhe femrës me të cilën do ta martoja nuk do ti tregojë emrin e tij. Pasi që u pajtuam për këtë çështje, unë shkova në banesën e një prostitute e cila ishte e angazhuar nga ana e ministrisë Angleze për Kolonizim që të rinjtë mysliman t’i mashtroj dhe t’i tërheq në punë të pamoralshme. Ajo

ishte në Basra, pra tregtonte me trupin e vet. Pasi u morëm vesh, vendosa që ajo ta bart emrin Safia dhe vendosëm që Muhamedin ta sjellim në banesën e saj.”

“Saktësisht mu në kohën që u morëm vesh, unë e sjella Muhamedin në banesën e Safisë. I martova për një javë me një sasi të vogël të arit në shenjë mehrit. Për një kohë të shkurtë e përgatitëm Muhamedin, unë nga ana e jashtme ndërsa Safia nga ajo e jashtme. Safia nuk ngurronte të përdorë çdo lloj namatisje, deri tek edhe punët më të turpshme vetëm për ta përvetësuar.”

“Tri ditë pas martesës shkova në banesën e tij. Këtë herë tema e bisedës tonë ishte ndalimi i përdorimit të pijeve alkoolike. Duke i shqyrtuar ajetet dhe hadithet që flasin në lidhje me to, unë i thash: “Nëse Muavija, Jezidi, Emevitët dhe Abasidët, e kanë konsumuar alkoolin, ndërkaq këta të mëdhenjtë nuk e kanë lëshuar fenë, atëherë, a vetëm ty të ndalohet pirja e alkoolit? Nuk ka dyshim se ata e kanë njohur më mirë se unë dhe ti Librin e Zotit dhe praktikën e të Dërguarit të Allahut. Ata në bazë të Librit të Zotit dhe të praktikës të Dërguarit të Allahut kanë pru vendim që alkooli nuk është i ndaluar por mekruh (qortim). Aq më tepër, në librat e Ehlul-kitabeve, të Hebrenjve dhe të Krishterëve, lejohet konsumimi i alkoolit, si dhe këto fe janë nga Zoti, por edhe islami i pranon pejgamberët e tyre. Si mund të jetë ashtu, që në disa nga ato

religjione të lejohet alkooli, ndërsa te të tjerat të ndalohet? Apo ndoshta këto fe ishin plotësisht në rrugë të gabuar për derisa nuk zbriti shpallja e një transmetimi të cilën e posedojmë... **Pra a po i jepni fund (alkoolit dhe bixhozit)-116:91.** Edhe hazreti Omeri pinte. Sikur të ishte e ndaluar atëherë Pejgamberi a.s. do ta ndëshkonte Omerin (haddi shurb), ndërkaq për atë pse nuk e ka ndëshkua është dëshmi që alkooli nuk është i ndaluar.” Pasi që më dëgjojë me vëmendje Muhamedi tha: “Alkooli nuk është i ndaluar por prodhimi i saj-të dehurit. Ajo çka nuk të deh nuk është e ndaluar. Allahu, xh.sh., thotë: **Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiçësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t’ju largojë nga namazi-116:91.**” Sikur alkooli të mos ngacmonte të dehurit ne nuk do të kishim kesi rezultati. Alkooli ngacmon gjendje të tillë dhe për atë është e ndaluar.” Kur Hempheri vërejti se në këtë mënyrë nuk mund ta lëviz bindjen e tij, atëherë e ndërroi taktikën.

“Duke u ndërlidh me alkoolin në mes tjerash Safisë i thashë: Kur shejh Muhamedi vjen te ti, detyra jote është që ta emocionosh aq shumë sa që ai ta humbi kontrollin, dhe që në atë gjendje atij t’i ofrosh pirjen e alkoolit të cilën ai në ato momente nuk do mund ta refuzoj.” Të nesërmen, kur e takova Safinë më tha se i kishte dhënë të pi alkool, dhe se aq shumë ishte dehur, sa që ashtu i dehur ka dalë në rrugë

duke i irrituar dhe skandalizuar kalimtarët nëpër rrugë. Në fund mund të them se unë dhe Safia, aq shumë patëm ndikim te Muhamedi dhe sjelljet e tija, sa që mu kujtuan fjalët e ministrit të Ministrisë për kolonizim, i cili me një rast më pat thënë: “Spanjën nga pa besimtarët e kemi kthye prapa me ndihmën e alkoolit dhe të ngatërresave. Dhe me po këto dy forca do t’i marrim edhe vendet e tjera.”

Në episodin e lartë e pamë se ç’farë roli kanë luajtur femrat në bashkësinë misionare angleze. Hempheri në lidhje me këtë në një vend tjetër të kujtimeve të tija shkruan edhe këtë: “Në këtë punë të rëndësishme Safia më ndihmoi shumë. Ajo aq shumë ishte tërheqëse dhe aq shumë e preokuponte Muhamedin sa që vazhdimisht e shtynte martesën e tyre të përkohshme (mut’a). Shkurt, ajo i posedonte të gjitha mendimet dhe përkujdesjet e tij.”

Ekzaltimi politik

Misionarët anglez në çdo moment i lavdëronin të rekrutuarit mysliman veçanërisht duke theksuar se ata janë njerëz që vështirë mund të gjenden. Gjithashtu, dhe në vazhdimësi theksonin se ardhmëria dhe analizat pa dyshim do të jenë në duart e tyre, dhe se populli dhe punët do të udhëhiqen nga ata. Meritat për këto çështje i takojnë kualitetit dhe karakteristikave të tyre. Hempheri i fliste Muhamedit se si të gjitha punët politike dhe fetare presin zgjidhje nga ai, dhe mos t’i humbi

shpresat se ajo ditë do të vijë. Kur njerëzit e tillë bien në këto faza atëherë, duke u shfrytëzuar me gënjeshtër, që kanë të bëjnë me ëndrra dhe ëndërrime, mund t’i kthejnë në anët dhe kahet e dëshiruara. Njërin prej këtyre “ëndrrave” të kurdisura me përplot gënjeshtër Hempheri në kujtimet e veta kështu e tregon:

“Mbrëmë kam ëndërruar Muhamedin a.s. të ulur në një çursie, ndërsa për rreth tij ishin ulur dijetar të cilët unë nuk i njohja. Sakaq arrite edhe ti aty. Fytyrën tënde e përshkonte një dritë. Muhamedi a.s. në shenjë respekti ndaj teje u ngrit në këmbë, tu afrua pranë dhe ta puthi dorën, dhe pastaj tha: ‘O adashi im! Ti je pasardhësi im që do të vijë pas meje dhe do të më pasojë në punët e shtetit dhe të fesë.’ Atëherë ti vazhdove duke thënë: ‘O i dërguari i Allahut! Unë, frikohem njerëzve tua zbuloi diturinë që e kamë.’ I dërguari i Allahut në këtë u përgjigj: ‘Mos u friko! Ti je më i mirë se ata.’ Muhamedi shumë u gëzua kur ia transmetova këtë ëndërr time të rrejshme, pas kësaj sa here që vinte te unë më pyeste a thua kam ëndërruar edhe diç tjetër.”

Myslimanët e rekrutuar i mbanin sa më larg dijetarëve

Misionarët spiun, në mënyra të ndryshme dhe aq sa kishin mundësi, të rekrutuarit mysliman i mbanin sa më larg rrethit dhe shoqërisë me dijetarë, ndërsa sa më shumë pranë veti në

mënyrë që t'i kenë vazhdimisht nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e vetë, që këta të mjerë mos të bien nën sprovat e pendimit.

Hempheri në lidhje me këtë në kujtimet e tija shkruan: “Dhe, me të vërtetë nuk dëshiroja që ai (lexo Muhamedi, SH.V.) të kontaktoj apo të shihej me dijetarët e ehli-synetit dhe të komunikoj me ata, sepse çdoherë paraqitej rreziku që me ndihmën e logjikës dhe gjykimeve të forta të tyre, sërish të kaloj në anën e tyre dhe të bie nën ndikimin e tyre. Për këtë arsye bëja përpjekje që vazhdimisht ta mbaja larg nga këta njerëz të ditur.”

Përgatiti dhe përshtati:

Shevki Sh. Voca

P.S. Ihsan Sureyya Sirma është historian dhe shkrimtar turk, i lindur në vitin 1944 në Pervar. Mësimet e mesme i kryen në Sirta, ndërsa në vitin 1966, diplomon në fakultetin teologjik të Unive-

rsitetit të Ankarasë. Tre vjet më vonë vazhdon studimet shkencore në Francë, pastaj në vitin 1969 shkon në Tunizi. Në vitin 1973 kthehet në Francë ku doktoron në fushën e historisë Islame. Që nga viti 1989, është profesor i rregullt në Fakultetin e shkencave islame ku punon si ligjërues në katedrën e Historisë islame.

Profesor Ihsani është autor i shumë veprave prej të cilëve ne me këtë rast do t'i cekim vetëm disa prej tyre:

“Roli i kryengritjeve në Jemen për shkatërrimin e Shtetit Osman”; “Periudha para islame në Meke dhe Muhamedi a.s.”; “Misionarët Anglez-agent të kolonializmit” (ky është titulli origjinal i librit nga i cili ne e kemi shkoqitur materialin e sipërm); “Periudha e davetit në Medine dhe xhihadi”; “Çështja e hebrenjve në kohën e Muhamedit a.s.”; “Abdullah-imi II dhe politika e bashkimit të botës myslimane.” Etj.

* Pjesë e shkoqitur nga libri i autorit Ihsan Sureyya Sirma: “Misionarët dhe Masonët në Perandorinë Osmane”, faqe 83-100. Sarajevë 2006. Këtu për hir të lexuesve më duhet të shtoj se gjatë përkthimit të këtij teksti nga gjuha boshnjake, më është dashur të bëj ca ndërhyrje dhe krahasime prej versionit origjinal të ri botimit të 12 të librit në turqishte botuar në vitin 1993, faqe 76-82. Sepse siç do të shohim më poshtë libri nuk e mban titullin origjinal të tij.

PËRMBAJTJA

Qemajl Morina Mehmet Akif Ersoji në faqet e revistës “Err-rrisale” të Kajros.....	5
Nexhat Ibrahim Imam el-Esh’ariu	15
Orhan Bislimaj Ndalohet përjashtimi “inshallah” në besim	43
Tahir efendi Boshnjaku - Gjakova Hydâ Rabbem - “Perëndia është Zoti im”	61
Qemajl Morina Glosari çifut - (5)	69
Mr. Sadik Mehmeti Vështrim tri vakëfnameve origjinale (1608) të Mehmed pashë Kaçanik(li)ut	91
Mr. Samir B. Ahmeti Osmanlinjtë dhe metodat e tyre rreth përhapjes së fesë islame në Kosovë.....	117
Nehat Krasniqi Vrojtime të reja mbi jetën dhe veprën letrare të Nezim Frakullës.	135
Mirnes Kovaç Islami përballë Islamizmit: Vëllezërit myslimanë.....	151
Muhamed Abdullah el-Shebani Problemi ekonomik dhe trajtimi i tij nga këndvështrimi islam	175
Emine A. Vezaj Të shkruash historinë me aversion.....	207
Hajrudin S. Muja Isabela.....	215
Tajib Salih Koha e shpërnguljes në veri - (6)	251
Dr. Ihsan Sureyya Sirma Sjellja e vendimit për shkatërrimin e shtetit osman	277
Përmbajtja.....	289